

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
INSTITUTI I STUDIMEVE EVROPIANE**

**TRANZICIONI POLITIK DHE ROLI I TIJ NË
MARRËDHËNIET E SHQIPËRISË ME BASHKIMIN
EVROPIAN**

**Kandidati:
MA. Elda ZOTAJ**

**Udhëheqës Shkencor:
Prof. Asoc. Dr. Eva TAFILI (Hyskaj)**

SHKURT 2014



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
INSTITUTI I STUDIMEVE EVROPIANE**



Disertacion i paraqitur nga:

Elda ZOTAJ

Në kërkim të gradës shkencore:

DOKTOR

Në

“Studime Evropiane dhe Integrim Evropian”

**TRANZICIONI POLITIK DHE ROLI I TIJ NË
MARRËDHËNIET E SHQIPËRISË ME BASHKIMIN
EVROPIAN**

Specialiteti: Diplomaci dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare

Udhëheqës Shkencor:

Prof. Asoc. Dr. Eva Tafili (Hyskaj)

Mbrohet më, dt. /2014

1. Kryetar
2. Anëtar (oponent)
3. Anëtar (oponent)
4. Anëtar
5. Anëtar

TIRANË, Shkurt 2014

Falenderime:

Ndonëse nuk mund t'i përmend të gjithë, në radhë të parë dëshiroj të falenderoj dhe t'i shpreh mirënjohjen time të veçantë udhëheqëses shkencore Prof. Asoc. Dr. Eva Tafili (Hyskaj), për ndihmën e pakursyer në realizimin e kësaj sipërmarrjeje kaq të rëndësishme për mua. Inkurajimet e vazhdueshme, këshillat, orientimet, sugjerimet dhe vërejtjet e saj më kanë ndihmuar që të arrija deri këtu. Pa ndihmën e saj të singertë dhe të vazhdueshme, ky punim nuk do të ishte realizuar në formën që ka sot. I detyrohem shumë për përkrahjen dhe përkushtimin e jazhtëzakonshëm që ka treguar ndaj meje.

Dëshiroj të falenderoj të gjithë ata miq, kolegë e punonjës të institucioneve të ndryshme, të cilët nuk më kanë kursyer materialet, mendimet, sugjerimet dhe vërejtjet e tyre.

Një falenderim i veçantë i shkon mikeshës time Dr. Bavjola Shatro, e cila ka bërë të mundur redaktimin letrar të këtij punimi.

Së fundi, dëshiroj t'iu shpreh mirënjohjen time të thellë prindërve, bashkëshortit dhe vajzave të mija të dashura, për mbështetjen, kurajon, për lehtësitë e mëdha që më ofruan, si edhe që më krijuan të gjitha mundësitë për ta realizuar këtë projekt.

PASQYRA E LËNDËS

	<i>faqe</i>
PARATHËNIE	8
HYRJE	12
METODOLOGJIA	16
KREU I PARË	17
TOTALITARIZMI, DEMOKRACIA DHE TRANZICIONI SI PROCES I NDËRMJETËM	17
1.1 Totalitarizmi, përcaktimi si koncept	17
1.1.1 Totalitarizmi si regjim.....	19
1.1.2. Karakteristikat dhe tiparet kryesore të regjimeve totalitare; tipi komunist.....	22
1.1.3 Pasojat e totalitarizmit.....	34
1.2 Demokraci, përcaktimi si koncept	36
1.2.1 Demokracia si regjim, Demokracia Liberale	39
1.2.2 Karakteristikat dhe tiparet kryesore të regjimeve demokratike	41
1.3 Tranzicioni dhe tranzitologjia, përcaktime teorike	46
1.3.1 Tranzicioni i vendeve të Europës Jugore dhe Amerikës Latine në krahasim me tranzicionin e vendeve ish-komuniste; ndryshimet ndërmjet tyre.	49
1.3.2 Vala e katërt e demokratizimit, problematikat e hasura	53
1.4 Këndvështrimi elitist.....	56
1.4.1 Elitat në tranzicion, formimi dhe roli i tyre	60
KREU I DYTË	63
SHQIPËRIA NËN DREJTIMIN KOMUNIST 1945 – 1990.	63
2.1 Një vështrim mbi lëvizjen komuniste shqiptare.....	63
2.2 Disa aspekte politike, ekonomike dhe sociale të Shqipërisë gjatë viteve 1945 – 1985.....	66
2.2.1 Tendencat politike nën drejtimin e Enver Hoxhës.....	68
2.2.2 Tendencat ekonomike, sociale dhe kulturore gjatë kësaj periudhe.....	79
2.3 Shqipëria nën drejtimin e Ramiz Alisë (vitet 1985 – 1991)	89
2.3.1 Shqipëria në prag të viteve ‘90, fundi i regjimit komunist	100
2.4 Dallime dhe përbashkësi të regjimit komunist shqiptar me Bllokun Lindor	105
2.5 Trashëgimia komuniste	108

KREU I TRETË	112
ZHVILLIME POLITIKE TË TRANZICIONIT SHQIPTAR	112
3.1 Situata politiko – ekonomike në vend dhe zgjedhjet e 22 marsit 1992	112
3.2 Kursi i ri politik, proceset e shndërrimit të shtetit, institucioneve dhe shoqërisë; vitet 1992 – 1994	115
3.3 Konfigurimi post-komunist i elitës politike shqiptare; tiparet e saj.....	120
3.4 Shqipëria dhe orientimi drejt Komunitetit Evropian	124
3.5 Klasa politike dhe ngjarjet e viteve 1994 – 1997; raportet me Bashkimin Evropian	126
3.6 Rikthimi i “komunistëve të moderuar”, stabiliteti i vendit 1998 – 2005	135
3.7 Trashëgimia politike dhe drejtuesit e rinj	142
KREU I KATËRT	147
ZHVILLIMET POLITIKE DHE ROLI I KLASËS POLITIKE NË MARRËDHËNIET ME BASHKIMIN EVROPIAN	147
4.1 Bashkimi Evropian dhe mekanizmi i Kushtëzimit Demokratik, ndikimet në Shqipëri	147
4.2 Vullnet politik apo demokratizim institucional, qasja e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian.....	153
4.2.1 Pushtet apo institucione, zgjedhje e vështirë për klasën politike shqiptare!.....	156
4.3 Angazhimi i politikanëve shqiptarë drejt BE, realitet apo demagogji	160
4.4 Shqipëria gjatë viteve 2005 – 2011; vazhdimi i proceseve integruese dhe angazhimi politik i Shqipërisë në kuadrin e perceptimeve të Bashkimit Evropian.....	163
4.5 Perspektiva e integritit të Shqipërisë në vazhdim	168
KONKLUZIONE	169
BIBLIOGRAFIA	170
7. Aneksi A	179

Lista e Tabelave:

	<i>faqe</i>
Tabela 1. Anëtarësimi në Partinë Komuniste Shqiptare.	31
Tabela 2. Prona Bujqësore në vend përpara Reformës Agrare të vitit 1945.....	80
Tabela 3. Rritja vjetore e prodhimit të brendshëm bruto.	114
Tabela 4. Indikatorët kryesorë të zhvillimit makroekonomik (1997 – 2004).	136
Tabela 5. Zgjedhjet parlamentare të vitit 2001.	138
Tabela 6. Konstatime në Progres Raporte (2003 – 2005).	140
Tabela 7. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit sipas Transparency International (2002 – 2005).	141
Tabela 8. Të dhënat e organizatës Freedom House për Shqipërinë 1998-2005.....	142
Tabela 9. Mbështetja e qytetarëve shqiptarë për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian.	151
Tabela 10. Faktorët përcaktues të Integritimit Europian.....	161
Tabela 11. Transformimi i Shqipërisë sipas Bertessmann Transformation Index (BTI 2003-2012).	161
Tabela 12. Hapat e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian.	162
Tabela 13. Zgjedhjet Parlamentare të Viti 2005.	164
Tabela 14. Indeksi i demokracisë për Shqipërinë 2007 – 2012.	166
Tabela 15. Të dhënat e organizatës Freedom House për Shqipërinë 2006-2013.....	167
Tabela 16. Indikatorët kryesorë të zhvillimit makroekonomik (2005 – 2010).	167

Lista e shkurtimeve:

BS – Bashkimi Sovjetik
RPSH – Republika Popullore e Shqipërisë
RPSSH – Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë
RFJ – Republika Federative e Jugosllavisë
RP Kinës – Republika Popullore e Kinës
RD Gjermane – Republika Demokratike Gjermane
BE – Bashkimi Evropian
MPB – Ministria e Punëve të Brendshme
MSA – Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit
PKSH – Partia Komuniste Shqiptare
PPSH – Partia e Punës e Shqipërisë
PKJ – Partia Komuniste Jugosllave
PD – Partia Demokratike
PS – Partia Socialiste
EQL – Evropa Qendrore dhe Lindore
VEQL – Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore
ODIHR – Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

PARATHËNIE

Tranzicioni politik dhe ndikimet shumëkahëshe të këtij procesi po bëhen gjithnjë e më tepër fokus analize për studiuesit që trajtojnë këtë dimension të politologjisë. Një interes i veçantë u kushtohet vendeve ish-komuniste, për të cilat autorë dhe studiues të ndryshëm kanë dhënë pikëpamje mbështetëse apo kundërshtuese në çështjet e tranzicionit apo të transformimit¹ të këtyre vendeve. Studimet e tranzicionit politik marrin në analizë udhëtimin e bërë nga këto vende, problematikat e hasura dhe ato që konsiderohen arritje drejt demokratizimit.

Çdo vend që përjeton udhëtimin drejt proceseve të transformimit dhe ndryshimit politik ka padyshim një specifikë dhe eksperiencë unike. Por, në të njëjtën kohë, ka nevojën e padiskutueshme t'iu referohet eksperiencave të vendeve të tjera. Kjo krijon lehtësi që rruga e ndryshimit të jetë më e qartë dhe të arrihen sa më shpejt objektivat e përcaktuara. Shqipëria, ashtu si shumë vende tjera, të cilat nuk kanë shumë kohë që kanë dalë nga pjesa e errët e historisë së tyre, vlerësojnë si një model të së ardhmes integrimin në Bashkimin Evropian. Arsyeja nuk është vetëm të qenët pjesë e BE-së, por edhe fakti që kjo është parë edhe si mundësia e vetme për zhvillim e përparim drejt demokracisë.

Në përkufizimin e studiuesve T. Karl dhe C. Schmitter, tranzicioni nuk është veçse "...një periudhë e madhe pasigurie politike. Ai u nënshtrohet pasigurive të paparashikuara, proceseve të pafundme dhe rezultateve të paimagjinueshme."² Referuar këtij konteksti mund të kuptohen shumë mirë vështirësitë që studiues të ndryshëm kanë hasur në analizën e proceseve tranzitore/transformuese të vendeve ish-komuniste dhe në klasifikimin "on block" (në grup) të karakteristikave e ndryshimeve që kanë pësuar ato. Secili vend ka vijuar një rrugë të vetën me tipare të dallueshme, hera-herës unike krahasuar me vendet e tjera. Këto dallime që hasim në përjasjet e tyre drejt proceseve demokratizuese vënë në diskutim shumë nga pikëpamjet teorike lidhur me tranzicionin drejt demokracisë. Për më tepër, me zhvillimin e valës së tretë të demokratizimit³, shumë studiues janë përpjekur të ndërtojnë dhe argumentojnë teza të një natyre gjithëpërfshirëse në shpjegimin e etapave dhe përmbajtjes së tranzicionit. Kështu, duke u fokusuar në elemente të përbashkëta dhe përgjithësuese, shumë herë është anashkaluar trajtimi i faktorëve lokalë, tek të cilët mund të gjendet shpjegimi për format dhe devijimet nga trajtesat teorike. Kjo bëhet më e dukshme në rastin e vendeve ish-komuniste. Dallimet në udhëtimin e tyre ekzistojnë si në afatin kohor të etapave tranzitore (të parashikuara nga ekspertët dhe studiuesit), ashtu dhe në përmbajtjen dhe në cilësinë e këtyre proceseve. Ndryshimet lidhen kryesisht me faktorë historikë, ekonomikë, shoqërorë, strukturorë etj.

¹Sqarim: Sipas disa studiuesve, vendet ish-komuniste kanë pësuar transformim dhe jo gjendje tranzitore. Ky koncept trajtohet në vijim të punimit.

²Terry Lynn Karl and Philippe C. Schmitter, "Models of the transition in Latin America, Southern and Eastern Europe" në Eva Etzioni-Halevy, "*Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim*", Botimet Dudaj, Tiranë, fq. 207.

³Shiko: Samuel Huntington, "*Vala e trete*", AIIS, Tiranë, 2011, fq. 7.

Në rrugën drejt demokracisë, këto faktorë konsiderohen përcaktues si në momentin e ndryshimit të sistemit politik (në prag të viteve '90), ashtu dhe në përshtatjet e shoqërive dhe klasave politike në vijimësi. Shumë studiues pohojnë se nëse qëllimet e tranzicionit ishin të përbashkëta për shumicën e vendeve ish-komuniste, sukseesi dhe koha e realizimit të këtyre objektivave u kushtëzua në radhë të parë nga 3 faktorë kryesorë: *trashëgimia politike, ekonomike dhe shoqërore*.

Nevoja e madhe për t'i studiuar ndryshimet e ndodhura më thellë dhe në nivele kombëtare vjen edhe si pasojë e problematikave dhe e vonesave të hasura nga disa vende, ndër to edhe Shqipëria.

Për çështjet e tranzicionit politik diskutohet në literatura e analiza të ndryshme, por shumë pak flitet për Shqipërinë. Megjithatë rasti i vendit tonë mund të quhet specifik. Në Shqipëri, procesi i ndërtimit të demokracisë gjatë tranzicionit politik pas ndryshimit të regjimit, nuk mund të përkufizohet as si një rilindje dhe as si një rindërtim. Kjo ndoshta përbën një karakteristikë unike të këtij tranzicioni. Nëse analizojmë historinë e vendit tonë shohim se nuk mund t'i referohemi asaj për një rilindje apo rindërtim të demokracisë, pasi në të nuk ka një eksperiencë demokratike të mëparshme e që duhet rikuperuar.

Ndërrimi i regjimeve konsiderohet pa diskutim një proces i vështirë. Në vendet ish-komuniste të Lindjes vështirë të gjesh ndonjë klasë politike, e cila të ketë shndërruar sistemin e vet politik në një instrument ndryshimi. Në Shqipëri, ashtu sikundër edhe në vende të tjera konstatohet që pikërisht *politika si instrument kryesor ndryshimi* të ketë shtuar "pengesa artificiale" në proceset e tranzicionit. Për këtë arsye, analiza e tranzicionit politik në vend kërkon studime shkencore ndërdisiplinore si në trajtimin e përbërjes, ashtu dhe në dinamikat e elitave politike, sa i takon kujtesës historike, qëllimeve dhe protagonistëve politikë, ecurisë së zhvillimeve ekonomike, dallimeve kulturore, faktorit ndërkombëtar etj. Duke u mbështetur edhe në zhvillimet politike të viteve të fundit, studimi i tranzicionit politik e sidomos i klasës politike drejtuese (në tranzicion) konsiderohet një çështje e rëndësishme. Interesi rritet kur kjo shihet në raport me proceset demokratizimit dhe sidomos me ato të integritimit në BE.

Punimi i paraqitur ka në qendër një analizë të thelluar të këtij tranzicioni politik në vend. Përmes tij, ne përpiqemi të kompensojmë çdo anashkalim të hasur në studimet krahasuese që janë realizuar më parë nga studiues apo autorë të tjerë. Qëllimi i këtij punimi është induktimi i një këndvështrimi të ri në shpjegimin e rrugës së tranzicionit që ka ndjekur rasti shqiptar, duke vendosur si variabla shpjegues të këtij tranzicioni elementët lokalë. Madje vetë faktori politik vlerësohet nga autori si një variabël predominues në zhvillimet e shumë sektorëve të sferës ekonomike dhe sociale. Ne guxojmë dhe hedhim hipotezën se: *Politika dhe institucionet e saj janë përgjegjëse për reformat e pamjaftueshme dhe për ritmin e ulët të ndryshimit të arritur në vend deri tani*.

Shqipëria paraqet një rast interesant studimi. Asyeja është se udhëtimi i saj drejt demokracisë është i mbushur plot me kontradikta dhe zhvillime të paparashikuara.

Megjithatë, i gjithë ky udhëtim ka në gjenezë kalimin nga një regjim autoritar në një tranzicion demokratik. Vlerësimi i kësaj etape ndihmon në kuptimin dhe njohjen e procesit të lindjes së demokracisë. Në këto 22 vite pluralizëm politika shqiptare është shoqëruar nga një kontradiktë e thellë⁴, mes aspiratës e përpjekjeve të popullit shqiptar për demokratizim dhe orientim evropian, dhe realiteteve politike zhvilluar nga elita politike. Vetë politika dhe politikëbërësit, në të shumtën e rasteve, kanë reflektuar një efekt të kundërt me aspiratat integruese dhe demokratizuese shprehur në ligjërimet e tyre politike.

Orientimi drejt strukturave euroatlantike e në veçanti drejt BE-së nis me përpjekjet e para të shoqërisë dhe politikës shqiptare për transformim dhe demokratizim të vendit. Perspektiva e integritit në BE përbën një stimul të fortë në mbarë shoqërinë për arritjen e progresit dhe demokratizimin e vendit. Studimet tregojnë se mbi 90% e popullsisë shqiptare dëshiron arritjen e standardeve demokratike dhe anëtarësimin e vendit në BE. Në anën tjetër, kjo ëndërr shoqërohet me një realitet politik kundërshtues. Pavarësisht spektrit, zhvillimet politike në vendjanë shoqëruar, pothuajse në mënyrë permanente, me konflikte të mëdha qeveri – opozitë. Ky konflikt ka ndikuar jo vetëm në cilësinë e qeverisjes, por dhe në frenimin e përmbushjes së standardeve të BE-së. Destabiliteti i vazhdueshëm politik ka larguar partitë politike nga interesat e qytetarëve. Mungesa e alternativave reale në ‘tregun politik’ ka rritur dukshëm krizën e përfaqësimit të shumë grupeve të shoqërisë.

Megjithë premisat pozitive, problemi qëndron në faktin se nuk ka mjaftuar puna, përpjekjet dhe dëshira e shqiptarëve për integrim, madje as ndihma e dhënë nga Bashkimi Evropian (përmes mekanizmit të kushtëzimi demokratik) që ky objektivi të arrihet të paktën në nivel të marrjes së statusit të vendit kandidat. Standardet dhe kushtet e vëna nga Bashkimi Evropian nuk patën rezultatet që priteshin nga ana e vendit tonë, kjo edhe si pasojë e asaj që u trashëguar nga sistemi totalitar, si dhe nga vendimmarrja politike e viteve të tranzicionit të hershëm. Mjafton të përmendim terapinë e “shokut” që u ndoq në ekonomi pa marrë parasysh kostot dhe fitimet në planin afatgjatë. Ajo që na lidh me të shkuarën është më e madhe nga sa mendojmë ne. Ndërsa shoqëria riprodhon vetveten, e gjithë e vjetra shndërrohet në të re, ndonëse jo domosdoshmërisht në sensin progresiv. Në të njëjtën kohë, kultura në të cilën jemi të zhytur, ndërtohet në një mënyrë të tillë që ne jemi kurdoherë gati ta perceptojmë të vjetrën.⁵ Gjatë këtyre 20 viteve pluralizëm, integrimi ka qenë kryefjala e çdo politikani shqiptar. Edhe pse është artikuluar dhe folur shumë mbi këtë argument, Shqipëria ende ka shumë “detyra shtëpie për të bërë” për të arritur demokratizimin dhe integrimin e plotë drejt BE-së. Megjithë përparimet e

⁴ Sipas sondazheve dhe studimeve të realizuara nga Instituti i Studimeve Ndërkombëtare nga viti 2003 e në vazhdim del se shqiptarët e mbështesin integrimin e vendit në BE pothuajse në mënyrë unanime, nga 90-95%. Shiko: *Perspektiva Evropiane e Shqipërisë, perceptime dhe realitete nga 2003 deri 2012* AIIS, (studime).

⁵A. Vehbiu. “Obsesioni ynë me origjinën”, *Roli i miteve në historinë e Shqipërisë*, Revista *Përpjekja*, Nr. 15-16 Janar-Dhjetor, 1999. fq. 70.

pretenduara dhe të arritura, për të tretën herë radhazi është refuzuar nga Komisioni Evropian pranimi i kërkesës së statusit të vendit kandidat për Shqipërinë.

Ndër arsyt kryesore të përmendura në progres-raportet e KE-së ka qenë kriza e zgjatur politike dhe progresi shumë i vogël në zbatimin e reformave të kërkuara nga Komisioni Evropian. Opinioni i tij nënvizon në një masë të madhe faktin se progresi është penguar nga ngërçi politik dhe bojkoti parlamentar, megjithatë analizat e tyre janë të rezervuara e me gjuhë diplomatike. Ata, dhe në një masë të madhe opinioni qytetar apo i analistëve/studuesve të ndryshëm, rreken të gjejnë shkaqet e këtij konfliktualiteti politik, i cili ka dëmtuar si zhvillimin, ashtu edhe integrimin e vendit.

Rotacioni i paqshëm politik i vitit 2005 dhe rezultatet pozitive të dy viteve të para të qeverisjes së re dhanë shpresën se më në fund politika shqiptare ishte shkëputur njëherë e mirë nga problematika zgjedhore, nga gjuha e konflikteve dhe e mosbashkëpunimit midis aktorëve politikë, dhunës nëpër sheshe etj. Të gjithë besuan në një maturi dhe hap cilësor të klasës politike shqiptare. Zhvillimet politike në vend, sidomos pas zgjedhjeve të vitit 2009 kanë ngritur shumë pikëpyetje mbi faktin nëse është ose jo Shqipëria dhe veçanërisht klasa politike në rrugën e duhur për afrimin e vendit drejt Bashkimit Evropian. Një nga elementët më problematikë që evidentohet jo vetëm nga ndërkombëtarët, por edhe nga shoqëria shqiptare⁶ është klasa politike. Përfaqësuesit evropianë kanë lëshuar kritika të forta në drejtim të klasës politike. Në opinionin e Komisionit Evropian të vitit 2010, ndër të tjera theksohet fakti që “Dialogu politik është konfrontues dhe destruktiv edhe për shkak të ngërçit politik që nga qershori i Zgjedhjeve 2009.”⁷ Shumë pyetje kanë të bëjnë me faktin se çfarë e pengon Shqipërinë në rrugën drejt demokracisë e rrjedhimisht drejt BE-së? Çfarë ua bën të vështirë politikanëve shqiptarë gjetjen e kompromisit për realizimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, për konsolidimin e institucioneve të pavarura, me pak fjalë realizimin e normave demokratike në vend? Përse nuk përputhet orientimi i shumicës dërrmuese të shoqërisë me realizimin konkret të vlerave demokratike si në formimin e shtetit, institucioneve, politikës dhe qytetarisë? Përse ende sot, demokracia shqiptare mbetet një demokraci e dobët si nga funksionimi i procesit politik, ashtu edhe nga institucionalizimi i saj? Përse përpjekjet e ndërkombëtarëve e veçanërisht të Bashkimit Evropian kanë rezultuar joefikase? Përse demokracia shqiptare është në *stanjacion*, e që nëse do të përdornim konceptin e Carothers, do të thoshim, në “zonën gri” të regjimit politik? Këto janë pyetje të mëdha, komplekse, të kohës dhe të rëndësishme. Çështjet të cilat ne tentojmë të trajtojmë janë kokëforta dhe të lidhura ngushtë me zhvillimet historike dhe ndreqja e tyre së pari lyp një rivlerësim të thelluar të vlerave themelore politike dhe shoqërore.

⁶ Shiko, “*Perspektiva Evropiane e Shqipërisë, perceptime dhe realitete*”, AINS, Tiranë, 2010.

⁷ Commission Opinion on Albania's application for membership of the European Union, European Commission Brussels, 9.11. 2010. fq. 5.

HYRJJE

Në punimin tonë, ne jemi përpjekur që problemin e zgjatjes së tranzicionit dhe zgjidhjen e tij ta shikojmë si një produkt të klasës politike shqiptare. Argumenti ynë kryesor është se: Frenimi i Shqipërisë në arritjen e rezultateve pozitive në reforma, zhvillim, demokratizim dhe integrim në familjen Evropiane është ndikuar dukshëm nga klasa politike e këtyre 22 viteve tranzicion. Klasa politike është aktori më i rëndësishëm në politikëbërje dhe në Shqipëri, ndryshe nga të gjitha vendet ish-komuniste, liderët politikë historikë janë aktivë dhe në konkurrencë për poste të larta drejtuese⁸. Në dy dekadat e fundit, skena politike shqiptare është pothuajse dominuar nga të njëjtët aktorë politik. Politikëbërja konsiderohet një proces paktesh, negociatash dhe kompromisesh ndërmjet aktorëve⁹ dhe riciklimi i tyre bëhet i domosdoshëm për zhvillimin e demokracisë dhe të vendit në tërësi.

Studiuesit theksojnë se: “Pavarësisht plejadave relativisht të favorshme, kalimi në demokraci mund të dështojë kur *mungon vullneti dhe kur veprohet politikisht me ngathtësi*¹⁰”, dhe që të dyja këto janë elemente shumë të pranishme në politikën shqiptare. Kjo vihet në dukje edhe nga deklarata e eurokomisionerit për Zgjerimin, z. Stefan Fyle, i cili thekson se “mungesa e kulturës së kompromisit...”¹¹ është çështje kritike.

Duhet patur parasysh fakti se pluralizmi politik në Shqipëri erdhi si një produkt i elitës së vjetër qeverisëse. Demokratizimi i vendit pas përmbysjes së regjimit komunist shkaktoi një ndryshim të rëndësishëm të elitës politike. Mirëpo, me gjithë këto ndryshime, elitat e tanishme kanë ngjashmëri shumë të madhe me paraardhësit komunistë¹². Studimi i klasës politike vjen si një domosdoshmëri jo vetëm e perceptimeve negative që ka shoqëria për këtë klasë, por është rrjedhim edhe i kritikave të forta që i kanë adresuar asaj ndërkombëtarët. Objekti i studimit të elitës në tranzicion është shqyrtimi i strukturës të pushtetit, i veprimtarisë shtetformuese dhe i ndikimeve në sektorët vitalë të shoqërisë. Sa është ripërtëritë ajo gjatë këtyre viteve? Sa dhe si ka ndikuar klasa politike drejtuese në realizimin e proceseve tranzitore? Nëse ka patur vonesa në këtë proces, sa ka qenë pesha e elitave drejtuese në to? Nëse pushteti është në duart e një pakice, kjo ka qenë rezultat i rastësishëm apo i parashikueshëm? Qëllimi i këtij punimi është: *studimi objektiv i rolit që luan klasa politike shqiptare në realizimin*

⁸Shiko, Afrim Krasniqi, “Partitë Politike dhe Sistemet Politike”, Iliar, Tiranë, 2008, fq. 127. Përveç largimit të kryetarit të partisë socialiste F. Nano, të gjithë drejtuesit e partive kryesore në vend janë po ata të fillim-viteve 1990.

⁹Mirela Bogdani, John Loughlin, “Shqipëria dhe Bashkimi European, Integrimi European dhe Prespektiva e Pranimit” Dajti, Tiranë, 2004. fq. 85.

¹⁰Manfred G. Schmidt, “Teoritë e Demokracisë”, Botart, Tiranë, 2012, fq. 446 sqarimi: theksimi me bold dhe italic është bërë nga autori.

¹¹<http://www.ama-news.al/2013/02/fyle-ne-shqiperi-mungon-kultura-e-kompromisit/>

¹²Elez Biberaj, “Shqipëria në tranzicion, Rruga e vështirë drejtë demokracisë 1990-2010”, AIIS, Tiranë, 2011, fq. 478.

me sukses ose jo të tranzicionit politik, si dhe ndikimi i saj në proceset integruese të vendit në Bashkimin Evropian. Nga hulumtimi dhe analizat rezulton se proceset e tranzicionit dhe integrimi i Shqipërisë në BE kanë qenë dy procese që janë zhvilluar njëkohësisht duke u ndërthurur në mënyrë të ndërlikuar mes tyre.

Duam të theksojmë që ky studim nuk ka në objektin marrëdhëniet Shqipëri-BE të zhvilluara gjatë periudhës së tranzicionit, pavarësisht rëndësisë që kanë këto marrëdhënie në vetvete; fokusi i saj është roli i klasës politike gjatë tranzicionit politik në proceset integruese të Shqipërisë drejt BE-së.

Thelbi teorik i doktrinës elitiste është se “në shoqëri mund të ekzistojë një pakicë popullsie që merr vendime të mëdha... duke ndikuar aspektet më të përgjithshme të shoqërisë, ato zakonisht njihen si vendime politike¹³”. Tezat elitiste nuk pohojnë thjesht se në një shoqëri pakica merr vendime dhe shumica bindet; argumenti elitist është një argument më i fortë: “Pakica mbizotëruese nuk mund të kontrollohet nga shumica, çfarëdo mekanizmesh demokratike të përdoren¹⁴”. Michels është shprehur se: “nëse vihen ligje për të kontrolluar sundimin e krerëve, është ligji ai që dora-dorës zbret, dhe jo krerët¹⁵”. Pushteti i elitave drejtuese bëhet problematik për shtetin dhe shoqërinë sidomos kur demokracia është në fazën e saj të brishtë. Pushteti qeverisës është një tundim i fortë për këdo, ashtu siç është shprehur edhe presidenti amerikan W. Willson: “Historia e lirisë është historia e kufizimit të pushtetit qeverisës dhe jo i rritjes së tij¹⁶”, ndaj kërkohet përgjegjshmëri dhe moral i lartë politik për njerëzit që marrin përsipër detyra qeverisëse.

Tranzicioni politik drejt një demokracie të konsoliduar ka rëndësi të madhe jo vetëm për ndërtimin e shtetit funksional dhe garantimin e përfitimeve politike për të gjithë qytetarët e vendit, por mbi të gjitha sepse është pikërisht ajo rruga drejt integritit dhe anëtarësimit për në Bashkimin Evropian. Ne kemi zgjedhur të studiojmë pikërisht ndikimin e klasës politike në proceset tranzitore dhe ndikimin e saj në rrugën e vendit drejt BE-së. Për realizimin e një tranzicioni të pakthyesëm, ne duhet të jemi të aftë të trajtojmë siç duhet *çështjet politike* të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi sigurinë dhe zhvillimin. Kjo bën të mundur njëkohësisht gjetjen e zgjidhjeve të duhura, të cilat mund të zbatohen me sukses në terren. Zhvillimi i Shqipërisë, tranzicioni demokratik, integrimi dhe evropianizimi i saj është i lidhur ngushtësisht me prespektivën e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Njëkohësisht, procesi i integritit ka si synim edhe evropianizimin e vendeve candidate për në Bashkimin Evropian. Po t'i referohemi studiuesi Radaelli, evropianizimi ka të bëjë me një proces të:

“a) ndërtimit, b) difuzimit, c) dhe institucionalizimin e rregullave formale ose jo, procedurave, modeleve të politikave, stileve, mënyrës së bërjes së gjërave dhe normave apo besimeve të përbashkëta që janë themeluar dhe konsoliduar në

¹³Geraint Parry, “*Elitat Politike*”, Botimet Dudaj, Tiranë, 2010, fq. 48.

¹⁴Ibid., fq. 49.

¹⁵Robert Michels, “*Political parties*”, Free Press Glencoe, 1915, (ribotim 1958), fq. 423.

¹⁶Vep.cit Rexhep Meidani, “*Kushtetuta: Bilanci dhe prespektiva*”, Toena, Tiranë, 2009, fq. 58.

nivel të politikave në BE, që më pas përfshihen në logjikën e diskursit vendor, të identitetit, strukturave politike dhe politikave publike¹⁷”

Nga kjo perspektivë, vlerat, normat, rregullat e Bashkimit Evropian janë objektiva që duhet të arrihen nga shoqëria shqiptare dhe sidomos nga drejtuesit politikë shqiptarë.

Gjithashtu, tranzicioni demokratik është parë si një proces i dykahshëm jo vetëm i ndihmës dhe presionit nga Bashkimi Evropian (përmes mekanizmit të kushtëzimit demokratik), por edhe si pasojë e presionit nga shoqëria, intelektualët dhe nga politikanët shqiptarë për të qenë më shumë sesa një pjesë gjeografike e kontinentit.

Realizmi i një projekti të tillë që përfshin gati gjithë historinë moderne të shqiptarëve është përtej mundësive tona, prandaj një sërë kufizimesh të objektit të studimit ishin të nevojshme. Këto të fundit, natyrisht që kanë ndikuar edhe në përfundimet e arritura.

Ky punim është ndërtuar në katër kapituj. Punimi hapet me shtjellimin e kuadrit teorik. Në këtë pjesë të punimit janë trajtuar materiale teorike (literature review) që shqyrtojnë jo vetëm pikëpamjet teorike mbi tranzicionin dhe elitat, por edhe totalitarizmin dhe demokracinë në tërësi. Kuadri i gjerë teorik na ka ndihmuar të kuptonim shumë arsye dhe simptoma të ngjashme të mospjesëmërisë drejt demokracisë tek disa vende ish-komuniste dhe rrjedhimisht edhe në rastin e Shqipërisë. Hulumtimet teorike fillojnë me trajtimin e totalitarizmit si koncept dhe si regjim. Kemi trajtuar karakteristikat dhe tiparet kryesore të regjimeve totalitare duke u thelluar në regjimin e tipit komunist. Një vëmendje e veçantë u është kushtuar pasojave të totalitarizmit. Po kështu, baza teorike mbi demokracinë trajton përcaktimin si koncept dhe regjimin e demokracisë liberale, si edhe karakteristikat e regjimeve demokratike. Ajo na ka ndihmuar në vlerësimin e shkallës së përparimit demokratik, të rendit politik dhe të kulturës politike shqiptare në përfrimin e saj me demokracitë perëndimore. Vlen të cilësojmë këtu konceptet e demokracisë, legjitimitetit dhe konsolidimit. Njohja e parametrave të demokracisë na ndihmon të matim demokratizimin për të sqaruar, “nëse një shtet është i ndërtuar në gjysmë të rrugës, plotësisht apo aspak në mënyrë demokratike¹⁸”. Një arsye për këtë trajtimin teorik të demokracisë e gjejmë tek argumentimi i studiuesit J. Olsen, i cili përcakton se “kriteri për anëtarësim i vendeve kandidate në Bashkim Evropian është demokracia liberale...¹⁹”. Një vëmendje e veçantë u është kushtuar hulumtimeve mbi tranzicionin, përcaktimit si koncept dhe problematikave që vijnë si pasojë e përgjithësimin teorik të tranzitologjisë. Po në këtë pjesë kemi paraqitur edhe trajtime teorike krahasuese midis tranzicioneve të zhvilluara midis

¹⁷Op.cit në Heather Grabbe, “*Europeanisation Goes East: Power and Uncertainty in the EU Accession Process*” The Politics of Europeanisation, Oxford: Oxford University Press. 2002 (Chapter to appear in K. Featherstone and C. Radaelli (eds.), fq. 7.

¹⁸Manfred G. Schmidt, “*Teoritë e Demokracisë*”, Botart, Tiranë, 2012, fq. 379.

¹⁹Johan P. Olsen, “The Many faces of Europeanization” fq. 8, burimi online: http://www.ceses.cuni.cz/CESES-141-version1-2_1_Olsen_The_many_faces_of_Europeanization_2001.pdf

vendeve të Europës Jugore si Spanja, Portugalia dhe Greqia krahasuar me tranzicionin e zhvilluar në vendet e Amerikës Latine, dhe jemi përqendruar në pikat më kryesore. Gjithashtu është parashtruar edhe një analizë krahasuese midis vetë vendeve ish-komuniste duke evidentuar problematikat dhe diferencat brenda vendeve të bllokut ish-komunist. Një pikë teorike interesante është trajtesa që përmban argumentet, të cilat vijnë nga studiuesit e lindjes, sipas të cilëve për vendet e përfshira në valën e katërt të demokratizimit, termi i saktë është transformim dhe jo tranzicion. Këtu ballafaqohen pikëpamje të grupeve të autorëve të lindjes dhe të perëndimit. Në mbyllje të kapitullit teorik jemi ndalur në rolin e elitave politike në tranzicion duke e trajtuar nga këndvështrimi i teorisë elitise. Këto njohuri kanë plotësuar perspektivën teorike të studimit dhe kanë shërbyer si bazë për analizimin dhe argumentimin e asaj se ku është Shqipëria në procesin e demokratizimit dhe si duhet të jetë rruga e saj për përmbushjen e suksesshme të këtij procesi.

Pjesa e dytë e punimit merret me trajtimin historik të Shqipërisë në periudhën 1945-1990. Ky kapitull shërben si hyrje dhe ndihmon për të kuptuar atë që studiuesi Elezi e ka përcaktuar kështu: “Pa e njohur mirë të kaluarën, nuk kuptohet e sotmja dhe nuk mund të ndërtohet e ardhmja e mirë²⁰”. Në këtë pjesë merret në shqyrtim vendosja, zhvillimi dhe shpërbërja e komunizmit. Më konkretisht, aty trajtohet marrja e pushtetit nga komunistët dhe aspektet politike, ekonomike dhe sociale gjatë atyre viteve. Kjo periudhë është e ndarë në dy faza. Në fazën e parë përfshihet trajtimi i periudhës të sundimit të Enver Hoxhës nga vitet 1945 deri në vitet 1985. Aty trajtohen aspektet politike, ekonomike dhe shoqërore nën drejtimin e tij dhe ndikimet në shoqëri dhe në klasën politike. Faza e dytë fillon me vdekjen e Hoxhës dhe me ardhjen në krye të partisë komuniste të Ramiz Alisë deri në vitin 1991. Një vend të veçantë zë trajtimi i aspektit ekonomik dhe politik të Shqipërisë në prag të viteve ‘90. Jepet një qasje krahasuese midis të veçantave dhe të përbashkëtave të regjimit komunist në Shqipëri me vendet e tjera të bllokut komunist. Ky kapitull mbyllet me analizën e trashëgimisë totalitare në Shqipërinë e viteve 1990, duke u ndalur në pasojat dhe produktet negative që la ky regjim. Në të evidentohen gjithashtu edhe problematikat e fillimit të tranzicionit.

Pjesa e tretë e punimit trajton zhvillimet politike të pasviteve ‘90. Kreu nis me trajtimin e kushteve ekonomike, sociale dhe politike që ndikuan në ndryshimin e sistemit politik. Trajtohen proceset institucionale të ndodhura, si dhe formatimi i shtetit dhe i institucioneve me vendosjen e pluralizmit politik, problemet dhe vështirësitë e fillimit. Klasa e re politike dhe orientimet e saj janë një nënçështje tjetër e këtij kapitulli.

Aty analizohet lindja e aktorëve të rinj politikë, kalimi i pushtetit tek forcat reformatore dhe orientimi euro-atlantik i politikës së vendit. Pjesë e këtij kapitulli janë ngjarjet e vitit 1997, si dhe ardhja në pushtet e socialistëve. Periudha kohore e trajtuar përfshin hapësirën nga viti 1991 deri në vitin 2005, kohë që përkon me ardhjen në pushtet të demokratëve.

²⁰ Ismet Elezi, “*Me syrin e një juristi 20 vjet të qeverisjes moniste*”, Botimet Toena, Tiranë, 2004, fq. 6.

Pjesa e katërt e punimit trajton zhvillimet më të rëndësishme politike nga viti 2005 deri në vitin 2012. Aty analizohen ndikimet dhe ndihma e dhënë nga Bashkimi Evropian për zhvillimin e demokracisë në vend. Modeli politik dhe institucional i ndjekur nga drejtuesit shqiptarë dhe sa ka qenë ai në përshatje të normave dhe parimeve që përdor BE-ja sot. Një nënçështje e saj trajton dhe analizon ligjërimin politik dhe angazhimin faktik të politikanëve për ecjen e vendit drejt Bashkimit Evropian, pra sa reale janë përpjekjet e tyre.

Një pjesë e rëndësishme e këtij kapitulli është edhe trajtimi i zhvillimeve politik dhe proceseve integruese të Shqipërisë gjatë viteve 2005 – 2011 të trajtuara këto edhe në kuadrin e perceptimeve të Bashkimit Evropian. Kjo pjesë përfundon me analizën e perspektivës integruese të Shqipërisë në vazhdim.

Punimi mbyllet me paraqitjen e përfundimeve kryesore.

METODOLOGJIA

Puna për përgatitjen e këtij punimi kërkimor ka konsistuar në mbledhjen e materialeve dhe të dhënave nëpërmjet monografive, studimeve, revistave shkencore, punimeve të ndryshme të paraqitura si disertacione, artikujve të gazetave, periodikëve, raporteve të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare dhe të qeverisë shqiptare, materiale të marra nga interneti, arkivat etj. Literatura e shfrytëzuar ka qenë në një pjesë të madhe në gjuhën shqipe, por edhe angleze dhe italiane. Për çështjet e trajtuara janë shfrytëzuar monografi dhe studime të studiuesve më në zë për fushat përkatëse.

Analiza empirike është shtrirë në treguesit kryesorë të matjes së shkallës së demokracisë që përfshin të dhënat për Shqipërinë, duke shfrytëzuar të dhënat e marra nga raportet periodike të përgatitura nga institucionet e Bashkimit Evropian (Komisioni Evropian), Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Freedom House, Insituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare, Gallup Balkan Monitor etj.

Në ndërtimin e variablave është tentuar të ruhet njëtrajtshmëria dhe qasja krahasuese duke e bërë sa më të besueshëm punimin për ilustrimin teorik. Mendojmë se studimi është një burim të dhënash të besueshme dhe të hollësishme për studiuesit që përpiqen të kuptojnë ndikimin e tranzicionit politik dhe në veçanti marrëdhëniet e klasës politike shqiptare në proceset integruese të vendit në Bashkimin Evropian.

KREU I PARË

TOTALITARIZMI, DEMOKRACIA DHE TRANZICIONI SI PROCES I NDËRMJETËM

1.1 Totalitarizmi, përcaktimi si koncept

Kur vjen fjala për të përcaktuar totalitarizmin si koncept, studiuesit pranojnë që ka vështirësi të brendshme në zbërthimin e tij. Vështirësitë hasen në tri aspekte kryesore. Nëse i referohemi Xhovani Sartorit, një nga aspektet që duhet marrë në konsideratë për analizë është fakti nëse: “fjala *totalitarizëm*²¹” duhet të tregojë një tipar i cili është i përbashkët për shumë shtete dhe shoqëri të ndryshme, apo nëse fjala duhet të tregojë një tip të veçantë sistemi politik, i cili karakterizohet nga një sindromë tiparesh të veçanta²². Mendoj që ne të biem dakord me pjesën e dytë të pohimit, që termin totalitarizëm ta cilësojmë si një tip i veçantë sistemi politik duke dhënë në vijim tiparet dhe arsyet e këtij kategorizimi.

Një aspekt tjetër i domosdoshëm lidhet me dimensionin kohor të konceptit, nëse termi totalitarizëm është një term që përshtatet për sisteme despotike në të gjitha periudhat kohore apo është një risi në përkufizimin e ndonjë sistemi të pahasur më parë. Do të ishte e udhës t’i përmbaheshim faktit që: “Totalitarizmi është dukuri e shekullit të XX”²³. Në këtë kontekst, termi *totalitar* veçohet dhe kufizohet në kohë. Për Xhovani Sartorin “totalitarizmi është një (përcaktim) emër i ri për diçka që nuk është arritur gjë tani²⁴”. Këto forma të reja sundimi dhe pushteti kishin nisur të zhvilloheshin si në shoqëri që kishin kaluar eksperiencën demokratike dhe kapitaliste si Italia dhe Gjermania, po ashtu dhe në vende pa traditë në demokraci dhe me ekonomi të pazhvilluar, si Rusia. Një nga mendimtarët më të shquar të këtij shekulli, Claude Lefort, pohon me të drejtë se “Përkundër një mendimi të përhapur, totalitarizmi nuk del nga një ndryshim i mënyrës së prodhimit. Kjo mund të dëshmohet me rastin e fashizmit gjerman apo italian që u gjend rehat me mbajtjen e një strukture kapitaliste, pavarësisht nga ndryshimet që mund të ketë pësuar ajo me ndërhyrjen e shtetit në ekonomi²⁵”

Nëse vështrojmë në të shkuarën, gjykojmë se ka patur përpjekje për dominim total, por asnjë nuk mund të krahasohet me manipulimin e masave dhe me kontrollin qeverisës të ushtruar nga regjimet komuniste, naziste dhe fashiste të shekullit të XX. Askush më parë, nuk ka patur dhe nuk ka mundur, të realizojë si qëllim, shndërrimin rrënjësor të shoqërisë dhe krijimin e një shoqërie pa klasa, shtetin si pronar të vetëm dhe

²¹Shënim i autorit.

²²Giovani Sartori, “Edhe njëherë për teorinë e demokracisë”, Dituria, Tiranë, 1998. fq. 243.

²³Llambro Filo, “Historia për sistemet e qeverisjes”, EXTRA, Tiranë, 2005. fq. 241.

²⁴Ibid.

²⁵Claude Lefort, “Demokracia dhe Totalitarizmi”, Dukagjini, Pejë, 1994. fq. 24.

udhëheqësin si lider të përjetësuar në çdo aktivitet njerëzor. Për studiuesin Lefort, totalitarizmi duhet trajtuar si një tip i ri despotizmi “po aq i ri në raport ndaj despotizmave të mëzëm sa edhe demokracia moderne, e cila është në raport ndaj demokracisë antike²⁶”.

Aspekti i tretë i domosdoshëm lidhet me faktin se sistemet totalitare kanë një diapazon të ngushtë diferencash ndërmjet tyre; atëherë cilit nga sistemet politike i përshtatet më shumë ky term? E thënë më thjeshtë, cili sistem politik mund të përkufizohet si totalitar/totalitarizëm? Totalitarizmi si koncept ka lindur për herë të parë në periudhën midis dy luftërave botërore. Ka qenë pikërisht Giovanni Amendola ai që përdori nocionet e pushtetit “total” dhe të “totalitarizmit” për të përkufizuar veprimtarinë subversive të ushtruar nga institucionet fashiste. Ai arriti në përfundimin se: “Regjimi i Musolinit ndryshonte në mënyrë rrënjësore nga diktatura e zakonshme” fakt të cilin, më vonë, edhe vetë Musolini (në qershor të vitit 1925), do ta cilësonte regjimin e tij si “totalitarizëm” **në kuptimin se çdo gjë i nënshtrohej shtetit**²⁷. Për Musolinin, shprehja "shtet totalitar" tingëllonte si diçka e rëndësishme, që bën përshtypje. Etiketa "shtet totalitar" ishte mikluese për mendjemadhësinë dhe një mbështetje për retorikën e tij. Tri janë sistemet politike (dhe derivatet që kanë lindur nga tipi komunist) që janë etiketuar si totalitarizëm: nazizmi, fashizmi dhe bolshevizmi.

Nëse për dy regjimet e para studiuesit ndahen në faktin që t'i cilësojnë apo jo ato si sisteme totalitare, për regjimin bolshevik ky diskutim nuk shtrohet.

Po t'i referohemi studiueses Hanah Arend, një nga personalitetet më me peshë në fushën e mendimit politik, në studimin e saj “Origjinat e Totalitarizmit”, ajo përcakton vetëm dy vende që kanë njohur totalitarizmin: Gjermaninë gjatë regjimit nazist të Hitlerit dhe BS gjatë sundimit të Stalinit.

Për Sartorin, fashizmi ishte një rast i qartë diktature autoritare, mjaft më shumë se një diktaturë e thjeshtë, por mjaft më pak se një shtet totalitar²⁸. Pavarësisht emërimit, Huntington vë theksin tek legjitimiteti që fitojnë këto forma qeverisëse si pasojë e nacionalizmit dhe ideologjisë. Ja, si shprehet ai:

Në kohët moderne autoritarizmi është përligjur nga nacionalizmi dhe ideologjia. Efektiviteti i të parit si një bazë e regjimit jodemokratik, gjithsesi varet në një masë të madhe nga ekzistenca e një armiku të besueshëm kundër aspiratave kombëtare të një populli. Nacionalizmi është edhe një forcë popullore dhe mund ta legjitimojë fare mirë si demokratik një regjim autoritarist. Justifikimi kryesor ideologjik i autoritarizmit në kohët moderne ka qenë marksizëm – leninizmi. Ai siguron bazën ideologjike për diktaturën dhe regjimin njëpartiak të një elite burokratike të vogël, të vetëpërjetësuar²⁹.

²⁶Ibid., fq. 18.

²⁷Ibid., 21, (Ll. Filo).

²⁸Ibid., 20, fq. 242-3 (G, Sartori).

²⁹Samuel Huntington, “*Vala e tretë*”, Tiranë, AIIS, 2011, fq. 33.

Megjithatë për të kuptuar përse komunizmi, sidomos tipi Stalinist, i mishëron të plotat tiparet totalitare duhet vënë në dukje diferencat midis tij dhe regjimit fashist. Siç u përmend edhe pak më lart, ky regjim mund të klasifikohet si një regjim autoritar pavarësisht synimit për t'u vetshpallur totalitar.

Kjo për disa arsye:

- 1) Nuk arriti të eliminonte tërësisht pluralizmin politik. Në strukturën drejtuese të shtetit italian, mbreti dhe oborri i tij funksiononin edhe pas ardhjes në pushtet të Musolinit.
- 2) Nuk arriti dot të eliminonte klasën e sipërmarrësve të mëdhenj. Nuk eliminoi dot aktivitetin në sferën private.
- 3) Nuk eliminoi dot ndikimin e kishës katolike tek regjimi i tij.
- 4) Ligjërimi politik bazohej në trekëndëshin: familja, zoti dhe atdheu.

Sipas kësaj logjike, tentativën e dytë për krijimin e një regjimi totalitar e gjejmë tek regjimi nazist, i cili po të analizohet në thellësi dhe po ta krahasojmë me regjimin stalinist rezulton të jetë një regjim në tentativë për t'u bërë total. Pavarësisht se edhe totalitarizmi edhe autoritarizmi janë dy koncepte që lindën si pasojë e fashizmit, studiuesit përgjithësisht pranojnë se në tri format e lartpërmendura, ajo që përmbush tiparet totalitare është regjimi i Stalinit. Megjithatë prej tyre është pranuar gjerësisht se të tri regjimet përfaqësonin një formë të re shoqërie politike³⁰.

1.1.1 Totalitarizmi si regjim

Shekulli i XX-të nuk njihet në histori vetëm si shekulli i zhvillimeve të mëdha ekonomike, politike dhe teknologjike, por edhe siç e ka cilësuar studiuesja Millon – Delsol “Shekulli i terrorizmit institucional³¹”. Për studiuesin Brzezinski “politika e shekullit të njëzetë... meriton të cilësohet si politika e marrëzisë së organizuar³²”. Në këtë shekull, transformimi i tendencave autoritariste të regjimeve arriti në atë formë qeverisjeje, e cila do të cilësohej me emërtimin *Totalitarizëm*.

Regjime totalitare të tipit komunist gjatë gjysmës së parë të shekullit XX-të u instaluan pothuajse në gjysmën e rruzullit tokësor. Ndër regjimet totalitare komuniste në botë studiuesit cilësojnë më të egrit regjimin Kamboxhian të Pol-Poltit dhe regjimin e Enver Hoxhës në Shqipëri. Duhet theksuar se pavarësisht karakteristikave të përbashkëta, regjimet komuniste morën tipare të caktuara dhe pësuan ndryshime në varësi të kontekstit historik dhe të tipareve të lidërshiptit. Psh: komunizmi shqiptar përfaqëson një lloj hibrid

³⁰Shiko: Arjan Dedej., etj, “Hyrtje në Shkenca Politike”, Durrës, 2011, fq. 138-40.

³¹Chantal Millon-Delsol, “*Idetë Politike në shekullin XX*”, Onufri, Tiranë, 2006. fq. 9.

³²Zbigniew Brzezinski, “*Jashtë Kontrollit, trazira që përfshiu botën në prag të shekullit XXI*”, Elena Gjika, Tiranë, 1995, fq. 7.

të totalitarizmit ku janë përzier dhe ndërthurur ideologjia marksiste-leniniste me praktikat staliniste-enveriste shtuar edhe maocedunizmin kulturor.

Po si u bë e mundur një gjë e tillë? Ashtu si edhe argumenton më tej Millon – Delsol “ato janë rezultat i braktisjes së statusit të njeriut, i shkarjes së vlerës nga njeriu tek sistemi”.

Për të kuptuar shkaqet, studiuesja na kujton se ky shekull arriti që për herë të parë të harmonizojë dy kushtet e domosdoshme për realizimin praktik të teorive utopike: a) kushti intelektual dhe b) kushti teknik³³. Shfrytëzimi i kushteve që ofronte fillimi i këtij shekulli me gërshetimin e ideve dhe aspiratave të njerëzimit për të gjetur shpresë në krijimin e një rendi të ri, të “mirëqenies”, të “barazisë”, të “prosperitetit” i dorëzuan ata në kthetrat e totalitarizmave. Por totalitarizmi i ngriti ato në një “qëllim” të realizimit praktik” përmes një “lëvizjeje konkrete”: format e totalitarizmit ushqyen vizionin e “njeriut të ri”, i cili kishte për mision krijimin e “rendit të ri” të pastruar nga të gjitha të këqijat.³⁴

Historikisht, regjimet jodemokratike kanë pasur një shumëllojshmëri të madhe formash. Sipas Huntingtonit, regjimet e demokratizuara në valën e parë ishin në përgjithësi monarki absolute, aristokraci feudale të qëndrueshme dhe shtete pasuese të perandorive kontinentale. Ato që u demokratizuan në valën e dytë kishin qenë shtete fashiste, koloni dhe diktatura ushtarake personale dhe shpesh kishin pasur një farë përvoje të mëparshme demokratike. Regjimet që lëvizën drejt demokracisë në valën e tretë, në përgjithësi, futen në tri grupe: sistemet njëpartiake, regjimet ushtarake dhe diktaturat personale³⁵. Sistemet njëpartiake u krijuan me revolucion ose me imponim nga sovjetikët dhe përfshinin vendet komuniste. Në këto sisteme, partia në fakt monopolizonte pushtetin; mundësia drejt pushtetit jepej nëpërmjet organizatës së partisë, ndërsa partia e legjitimonte sundimin e saj nëpërmjet ideologjisë. Këto sisteme shpesh arritën një nivel relativisht të lartë të institucionalizimit politik. Diktaturat personale ishin grupi i tretë dhe më i larmishëm i sistemeve jodemokratike. Karakteristika dalluese e një diktature personale është se një udhëheqës i vetëm është burimi i autoritetit dhe se pushteti varet nga mundësia, afërsia, besimi dhe mbështetja nga udhëheqësi³⁶.

Përgjithësisht studime serioze për analizën e këtyre regjimeve filluan vetëm pas Luftës së II-të Botërore, kjo edhe si pasojë e lindjes së konfliktit ideologjik lindje – perëndim me fillimin e luftës së ftohtë. Sistemi që kishte arritur t’i mbijetonte luftës ishte komunizmit sovjetik. Ky triumf ishte një kërcënim i vazhdueshëm për demokracinë liberale ndaj dhe interesi i studimit u rrit shumë. Politologë, mendimtarë dhe studiues të shquar perëndimorë si Arendt, Lefort, Aron, Sartori, Brzezinski, Djilas etj, e kanë analizuar gjerësisht konceptin e totalitarizmit.

³³Ibid., fq.11. *Kushti intelektual kishte të bënte me filozofinë moderne të shndërrimit rrënjësor të shoqërisë dhe njeriut, ndërsa kushti teknik më zhvillimet teknologjike që u vunë në shërbim të shtetit shtypës.*

³⁴Llambro Filo, “*Historia për sistemet e qeverisjes*”, EXTRA, Tiranë, 2005, fq. 243.

³⁵Samuel Huntington “*Vala e tretë*”, Tiranë, AIIS, 2011, fq. 71.

³⁶ Ibid., fq. 72.

Pavarësisht pikëpamjeve të tyre mbi këtë çështje, të gjithë bashkohen në një pikë se: *totalitarizmi nuk është gjë tjetër veçse dhunimi i lirisë së individit dhe shtetit apo se totalitarizmi ndërtohet mbi rrënimin e të drejtave të njeriut dhe të shtetit*³⁷.

Megjithatë, tablonë dhe përkufizimin më të plotë të konceptit mbi sistemin totalitar na e jep studiuesja Hanah Arendt. Ja, si shprehet ajo:

Totalitarizmi është një formë rrënjësisht e re shfrytëzimi që karakterizon si bolshevizmin ashtu dhe nazizmin, që të dy sisteme politike të mbështetur mbi terrorin e të dominuar prej “ideologjisë totalitare”. Totalitarizmi nuk synon vetëm transformimin e shoqërisë mbi të cilën ushtrohet pushteti, por kërkon të ndryshojë vetë “natyrën njerëzore” (krijimin e “njeriut të ri”). Despotizmat dhe tiranitë e vjetra në thelb u mjaftuan me shkatërrimin e kapaciteteve politike dhe organizative të njerëzve dhe nuk arritën të vinin nën shënjestër apo të shkatërronin rrjetin e marrëdhënieve private të tyre, pra nuk goditën mbi “unin” në aspektin e personalitetit të çdo individi, gjë që në eksperiencën totalitare goditet sistematikisht.³⁸

Më tej, ajo vazhdon se: “Totalitarizmi nuk kënaqet kurrë me sundimin me mjete të jashtme, d.m.th. përmes shtetit dhe makinerisë së dhunës; falë ideologjisë së tij të veçantë dhe rolit të caktuar atij në këtë aparat të detyrimit, totalitarizmi ka shpikur një mënyrë të dominimit dhe terrorizmit të qenieve njerëzore nga brenda”.³⁹

Një studiues tjetër, Richard Pipes pohon se “Shtetet totalitare kanë për qëllim të errësojnë çdo dallim mes tyre dhe qytetarisë (shoqërisë) duke penetruar dhe kontrolluar çdo aspekt të jetës së organizuar... në një shtet të tillë, ligji nuk është mjet për mbrojtjen e individit por mekanizëm për të qeverisur⁴⁰”.

Pra, thelbi i totalitarizmit është frika për të nesërmen si pasojë e asgjësimit të njeriut dhe e ndërtimit të shoqërisë si një e tërë. Totalitarizmi përcaktohet si një sistem politik i regjimeve njëpartiake, të cilat nuk tolerojnë asnjë opozitë të organizuar në jetën politike. Në këtë sistem politik, shteti kontrollon totalitetin e aktiviteteve të shoqërisë dhe të individit.

Pas Luftës së Dytë Botërore, falë rolit që luajti shteti sovjetik për arritjen e fitores mbi fashizmin, regjimi i tipit sovjetik u shtri në një varg shtetesh të Evropës Lindore e Juglindore (Poloni, Hungari, Çekosllovakia, R.D. Gjermane, Rumani, Bullgari, Jugosllavi, Shqipëri)⁴¹.

Për arsye të arritjes së objektivave të këtij punimi vëmendja jonë do fokusohet në tiparet e sistemit totalitar, tipi komunist – stalinist, pasi regjimi që ndoqi Shqipëria pas Luftës së Dytë Botërore ishte në një masë të madhe kopje e tij.

³⁷ Sintezë e autorit.

³⁸ ASHRT, “*Dekomunizmi: Aktualitet dhe Histori*”, Nr. 4, 2004, fq. 70.

³⁹ Hannah Arendt, “*Origjinat e totalitarizmit*”, DIJA, Prishtinë, 2002, fq. 420.

⁴⁰ Richard Pipes, “*Komunizmi, Historik i shkurtër*”, Gjergj Fishta, Tiranë, 2002, fq. 79.

⁴¹ Adem Mezin, “Si ta përcaktojmë shekullin XX?”, Sfidë, Nr.5, Vjeshtë 2005-Dimër 2006, fq. 24.

1.1.2. Karakteristikat dhe tiparet kryesore të regjimeve totalitare; tipi komunist

Pas Luftës së Dytë Botërore shumë shtete zgjodhën modelin ideologjik marksist – leninist si rrugë të vetën drejt modernizimit dhe si model të llojit të regjimit. Ideologjia marksiste – leniniste që ato përkrahën u dha në një masë të caktuar karakteristika uniforme, të hekurta, në realizimin e sistemit politik dhe shoqërisë. Komunizmi bashkëkohor është ai lloj i totalitarizmit në të cilin tre janë faktorët bazë për sundimin mbi njerëzit d.m.th. pushteti, prona dhe ideologjia janë monopol i vetëm i një partie politike. Fjala *Komunizëm* filloi të përdorej në Paris rreth vitit 1840 duke u lidhur me tri fenomene qartësisht të dallueshme nga njëri-tjetri: ideali, programi dhe regjimi i ngritur për realizimin e dy të parave⁴². Deri në vitin 1917, socializmi ekzistonte vetëm si teori, kurse pas Revolucionit Rus u bë realitet. Kështu, filloi alternativa e socializmit totalitar, e cila për 75 vjet dominoi dhe paraqitej si tendencë e përgjithshme e zhvillimit historik⁴³.

Pikë së pari, totalitarizmi komunist imponon një model të shoqërisë që do të themelohet pa ndarje, që do ta zotëronte plotësisht organizimin e vet, që do të hynte në raport me vetveten në të gjitha pjesët e veta, nëpërmjet projektit të ndërtimit të socializmit. Në ideologji, socializmi është parrullë dhe premtim, besim dhe lumturi. Studiuesi Vyshka na kujton faktin se është e nevojshme që të kuptohet se utopia e ideologjisë komuniste nuk mund të implementohet sipas teorisë së Marksit. Ai pohon se: *“Ndofta duhet ta marrim në konsideratë edhe mundësinë që komunizmi të ketë qenë, në fakt, një mutacion spontan që deformati tmerësisht perspektivat sociale, të menduarit, logjikën politike dhe orientimin ekonomik, të gjysmës së rruzullit⁴⁴”*.

Në veprën e Milovan Gjilasit “Fytyra e totalitarizmit” ky deformim i adresohet interpretimit nga ana e Leninit.

“Tezat revolucionare të Marksit janë të kushtëzuara dhe aspak të domosdoshme për të gjithë”, shkruan Gjilas, ndërsa Lenini i ngriti ato në parim absolut dhe universal. Në librin e tij “Sëmundja foshnjore e “majtizmit” në “komunizëm” që ndoshta është punimi i tij më dramatik, ai “e zhvilloi më tej” dhe e thënë me fjalë të tjera e ndryshoi tezën e Marksit.⁴⁵”

Pasuesit e Marksit u përpoqën që tezat e tij t’i sistemonin në një qasje gjithëpërfshirëse duke krijuar një filozofi të re, e cila ndryshonte në esencë nga doktrina Marksiste. Duke mos dashur të hyjmë në detaje, baza ideologjike e komunizmit ishte binomi doktrinal Marksizëm – Leninizëm.

Studiuesit mendojnë se disa nga arsyet që këto vende parapëlqyen këtë model janë:

⁴²Shiko: Richard Pipes, “Komunizmi, Historik i shkurtër”, Gjergj Fishta, Tiranë, 2002, fq. 5.

⁴³Adem Mezini, “Shekulli XX”, EXTRA-R, Tiranë, 2010, fq. 48.

⁴⁴Gentian Vyshka, “(De)Komunizmi: Aktualitet dhe Histori”, *Dekomunizmi: Aktualitet dhe Histori*, ASHRT, Nr. 4, 2004, fq. 122-3.

⁴⁵Milovan Gjilas, “Fytyra e Totalitarizmit”, Fan Noli, Tiranë, 2006, fq. 158.

- a) Leninizmi kishte si vlerën më të rëndësishme ringjalljen ekonomike, më shumë sesa të drejtat abstrakte individuale.
- b) Duke pretenduar të ofrojë saktësi shkencore në parashikimet e veta për triumfin e të shtypurve, leninizmi u jep shpresë të pashpresëve.
- c) Duke justifikuar prapambetjen e vendeve të pazhvilluara në kuadrin e shtypjes së perëndimit, leninizmi e zhvendos fajin për moszhvillim dhe kështu nxit respektin e botës më pak të zhvilluar.
- d) Marksizëm – leninizmi ofron një model të industrializimit të suksesshëm brenda një brezi, në kundërvënje me dy shekujt që u deshën për këtë proces në perëndim⁴⁶.

Ndër regjimet totalitare të tipit komunist veçojmë atë në Bashkimin Sovjetik, në vendet e Europës Lindore dhe Qendrore, në Shqipëri, Kinë, Korenë e Veriut etj. Secili vend pati specifikat dhe të veçantat e tij, kjo kushtëzuar edhe nga faktorët pararendës psh “totalitarizmi komunist në aplikimin e tij sovjetik ishte i gjithi i projektuar drejt së ardhmes, ndërsa në aplikimin aziatik rekuperon disa elemente tradicionale të së kaluarës⁴⁷”. Pavarësisht diferencave gjithmonë mund të bëhet një lidhje me vijën e përpunuar në Moskë në nëntor 1917. Sipas studiuesit Pipes “kjo lidhje formon një lloj kodi gjenetik të komunizmit⁴⁸”, ku pavarësisht ndryshimeve, karakteristikat themelore mbeten po ato.

Këtu vlen të ndalemi pak tek zanafilla e regjimeve totalitare të tipit komunist. Shumëkush e di se ngjarjet që rrodhën fill pas revolucionit të vitit 1917 në Rusi merren si shkaktaret, të cilat përcaktuan fatin e një vendi si Rusia për një periudhë 70 vjeçare. Rrënjët e instalimit të sistemit komunist në Rusi gjenden në fitoren e Partisë Komuniste në Revolucionin e Tetorit të vitit 1917. Ka diskutime të gjera në lidhje me arsyet që çuan në zhvillimin e këtij revolucion. Vetëkuptohet që revolucionin nuk ndodhi sipas parashikimeve të Marksit.

Rusia nuk ngjasonte në asnjë aspekt me djepin ku sipas Marksit do të lindte revolucionin. Rusia e vitit 1917 ishte e prapambetur, gjysmëfeudale, me një rend monarkik absolut e me një centralizim burokratik, një vend që nuk kishte njohur reformimin, rilindjen dhe borgjezinë.

Deri në atë kohë asnjë revolucion, asnjë parti nuk i kishte vënë vetes detyrën e ndërtimit të marrëdhënieve shoqërore, gjë e cila për revolucionet komuniste ishte qëllimi bazë. Një pamje të plotë të asaj se si një rend zëvendëson një tjetër nëpërmjet manipulimit, përpiqet të na e argumentojë studiuesi Ferdinand Braudel kur fletë për revolucionin e vitit 1917 në Rusi. Ja, si shkruan ai:

⁴⁶Lawrence C. Mayer, John H. Burnett, “Politikat Krahasuese kombet dhe teoritë në një botë që ndryshon”, Ora, Tiranë, 2003, fq. 225.

⁴⁷Arjan Dedej etj, “Hyrje në Shkenca Politike”, Durrës, 2011, fq. 140.

⁴⁸Richard Pipes, “Komunizmi, Historik i shkurtër”, Gjergj Fishta, Tiranë, 2002, fq. 86.

... revolucioni socialist filloi rastësisht në vendin e madh më të paindustrializuar të Europës së asaj kohe. Për rrjedhojë, ishte e pamundur që revolucioni të zhvillohej atje sipas skemës marksiste të marrjes së pushtetit nga proletariati. Pushteti u mor nga Partia Komuniste domethënë një pakicë shumë e vogël në shkallë Rusie, mbase 100,000 vetë. Kjo pakicë e organizuar për mrekulli përfitoi nga shpartallimi i dhjetë deri dymbëdhjetë milionë fshatarëve që ikën nga radhët e ushtrisë dhe duke u vrarë me njëri-tjetrin kur ua lypte nevoja, u derdhën drejt fshatrave të tyre dhe filluan të pushtonin atje tokat e aristokratëve, e borgjezëve të pasur, të kishës, të manastireve, të Kurorës dhe të shtetit...⁴⁹.

Strategjia e marrjes së pushtetit nga Partia Komuniste është eliminimi i të gjitha formacioneve politike rivale, nënshtrimi i të gjitha formave të organizimit shoqëror, përqendrimi i të gjitha mjeteve të vendosjes dhe detyrimit në duart e saj.

Po si u arrit të transformohej një ideologji utopike në veprime praktike konkrete? Si u përdorën miliona fshatarë që as e njihnin Marksizmin dhe marksizmin për të realizuar një revolucion mbi të cilin një pakicë njerëzish fituan dhe mbajtën legjitimitetin e pushtetit? Si arritën Lenini, e më pas Stalini, të skllavërojnë në emër të diktaturës së proletariatit tashmë jo vetëm Rusinë, por gati gjysmën e botës? Sipas studiuesit Pipes nëse dikush habitet, se si një qeveri mund t'i shkaktojë popullit të saj vuajtje të tilla shkatërrimtare, duhet të ketë parasysh se për komunistët revolucionarë në Rusi e kudo, qeniet njerëzore *ashtu siç ishin* përfaqësonin një parodi të asaj se çfarë mund dhe *duhej doemos të bëheshin* (nënvizimi ynë- E.Z.). Çmimi dhe sakrificat ia vlenin sepse “njeriu i ri”, në sajë të sistemit komunist do të ishte ndryshe nga çdo krijesë njerëzore e deritanishme. “Për të arritur këtë ideal, pra, a nuk ia vlen të sakrifkoheshin ato lloje të mjerë njerëzish që popullonin këtë botë të degjeneruar? E parë nga kjo perspektivë, njerëzimi ekzistues ishte fundërrinë, pleh i një bote të rrënuar dhe masakrimi i tij ishte diçka pa pasoja⁵⁰”.

Pra, baza e fatkeqësisë duhet kërkuar tek ideologjia e marksizëm – leninizmit, sidomos tek leninizmi, i cili është edhe themeluesi i vërtetë i komunizmit.

Studiuesit më në zë si Arendt, Aron, Friedrich & Brezezinski, Lefort, Shumpeter etj, që kanë studiuar dhe analizuar tipet dhe format e regjimeve totalitare bien dakort për disa karakteristika të përbashkëta të këtyre regjimeve dhe sidomos për tipin komunist. Psh: Studiuesi R. Aron përcakton pesë elementët kryesorë të totalitarizmit:

- 1) Fenomeni totalitar shfaqet në rastin e regjimit kur një parti ka monopolin e veprimtarisë politike,
- 2) Partia monopoliste ka një ideologji me pozita absolute, e cila është ideologji zyrtare e shtetit,
- 3) Përhapja dhe mbrojtja e ideologjisë zyrtare dhe e të vërtetave të saj bëhet nga shteti nëpërmjet mjeteve të dhunës dhe mjeteve të informimit masiv që kontrollohen tërësisht nga shteti,

⁴⁹Fernand Braudel, “Gramatikë e qytetërimeve”, SHL&K, Tiranë, 2005, fq. 529-530.

⁵⁰Richard Pipes, “Komunizmi, Historik i shkurtër”, fq. 54 – 55.

- 4) Veprimtaria ekonomike e profesionale kontrollon gati tërësisht nga shteti dhe i shërben ideologjisë zyrtare,
- 5) Shoqëria është tërësisht e politizuar dhe çdo gabim shikohet në prizmin ideologjik dhe goditet ashpër me të gjitha metodat⁵¹.

Po në të njëjtën kohë, dy studiues të tjerë duke analizuar cilësitë e totalitarizmit i grupuan ato si më poshtë:

- 1) Një ideologji gjithëpërfshirëse dhe militariste si udhëheqje për të gjitha aspektet e jetës.
- 2) Një parti e vetme, elitë, e përkushtuar ndaj kësaj ideologjie.
- 3) Një sistem terrori i dhunës dhe arbitraritetit të pakontrolluar.
- 4) Kontroll i plotë i mjeteve të komunikimit masiv.
- 5) Kontroll i plotë dhe i centralizuar i përdorimit të armëve efektive.
- 6) Kontroll i centralizuar i ekonomisë dhe i gjithë institucioneve të tjera të shoqërisë civile⁵².

Ne po ndalemi tek disa prej këtyre tipareve duke i analizuar pak me gjerë.

Ideologjia totalitare

Ideologjia totalitare⁵³ lidhet me shndërrimin e njeriut dhe të shoqërisë ndryshe nga ç'ka qenë ajo gjithmonë, nëpërmjet një plani për ndryshimin tërësor të saj. Ky ndryshim duhet të jetë total dhe rrënjësor dhe ideologjia e gjithanshme e realizon këtë. Ajo është harta, rruga nga ku duhet të kalojë shoqëria si një e tërë për realizimin e qëllimit final: *shoqërinë e përsosur*.

Një përkufizim klasik të ideologjisë totalitare na e japin studiuesit Friederich dhe Brzezinski kur pohojnë se:

“Ideologjia është një bashkësi idesh në mënyrë të arsyeshme dhe koherente, që u përkasin mjeteve praktike për të ndryshuar totalisht dhe për të ndërtuar një shoqëri me forcë ose me dhunë, të bazuar mbi një kritikë botërore ose të përgjithshme të asaj që është e gabuar në shoqërinë ekzistuese ose paraprirëse”⁵⁴

Ky grup idesh e konsideron shoqërinë njerëzore si një problem historik dhe si i tillë ai është edhe i ndryshueshëm dhe i mundshëm për çdo lloj eksperimentimi që prek thelbin e saj pra, strukturën e organizimit. Kjo teori shkencore e ligjëronte transformimin e njeriut

⁵¹ Vep.cit në Sfidë, Nr.5, Viti IV, botimi Vjeshtë 2005-Dimër 2006, “Si ta përcaktojmë shekullin XX?”. Adem Mezin fq. 34; burimi origj. R. Aron, “Democratie et totalitarisme”, Gallimard, Paris, 1965, fq. 287-288.

⁵²Ibid., vep.cit., fq. 34.

⁵³Shiko: Llambro Filo, “Historia për sistemet e qeverisjes”, EXTRA, Tiranë, 2005, fq. 28-30 dhe fq. 283-9.

⁵⁴Vep.cit. në Arjan Dedej etj, “Hyrje në Shkenca Politike”, Durrës, 2011, fq. 143.

si shfaqjen e një specijeje të re që gjenialiteti i Marksit e kishte parashikuar. Ky njeri i ri i zhveshur nga individualizmi i tij egoist, tashmë pa kontradikta, do të ndërtonte lumturinë e vet duke u sakrifikuar për lumturinë e bashkësisë. Bashkësia shoqërore nuk mund të ishte e tillë pa eliminimin e strukturave të vjetra klasore.

Kjo i hap rrugë luftës së klasave që është shtylla e realizimit të teorisë marksiste – leniniste. E bazuar në luftën e klasave, teoria marksiste – leniniste e koncepton shtetin si instancë të sundimit të një klase mbi klasat e tjera dhe shoqërinë komuniste – fazën përfundimtare të socializmit – e koncepton si shoqërinë ku klasat do zhduken, e në të njëjtën kohë, çka është logjike, do të zhduket edhe shteti⁵⁵. Nën ndikimin e vazhdueshëm ideologjik dhe indoktrinues të sistemit totalitar, shoqëria pëson goditje si e tërë. Ajo arrin në një proces indoktrinues saqë e shkëput atë nga realiteti duke e bërë vegël të sistemit. Në lidhje me këtë pikë, studiuesja Delsol argumenton se: “Deri diku, ideologjia s’është gjë tjetër veçse një arsytim i hapur, që përpunohet vazhdimisht që të harrohen më kollaj realitetet që ajo mohon⁵⁶”. Në emër të tjetërsimit dhe të ndërtimit të shoqërisë së re njerëzit duhet të pohojnë krime imagjinare në mënyrë që dhuna e ushtruar të justifikohet deri në atë masë sa të përshfaqet si akt heroik dhe në të mirë të vetë shoqërisë. Ideologjia nuk pranonte asnjë kritikë: kritika për të përbënte krim.

Terrori totalitar

Terrori fillon kryesisht kur shtypet dhe eliminohet opozita dhe kur grupet “armiqësore” asgjësohen. Terrori realizohet nëpërmjet një aparati policor të bindur deri në verbëri dhe të mirëdisiplinuar. Regjimi e bazon jetën e tij mbi manipulimin e masës, e cila doemos që nuk mund të jetë 100% e bindur ose e manipuluar dhe për pasojë prodhon gjithmonë një armik, një sabotator ose komplot imagjinari. Imazhi i armikut ku do të ushtrohet terrori dhe shembulli kuptohet përmes metaforës së trupit që ishte e pranishme që në kohën e Leninit. “*Fushata kundër armiqve të popullit zhvillohej nën parrullën e profilaksisë sociale: integriteti i trupit varet nga eliminimi i parazitëve*⁵⁷”. Shoqëria në tërësinë e vet shikohet si një organizatë e madhe, brenda të cilës shtohen në të gjithë hapësirën organizime dhe struktura të ngjashme si një rrjetë merimange të cilës nuk mund t’i shpëtojë asgjë dhe në këto kushte: “Terrori ka vlerë terapeutike⁵⁸”; madhështia e qëllimeve për ligj mizorinë e mjeteve. Lenini ishte hartuesi dhe ideatori i terrorit. Të dhënat tregojnë se në katër vitet e para të sundimit të tij, “ai ekzekutoi 140,000 njerëz dhe hapi 132 kampe përqendrimi”. Si në Rusi, edhe në Shqipëri ashpërsimi i sundimit komunist u shoqërua me institucionalizimin e mekanizmit të terrorit. Studiuesi Musta na përmend të dhëna mbi këtë fakt: “*Shtimi i efektivitetit të policisë politike (të Ministrisë së Punëve të Brendshme) të cilët nuk i kalonin 4,000 efektiva në vitin 1945; vetëm pas 5*

⁵⁵Chantal Millon-Delsol, “*Idetë Politike në shekullin XX*”, Tiranë, Onufri, 2006, fq. 15.

⁵⁶Ibid., fq. 57.

⁵⁷Claude Lefort, “*Demokracia dhe Totalitarizmi*”, Dukagjini, Pejë, 1994, fq. 115.

⁵⁸Delsol, fq. 37.

vitesh, në vitin 1950, numri i tyre në këtë dikaster shkoi rreth 20,000 vetë⁵⁹”. Shtimi i policisë sekrete zhvilloi dukshëm politikën e terrorit dhe represionin masiv.

Terrori nuk buron vetëm nga etja për pushtet. Ai ushtrohet pikërisht për të përmirësuar dhe transformuar njeriun e ri, i cili është i dobët dhe ka nevojë që të drejtohet dhe të udhëhiqet me dorë të hekurt.

Ndërtimi i shtetit të diktaturës bazohet në ushtrimin e dhunës sistematike. Është karakteristike e tij që armët e dhunës në fillim të përdoren për të shkatërruar borgjezinë dhe në rrjedhën e kohës kjo diktaturë e proletariatit shndërrohet në diktaturën e partisë mbi popullin, siç pohon dhe Mao “*pushteti del nga gryka e pushkës, por është partia ajo që kontrollon pushkën*”. Por si ka mundësi që pavarësisht kombësisë, komunistët kudo nëpër botë janë shquar për terrorin e ushtruar? Si ka mundësi që edhe kur nuk ishte i nevojshëm ai ushtrohej sistematikisht?

Për disa studiues, psikologjia e pushtetit dhe e krimit të drejtuesve të partive komuniste ngjason me atë të organizatave kriminale të ditëve tona. Sipas analizës së studiuesit Fredo Arias-King “*fenomeni i terrorit duhet kërkuar tek psikologjia e nomenklaturës*⁶⁰”. Krahasimi i psikologjisë së individëve që bëheshin pjesë e nomenklaturës është shumë interesant. Shpesh në partitë komuniste afroheshin njerëz veprimet e të cilëve në kushte normale do ishin dënuar apo këta njerëz do të ishin mbyllur në institucionet e shëndetit mendor. Kjo liri e pakufizuar gjendej pikërisht në strukturat e policisë sekrete të çdo vendi komunist. Për të konkretizuar mekanizmin e orkestruar nga kryedrejtuesi i komunizmit, Lenini, po japim disa pasazhe nga urdhrat kriminalë të tij. Gusht 1918; direktivë e Leninit drejtuar punëtorëve⁶¹:

Kulaku përçmon marrëzisht autoritetin sovjetik dhe është i gatshëm të mbysë e të copëtojë qindra mijëra punëtorë... Ose kulaku do të copëtojë një numër të pafund punëtorësh, ose punëtorët do të shtypin pa mëshirë kryengritjen e një pakice hajdutësh kundër atyre që punojnë tokën... kulakët janë shfrytëzuesit më të egër, më të ashpër dhe më gjakësorë... këta gjakëpirës kanë mbledhur pasuri gjatë luftës duke shfrytëzuar popullin... Këto shushunja janë dhjamosur nga shfrytëzimi i fshatarëve të varfëruar nga lufta dhe i punëtorëve të uritur. Ata pijnë gjakun e atyre që punojnë tokën duke u bërë gjithnjë e më të pasur, sa më tepër vuajnë nga uria punëtorët në qytete e fabrika. Vampirët kanë mbledhur e vazhdojnë të mbledhin në duart e tyre tokat e pronarëve të mëdhenj duke i skllavëruar gjithnjë e më tepër fshatarët e varfër. Luftë të pamëshirshme kundër kulakëve! Vdekje atyre!

⁵⁹Agim Musta, “*Libri i zi i komunizmit shqiptar*”, Naim Frashëri, Tiranë, 2007, fq.389-0.

⁶⁰Arias-King Fredo, “*The centrality of elites*”, Demokratizatsiya, winter 2003, fq.152, Pro Quest Central (burim online)

⁶¹Vep.cit në Richard Pipes, fq. 41- 42.

Urdhër i fshehtë, dërguar zyrtarëve komunistë në provincën Penza:

Shokë! Kryengritja e pesë distrikteve kulake duhet shtypur pa mëshirë. Interesat e revolucionit e kërkojnë këtë, sepse tani është “beteja e fundit Vendimtare”! Me kulakët po vazhdon gjithkund. Duhet dhënë një shembull:

- 1) Varini (varini pa ngurim, që njerëzit t’i shikojnë) jo më pak se 100 kulakë të njohur, të pasur e gjakëpirës.
- 2) Publikoni emrat e tyre.
- 3) Konfiskoni gjithë grurin e tyre.
- 4) Merrni pengje sipas telegramit të djeshëm. Bëjeni këtë në mënyrë të atillë që për qindra kilometra rreth e rrotull njerëzit të shikojnë, të dridhen, ta marrin vesh e të bërtasin, “po u përdridhet koka deri në vdekje kulakëve gjakëpirës”.
- 5) Telegrafim dhe zbatim.
Gjeni disa njerëz, vërtet të vështirë e të vendosur!
Gjeni disa njerëz, vërtet të vështirë e të vendosur!

Juaji Lenin

Në një memorandum drejtuar Byrosë Politike, pranverë 1922:

“Pikërisht tani dhe vetëm tani, kur në rajonet e uritura njerëzit po hanë mish njeriu dhe qindra në mos mijëra kufoma mbeten rrugëve, ne mund (dhe duhet) të kryejmë konfiskimin e pasurive të kishës duke vepruar energjikisht e pa mëshirë... për të siguruar kështu për veten tonë një fond prej disa qindra milionë rubla ari⁶²”

Politika të ngjashme terrori janë ndjekur pothuajse nga çdo drejtues komunist përgjatë sundimit të vet. Rezultati më domethënës i terrorit ishte “krijimi i frikësimit masiv⁶³.”

Homogjeniteti i shoqërisë

Një tipar thelbësor i regjimeve totalitare është përpjekja e tyre e vazhdueshme për ta trajtuar shoqërinë si një e tërë. Kjo ka të bëjë pikë së pari me pushtetin, i cili afirmohet në fillim si pushtet social duke e konfiguruar shoqërinë si fuqi të vetëdijshme vepruese. Krijimi i një shoqërie homogjene pa ndarje dhe dallime realizohet nëpërmjet logjikës së identifikim – njësimi. Kështu, proletariati njësohet me popullin, partia me proletariatin, byroja politike me udhëheqësin dhe udhëheqësi me partinë dhe popullin. Organizimi i masës është kushti themelor që lëvizja totalitare të zhvillohet. Identiteti social i individëve i lë vendin ndjenjës të përkatësisë në një masë dhe devotshmëria ndaj kreut të shtetit kthehet në të vetmen arsye të ekzistencës dhe bëhet një fanatizëm psikotik. Në këtë

⁶² Vep. cit., në Richard Pipes, fq. 45.

⁶³ Vep. cit., Llambro Filo, fq. 264.

mënyrë realizohet edhe dominimi total: armiqtë bëjnë autokritikë gjatë proceseve në të cilat ata pranojnë fajet e tyre.

Një nga karakteristikat e regjimit totalitar është se ai nuk kontrollon vetëm aktivitetet e individit, siç ndodh në një diktaturë klasike, por arrin të futet deri në sferën intime të mendimit dhe veprimit duke imponuar tek të gjithë qytetarët aderimin në një ideologji të detyrueshme jashtë të cilës ata do të konsideroheshin si armiq. Karakteri i veçantë i totalitarizmit nuk gjendet as tek propaganda, as tek përmbajtja ideologjike e tij, por tek organizmi. Prandaj, Hannah Arendt me të drejtë i cilëson lëvizjet totalitare si “shoqëri sekrete që zhvillohen në mes të ditës”. Studiuesja me të drejtë e cilëson masën popullore si gurin themelor të totalitarizmit.

Mënyra e punës dhe mekanizmat e saj i kthejnë njerëzit në automatizma të shoqërisë. Një njeri i masës, në regjimet totalitare mund të jetë çdokush, një njeri i izoluar që jeton eksperiencën e çrrënjëzimit social dhe kulturor. Ky individ shumë shpejt do të gjejë vetveten tek totalitarizmi, i cili i ofron një koherencë jashtë realitetit me të cilën përballet individi.

Shumë shpejt, ai do të identifikohet me udhëheqësin e lëvizjes, të cilin e shikonte si një qenie të jashtëzakonshme. Realizimi i unifikimit shoqëror çoi në një luftë të vendosur kundër lirisë së fjalës dhe shkatërrimit të jetëve njerëzore. Duheshin kontrolluar të gjitha rrugët e informimit të popullatës, propaganda duhej të ishte në çdo fushë të jetës. Në përpjekje për të realizuar unifikimin e shoqërisë, regjimet komuniste internuan, burgosën dhe ekzekutuan ata që kishin guximin dhe iniciativën për të mos pranuar konformizmin. Në më të shumtën e rasteve, këto sisteme zhdukjin më të aftit dhe iniciatorët. Popujt humbën besimin tek aftësitë e tyre për më shumë se gjysmë shekulli; ata brendësuan modelin apatik, të nënshtruar, pa kurajo dhe pa iniciativë.

Sipas Gjilasit:

“Këta oligarkë kujdestarë shpirtrash që mbikqyrin me vigjilencë se mos mendimi njerëzor fillon të notojë në “ujëra armike antisocialiste”, këta furnitorë të mallrave shpirtërore të pavlera, këta njerëz kanë ngurtësuar dhe e kanë vrarë jetën shpirtërore të popujve të tyre⁶⁴”.

Vlerat perëndimore u trajtuan si antivlera, madje si krime të rënda. Nëse i referohemi studiuesit S. Meksi “Ideokracia formon identitetin shoqëror nëpërmjet aparatit politik të propagandës dhe dhunës. Kjo kulturë e re që i imponohet masës së popullsisë paraqitet në antitezë me trashëgiminë e vjetër kulturore pretotalitare⁶⁵”

Nomenklatura ose Klasa e Re⁶⁶

⁶⁴Milovan Gjilas, “Fytyra e Totalitarizmit”, Tiranë, Fan Noli, 2006, fq. 300.

⁶⁵Sofokli Meksi, “Mbi disa aspekte të trashëgimisë totalitare gjatë periudhës së tranzicionit shqiptar”, Jehona, Tiranë, 2008, fq. 65.

⁶⁶Titulli i një prej punimeve më interesante mbi këtë argument nga M. Gjilas.

“Komunizmi bashkëkohor është para së gjithash bartës i klasës së re të pronarëve dhe shfrytëzuesve⁶⁷”. Dogma kryesore e regjimit komunist, pa diskutim që ishte ndërtimi i një shoqërie pa klasa. Komunizmi justifikoi e propagandoi çdo gjë, vetëm e vetëm për ta mohuar këtë tendencë të pashmangshme. Eliminimi i pronës private dhe lindja e pronës shtetërore krijoi një klasë të panjohur deri atëherë në historinë e njerëzimit. “Ky ishte fati i pashmangshëm i çdo partie udhëheqëse komuniste⁶⁸”. Për Arendt një nga elementët kryesorë të vendosjes së totalitarizmit është ndërtimi i burokracisë, e cila është e domosdoshme për funksionimin e regjimit totalitar. Shkatërrimi i sistemit klasor do të thoshte automatikisht shkatërrimi i sistemit partiak, kryesisht sepse këto parti, duke qenë parti interesash nuk mund të përfaqësonin më gjatë interesat klasore⁶⁹.

Duke shkatërruar pronën private, klasa e re në parim nuk mund të bazohej në ndonjë lloj prone tjetër që të kishte pamjen e saj. Për Gjilasin⁷⁰ “Iluzioni se rendi komunist nuk krijon pronësi në ndonjë klasë të caktuar dhe se prona ishte e të gjithë shoqërisë dhe të gjithë kombit ishte një hedhje hi sysh për njerëzit e thjeshtë, të cilët nuk e kuptonin mekanizmin e përdorimit dhe shfrytëzimit të pronës së të gjithëve të cilën e gëzonin vetëm ata *klasa e re e drejtuesve*”. Totalitarizmi i pushtetit dhe monopoli mbi pronën është struktura mbi të cilën është themeluar kjo klasë. Udhëheqja është zemra e sistemit që ju jep mundësinë të drejtojnë dhe të gëzojnë privilegje.

Karakteristika dalluese e klasës drejtuese është pronësia e një lloji të veçantë, pronësia kolektive, më saktë karakteri gjithëpërfshirës dhe total i pronës në duart e shtetit. Klasa drejtuese e ndjen instinktivisht se pasuritë kombëtare janë bërë faktikisht pronë e saj ndërsa etiketat e tipit “pronë socialiste”, “pronë shoqërore” apo “pronë shtetërore” janë vetëm terma juridike boshe. Kulti i shtetit kuptohet fare qartë. Shteti nuk është më mjet i shoqërisë, por është shoqëria që kthehet në mjet të shtetit. Shkrirja e politikës me ekonominë është thelbi i dominimit të shoqërisë, si edhe nënshtrimi total i forcave ushtarake ndaj pushtetit politik.

Është jashtëzakonisht afër reales interpretimi që ka bërë mendimtari jugosllav Milovan Gjilasi në lidhje me këtë argument. Në punimet e tij argumentohet pikërisht mosarritja e këtij synimi (shtetit të zhveshur nga interesat e veta) nga sistemi komunist. Po ashtu siç pohon dhe studiuesi Pipes: “Midis shumë zhgënjimeve të Leninit ishte edhe lindja e një burokracie të pakontrollueshme gjigande dhe që i shërbente vetes⁷¹”. Në doktrinën marksiste, shteti nuk është asgjë më tepër se një shërbëtor i klasës që zotëron mjetet e prodhimit dhe nuk ka interesa të tijat.

Po cila ishte kjo klasë? Cilët ishin faktorët që çuan në lindjen e saj? Si arriti ajo të impononte sundimin e vet? Sipas Milovan Gjilasis, kjo klasë e re është burokracia

⁶⁷Ibid.,(62) (M.Gjilasi), fq. 218.

⁶⁸Ibid., fq.195.

⁶⁹Hannah Arendt, “*Origjinat e totalitarizmit*”, DIJA, Prishtinë, 2002. fq. 407.

⁷⁰Milovan Gjilasi njihet nga lexuesi shqiptar përmes dy veprave, “*Fytyra e Totalitarizmit*” dhe “*Shoqëri e Papërsosur*” në të cilat trajtohet gjerësisht argument i lartpërmendur. Për sa më sipër shih Gjilasi fq. 200-220.

⁷¹R. Pipes, fq. 38.

politike, e cila mbart atributet e çdo klase sunduese që njih historia, por me një cilësi të veçantë: lindja e saj nuk u parapri nga një formë e re marrëdhëniesh ekonomike, përkundrazi ajo mori përsipër pikërisht realizimin dhe krijimin e marrëdhënieve ekonomike përmes sundimit të saj. Ky kapërcim jonatyral në vendosjen e sunduesve të rinj gjendet pikërisht tek partia komuniste. Pra, bazat e klasës së re gjenden tek ajo shtresë që përbën bërthamën e partisë përpara marrjes së pushtetit që me triumfin e arritur qoftë në rrugë revolucionare (si në Rusi, qoftë me atributet e çlirimtarëve si në Shqipëri) do të shndërrohet gradualisht në klasën e re udhëheqëse dhe shfrytëzuese. Komunisti që hyn në klasën e re beson gjithashtu se pa partinë e tij shoqëria do të kthehej prapa e do të vdiste. Po t'i referohemi të dhënave për Shqipërinë, numri i anëtarëve në Partinë Komuniste në kohën e luftës numërohej rreth 3,000. Brenda një harku kohor prej 28-30 vitesh, numri u 30-fishua duke arritur 88,000 anëtarë. Nuk përjashtohet fakti që ndërmjet tyre ka patur njerëz idealistë, komunistë të vërtetë, ashtu siç nuk mund të përjashtohet fakti që shumë prej tyre janë anëtarësuar për mundësi përfitimi, sigurie, punësimi dhe karriere, pra, shkurtimisht për të qenë pjesë e kësaj “klase”. (shiko tab.1.)

Tabela 1. Anëtarësimi në Partinë Komuniste Shqiptare.

Nr. i anëtarëve në Partinë Komuniste	3.000 anëtarë në Partinë Komuniste	29.137 anëtarë në Partinë Komuniste	44.418 anëtarë në Partinë e Punës	41.372 anëtarë në Partinë e Punës	50.802 anëtarë në Partinë e Punës	63.013 anëtarë në Partinë e Punës	86.985 anëtarë në Partinë e Punës	88.000 anëtarë në Partinë e Punës
Në vite	1944 Anëtarë gjatë luftës	Nëntor 1948 Kongresi i I i PKSH	Prill 1952 Kongresi i II i PPSH	Qershor 1956 Kongresi i III i PPSH	Shkurt 1961 Kongresi i IV i PPSH	Nëntor 1966 Kongresi i V i PPSH	Nëntor 1971 Kongresi i VI i PPSH	Nëntor 1976 Kongresi i VII i PPSH

(Burimi i të dhënave: Kastriot Dervishi, “Historia e Shtetit Shqiptar, 1912-2005” fq. 603, 639, 660, 678, 702)

Ja, si e përshkruan këtë metamorfozë të shoqërisë mendimtari Gjilas:

“Partia lind klasën. Pastaj më vonë, klasa rritet duke u mbështetur në forcat e saj, duke shfrytëzuar bazën e saj, partinë. Klasa forcohet ndërsa partia dobësohet, ky është fati i pashmangshëm. Klasa e sistemit komunist nuk pranon ta kundërshtosh dhe e mbron sundimin e vet me fanatizëm. Po që se nocionin “pronë” do ta shohim konform formulës të pranuar nga shkenca qysh me të drejtën romake d.m.th. si zotërim, përdorim dhe si e drejtë për të bërë me të si të të pëlqejë sikundër edhe me prodhimet e saj materiale (usus, fructus, abusus), atëherë po themi se burokracia politike komuniste e përmendur vepron tamam kështu me pronën e shtetëzuar.... Në fakt, pronësia e klasës së re shfaqet me anë të të drejtës së veçantë dhe të monopolit të burokracisë partiako-politike për shpërndarjen e të ardhurave kombëtare, caktimin e kufirit të pagave, zgjedhjen e drejtimit drejt të cilit do bëhet zhvillimi i ekonomisë, si edhe me të drejtën për të përdorur mjetet e shtetëzuara e mjetet e tjera; në sytë e njeriut të zakonshëm

duket qartë se jeta dhe puna e funksionarëve komunistë është më e lehtë dhe se ata jetojnë shumë më mirë se të tjerët⁷².

Pushteti është burimi për të përdorur pronën kombëtare. Ai sjell me vete të gjitha të mirat e botës. Kush kupton mekanizmin i përvishet punës që të bëhet një nga ata. Shfaqja e klasës së re dhe e pronës së saj u pasqyrua në çdo mënyrë të jetesës së tyre të re. Në varësi të pushtetit dhe postit u përvetësuan të gjitha, vilat, apartamentet më të mira, mobiljet etj. Burokracia e lartë, elita e klasës së re, jetonte në zona të veçanta dhe bënte pushimet në vende klimaterike të veçanta. Karrierizmi dhe burokratizmi janë sëmundje të pashërueshme të komunizmit. Në radhët e partisë fillon të lulëzojë hipokrizia, servilizmi e zilia. **“Klasa e re është e etur dhe e pangopur tamam si borgjezia e re, por i mungon ndjenja e kursimit që është karakteristikë për borgjezinë”⁷³.**

Nga radhët e tyre zgjidheshin zyrtarët e lartë të partisë e qeverisë, të ashtuquajturit *nomenklatura*, të cilët jo vetëm monopolizonin të gjitha postet me pushtet, por gëzonin privilegje të veçanta duke formuar kështu një klasë të re shfrytëzuese. Pjesëmarrja në këtë klasë të siguronte një post të përhershëm dhe bëhej e trashëgueshme⁷⁴.

Pikërisht për faktin se komunistët janë shndërruar në pronarë mbi bazën e besnikërisë dhe devocionit ekstrem, aftësia për të bërë gjithçka është një nga karakteristikat dalluese të nëngrupit shoqëror me emrin *nomenklaturë*. Ata nuk janë vetëm pjesë e aparatit shtetëror apo partisë komuniste, ata janë grupi i cili mbahet lidhur pikërisht prej pronësisë monopoliste. Kjo ishte forca e partisë komuniste, të cilën e zhvilloi dhe përdori në fillim Stalini dhe më tej çdo lider komunist. Politika e krijimit të një elite të privilegjuar mbështeti regjimin komunist rus në 70 vitet që vijuan; sigurimi i një jetese të rehatshme për shtresën e zyrtarëve ishte grepi lidhjes me regjimin dhe forca e tij. Nuk ekziston në botë asnjë burokraci që të shkojë drejt qëllimeve të saj me kaq konsekuencë.

Monopartitizmi

Në totalitarizëm (tipi komunist) ka vetëm një parti. Regjimi pretendon se ka vetëm një të vërtetë totale dhe të duash një të vërtetë tjetër ose parti tjetër konsiderohej tradhti ndaj vijës së drejtë. Zhdukja e opozitës ligjërohet me pretendimet se ata (partia) e dinë se çfarë duhet bërë për të shpëtuar shoqërinë nga shtypja dhe abuzimi (alternativa opozitare). Janë ata që sakrifikojnë dhe marrin përgjegjësinë që të krijojnë një shoqëri ideale, të përsosur ku barazia, prosperiteti dhe zhvillimi janë rezultate të rrugës së vërtetë të njohur vetëm prej tyre.

⁷²M. Gjilasi, fq. 200-201.

⁷³Ibid. fq. 219.

⁷⁴R. Pipes, fq. 52-3.

Partia ndërtohet mbi bazën e një ndryshimi esencial nga partitë tradicionale, ajo është mbajtësja e aspiratave të popullit dhe pronare legjitime e pushtetit politik. Binomi Parti-shtet i jep asaj natyrën antikonstitucionale pasi ajo është mbi ligjet (i shmanget çdo kontrolli ligjor) dhe nuk pranon t'i japë llogari askujt.

“Sundimi nga një parti e vetme monopoliste e organizuar në bazë të rregullave ushtarake e që kërkonin bindje të verbër; pushteti i saj ishte pa kufij dhe ku gjithmonë e drejta është në anën e saj. Linja e ndarjes midis shtetit dhe shoqërisë bëhet e padukshme”⁷⁵.

Partia-shtet në orvatjet e saj për pushtet total bën një shkrirje midis sferës së pushtetit, sferës së ligjit dhe sferës së dijes. Është e theksuar tendenca që të ngatërrohet shteti e shoqëria civile, duke e bërë partinë të gjithëpranishme. Partia e plotfuqishme bëhet atraktive për shoqërinë sepse vetëm aty dhe si pjesë e saj individët ndihen të “mbrojtur pasi pranojnë të shërbejnë dhe të jenë pjesë e sistemit dhe të gëzojnë dhe përfitojnë nga privilegjet dhe akseset që krijon mbrojtja partiake”. Partia-shtet është ajo që ka në kontroll çdo aspekt të jetës njerëzore. Jetëgjatësia realizohet nëpërmjet nënshtrimit, bindjes pa kushte të anëtarëve dhe burokratëve (dhe nëpërmjet tyre shoqërisë) ndaj urdhrave të Njëshit dhe të parisë drejtuese. Individët dhe shoqëria në tërësi nuk kanë alternativë për të qenë anti-konformiste ndaj devizës së partisë-shtet. Partia-shtet gëzon monopolin e të drejtave të të gjithë qytetarëve, duke i bërë këta të fundit peng “të përjetshëm” të kapriçove dhe persekutimeve në rast kundërshtimi. Monopoli i punësimit, strehimit, arsimimit, ushqimit etj, e kushtëzojnë ekzistencën e individëve dhe të shoqërisë në kuadratin e vendosur nga Partia-Shtet. Ata varen katërcipërisht prej binomit parti-shtet. Kjo formë moderne e skllavërimit të shekullit të 20-të është e pahasur ndonjëherë në historinë njerëzore. Pushteti i përket një grupi njerëzish dhe në shkallën më të lartë një njeriu/liderit. Ai është i veshur me dijen absolute dhe të pakundërshtueshme nga askush që mund ta mposhtë⁷⁶. Shoqëria është e ngërthyer në mënyrë totale nga Partia-Shtet, e cila gëzon të gjitha atributet e një rendi “faraonik” të shekullit tonë.

Drejtimit qendror të ekonomisë

Në regjimin komunist, zhvillimi i ekonomisë nuk është vetëm baza, por edhe pasqyrimi i rrugës së vetë regjimit nga diktatura revolucionare, drejt despotizmit reaksionar⁷⁷. Ekziston vetëm prona shtetërore dhe Shteti është pronari i vetëm i saj. Në fakt, shteti që drejtohet nga partia identifikohet me parinë drejtuese që realisht janë pronarët e vërtetë ndonëse jo të shpallur të pronës shtetërore. Planifikimi i ekonomisë nuk realizohet nga ekspertët dhe teknokratët e vërtetë. Ata janë zëvendësuar nga partia pikërisht për të implementuar rendin e ri ekonomik mbi bazat e ideologjisë dhe jo mbi

⁷⁵Claude Lefort, “Demokracia dhe Totalitarizmi”, Dukagjini, Pejë, 1994, fq. 110.

⁷⁶Për mendimet e lartpërmendura jam bazuar tek: C. Lefort, fq. 24-27.

⁷⁷Shiko: M. Gjilas, fq. 266-300.

bazën e kërkesave dhe të nevojave të vendit. Baza e ekonomisë ishte stimulimi dhe zhvillimi i industrializimit. Sektorë si industria e lehtë dhe bujqësia u lanë në plan të dytë. Me kalimin e kohës, këto politika ekonomike ndikuan në cilësinë dhe nivelin e jetesës së qytetarëve të këtyre vendeve.

Uzarpimi i gjithë veprimtarisë ekonomike, në fillim në emër të qëllimeve “ideale” dhe më vonë për të mbajtur plotësisht në dorë pronën dhe sundimin absolut, është arsyeja e vërtetë e masave të herëpashershme politike në ekonominë komuniste. Drejtimi i ekonomisë bëhet jo nga pikëpamja e prirjeve, mundësive dhe nevojave të kombit, por duke u bazuar në interesin ideologjik për ruajtjen e monopolit totalitar mbi çdo hallkë të shtetit.

Njerëzit projektohen dhe përdoren si vegla prodhimi. Një element i ri shfrytëzimi del në pah. Puna e detyruar është një dukuri e përhershme në këtë sistem. Në varësi të kërkesave dhe momentit, regjimi e përdor këtë mekanizëm herë të forcuar e herë në mënyrë të zbutur. Përgjithësisht, në periudhën mbas Luftës së Dytë Botërore, pothuajse në të gjitha vendet komuniste ishin të pranishme forma të pastra skllavëruese të punës. Midis tyre dhe punës në fabrikë praktikisht nuk kishte dallim. Kampet e punës dhe lloj-lloj aksionesh të punës “vullnetare” janë forma ekstreme e shumë të rënda të punës së detyruar. Punësimi i të gjithë njerëzve ishte një politikë ekonomike, e cila nuk mund të konsiderohej pasojë e socializmit komunist. Privimin e mundësisë për të bërë grevë, komunistët e shpjegojnë me atë se gjoja klasa punëtore është në pushtet dhe mbrohet nëpërmjet shtetit të saj dhe se ajo është pronare e mjeteve të prodhimit dhe në këto kushte grevat do të ishin një veprim kundër vetvetes.

1.1.3 Pasojat e totalitarizmit

Historia e regjimeve totalitare e të gjitha llojeve na ndriçon në faktin se: “Besimi fanatik është gjithmonë një e keqe dhe është i papajtueshëm me objektivin e një rendi shoqëror pluralist; është obligimi ynë që t’i kundërvihemi fanatizmit të çdo formë – edhe atëherë kur objektivat e tij janë pa të sharë nga ana etike, dhe para së gjithash edhe atëherë kur objektivat e tij janë tonat”⁷⁸.

Për nga manipulimi, shtypja, shfrytëzimi, terrori, dhuna dhe centralizimi, pasojat e regjimeve totalitare komuniste të shekullit të XX janë nga më ekstremet.

Kudo ku këto regjimet hodhën rrënjë, në një masë të madhe ato morën tipare të ngjashme, duke prodhuar gjithashtu edhe pasoja të përafërta. Siç është shprehur edhe Zbigniew Brezezinski: “Doktrinat totalitare u diskredituan... ndërkohë një normë konsumizmi bën paradë si zëvendësuese e *standardeve etike*”, kjo është një pasojë e drejtpërdrejtë e ngritjes së antivlerës si vlerë në shoqëritë ish-totalitare. Ja, si e argumenton ai këtë deformim: “Në shumë aspekte, akuza më e madhe morale që mund t’i

⁷⁸Karl Popper, “*Mendime për historinë dhe politikën: referat dhe punime të përzgjedhura*”, Plejad, Tiranë, 2011, fq.11.

bëhet totalitarizmit të shek XX – ndryshe nga demokracitë e qeverisura nga ligji, që përpiqen t’i kufizojnë mangësitë morale si dhe nga fetë, që aspirojnë të nxitin një moral të veçantë – është se edhe nazistët edhe komunistët *ushqyen qëllimisht deformimin moral të qenies njerëzore.*” Shoqëria, më shumë se kurrë, u fragmentizua nga përçarja sistematike, nga krijimi i dualitetit mik-armik dhe nga kompleksi i viktimizimit duke lënë jo vetëm konfliktet sociale të hapura, por edhe një kulturë qytetare totalitare. Është e vështirë të identifikohen sidomos pasojat që lidhen me traditën politike të kaluar. Në këto regjime, eliminimi i opozitës, i elitës intelektuale dhe, nuk e teprojmë po të themi, i të gjithë atyre që mendonin dhe vepronin ndryshe nga ideologjia zyrtare pësuan fate të ngjashme.

Ndër pasojat më të rënda të trashëguara nga këto regjime janë rezultat i politikës së luftës së klasave, si instalimi i diktaturës së proletariatit, centralizimi ekonomik, politik dhe shoqëror, si edhe varfëria dhe prapambetja ekonomike. Ndër produktet e kësaj politike veçojmë historinë e tmerreve dhe vrasjeve masive që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në kujtesën kolektive të këtyre shoqërive.

Numri i viktimave të komunizmit është marramendës edhe për faktin se diktatura e proletariatit nuk ishte fazë tranzitore, por një sistem permanent dhe sistematik spastrimi.

Nëse i referohemi Shqipërisë, për 50 vjet u ekzekutuan për motive politike “5,037 burra dhe 450 gra. U dënuan me burgime 16,788 burra dhe 7,367 gra, u internuan 48,217 burra dhe 10,792 gra. U dëbuan nga qytetet kryesore dhe nga zonat kufitare 11,536 familje...etj⁷⁹”. Këto shifra na tregojnë më shumë nga ç’mund të imagjinonim se sa thellë e ka copëtuar indin shoqëror ky regjim.

Shoqëritë e sotme post-totalitare vuajnë nga simptoma të ngjashme. Ato trashëgojnë prapambetje ekonomike, probleme sociale, kulturore dhe psikologjike. Ne konstatojmë se: *Pavarësisht se tanimë shkatërrimi i regjimeve totalitare është realitet, shoqëritë post-komuniste nuk janë çliruar, ashtu siç mendohej, nga të menduarit, dhe nga të besuarit e vlerave të shoqërive totalitare.* Shoqëritë e këtyre vendeve vuajnë nga simptoma frike, mosbesimi, nga shprehitë e nënshtrimit, nga mungesa e besimit dhe e respektimit të ligjit dhe shtetit. Në shumë vende, rrëzimi i diktaturave në një masë ka çliruar viktimat nga vuajtjet në këto sisteme dhe ka krijuar mundësi për rindërtimin e këtyre shoqërive me më shumë demokraci dhe të drejta. Megjithatë, çlirimi prej diktaturës nuk ka eliminuar probleme si “varfëria, krimi, inefficiencia burokratike dhe shkatërrimi i mjedisit⁸⁰”, probleme këto që shpesh janë trashëgimi e lënë pas nga këto regjime. Shoqëritë e vendeve komuniste jetonin në një varfëri ekstreme dhe ishte pikërisht kjo varfëri që zhbëri moralin dhe justifikoi vjedhjen dhe plaçkitjen e pronës shtetërore. Njerëzit mësuan të vidhnin dhe nga skamja vidhnin gjithçka; tashmë, ata jo vetëm nuk ndjenin më turp, por krijuan mekanizma justifikues për të përligjur vjedhjen dhe abuzimin. Ky mentalitet i vjedhjes, i zaptimit apo shkatërrimit të pronës publike

⁷⁹ Vep.cit., në Kastriot Dervishi, “*Historia e Shtetit Shqiptar*”, 1912-2005”, ShB 55, Tiranë, 2006, fq. 616.

⁸⁰ Gene Sharp, “*Nga diktatura në demokraci*”, ShB: Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2012, fq. 16.

zhvilloi në mënyrë të paimagjinueshme korrupsionin dhe përçmimin ndaj pronës së përbashkët dhe shtetit. Ideali se komunizmi ishte një regjim që nuk prodhonte korrupsion dhe abuzim ishte një shaka e hidhur. Korrupsioni jo vetëm që ekzistonte, por ishte edhe në përmasa të frikshme dhe të panjohura deri në kohën kur ndodhi ndryshimi i sistemit politik.

Kështu vështirësitë e tranzicionit politik që hasen në këto vende sot janë në një masë të madhe, pasojë e formave dhe e trajtave që mori mendimi, kultura, jetesa e këtyre shoqërive për më shumë se 50 vjet. Siç shprehet edhe studiuesi Sharp “Për fat të keq e shkuara është ende në mesin tonë⁸¹”, pra, këta popuj kanë ende shumë punë për të larguar njëherë e mirë pasojat e të kaluarës dhe për të institucionalizuar një demokraci pa kthim mbrapa. Këtu vlen shprehja e studiues Etzioni-Halevy se: “pushteti shtetëror i pakufizuar përbën një kërcënim për të drejtat dhe liritë e njeriut dhe se ky pushtet duhet të kufizohet në interes të këtyre të drejtave...⁸²”. Shija për liri, zhvillim dhe demokratizim nuk fitohet në gjirin e tjetërsuar të vlerave njerëzore. Gjatë këtyre 20 viteve, në shoqëritë post-komuniste është vërtetuar që pasojat e totalitarizmit janë më të rënda nga çfarë ishte menduar.

1.2 Demokraci, përcaktimi si koncept

Koncepti “demokraci” (demos – popull, kratia – sundim) ashtu si shumë koncepte të tjera politike, origjinën e ka nga djepi i qytetërimit grek, Athina, diku nga shek. V p.e.s. Në kontekstin e kohës dhe sipas kuptimit literal, koncepti tregon të drejtën e *qytetarëve* për të ushtruar vullnetin e tyre politik. Shpeshherë *demokracia* ngatërrohet ose zëvendësohet me termin *liri*, por në fakt ato nuk janë sinonime të njëra-tjetrës. Demokracia përfshin një sërë idesh dhe parimesh mbi lirinë; ajo gjithashtu përbëhet prej praktikave dhe procedurave, të cilat janë formuar për një kohë të gjatë dhe plot ndërlikime. Demokracia është institucionalizimi i lirisë⁸³.

Nëse i referohemi literaturës, ajo na ofron një trajtesë të gjerë të demokracisë. Që nga koha e antikitetit dhe deri në ditët tona, termi “demokraci”, ka ndezur shumë diskutime sidomos në kuptimin dhe kontekstin e sistemit politik. Për Sartorin kuptimi i parë i fjalës demokraci ka treguar gjithmonë “një entitet politik, një formë shteti e qeverisjeje⁸⁴”. Një nga përkufizimet më të njohura për demokracinë si “Sundimi i popullit, nga populli, për popullin⁸⁵”, është dhënë nga presidenti amerikan Abraham

⁸¹Ibid. fq. 17.

⁸²Eva Etzioni-Halevy, “Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim: lexime të zgjedhura”, Botimet Dudaj, Tiranë, 2009, fq. 28.

⁸³“Democracy in a brief”, Bureau of International Information Programs U.S Department of State, fq. 3. <http://usinfo.state.gov>; shiko gjithashtu: The Economist Intelligence Unit’s, *Democracy Index*, 2007, fq. 1.

⁸⁴ Giovanni Sartori, “Ç’është Demokracia”, Dituria, Tiranë, 1998, fq. 8.

⁸⁵Ibid.

Linkoln. Kjo lloj mënyre e të kuptuarit të demokracisë mbart vlera të mëdha përsa i përket idealeve dhe frymëzimit, pasi në kuptimin e drejtpërdrejtë, ajo nuk përshkruan asnjë sistem real politik. Termi demokraci mishëron më shumë idealin e një sistemi të përsosur politiko-shoqëror drejt të cilit shoqëritë dhe drejtuesit politikë tentojnë të arrijnë. Për Robert Dahl, “asnjë sistem i qëndrueshëm në botën reale nuk është tërësisht i demokratizuar”, ndaj ai përdor temin *poliarki*, i cili përkufizon “regjime relativisht (por jo krejtësisht) të demokratizuara”⁸⁶. Në këtë kontekst, kuptimi primar i fjalës demokraci si “Pushtet i Popullit” ndryshon dukshëm nga zbatimi i vlerave të tij në sistemin politik. Për Sartorin pushteti i popullit është “një shprehje mungesore”⁸⁷ që do të thotë se nuk përcakton as procesin politik dhe as ushtrimin e këtij pushteti politik.

Për studiuesin Jacques Ranciere: në këtë mënyrë “Pushteti i Popullit” (pra, në përkufizimin fillestar)⁸⁸ si për shoqëritë e pabarabarta, ashtu sikurse edhe për shoqëritë oligarkike është heterotopik (nuk ka vetëm një vend origjine). Kjo është ajo që ndan qeverinë nga vetja, duke ndarë shoqërinë nga vetja. Kjo është, po ashtu, ajo që ndan të ushtruarit e qeverisë nga përfaqësimi i shoqërisë⁸⁹. Më tej, ky autor argumenton se “koncepti demokraci nuk tregon në vetvete një formë shoqërie as një formë qeverie. “Shoqëria Demokratike” nuk është gjë tjetër veç një kuadër i imagjinuar, me qëllimin për të mbështetur njërin ose tjetrin parim të qeverisjes së mirë”⁹⁰. Historiani A. Mezini na tërheq vëmendjen në përdorimin e shumëanshëm të termit në kohët moderne. Sipas tij: “Deri në fund të shek XIX-të (koncepti) u përdor më tepër në kuptimin politik dhe presupozonte demokraci politike. Në shek XX, në përputhje me zhvillimet politike historike, ky koncept u thellua edhe në drejtime të tjera dhe filloi të përdorej në shumë fusha”⁹¹. Demokracia moderne lidhet me zhvillimin e komb-shtetit. Sot termi demokraci shenjon një regjim në të cilin autoriteti i qeverisjes buron nga miratimi i shumicës së popullit⁹².

Është pranuar si në qarqet akademike edhe në ato politike se për të etiketuar sistemet e sotme politike të cilat mishërojnë vlerat më të larta të demokracisë, koncepti *Demokraci* shoqërohet me terma si: Liberale, Përfaqësuese, Konsensuale, Delegruese etj. Për Schumpeter demokraci do të thotë “vetëm që populli të ketë të drejtën për të pranuar ose refuzuar njerëzit që do ta qeverisin atë”⁹³. Ky proces selektimi nuk është pa kriter. Downs argumenton se populli zgjedh për postet publike ata kandidatë, të cilët jo vetëm përfaqësojnë alternativën sipas preferencave të tyre, por njëkohësisht japin edhe

⁸⁶Robert A Dahl, “*Poliarkia: Pjesëmarrja dhe Opozita*”, Pegi, Tiranë, 2005, fq. 7.

⁸⁷Giovani Sartori, “*Ç’është Demokracia*”, Dituria, Tiranë, 1998, fq. 21.

⁸⁸Shënim i autorit.

⁸⁹Jacques Ranciere, “*Demokracia, Republika, Përfaqësimi*”, Polis 4, fq. 139.

⁹⁰Ibid.

⁹¹Adem Mezini, “*Shekulli XX*”, EXTRA-R, Tiranë, 2010, fq. 16-7.

⁹²Eva Etzioni-Halevy, “*Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim*”, Botimet Dudaj, Tiranë, 2009, fq. 21.

⁹³J.A. Schumpeter, “*Capitalism, socialism and Democracy*”, vep. cit në Eva Etzioni-Halevy, “*Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim*”, Botimet Dudaj, Tiranë, 2009, fq. 109.

alternativën më të mirë se pjesa tjetër e konkurrencës⁹⁴. Pra, e trajtuar në këtë formë, ajo që i jep pushtet popullit për të qeverisur nuk është sundimi nëpërmjet tij, por vullneti për të zgjedhur sunduesin. Për Vanhanen demokracia është “një sistem politik, ku grupe ideologjike dhe shoqërisht të ndryshme kanë të drejtën me ligj të garojnë për pushtetin politik dhe ku pushtetmbajtësit institucionalë zgjidhen nga populli dhe japin llogari përpara tij⁹⁵”. Në librin e tij të famshëm *Demokracia në Amerikë*, Tukvil argumenton se ishte pikërisht, “ideja e së drejtës ajo që u dha mundësinë njerëzve të përcaktonin anarkinë dhe tiraninë dhe që i mësoi ata, se si të ishin të pavarur, pa qenë arrogantë, e si të bindeshin pa qenë servilë... shteti demokratik e zbret konceptin e të drejtave politike deri në shkallën e shtetasve më të thjeshtë⁹⁶”. Për Lefort: “Ajo që shquan demokracinë moderne është fakti se askush, asnjë njeri, asnjë grup s’do të mund ta përvetësonte pushtetin; gjithashtu edhe se askush nuk mund ta shpallte ligjin dhe askush nuk mund ta zotëronte dijen e fundit; atë e shquante po ashtu fakti se njerëzit e pranonin heshtazi ndarjen shoqërore: ndarjen midis shtetit dhe shoqërisë civile, ndarjen e sferave të aktivitetit, ndarjen e interesave, të pikëpamjeve, të bindjeve⁹⁷. Po kështu Huntington pohon se “koncepti i demokracisë nënkupton kufizimet e pushtetit⁹⁸”. Kjo do të thotë se në demokraci, vendimmarrësit e zgjedhur nuk ushtrojnë pushtet të plotë, ata e ndajnë pushtetin me grupe të tjera të shoqërisë.

Në këtë kuptim, demokracia (si koncept politik) bashkegzigiston me kundërthënien e kuptimit të saj, dmth koncepti bashkon pushtetin si burim nga populli dhe pushtetin në këtë kontekst si pushtet i askujt. Demokracia që njohim sot jeton nga kjo kontradiktë. Po në këtë linjë, Tokevil argumenton faktin që “Kur populli shpreh vullnetin e vet, ai ka një fuqi të mahnitshme, dhe kur ai deklarohet, edhe vetë përfytyrimi i atyre që do të donin ta kundërshtonin zverdhet nga frika. Partitë e njohin mirë të vërtetën e kësaj gjëje...⁹⁹”. Për Herbert Marcuse “Forca çliruese e demokracisë qëndron në mundësinë për opozitën si në nivelin individual, ashtu edhe në atë shoqëror, në mundësinë e hapjes së saj përkundrejt formave të ndryshme cilësore të qeverisjes, kulturës, edukimit, punës, të ekzistencës njerëzore në përgjithësi¹⁰⁰. Regjimi demokratik bazohet në vullnetin e popullit ndryshe nga ai totalitar që u imponohet masave të popullsisë. Karakteri i regjimit përcaktohet nga shkalla e zhvillimit të demokracisë. Për John Stuart Mill-in, demokracia plotëson kriteret dhe formën më të mirë qeverisëse sesa format e tjera shtetërore. Me formë të mirë qeverisëse, ai nënkuptonte zhvillimin e virtyeteve shoqërore, inteligjencën dhe krijimin e kushteve më të mira për qytetarët e saj, duke krijuar të gjitha mundësitë për mbrojtjen e të

⁹⁴Shiko:Manfred G. Schmidt, “*Teoritë e Demokracisë*”, Botart, Tiranë, 2012, fq. 196.

⁹⁵Vep.cit në Manfred G. Schmidt, “*Teoritë e Demokracisë*”, Botart, Tiranë, 2012, fq. 379.

⁹⁶Aleksi De Tokevil, “*Demokracia në Amerikë*”, Kristalina-KH, Tiranë, 2002, fq. 85.

⁹⁷Claude Lefort, “*Demokracia dhe Totalitarizmi*”, Dukagjini, Pejë, 1994, fq. 14.

⁹⁸Samuel Huntington, “*Vala e trete*”, AHS, Tiranë, 2011, fq. 11.

⁹⁹Tokevil, fq.86 sqarim:analiza e Tukvilit i referohet vetem realitetit Amerikan.

¹⁰⁰Herbert Marcuse “*Toleranca shtypëse në demokracinë bashkëkohore*”, op cit në Eva Etzioni-Halevy, “*Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim*”, Botimet Dudaj, Tiranë, fq. 50.

drejtave dhe interesave të tyre përmes pjesëmarrjes në krijimin e vullnetit politik¹⁰¹. Për Huntington, demokracia si një formë e qeverisjes është përcaktuar në lidhje me burimet e autoritetit të qeverisjes, qëllimeve të paraqitura nga qeveria dhe procedurat për konstituimin e qeverisë¹⁰². Edhe për kritikët e demokracisë përfaqësuese vlerat e këtij sistemi spikatin mbi të gjitha sistemet e tjera. Sipas Mosca-s “Është e pamohueshme se sistemet përfaqësuese krijojnë mundësinë që shumë forca politike të marrin pjesë në sistemin politik dhe, për pasojë, të kontrollojnë dhe të ekuilibrojnë ndikimin e forcave të tjera shoqërore...¹⁰³”.

Përcaktimi se çfarë kupton shoqëria dhe studiuesit me fjalën demokraci është shumë i rëndësishëm. Në këtë kuptim, binomi koncept – regjim bëhet përcaktues i definicionit demokraci. Psh. ne, shoqëria cilësojmë një regjim pak apo shumë demokratik në varësi të perceptimit tonë të karakteristikave dhe tipareve që duhet të ketë një regjim demokratik. Kjo na sjell ndër mend që në rastin e parë (kur e cilësojmë pak demokratik) ka shumë punë për ta demokratizuar regjimin ndërsa në rastin e dytë të shembullit ky regjim ka plotësuar kriteret për t’u cilësuar i tillë. Në nënçështjen që vijon ne do të ndalemi në trajtimin e *Demokracisë Liberale*.

1.2.1 Demokracia si regjim, Demokracia Liberale

Kur kemi folur për totalitarizmin kemi pranuar që ai është dukuri e shekullit të XX. Ky shekull është gjithashtu edhe shekulli i realizimit të suksesshëm të shtetit të së drejtës dhe triumfit të demokracisë liberale. Forma më e përhapur e demokracisë përfaqësuese në kohët moderne është demokracia liberale. Shumica e shteteve perëndimore u bënë liberale përpara se të bëheshin demokratike. Kjo është një karakteristikë themelore e demokracisë së këtyre vendeve, e cila ka përcaktuar jetëgjatësinë e këtij sistemi. Në historinë e këtyre vendeve, procesi i liberalizimit kushtetues u bë përpara se ato të garantonin votimin e përgjithshëm apo të zhvillonin partitë politike masive. Ato arritën t’i jepnin sistemit qeverisës tipare të tilla si: varësia e qeverisë ose e ekzekutivit nga ligjet e miratuara nga një parlament i zgjedhur, të drejta të argumentuara të individit për një proces të drejtë ligjor dhe për lirinë e fjalës, mbledhjes dhe lëvizjes, një sistem gjyqësor me pavarësi të mjaftueshme si nga parlamenti ashtu edhe nga ekzekutivi¹⁰⁴. Demokracia moderne është e lidhur me liberalizmin, prandaj zakonisht sistemet bashkëkohore të qeverisjes demokratike janë njëkohësisht edhe liberale. Ajo është një formë e sundimit politik ku balancohen parimet e qeverisjes së

¹⁰¹Shiko: Arend Lijphart, “*Le democrazie contemporanee*”, Il Mulino, Bologna, 2001, fq. 309-13

¹⁰²Samuel Huntington, “*Vala e trete*”, AIIS, Tiranë, 2011, fq. 8.

¹⁰³Vep. Cit në Eva Etzioni-Halevy, fq.88 marrë nga vepra e Gaetano Mosca “*The Ruling Class*”.

¹⁰⁴David Beetham, Kevin Boyle, “*Demokracia: 80 Pyetje dhe Përgjigje*”, Dita, Tiranë, 2001, fq. 13-4.

kufizuar krahas idealit të pëlqimit popullor¹⁰⁵. Në procesin e zhvillimit të saj, demokracia liberale realizoi barazinë politike nëpërmjet institucionalizimit të të drejtave politike, ku e drejta e votës ishte më kryesorja. Demokracia liberale duke u bazuar në shprehjen e vullnetit të elektoratit masiv (një njeri një votë) dhe mbeshtetur në parimin e sundimit të shumicës i dha kuptim dhe legjitimitet të plotë qeverisjes përfaqësuese¹⁰⁶. Shumë studiues pranojnë se pavarësisht faktit që demokracitë nuk sundohen nga populli, por nga drejtuesit politikë, ato kanë disa tipare që i bëjnë të ndryshme nga regjimet e tjera. Kjo nënkupton jo vetëm zgjedhje të lira, por edhe pushtet të qeverive që buron nga këto zgjedhje të lira, si dhe garë qeveritare ndërmjet elitash qeverisëse për votën e popullit. Kjo nënkupton, gjithashtu, se në regjimet demokratike disa elita të tjera (për shembull elitat e biznesit, të medias, elitat akademike dhe udhëheqësit sindikalistë) kanë fituar një shkallë autonomie nga shteti, çka u jep atyre mundësinë të kundërbalancojnë dhe të kufizojnë pushtetin shtetëror¹⁰⁷. Të gjitha demokracitë janë sisteme tek të cilat qytetarët lirisht marrin vendime politike sipas parimit të sundimit të shumicës¹⁰⁸. Për S. Martin Lipset, demokracia në një shoqëri komplekse mund të përkufizohet si një sistem politik “që furnizon me mundësi të rregullta kushtetuese *ndryshimin e zyrtarëve që qeverisin*, dhe një mekanizëm shoqëror, i cili lejon pjesën më të madhe të mundshme të popullsisë që të ndikojë në vendimet e mëdha duke zgjedhur ndër pretendentët për poste politike¹⁰⁹”. Një element tjetër i demokracisë moderne është fakti që vendos rregulla midis grupeve të ndryshme interesi, “Në çdo demokraci moderne, konflikti midis grupeve të ndryshme është i shprehur përmes partive politike, të cilat, në thelb, përfaqësojnë një *“përkthim demokratik të luftës së klasave*.”¹¹⁰ Kjo do të thotë që rregullim institucional i demokracisë liberale realizohet me metoda demokratike dhe “...siguron realizimin e një vendimi politik nëpërmjet të cilit individët fitojnë pushtetin vendimmarrës nëpërmjet betejave konkurruese për votën e popullit¹¹¹”. Për Dahl, një demokraci e tillë mund të ekzistojë dhe dallohet nga regjimet e tjera nga shkalla me të cilën tetë kushtet institucionale (të poshtëshënuara) janë të vlefshme për të gjithë qytetarët.

1. Liria e organizimit dhe e aderimit
2. Liria e shprehjes
3. E drejta e votës
4. E drejta për të kërkuar punë në Administratën Publike

¹⁰⁵ Arjan Dedej..., etj, “Hyrje në Shkenca Politike”, Durrës, 2011, fq. 118.

¹⁰⁶ Shiko: Llambro Filo, fq. 92.

¹⁰⁷ Eva Etzioni-Halevy, “Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim”, Botimet Dudaj, Tiranë, fq. 26-8.

¹⁰⁸ The Economist Intelligence Unit’s, *Democracy Index, 2007*, fq. 2.

¹⁰⁹ Seymour Martin Lipset, “*Political Man: The Social Bases of Politics*”, Doubleday & Company, Inc., Garden City, New York, 1960, fq. 45.

¹¹⁰ *Ibid.*, fq. 220 (Lipset).

¹¹¹ J.A. Schumpeter, “Capitalism, socialism and Democracy”, Op. cit. Eva Etzioni-Halevy, “Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim” Tiranë, Botimet Dudaj, fq. 106-107.

5. E drejta e konkurrimit të udhëheqësve politikë për të fituar vota
6. Burime alternative informimi
7. Zgjedhje të lira dhe të ndershme
8. Institucione për t'i kushtëzuar politikat qeveritare me vota dhe shprehjet e tjera të parapëlqimit

Po sipas këtij autori, në bazë të analizës së këtyre tetë kushteve mund të krahasonim regjimet e ndryshme në lidhje me “shkallën e lejueshme të opozitës, të kontestimit publik dhe konkurrimit politik¹¹²”. Gjashtë kushtet e para të evidentuara nga Dahl kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave bazë të lirisë dhe barazisë ndërsa dy kushtet e fundit kanë të bëjnë me zgjedhjen dhe mbikqyrjen e qeverisë. Ai argumenton se reagimi i vazhduar i qeverisë ndaj parapëlqimeve të qytetarëve, të parë këta si qenie të barabarta politike, është karakteristika themelore e demokracisë.¹¹³ Për Dahrendorf, “Bota reale është përherë botë e pikëpamjeve të ndryshme. Ajo është botë e konfliktit dhe e ndryshimit. Madje konflikti dhe ndryshimi janë liria jonë; pa këto nuk mund të ketë liri¹¹⁴”. Për të realizuar dhe mbështetur këto kushte, demokracia liberale ka si parakusht një shtet efektiv, me strukturë të fortë institucionale dhe ligjore, me autonomi që ta mbrojnë nga influencat politike¹¹⁵. Konstitucionalizmi, qeveria përfaqësuese dhe pluralizmi politik janë ndër elementet kryesore të demokracisë liberale duke krijuar një situatë të çuditshme që nëse do të përdornim shprehjen e Delsol do të pohonim se: “Shteti-garant mbron gjithçka veç vetes dhe, për pasojë, kalon në plan të dytë, *çka duket paradoksale*¹¹⁶”. Në praktikë, këto tri elemente nuk realizohen vetëm nga një kushtetutë e shkruar mbi parimet demokratike; zbatimi i saj “është i sigurtë vetëm nëse një gjyqësor i pavarur ka autoritetin dhe vendosmërinë për të imponuar respektin ndaj saj dhe nëse publiku i gjerë është vigjilent në mbrojtjen e saj¹¹⁷”.

1.2.2 Karakteristikat dhe tiparet kryesore të regjimeve demokratike

Të përmbledhësh karakteristikat apo tiparet e regjimeve demokratike nuk është një sipërmarrje e lehtë. Evidentimi dhe klasifikimi i tyre ka ndihmuar studiuesit të realizojnë matjet e përmbajtjes së demokracisë. Në studimet e hasura, analizat orvaten sa në klasifikimin e tipareve, aq edhe në kushtet që krijojnë terrenin për formimin e regjimeve demokratike. Në këtë pjesë të punimit, ne nuk do ndalemi tek njëra apo tjetra teori e demokracisë për të trajtuar regjimet demokratike; qëllimi ynë është të eidentojmë tiparet kryesore të një regjimi demokratik të suksesshëm. Po t'i referohemi historisë,

¹¹²Robert Dahl, *Poliarkia, Pjesëmarrja dhe Opozita*, Pegi, Tiranë, 2005, fq. 3-4.

¹¹³Robert Dahl, fq. 1.

¹¹⁴Ralf Dahrendorf, “Konflikti shoqëror modern, ese për politikën e lirisë”, Dituria, Tiranë, 1997, fq. 105.

¹¹⁵Shinasi A. Rama, “Përrallat e tranzicionit Shqiptar”, Botimet Princ, Tiranë, 2012, fq. 19.

¹¹⁶Chantal Millon-Delsol, “Idetë Politike në shekullin XX”, Onufri, Tiranë, 2006, fq. 203.

¹¹⁷David Beetham, Kevin Boyle, “Demokracia: 80 Pyetje dhe Përgjigje”, Dita, Tiranë, 2001, fq. 15.

themelimi i regjimeve demokratike ka kaluar në një sërë procesesh të vështira dhe të gjata kohore. Huntington¹¹⁸ merr si pikënisje të proceseve të para demokratizuese revolucionet franceze dhe amerikane. Gjatë valës së parë të demokratizimit që përfshin periudhën nga viti 1828 deri në vitin 1922, rreth tridhjetë vende vendosën institucione kombëtare minimale demokratike. Ndër proceset më të rëndësishme demokratizuese gjatë kësaj periudhe mund të përmendim: konstitucionalizmin, ndarjen e pushteteve, të drejtën e përgjithshme të votës, qeverinë e zgjedhur mbi bazën e mbështetjes të shumicës nga një parlament të zgjedhur në mënyre periodike etj.

Që nga ajo kohë dhe deri në ditët tona kanë ndodhur edhe tri valë të tjera demokratizimi duke shtuar në shoqëritë demokratike elemente të tjera demokratizuese, si edhe duke rritur numrin e vendeve me regjime demokratike. Duhet mbajtur parasysh fakti se vendet të cilat kishin nisur proceset demokratizuese jo gjithmonë ia arrinin t'i zhvillonin dhe konsolidonin ato. Përveç valëve drejt demokracisë ka patur edhe valë të kundërta me to duke i rikthyer disa vende në regjime autoritarise. Po përse disa vende kanë arritur të demokratizohen dhe të themelojnë regjime demokratike dhe disa të tjera jo? Cilat janë ato kushte që favorizojnë lindjen e demokracisë?

Nëse i referohemi analizës së “suksesit të metodës demokratike” të Schumpeter-it,¹¹⁹ ai vë theksin tek disa nga kushtet themelore që sigurojnë zhvillimin e një regjimi demokratik:

Kushti 1: Lidërsia cilësore – sipas këtij kushti, “materiali njerëzor i politikës” duhet të ketë cilësi relativisht të lartë. Kjo nënkupton se njërëzit që drejtojnë partinë, që janë zgjedhur të jenë në parlament apo në poste qeveritare duhet të mbartin vlera të larta njerëzore dhe profesionale. Ai thekson se ky material njerëzor politik duhet t'u nënshtrohet proceseve të rrepta të përzgjedhjes nëpërmjet metodave që e realizojnë këtë gjë.

Kushti 2: Hapësira e vendimeve politike të mos jetë shumë e gjerë. – Sipas Schumpeter-it, kjo ka të bëjë me kufizimin e vetvetes, dmth me kontrollin mbi ndërhyrjen e shtetit në shoqëri dhe ekonomi. Sfera e politikës të jetë e kufizuar.

Kushti 3: Një administratë të miredukuar – Qeverisja demokratike e ka domosdoshmëri të ndërtuarit dhe të paturit e një administrate profesionale dhe të pavarur, në mënyrë që të ofrojë shërbime “me një pozitë dhe traditë të mirë të pajisur me ndjenjën e përgjegjësisë dhe të përkatësisë”. Burokracia përmbush dhe plotëson boshllëqet e kushtit të dytë, ndaj domosdoshmëria e realizimit të saj është kategorike.

Kushti 4: Vetëpërmbytja demokratike – Me këtë, Schumpeter-i nënkuptonte se politikanët (opozita) duhet t'i rezistojnë tundimit që ta vënë në vështirësi qeverinë sa herë

¹¹⁸Shiko:Huntington fq. 12-20 sqarim: *Me valë demokratizimi, ai nënkupton “një grup kalimesh nga regjimet jodemokratike në regjime demokratike, që ndodh brenda një periudhe të caktuar kohe dhe që i tejkalon ndjeshëm kalimet në drejtimin e kundërt gjatë asaj periudhe kohe.*

¹¹⁹Shiko: Joseph A. Schumpeter “*Capitalism, Socialism and Democracy*”, Routledge, London and New York, (published in the Taylor & Francis e-Library), 2003, fq. 290-296.

që u jepet mundësia. Sipas tij, asnjë politikë e suksesshme nuk është e mundur nëse ata e ushtronë këtë mundësi.

Kushti 5: Ekzistenca e një shkalle të gjerë tolerance për opinionet e ndryshme – Duhet të ekzistojnë mekanizmat që çdo lider i supozuar të ketë mundësinë që të konkurojë dhe të jetë alternativë për të realizuar në njëfarë mase edhe kushtin e parë.

Për Downs-in, demokratik quhet ai sistem qeveritar, i cili plotëson katër kushte:

Së pari; Ekzistenca e garës partiake dhe marrja e posteve drejtuese politike në bazën e zgjedhjeve të përgjithshme.

Së dyti; Zgjedhjet duhet të mbahen në mënyrë periodike, kjo e rregulluar me instrumenta që tejkalojnë vendosjen e tyre nga partia që qeveris.

Së treti; Popullsia në moshë madhore duhet të gëzojë të drejtën e përgjithshme për të votuar dhe të gëzojnë njëkohësisht të drejtën e barabartë elektorale dhe të drejtën e barabartë të votës.

Së katërti; Pranimi i rezultatit të zgjedhjeve dhe mos përdorimi i mjeteve të paligjshme dhe të dhunshme nga ana e fituesve dhe e humbësve të zgjedhjeve¹²⁰.

Përpos kushteve të lartpërmendura shumë studiues, pranojnë se demokracia është më tepër një sistem politik, sesa sistem ekonomik. Megjithatë, ata pranojnë se ka ende vend për investigim rreth raporteve që kjo formë qeverisjeje mund të ketë me modelet ekonomike dhe me shkallën e pabarazive apo të barazive ekonomike.¹²¹ Pavarësisht interpretimeve ata pranojnë lidhjen midis zhvillimit ekonomik e social dhe ndikimeve të tij si në favorizimin e kushteve për ndryshimin e sistemit politik edhe në ruajtjen e demokracisë. Sipas Seymour Martin Lipset “përgjithësimi më i përhapur, që e lidh sistemin politik me aspektet e tjera të shoqërisë, është ai se demokracia lidhet me nivelin e zhvillimit ekonomik... sa më i kamur të jetë një komb, aq më shumë shanse ka që ta mbështesë demokracinë¹²²”.

Sipas analizës së tij, vetëm një shoqëri disi e zhvilluar e tregut të lirë dhe që ka një nivel relativisht të lartë pasurie krijon mundësinë e funksionimit të një demokracie si procedurë e arbitrimit dhe e pajtimit të interesave¹²³. Ai vë theksin në dy aspekte themelore:

E para: ka të bëjë me përgjithësimin se *sistemin politik lidhet me zhvillimin ekonomik*. Më konkretisht, ai pohon se: “Sa më i kamur të jetë një komb, aq më shumë shanse ka që ta mbështesë demokracinë.” Më tej, ai vazhdon se “vetëm në një shoqëri të shëndetshme, ku vetëm pak qytetarë jetojnë në varfëri, mund të kemi një situatë të tillë ku masat e qytetarëve të marrin pjesë në mënyrë të vetëdijshme në politikë dhe të mund të kenë vetëpërmbytjen e nevojshme për të shmangur rënien në grackë të demagogëve të

¹²⁰ Vep.cit në Manfred G. Schmidt, “*Teoritë e Demokracisë*”, Botart, Tiranë, 2012, fq. 197.

¹²¹ Shiko: Etzioni-Halevy, fq. 22.

¹²² Vep. cit, në Eva Etzioni-Halevy, “*Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim : lexime të zgjedhura*”, Botimet Dudaj, Tiranë, 2009, fq. 68. Marrë nga vepra e Seymour Martin Lipset, “*Some Social Requisites of Democracy*”.

¹²³ Vep.cit në Claus Offe, “*Capitalism by Democratic Design? Democratic Theory Facing the Triple Transition in East Central Europe*”, Social research Vol. 71: No 3: Fall 2004, f. 510.

papërgjegjshëm”. Për Dahl, ndërmjet nivelit ekonomik-shoqëror dhe zhvillimit politik ekziston padiskutim një lidhje domethënëse. Në trajtesën e tij, ai pranon një korrelacion të dykahshëm, çka do të thotë jo vetëm niveli i lartë ekonomik-shoqëror i rrit mundësitë e një regjimi politik konkurrues, por edhe niveli i lartë konkurrues i një rregjimi politik i rrit mundësitë e një zhvillimi më të lartë ekonomik-shoqëror¹²⁴. Si përfundim, ai pranon se: “gjasat e konkurrimit politik kushtëzohen pa as më të voglin dyshim nga niveli ekonomik-shoqëror i vendit¹²⁵”. Pra, ekonomia e zhvilluar i ndihmon qytetarët jo vetëm për kushte më të mira punësimi, jetese e arsimimi, por mbi të gjitha kultivon tek ata detyrimin dhe përgjegjësinë qytetare për ta respektuar dhe mbrojtur demokracinë. Lipset konstaton gjithashtu se një shoqëri e ndarë në një masë të madhe të varfërisht dhe në një grup të vogël elitare të privilegjuarish, mund të përfundojë ose në oligarki... ose në tirani...¹²⁶”. Kjo nënkupton se krahas zhvillimit ekonomik nevojiten mekanizma institucionale që të garantojnë një rishpërndarje të të ardhurave dhe burimeve kombëtare duke ndihmuar në uljen e pabarazisë midis shtresave sociale.

E dyta: ka të bëjë me *marrëdhënien që ka niveli arsimor i shoqërisë me demokracinë*. Sipas këtij autori, ky raport është trajtuar më gjerësisht që kur një filozofi e tërë e qeverisjes demokratike ka parë në rritjen e shkollimit rritjen e kërkesave bazë të demokracisë. Siç ka thënë edhe Tukvil: “Nëse edukimi i bën të gjithë njerëzit në të tëra kohët të mbrojnë pavarësinë e tyre, kjo është veçanërisht e vërtetë në kohët demokratike¹²⁷”. Po kështu, filozofit liberal i shek. XIX J.S. Mill pohon se: “qeveria demokratike kërkon një nivel të zhvilluar civilizimi¹²⁸”, pra ekzistenca e një popullsie të arsimuar i shërben demokracisë si në mbështetjen e regjimit, edhe në përparimin dhe zhvillimin e saj. Shkollimi ndihmon në zhvillimin e botëkuptimit të fëmijëve dhe u krijon atyre mendësinë e kuptimit të nevojës për norma tolerance, i pengon ata të aderojnë në grupe ekstremiste dhe doktrina moniste dhe ua rrit aftësinë për të bërë zgjedhje të arsyeshme elektorale. Njeriu, si rregull, është përthithës vetëm në dy dekadat e para të jetës së tij. Në mbarim të kësaj periudhe, botëkuptimi i tij merr formë të qartë ose kristalizohet. Më pas bindjet ka të ngjarë të mbeten deri diku të pandryshueshme¹²⁹.

Këtu duhet nënvizuar fakti që institucionet arsimore janë efektive kur ato janë të pavarura dhe të depolitizuara, pasi në eksperiencën e vendeve komuniste shkolla ishte institucioni i cili përdorej për të edukuar qytetarët e rinj me doktrinën Marksiste – Leniniste dhe bindjen ndaj pushtetit qendror. Nëse përjashtojmë këtë fakt, studimet serioze në këtë drejtim tregojnë se shkollimi është jo vetëm shumë i rëndësishëm, por ky variabël është më i rëndësishëm edhe se të ardhurat apo punësimi. Megjithatë nuk mund të pohohet se

¹²⁴ Robert Dahl, “Poliarkia Pjesëmarrja dhe Opozita”, Pegi, Tiranë, 2005, fq. 62-4.

¹²⁵ Dahl, fq. 65.

¹²⁶ Mendimet në thonjëza janë vep. cit. në Eva Etzioni-Halevy, fq. 68.

¹²⁷ A. Tucq, fq. 282.

¹²⁸ Vep. cit, David Beetham, Kevin Boyle “Demokracia: 80 Pyetje dhe Përgjigje”, Dita, Tiranë, 2001, fq.

26.

¹²⁹ R. Dahl, fq. 167.

niveli i lartë i shkollimit është kusht i mjaftueshëm për demokracinë, por një kusht i domosdoshëm për botën moderne¹³⁰.

Rezultatet e punëve kërkimore të shumë studiuesve¹³¹ që kanë trajtuar demokracinë konvergojnë në një masë të madhe në klasifikimin e disa karakteristikave kryesore të përbashkëta të regjimeve demokratike. Ne do të ndalemi shkurtimisht në disa prej tyre:

Zgjedhje të lira dhe të drejta: - Zgjedhjet e hapura, të lira dhe të drejta janë thelbi i demokracisë, një *sine qua non* i pashmangshëm¹³². Zhvillimet historike dëshmojnë për një luftë të gjatë të shoqërive për të gëzuar të drejtën e votimit të përgjithëm, fshehtësinë e votës etj. Rëndësia e ekzistencës së mekanizmit kushtetues që garanton zgjedhje të lira dhe të drejta është thelbësore. Funkzioni primar i votës së zgjedhësve sipas Schumpeter është që ajo “të prodhojë qeveri¹³³”, pavarësisht faktit që në republikat parlamentare, ajo nuk vjen si një produkt i drejtpërdrejtë, rëndësia e saj është e padiskutueshme. Për Sartorin, *zgjedhjet dhe përfaqësimi* janë arsenali i instrumentave pa të cilin demokracia nuk mund të realizohet¹³⁴. Kjo do të thotë që jo vetëm të ketë disa produkte politike para elektoratit, por edhe që këto produkte të orientohen nga interesat e zgjedhësve të tyre duke i përfaqësuar në nivelet vendimmarrëse. Nëse zgjedhjet nuk janë të lira dhe të drejta atëherë edhe përfaqësimi nuk është i vërtetë, ndaj zgjedhjet janë mekanizmi i cili siguron legjitimitetin për të qeverisur. Studiuesja Halevy pohon se parimet elektorale të demokracisë janë binjake me parimet bazë të lirisë, që janë liritë civile – përfshi këtu lirinë e fjalës, të informimit, të organizimit politik, të kundërshtimit të pushtetit, pa të cilat zgjedhjet e lira nuk do të ishin të mundshme¹³⁵. Në tërësi, nga studiuesit është pranuar se një tregues i rëndësishëm i zhvillimit të demokracisë në një vend është aftësia e tij për të zhvilluar zgjedhje të lira, të barabarta, konkurruese dhe periodike. Në një demokraci të mirëfilltë, zgjedhjet janë i vetmi mjet i ligjshëm për të ndërruar zotërimin e pushtetit. Për Shqipërinë, historiku i zgjedhjeve dëshmon për probleme të ndjeshme në këtë drejtim, ndaj ky komponent do të trajtohet në vijim të punimit.

Pluralizmi Politik: - Zakonisht pranohet se demokracia mund të vendoset dhe të thellohet vetëm në qoftë se ka një sistem të fortë shumëpartiak dhe në qoftë se ata që janë në pushtet japin llogari në zgjedhje të rregullta dhe konkurruese¹³⁶. Pluralizmi politik nuk ka të bëjë thjesht me egzistencën e shumë partive politike. Partitë politike duhet të përfajsojnë alternativa të denja dhe konkurruese. Ato nuk duhet të jenë formacione ku ndryshon vetëm emri, në këtë kuptim pluralizmi politik është real kur ka alternativa qeverisëse të cilat përfaqësojnë interesat e shoqërisë në mënyrë sa më të plotë.

¹³⁰Shiko: Eva Etzioni-Halevy, fq. 69-70.

¹³¹Shiko: Manfred G. Schmidt, fq. 418-32.

¹³²Huntington, fq. 11.

¹³³Schumpeter, fq. 273.

¹³⁴Sartori, “Ç’është Demokracia”, fq. 21-2.

¹³⁵Eva Etzioni-Halevy, “Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim, lexime të zgjedhura”, Botimet Dudaj, Tiranë, fq. 21.

¹³⁶Elez Biberaj, fq. 369

Një sistem i zhvilluar partiak bashkë ne zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të drejta janë karakteristika të një demokracie të qëndrueshme.

Shoqëri demokratike: Një nga tiparet e shoqërisë demokratike është se aty ekzistojnë në mënyrë të pavarur nga shteti një numër i konsiderueshëm grupimesh dhe institucioneesh joqeveritare... këto organizma kanë rëndësi të madhe politike¹³⁷.

Qeverisje e hapur dhe e besuar: Pushteti shtetëror i pakufizuar përbën një kërcënim për të drejtat dhe liritë e njeriut dhe se ky pushtet duhet të kufizohet në interes të këtyre të drejtave. Kjo do të thotë që ekzistenca e institucioneve dhe pavarësia e tyre janë një garanci për ruajtjen dhe forcimin e demokracisë.

Kushtetuta dhe politika konstitucionale janë ndër elementët më të rëndësishëm. Pavarësisht kufizimeve që ajo i vendos si popullit, edhe qeverisë efektet e regullave konstitucional stabilizojnë dhe e forcojnë demokracinë.

Të drejta civile dhe politike: Ato janë parimet bazë, pa të cilat njerëzit nuk mund të jetojnë si qenie njerëzore me dinjitet. Respektimi i tyre bën të mundur progresin e plotë të individit dhe të shoqërisë në tërësi. Të drejtat njerëzore përbëjnë bazën e lirisë, të drejtësisë dhe të paqes dhe respektimi i tyre nga ekzekutivi dhe institucionet shtetërore shërben për zhvillimin e një shoqërie me rend demokratik.

1.3 Tranzicioni dhe tranzitologjia, përcaktime teorike

Studimet mbi tranzicionin na tregojnë që ka shumë rrugë që të çojnë drejt demokracisë. Termi “tranzicion demokratik” nënkupton kalimin nga një shtet A në një lloj shteti B, kalimin nga sistemi politik komunist drejt demokracisë liberale, nga ekonomia e centralizuar drejt ekonomisë së tregut etj. Ai përshkruan procesin e ndryshimeve të pushtetit prej fillimit të ndryshimeve të regjimit të vjetër deri në mbarim ose konsolidimin e regjimit të ri politik. Koncepti i tranzicionit “përcakton qartë një pikë të fundit të zhvillimeve politike, ndërsa teoria e tranzicionit përcakton qëllimin e ndryshimit dhe vendos se si ky qëllim realizohet dhe tranzicioni përfundon”¹³⁸.

Interesi i studiuesve për studimin e tranzicionit u rrit ndjeshëm kur në mesin e viteve '70 vende të “Evropës Jugore, të Amerikës Latine dhe të Azisë Lindore kaluan në demokraci”¹³⁹. Qasjet kryesore në fushën e demokratizimit, pavarësisht ndryshimeve, bëjnë pjesë në atë që mund të quhet “paradigma e tranzicionit”. Premisat ku u bazuan studiuesit për të shpjeguar në mënyrë teorike tranzicionin drejt demokracisë u fokusuan më tepër në përgjithësime të fenomenit se sa në një analizë të thelluar të tij. Ambicia e

¹³⁷Sharp, fq. 35.

¹³⁸Shiko: Christian W. Haerpfer, “Democracy and Enlargement in Post-Communist Europe, The democratization of the general public in fifteen Central and Eastern European countries, 1991–1998”, Routledge, London, 2002, fq. 1.

¹³⁹Manfred G. Schmidt, “Teoritë e Demokracisë”, Botart, Tiranë, 2012, fq. 440.

tranzitologjisë ishte që të bëhej e aplikueshme gjithandej në botën në “zhvillim”¹⁴⁰. Ajo fokusohej në dhënien e një sërë aksiomash dhe receta për demokratizimin e vendeve të ndryshme. Pretendimi i ithtarëve të saj ishte se me dijet dhe ekspertizën e akumuluar, ata mund t’i drejtonin vendet në kahun e drejtë të transformimit. Promotorët e demokracisë e zgjeruan këtë model si një paradigmë universale drejt demokratizimit. Ajo u bë e kudogjendur në qarqet politike të SHBA-së, si një mënyrë e të diskutuarit, të menduarit dhe si rrugë projektimi i ndërhyrjeve në ndryshimet politike nëpër botë. Vala e reformave, e cila është gjeneruar nga ky optimizëm teknokratik ka “pushtuar” kontinente të ndryshme.

Në tërësi supozimet kryesore ku u mbështet paradigma e tranzicionit janë:

Supozimi i parë: Çdo vend, i cili po *largohet* nga sistemi diktatorial mund të konsiderohet një vend në tranzicion *drejt* demokracisë.

Supozimi i dytë: Demokratizimi tenton të shpalolet nëpërmjet disa fazave.

Supozimi i tretë: Zgjedhjet kanë një rëndësi vendimtare.

Supozimi i katërt: Kushtet themelore në vendet në tranzicion, niveli i tyre ekonomik, historia politike, trashëgimia institucionale, përbërja etnike, traditat sociokulturore, ose çështje të tjera “struktorore” *nuk do të jenë faktorë madhorë në secilin fillim ose përfundim të procesit të tranzicionit*. Pra, ekzistenca e parakushteve nuk kushtëzon procesin drejt demokracisë.

Supozimi i pestë: Paradigma e tranzicionit qëndron në supozimin që tranzicionet demokratike, të cilat përbëjnë valën e tretë janë ndërtuar mbi shtete koherente dhe funksionale. Procesi i demokratizimit është supozuar të përfshijë disa ridizenjime të institucioneve shtetërore siç janë krijimi i institucioneve të reja zgjedhore, reforma parlamentare dhe reforma gjyqësore, gjithashtu edhe modifikimi i institucioneve funksionuese¹⁴¹.

Përsa më lart, modeli i ndërtimit të shoqërisë që ofron tranzitologjia është “një model që e detyron shoqërinë, cilëndo shoqëri, që t’u përshtatet strukturave që janë ideologjikisht të paracaktuara. Shoqëria duhet t’i përshtatet me dashje apo pa dashje, modelit të demokracisë liberale që ofrohet nga tranzitologjia¹⁴²”. Duke u fokusuar në realizimin e vendosjes së ekonomisë së tregut dhe demokracisë liberale dhe duke besuar se këto dy procese realizojnë kalimin, tranzitologjia nuk bën gjë tjetër veçse ofron një model të paracaktuar strukturash ideologjike që i përshtaten çdo shoqërie.

Në këtë kuptim, tendenca sipërfaqësore për ta bërë modelin e tranzicionit universal dhe të përshtatshëm për vende që kalojnë nga regjime autoritariste drejt

¹⁴⁰Mariana Heredia, Olesia Kirtchik, “Comparing Post-Soviet and Latin American Societies: From “Transition” to “Transformation”, Laboratorium, Vol. 2, No.3, 2010, fq. 6.

¹⁴¹Shiko: Thomas Carothers, “The end of the transition paradigm”, Journal of Democracy, 2002, fq. 6-8.

¹⁴²Shinasi A. Rama, “Përrallat e tranzicionit Shqiptar”, Botimet Princ, Tiranë, 2012, fq. 35.

regjimeve demokratike është ndoshta pika më e dobët e këtij modeli. Ky konkluzion vjen si rezultat i qasjes ideologjike dhe konceptuale që mbart kjo teori.

Në tërësi, literatura tranzitologjike ka një karakter parashikues, përshkrues dhe përgjithësues duke dhënë një paraqitje skematike të proceseve të kalimit nga një sistem shoqëror tek një tjetër. Literatura e gjerë fokusohet në tema që theksojnë se cilat politika janë të suksesshme, se cilat struktura institucionale janë efektive dhe çfarë reformash duhen ndërmarrë në një vend në tranzicion për të realizuar ndryshimin e gjithanshëm. Pavarësisht dobësive, si tranzitologët, ashtu edhe kritikët¹⁴³ e tyre kanë grumbulluar njohuri të dobishme mbi proceset e transformimit dhe kanë zbuluar modele të ndryshme, tendenca, dhe ritme themelore të tyre. Një numër i madh studimesh dhe kërkimesh krahasuese rreth tranzicioneve demokratike në vende të ndryshme kanë evidentuar rëndësinë e faktorëve lokalë si përcaktues kryesorë të zhvillimit të proceseve tranzitore. Për Carothers, paradigma e tranzicionit ka qenë disi e përdorshme gjatë momenteve të ndryshme dhe shpesh befasuese në përmbysjet politike në botë. Por ai pranon se realiteti i sotëm “nuk po përputhet me këtë model...¹⁴⁴”.

Nga debatet e pambyllura lidhur me tranzicionin në vende të ndryshme, shumë studiues këmbëngulin se tranzitologjia nuk është një qasje e dobishme për vendet ish-komuniste. Qasja tranzitologjike nuk arrin t’u japë shpjegim dështimit, zgjatjeve dhe trajtave të regjimeve politike që kanë ndodhur në disa vende ish-komuniste.

Mangësitë e kësaj qasjeje hasen së paku në tri drejtime kryesore:

- 1) Mosnjohja e një zhvillimi të ish-vendeve komuniste në momentin e hapjes së sistemit politik.
- 2) Mungesa e njohurive empirike rreth sistemit të ekonomisë së centralizuar.
- 3) Mosvlersimi si duhet i kapaciteteve politike dhe shoqërore të prirura për ndryshim real.

Deri në vitet 1990, tranzicionet e studiuara trajtonin proceset që kishin ndodhur në 22 vende¹⁴⁵ nga vitet 1973 deri në fundin e viteve ‘80. Hulumtimet teorike të ndërtuara gjatë këtyre viteve lidheshin pak ose aspak me interpretimin e ndryshimit të sistemeve në ish-kampin socialist. Gjatë viteve 1990, një numër studiuesish nisën sfidën me linjën e “jo parakushteve¹⁴⁶”, duke fokusuar analizat e tyre në drejtime si: zhvillimi ekonomik, trashëgimia institucionale, klasa shoqërore, si dhe faktorë të tjerë strukturorë që ndikojnë në realizimin e tranzicionit demokratik.

Për shkak të tipeve të ndryshme të tranzicionit, asnjë prej orientimeve teorike nuk mundet t’i sqarojë i vetëm, përgjithësisht dhe në mënyrë të mjaftueshme, proceset e ndryshme të demokratizmit.

¹⁴³Sqarim: Kritikët e skemave të përgjithësimit u kushtojnë rëndësi të veçantë tipareve në kontekstin lokal.

¹⁴⁴Ibid., (Carothers, fq.6).

¹⁴⁵Manfred G. Schmidt, “*Teoritë e Demokracisë*”, Botart, Tiranë, 2012, fq. 441.

¹⁴⁶Carothers, fq. 16.

Modelet kryesore në fushën e demokratizimit fokusohen si në procesin e tranzicionit , ashtu dhe në konsolidimin e demokracisë. Literatura mbi demokratizimin në përgjithësi bën dallimin midis disa modeleve të ndryshme teorike.

Qasjet aktuale të demokratizimit ndahen në tri shkolla kryesore: “qasje të modernizimit”, “qasje të tranzicionit” dhe “qasje strukturore”¹⁴⁷.

Studiuesi Haerpfer tenton të paraqesë një qasje të katërt, një koncept teorik, që sipas tij quhet “qasja transformuese”. Në fakt, ky ndryshim terminologjik nga “tranzicion” në “transformim” është propozuar fillimisht nga kritikët e tranzitologjisë klasike. Koncepti reflekton një kthim të rëndësishëm epistemik i cili shënon fundin e Teorisë së Madhe, Tranzitologjisë¹⁴⁸. Ajo nënkupton të paktën një synim për lënien e shpjegimeve teleologjike dhe pranimin e kombinimit të elementëve “modernë” dhe “tradicionalë”. Studiuesi Haerpfer, por edhe të tjerë e trajtojnë atë në kontekstin e një modeli teorik.

Në qasjen transformuese të Haerpfer¹⁴⁹ evidentohen tri proceset qendrore karakteristike:

Procesi i parë: Demokratizimi drejt demokracisë.

Procesi i dytë: Liberalizimi i tregut drejt ekonomisë së tregut.

Procesi i tretë: Krijimi i shoqërisë civile.

Sipas këtij modeli karakteristikat specifike të tranzicionit post-komunist konsistojnë në faktin që ne jemi dëshmitarë jo vetëm të një transformimi, por të shumë transformimeve të shumanshme dhe të njëkohshme. Supozimi bazë konceptual i qasjes transformuese është fakti që në të nuk bëhet fjalë për tranzicion, por për “transformim”. Në krahasim me mënyrën statike që përcjell qasja e tranzicionit, qasja transformuese e shikon morinë e ndryshimeve politike të pasviteve 1989 si dinamike dhe të hapura. Qasja transformuese nuk jep postulate “*quasi-natural*” për synimin dhe qëllimin e ndryshimeve; rezultati i transformimeve politike dhe ekonomike është i hapur dhe jo i dhënë në fillim apo gjatë analizës krahasuese të ndryshimit.

1.3.1 Tranzicioni i vendeve të Europës Jugore dhe Amerikës Latine në krahasim me tranzicionin e vendeve ish-komuniste; ndryshimet ndërmjet tyre.

Pas Luftës së Dytë Botërore,¹⁵⁰ proceset e tranzicionit drejt sistemeve demokratike të realizuara nga disa shtete tërhuqën vëmendjen e shumë studiuesve.

¹⁴⁷Vep.cit., Christian W. Haerpfer, “*Democracy and Enlargement in Post-Communist Europe, The democratization of the general public in fifteen Central and Eastern European countries, 1991–1998*” ,Routledge, London, 2002, fq. 1.

¹⁴⁸Vep.cit., Mariana Heredia, Olesia Kirtchik, “*Comparing Post-Soviet and Latin American Societies: From “Transition” to “Transformation”*”, Laboratorium, Vol.2 No.3, 2010, fq. 6.

¹⁴⁹Christian W. Haerpfer, fq. 1.

¹⁵⁰Shiko:Adem Mezini, Fatmir Xhaferi, “*Perqasje midis dy tranzicioneve*”, artikull botuar në Gazetën: Zëri i Populli, E merkurë 8.09.1999, fq. 9.

Tendenca e disa vendeve për të kaluar nga regjime autoritariste drejt regjimeve më liberale përbënin një dukuri interesante, komplekse dhe njëkohësisht produkt të shumë faktorëve. Në dekadat e fundit, ndërmjet studuesve janë zhvilluar polemika të shumta përsa i përket zbatimit të modelit të tranzicionit dhe konsolidimit të demokracisë në vendet e bllokut ish-komunist¹⁵¹. Modeli i ofruar nga ekspertët ndërkombëtarë për këto vende, u përpunua duke marrë si referencë eksperiencën e vendeve të Europës Jugore (Spanjë, Portugali, Greqi) dhe vendeve të Amerikës Latine. Paradigmat e zhvillimit të proceseve demokratike të nxjerra nga eksperiencia *pozitive* e këtyre vendeve u bënë baza konceptuale e rekomandimeve të ofruara nga shumë organizma ndërkombëtare si në fushën politike, ashtu dhe në asistencën ekonomike sidomos pas viteve '90.

Tashmë njihet dhe pranohet se tranzicioni i ndodhur në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore është dukshëm i ndryshëm nga tranzicioni i kaluar nga vendet e Europës Jugore dhe të Amerikës Latine.

Përsa i përket ekspertizës së ndërtuar mbi këto modele, ajo rezultoi të ishte e mangët dhe pa eksperiencën e nevojshme për të propozuar modele të përshtatshme e të suksesshme tranzicioni për vendet ish-komuniste. Studuesit, ekspertët, hartuesit e politikave si nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës edhe të Europës Perëndimore nuk kanë patur rast që të studiojnë shtete që kalojnë transformime të shumfishta¹⁵². Vendet e bllokut ish-komunist përbënin një rast të paprecedent dhe të pahasur më parë. Në këto kushte, në këtë pjesë të Europës, modeli i vendeve të Europës Jugore e Amerikës Latine u pa “i volitshëm përballë ndryshimeve të menjëhershme që po ndodhnin¹⁵³”.

Nëse u referohemi studuesve, ata pranojnë një kategorizim në katër grupe të mëdha vendesh që kanë realizuar “tranzicionin demokratik”.

Shkurtimisht këto katër grupe mund të ndahen si më poshtë:

- 1) Demokracitë e pasluftës, si Italia, Japonia dhe Gjermania Perëndimore.
- 2) Proceset demokratike mesdhetare të viteve '70 ku u përfshinë vende si Spanja, Portugalia dhe Greqia.
- 3) Rënia e regjimeve autoritare gjatë viteve 80-të në vendet e Amerikës Latine si Argjentina, Brazili, Uruguai, Kili, Paraguai.
- 4) Demokratizimi i vendeve ish-komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore¹⁵⁴.

¹⁵¹“Southern Europe, Eastern Europe, and comparative politics”, World Affairs, Vol.164, No.4 spring 2002, fq. 149.

¹⁵²Vendet ish-komuniste realizojne disa tranzicione njëherësh: nga ekonomia e centralizuar në ekonomi tregu, nga shteti totalitar në shtet demokratik dhe nga shoqëri kolektive në një shoqëri individualiste.

¹⁵³*Demokratizim pa politikë: Baza konceptuale e qasjes ndërkombëtare në Shqipëri*, Blendi Kajsio online: <http://revistapolis.com/polis/images/stories/Polis%204/Blendi%20Kajsio.pdf> aksesuar më 12.8.2012

¹⁵⁴Ky kategorizim i grupeve të tranzicionit është bërë bazuar në punimin e Claus Offe, “*Capitalism by democratic design? Democratic theory facing the triple transition in East/Central Europe*”, fq. 503; Online:

<http://homes.ieu.edu.tr/~ibagdadi/INT435/Readings/General/offe%20%20capitalism%20by%20democratic>

Ndër katër kategoritë e lartpërmendura, në tri grupimet e para, proceset demokratizuese janë fokusuar në *tranzicionin politik* dhe *kushtetues*, ndërsa tek grupi i katërt ai i vendeve ish-komuniste rruga drejt tranzicionit demokratik përmban një kompleksitetit të *transformimit në sferën ekonomike*.

Së pari; Një ndryshimi kryesor midis vendeve të Europës Jugore e Amerikës Latine dhe vendeve ish-komuniste është se tranzicioni i tyre drejt demokracisë pothuajse nuk përfshiu fushën ekonomike dhe çështjet e pronës. Për këto vende, rruga drejt demokratizimit ishte *më pak problematike* për shkak se tranzicioni ekonomik ishte minimalist.

Në tranzicionin e realizuar prej vendeve të *Evropës Jugore rreth viteve '70*, tregjet e tyre financiare dhe institucionet përkatëse iu nënshtruan transformimit me qëllim kapjen e ritmit të vendeve të tjera të Europës Perëndimore dhe jo krijimin apo ndërtimin e tyre nga asgjëja. Aty ekzistonin prej kohësh elemente të tilla si; ekzistenca e tregut, e institucioneve financiare, sektori i biznesit dhe i sipërmarrjes private, ndërsa në vendet ish-komuniste këto elemente pothuajse nuk ekzistonin. Nëse do të krahasonim Spanjën apo Portugalinë e viteve '50 me Rusinë apo Shqipërinë e viteve '91 – '92 do na binte në sy fakti që pavarësisht sistemit autarkik në dy vendet e para, ato kishin treg të lirë që funksiononte, institucione financiare, banka, një sistem ekonomie dhe komunikimi me tregjet ndërkombëtare, ndërsa në Rusi apo Shqipëri nuk ekzistonin as format më primitive të sektorit privat e jo më institucione të tilla. Në të gjitha vendet ish-komuniste, zhvillimi i ekonomisë shtetërore ishte një eksperiment me kosto të lartë që i kishte çuar këto vende drejt falimentimit. Në fund të viteve '80, ato hasnin probleme ekonomike serioze dhe ndodheshin në vështirësi të mëdha financiare. Nevoja e madhe për ndihmë dhe asistencë financiare ishte emergjente. Institucionet financiare ndërkombëtare si FMN dhe Banka Botërore, ofronin kredi dhe mbështetje financiare me kushte dhe rregulla të vendosura qartë dhe “të panegociueshm”. Doktrina e përshtatjes strukturore e aplikuar nga FMN dhe BB i detyronte vendet që kishin nevojë për asistencë financiare të kryenin një sërë reformash të detyrueshme ekonomike dhe financiare, të cilat konsistonin në hapjen e ekonomisë, në liberalizimin e tregtisë, në reduktimin e rolit të shtetit në ekonomi etj. Reformat e ofruara nga këto organizma mbështeteshin në doktrinën neoliberalë, e cila pavarësisht kritikave dhe kostove të argumentuara nga shumë ekspertë ishin pothuajse të detyrueshme që vendet ish-komuniste të përfitonin ndihmën¹⁵⁵. Procesi i demokratizimit në vendet ish-komuniste bëhet i veçantë edhe për shkak të përgjegjësive dhe rolit që merr klasa politike në realizimin e tranzicionit ekonomik. Drejtuesit politikë të vendeve ish-komuniste ndërmorën një sërë reformash sidomos për krijimin e hapësirës dhe pronës private. Ata jo vetëm që u përballën me procesin e tranzicionit, por me anë të

%20design.pdf shiko gjithashtu :Manfred G. Schmidt, “Teoritë e Demokracisë”, Botart, Tiranë, 2012, fq. 442-3.

¹⁵⁵Përsa më lart shiko: Robert Gilpin, “Ekonomia Politike Globale; Kuptimi i rendit ekonomik ndërkombëtar”, ISP&Dita 2000, Tiranë, 2009, fq. 269-74 dhe fq. 287-92.

reformave ekonomike do të përballeshin me krijimin e një klasë e re sipërmarrësish kapitalistë. Në këtë drejtim, krijimi i sferës private përmes reformave të privatizimit rezultoi një proces mjaft i ndërlikuar ku u ndërthurën interesa të grupeve të ndryshme sociale. Në këto kushte, transformimi ekonomik në Europën Qendrore dhe Lindore mbas 1989-ës rezultoi “më i vështirë e i rëndë sesa transformimi politik nga një regjim totalitar në një demokraci pluraliste¹⁵⁶”. Këtë fenomen post-komunist, studiuesi Offe e quan “Kapitalizëm Politik”. Për këtë studiues, kapitalizmi politik është një “kapitalizëm i skicuar, i organizuar dhe i vënë në lëvizje nga reformat e elitave. Motivi i tij udhëheqës nuk është karakteristika (Lokiane) parapolitike e të drejtës natyrore të pronarëve për pronë...¹⁵⁷”.

Pra, si një proces i diktuar nga zhvillimet politike në të gjitha këto vende, deformimet që kanë marrë mekanizmat e tregut dhe konkurrencës së lirë nuk janë rastësore. Prodhimi politik i një klase kapitaliste nuk është një gjë e lehtë. Dëshira për t’u pasuruar është shumë më e madhe tek shoqëritë të cilat nuk kanë më çfarë të humbasin. Kur në lojë luhet një pjesë kaq e madhe “fitimi”, ai që nuk përfiton etiketohet si i paaftë. Në vendin tonë, përkohshmëria në strukturat shtetërore ka rezultuar fatale dhe ka prodhuar një korrupsion të përmasave tepër të rrezikshme. Nëse i referohemi Robert Michel-it, ai shprehet se “kur liderët nuk janë njerëz të pasur dhe kur ata nuk kanë tjetër burim të ardhurash, ata ngulmojnë fort për t’i mbajtur pozicionet e tyre për arsye ekonomike dhe kështu fillojnë t’i shohin pozicionet që mbajnë si një e drejtë e tyre e patjetërsueshme¹⁵⁸”. Interesat ekonomike jo vetëm që deformuan tiparet e kapitalizmit në këto vende, por keqedukuan edhe klasën politike në shumë vend ish-komuniste. Kapitalistët e rinj jo vetëm që ishin produkt i klaneve të caktuara politike, por ato shkelën të drejtën bazë, atë të pronës. Kudo në vendet ish-komuniste, çështja e pronës është ende e pambyllur, megjithatë asnjë nga këto vende nuk krahasohet me problematikën që ka kjo çështje në Shqipëri. Kjo ka të bëjë me ndryshimet strukturore më të thella, më dramatike dhe gjithashtu edhe më të dukshme të realizuara në një periudhë shumë të shkurtër kohore dhe përfshin krijimin e të gjithë aktorëve të rinj ekonomikë, ndërtimin e institucioneve të reja ekonomike dhe një kuadër ligjor për të siguruar pavarësinë e aktivitetit ekonomik.¹⁵⁹”

Së dyti; Tranzicioni politik në vendet e grupit të dytë dhe të tretë u shoqërua me një transformim të madh në hapjen e regjimeve politike sipas modelit të demokracive liberale perëndimore. Tranzicioni kishte si qëllim arritjen e stadit dhe parametrave të shteteve tradicionalisht demokratike të vendeve të tjera evropiane. Ai ishte më shumë një tranzicion politik dhe ideologjik. Edhe në këtë pikë ka një ndryshim të dukshëm ndërmjet

¹⁵⁶Christian W. Haerpfer, “*Democracy and Enlargement in Post-Communist Europe, The democratization of the general public in fifteen Central and Eastern European countries, 1991–1998*”, Routledge, London and New York 2002, fq. 2.

¹⁵⁷ Claus Offe, fq. 512.

¹⁵⁸Robert Michels, “Political parties” op. cit në Eva Etzioni-Halevy, “*Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim : lexime të zgjedhura*”, Botimet Dudaj, Tiranë, 2009, fq. 268.

¹⁵⁹Ibid., (Christian W. Haerpfer, fq. 2)

këtyre dy grup-vendesh. Të dhënat teorike dhe empirike tregojnë që në aspektin politik, kalimi i një vendi nga një regjim autoritarist drejt demokracisë është më i lehtë sesa kalimi i vendit nga një regjim totalitar drejt demokracisë. Në disa vende ish-komuniste ende pas dy dekadash ndryshimi, hasen vështirësi në ndërtimin e shtetit me struktura institucionalisht të qëndrueshme, në rotacione të sukseshme të pushtetit politik, në shoqëri civile të dobëta për të reaguar ndaj qeverisjes së keqe, në konflikte politike ekstreme etj.

Së treti; Tranzicioni i grupit të dytë dhe të tretë u zhvillua në një terren ndërkombëtar dhe kushte historike të veçanta, të cilat në shumë drejtime nuk ngjasojnë me kushtet ndërkombëtare dhe historike të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore.

Shumë studiues bien dakort se edhe brenda vendeve të ish-blokut komunist hasen dallime të dukshme, dallime këto që kanë përcaktuar rrugën dhe suksesin drejt demokracisë Kështu, disa nga vendet ish-komuniste kanë hasur vështirësi të shumta, si: konflikte e ndarje etnike, destabilitet të dhunshëm, luftra, ndërsa disa të tjera jo.

Fragmentet historike përbëjnë gjithashtu elemente të ndryshimeve midis tyre. Vende si Polonia, Çekosllovakia apo Hungaria, R. D. Gjermane të cilat ndanin histori të përbashkët me vendet e Europës Perëndimore treguan më shumë përshtatshmëri me kushtet dhe standardet politike, ekonomike dhe sociale se vendet e tjera të bllokut ish-komunist¹⁶⁰. Vendet të cilat kishin qenë pjesë e historisë së përbashkët të Perandorive Osmane dhe Ruse nuk kishin të njëjtat afinitete me Perëndimin, gjë e cila do të kushtëzonte edhe mënyrën e tyre të qasjes drejt demokratizimit dhe evropianizimit.

Ndryshimet midis tyre hasen edhe në zbatimin e regjimit komunist, sidomos me formën e imponimit apo të pranimit të ideologjisë komuniste. Në sistemet njëpartiake ideologjia e partisë përcaktonte identitetin e shtetit. Në botën perëndimore, identiteti i shtetit bazohej në ndërtimin e unitetit kombëtar dhe bënte lidhjen e shumicës së njerëzve me politikën¹⁶¹ në mënyre natyrale dhe jo të kushtëzuar. Kështu, në Poloni, Hungari, Çekosllovakia, Rumani dhe Bullgari, ideologjia dhe sundimi komunist ishin imponuar nga Bashkimi Sovjetik. Të paktën në vende si Polonia, Çekosllovakia apo Hungaria, nacionalizmi i kundërvihet komunizmit. Si pasojë, këto vende e ripërcaktuan veten nga “republika popullore” në “republika” dhe si bazë të shtetit në vend të ideologjisë komuniste rivendosën nacionalizmin, ndaj edhe ndryshimet në sistemin politik pas viteve ’90 ndodhën relativisht më me lehtësi sesa në pjesën tjetër të vendeve ish-komuniste¹⁶².

1.3.2 Vala e katërt e demokratizimit, problematikat e hasura

Vala e katërt e demokratizimit është përhapur deri tani në 47 shtete. Në të përfshihen vendet ish-komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore dhe disa vende

¹⁶⁰Shiko: Mirela Bogdani, John Loughlin, “*Shqipëria dhe Bashkimi Europian, Integrimi Europian dhe Prespektiva e Pranimit*” Dajti, Tiranë, 2004, fq. 25.

¹⁶¹Sqarim: roli historik i procesit politik është paraqitur nga Rustow dhe përbën atë që ai e përfshin në fazën e parë ose “Background condition”. Për më shumë shiko: Dankwart A. Rustow, “*Transitions to Democracy: Toward a Dynamic Model*”, Comparative Politics, Vol. 2, No.3 (Apr., 1970), fq. 350-1

¹⁶²Shiko:Huntington, fq. 76.

ekonomikisht të varfëra¹⁶³. Pavarësisht faktit që tranzicioni i tyre nuk ka patur suksese të njëjta, ato kanë të paktën një rezultat të përbashkët: “...kanë çuar në ripërtëritjen e interesit për demokracinë tek intelektualët dhe kjo ka sjellë një valë interesi dituror jo vetëm për tranzicionin demokratik, por edhe për gjithçka që ka të bëjë me demokracinë si regjim¹⁶⁴.” Optimizmi i numrit të lartë të vendeve të përfshira në këtë valë, nuk përputhet me rezultatet e pritura nga tranzicionet e tyre demokratike. Nga të gjitha këto vende, vetëm një numër i vogël i tyre ka përfunduar me sukses realizimin e institucionalizimit të demokracisë.

Grupi i vendeve të mbetura në “fazën tranzitore” nuk mund të konsiderohet as vende diktatoriale dhe as të gëzojnë statusin e vendeve që janë në rrugën e mbarë drejt demokracisë. Sipas O’Donnell, kjo situatë shpjegohet me faktin që: “Demokracitë e reja mund të bëjnë regres drejt sundimit autoritar ose mund të ngecin në një situatë të dobët dhe të pasigurtë. Kjo situatë mund të zgjasë pa ndonjë shpresë për formën e demokracisë së institucionalizuar¹⁶⁵”. Për Carothers, këto vende “tranzitore” manifestojnë mangësi demokratike serioze. Në përgjithësi, jeta politike e tyre karakterizohet nga përfaqësimi i dobët i interesave të qytetarëve, nga nivel i ulët i pjesëmarrjes politike (përtej votës), nga abuzimi i shpeshtë me ligjet nga ana e zyrtarëve të qeverisë, nga zgjedhje me ligjshmëri të paqartë, nga nivele shumë të ulëta të besimit publik në institucionet e shtetit dhe, në mënyrë të vazhdueshme, nga performanca institucionale e varfër nga shteti¹⁶⁶.

Ka shumë arsye të cilat lidhen me dështimin e tranzicionit në këto vende. Sipas studiuesve, shpjegimi mund të gjendet sa tek doktrina e neoliberalizmit, tek teoria e trashëgimisë kulturore dhe tek kriza e qeverisjes¹⁶⁷, madje kjo e fundit përbën një rast interesant studimi.

Në botën post-komuniste, thekson Carothers, vende si Moldavia, Bosnja, Shqipëria dhe Ukraina kanë të paktën disa nga shenjat domethënëse të sindromës së zonës gri, ndërsa Bullgaria dhe Rumania po lëkunden në buzë të kësaj zone. Ato manifestojnë disa aspekte të përbashkëta, megjithatë këtu duhet mbajtur parasysh fakti që diversiteti i modeleve politike brenda zonës gri është shumë i gjerë. Ne po trajtojmë shkurtimisht disa prej tyre:

Së pari: vendet që ndodhen në zonën gri karakterizohen nga *pluralizmi i paefektshëm*. Në ato vende ku jeta politike është shënjuar me pluralizëm të paefektshëm dhe dominim të fuqisë politike, demokracia qëndron sipërfaqësore dhe e trazuar. Aty përfshihen elemente të demokracisë, por duhen kuptuar si drejtime alternative, jo si rrugë e qëndrueshme drejt demokracisë liberale.

¹⁶³Shiko: Manfred G. Schmidt, fq. 441.

¹⁶⁴Eva Etzioni-Halevy, “Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim” Tiranë, Botimet Dudaj, fq. 18.

¹⁶⁵Gulliermo O’Donnell, “Delegative Democracy” Op. cit në Eva Etzioni-Halevy, fq. 236.

¹⁶⁶Carothers, fq. 9.

¹⁶⁷Gilpin, fq. 288-92.

Së dyti: në këto vende, elitat politike nga të gjitha partitë kryesore ose grupimet janë të perceptuara gjerësisht si të korruptuara, me interesa vetiake, të pandershme, joefektive dhe jo serioze në punën e tyre për popullin. Ndërrimi i pushteteve duket që kryhet vetëm për të çuar problemet e vendit poshtë e lart sa në një anë në tjetrën. Në këto vende politikat ekonomike shpesh janë të konceptuara dhe të zbatuara dobët. Qeveritë e këtyre vendeve nuk mund të bëjnë progres në pjesën më të madhe të problemeve që has vendi, pasi si reformat sociale (në shëndetësi, edukimi, mirëqenia publike etj) edhe ato politike kërcënohen nga krimi dhe korrupsioni i lartë.

Publiku, i cili mbahet akoma të besimi i idealeve të demokracisë është shumë i pakënaqur dhe i palumtur për jetën politike të vendit. Politika perceptohet gjerësisht si bajate, e korruptuar dhe shteti si i dobët dhe i pafuqishëm për të funksionuar siç duhet. Po këtu lidhet edhe problemi i pazgjidhshëm që ndeshin tranzitologët; moskonsiderimi i faktit që “demokracia e mirëfilltë liberale mund të vendoset vetëm e vetëm kur paria beson se është në interesin e saj jetik që të mbrojë e respektojë rregullat e sjelljes në demokraci¹⁶⁸”. Në këto vende, drejtuesve politikë u kërcënohet pushteti pikërisht nga respektimi i parimeve dhe i rregullave të demokracisë, prandaj injorimi apo shkelja e tyre është një qasje problematike. Sipas analizës së shumë studiuesve, veçanërisht procesi i liberalizimit dhe i lindjes së institucioneve demokratike lidhet ngushtësisht me klasën politike, me forcën dhe vullnetin për të ndryshuar, përshtatur dhe përballuar me vizion realitetet e reja¹⁶⁹. Kultura, vlerat demokratike, formimi dhe aftësia për të reaguar ndaj zgjidhjes së problemeve imediate që shfaqen determinojnë formën dhe premisat se si do të jetë tranzicioni. Më konkretisht, studiuesit Diamond dhe Linz pohojnë se: “Në disa rrethana historike, vlerat dhe besimet e elitës mund të ndryshojnë shumë nga ato të publikut dhe këto ndryshime mund të ndikojnë në mënyrë vendimtare mbi zhvillimet demokratike¹⁷⁰”. Kur sqarojnë rëndësinë që kanë institucionet dhe struktura e shtetit, studiuesit Diamond dhe Linz¹⁷¹ theksojnë domosdoshmërinë e konsensusit politik midis elitave. Ata theksojnë pikërisht faktin se kur elitat ndryshojnë modelin e tyre të sjelljes nga beteja të dhunshme me norma sjelljeje pajtuese, regjimet liberale kanë më shumë mundësi të zhvillohen dhe të jenë më jetëgjata.

Së treti; Asetet kryesore të shtetit vihen gradualisht në shërbim direkt të partisë në pushtet. Kështu shteti shikohet si një burim parash, punësh, informimi publik (nëpërmjet medias shtetërore) etj.¹⁷²

¹⁶⁸ Shinasi A. Rama, “Përrallat e tranzicionit Shqiptar”, Botimet Princ, Tiranë, 2012, fq. 38.

¹⁶⁹ Shiko: Adam Przeworski, “Tranzicioni si kompromis klasor në demokracinë kapitaliste” në Eva Etzioni-Halevy, “Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim” Botimet Dudaj, Tiranë, 2009, fq. 152.

¹⁷⁰ Larry Diamond, Juan Linz. “Pabarazitë klasore, modelet e elitave dhe tranzicioni demokratik në Amerikën Latine” në Eva Etzioni-Halevy, “Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim” Botimet Dudaj, Tr, 2009, fq. 312.

¹⁷¹ Larry Diamond, Juan Linz. “Pabarazitë klasore, modelet e elitave dhe tranzicioni demokratik në Amerikën Latine” në Eva Etzioni-Halevy, “Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim” Botimet Dudaj, Tr, 2009, fq. 310-18.

¹⁷² Për sa më lartë shiko: Carothers, fq. 10-12.

1.4 Këndvështrimi elitist

Për shumë studiues, “maja” e hierarkisë drejtuese politike ka zgjuar një interes të veçantë hulumtimi dhe ekspertize shkencore. Fillimet e një pune shkencore dhe argumentuese në këtë drejtim i gjejmë në mesin e shekullit të XIX. Ndër klasikët e elitizmit mund të përmendim: Vilfredo Pareto (1848-1923), Gaetano Mosca (Moska) (1857-1941) dhe Robert Michels (Mikels) (1876-1936). Padiskutim që ka dhe shumë studiues të tjerë (elitistët modernë), të cilët janë marrë me temën në fjalë duke tentuar ta trajtojnë atë nga pikëvështrimi se “sistemet e sotme demokratike janë shumë larg idealit të vërtetë demokratik¹⁷³”. Veprat e klasikëve të teorisë elitiste trajtojnë gjërë e gjatë ekzistencën dhe natyrën e elitës politike. Elitistët klasikë shtruan hipotezën se sundimi i pashmangshëm i pakicës pohohet në çdo periudhë të historisë. Në punimet e tyre, ata mbështeteshin në studimin e fakteve empirike. Për rezultatet e punimeve të studiuesve të lartpërmendur ka shumë mbështetës, ashtu sikundër ka edhe nga ata të cilët pjesërisht apo plotësisht nuk i mbështesin apo i kundërshtojnë ata.

Pika e përbashkët për të tre këta autorë është argumenti se: “...pushteti politik gjithmon ushtrohet nga një minoritet i privilegjuar, nga një elitë¹⁷⁴”, e thënë ndryshe, në çdo regjim politik pakica qeveris shumicën. Po çfarë kuptohet me termin elitë? Së pari, neve na intereson interpretimi vetëm në kuptimin politik, që do të thotë se do të përqendrohemi në përkufizimin e konceptit “elitë politike”. Koncepti “elitë politike” është kompleks dhe, në varësi të kontekstit ideologjik, shpesh varet dhe interpretimi i tij. Studiuesi James Meisel thekson se tiparet (të cilat ai i quan 3 C-të) që sqarojnë konceptin elitë politike janë: *ndërgjegje, përbashkësi dhe konspiracion* i cili ka të bëjë me ekzistencën e një vullneti të përbashkët për veprim¹⁷⁵. Sipas Xhovani Sartorit, emërtimet “klasë politike, klasë sunduese, elitë, elitë në pushtet, elitë sunduese, pakicë udhëheqëse, udhëheqje” janë etiketa të ndryshme që tregojnë të njëjtin koncept. Më tej, ai vazhdon; “Klasa qeverisëse që dallon nga të qeverisurit, është një klasë e veçantë”, një “pakicë e organizuar, e cila vepron në mënyrë të koordinuar...” këtë klasë të veçantë/speciale do ta quajmë klasa politike¹⁷⁶. Për Giovanni Busino “shoqëritë janë të drejtuara përjetësisht nga pakica, nga një aristokraci, nga një klasë politike dominante, nga një elitë, shkurtimisht dominimi i pakicës mbi shumicën është një fakt konsubstancial nga jeta e njerëzve në shoqëri¹⁷⁷”. Po në këtë linjë mendimi, Hyppolite Taine pranon se “Masat nuk kanë patur dhe kurrë nuk do të kenë një rol krijues: historia është vepër e personaliteteve të mëdha ose të paktën e pakicave aktive dhe që veprojnë¹⁷⁸”.

¹⁷³ Andrew Heywood, “Politika”, Dudaj, Tiranë, 2008, fq. 99.

¹⁷⁴ Ibid.

¹⁷⁵ Vep.cit në G. Parry, fq. 50.

¹⁷⁶ Gian Mario Bravo, Corrado Malandrino, “Il pensiero politico del novecento”, PIEMME, 1994, fq. 50

¹⁷⁷ Ibid., fq. 48.

¹⁷⁸ Vep.cit Gian Mario Bravo, Corrado Malandrino “Il pensiero politico del novecento”, PIEMME 1994, fq. 47.

Për studiuesin Jacques Ranciere, shoqëritë, sot si dhe dje, janë organizuar nëpërmjet ndërveprimit të oligarkive dhe nuk ka qeveri demokratike në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Gjithmonë pakica qeveris shumicën¹⁷⁹. Për C. Wright Mills, elita e pushtetit përbëhet nga “njerëz, pozicionet e të cilëve u krijojnë mundësinë ta kapërcejnë mjedisin rrethues të grave dhe burrave të zakonshëm. Ata janë në pozicione të tilla që mund të marrin *vendime me pasojë të mëdha*¹⁸⁰”. Për Weber, në të gjitha shoqëritë që njohim, pabarazia shfaqet në dy përmasa: klasat që ndryshojnë njëra nga tjetra kryesisht për nga nevojat ekonomike, dhe elitat që ndryshojnë prej publikut për nga shtrirja dhe fuqia e ndikimit¹⁸¹. Këtu vlen të ndalemi tek burimet që bëjnë të mundur gjenerimin e një pozicioni të privilegjuar për elitën në pushtet. Nese diferencimi midis klasave bëhet kryesisht nga burimet ekonomike, burimet ku bazohet elita janë më komplekse. Pozitat e elitave mbështeten në burime ekonomike, burime organizative, burime politike dhe burime njerëzore. Burimet lehtësojnë dhe krijojnë mjedisin që një grup i caktuar njerëzish të gëzojnë të drejtën për të qeverisur. Gjithashtu, elementet themelore që i dallojnë elitat politike nga shtresat e tjera ose nga publiku në tërësi janë; roli që kanë në vendimmarrjen politike, ushtrimi i pushtetit dhe ndikimi që kanë mbi publikun. Kjo lidhet padiskutim me burimin e pushtetit që ata kanë në dispozicion. Për Kagan, pushteti lidhet me “aftësinë për të përfshirë të tjerët që të bëjnë atë që ju doni dhe për t’i ndaluar të bëjnë atë që ju nuk doni¹⁸²”.

Po si arrijnë ta realizojnë këtë gjë elitat qeverisëse? Sipas Moskës, kjo arrihet nëpërmjet organizimit. Elita¹⁸³ në pushtet pohon ai, është e organizuar në mënyrë të tillë që të ruajë pozitën dhe interesat e saj sa më gjatë, madje edhe duke përdorur mjetet publike në dispozicion të saj. Ai e bazon qëndrimin e tij në periudhat e historisë. Sipas tij, shkaku i kontrollit të elitës qëndron në aftësitë organizuese të pakicës sunduese, e cila favorizohet nga disa tipare që ka ky grup. Si pasojë e numrit të vogël që ka kjo klasë, organizimi është më i lehtë, antarët e saj gëzojnë prestigji, status, pasuri, influencë etj. Pjestarët e pakicës sunduese kanë zakonisht disa cilësi, reale ose fiktive, që vlerësohen lart dhe që kanë ndikim të madh në shoqërinë ku ata jetojnë.

Për Gaetano Moska, ka vetëm një formë qeverisëse, e cila është forma oligarkike, pra dominimi i një pakice është i pranishëm në çdo lloj regjimi politik, pavarësisht emërtimeve. Po kështu, në çdo shoqëri ka dy klasa njerëzish: sundimtarët (të cilët janë elitat që kanë pushtetin politik) dhe të qeverisurit (pjesa tjetër e shoqërisë). Më konkretisht, Moska shprehet:

“Në të gjitha shoqëritë, nga ato më pak të zhvilluarat dhe që mezi kanë arritur pragun e qytetërimit e deri tek shoqëritë më të përparuara dhe më të

¹⁷⁹Jacques Ranciere, “*Demokracia, Republika, Përfaqësimi*”, Polis 4, fq. 139.

¹⁸⁰C. Wright Mills, “The Power Elite” cit tek Etzioni-Halevy, fq. 100. (nënvizimi i autorit)

¹⁸¹Eva Etzioni-Halevy, “*Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim*”, Botimet Dudaj, Tiranë, fq. 23.

¹⁸²Robert Kagan, “Rikthimi i historisë dhe fundi i ëndrrave” Dudaj, Tiranë, 2008, fq. 21.

¹⁸³Sqarim: Moska nuk përdor termin ‘elitë’, por ‘klasë sunduese’.

fuqishme, janë shfaqur dy klasa njerëzish: një klasë që sundon dhe një klasë që është e sunduar. Klasa e parë, gjithmonë më e paktë në numër, kryen të gjitha funksionet politike, monopolizon pushtetin dhe gëzon të gjitha favorët që sjell ky pushtet, ndërsa klasa e dytë, klasa më e madhe, drejtohet dhe kontrollohet nga e para, në një formë që është herë pak e herë shumë legale, herë pak e herë shumë arbitrare dhe e dhunshme dhe e furnizon të parën, të paktën në dukje, me mjetet materiale të jetesës dhe me instrumentet që janë thelbësore për vitalitetin e organizmit politik¹⁸⁴.

Legjitimimi, ideologjia dhe arsyetimi moral i sundimit të pakicës realizohet me anë të “formulës politike”. Sipas Moskës, formula politike është e nevojshme për të justifikuar ekzistencën dhe pushtetin që gëzon klasa politike, në rast të kundërt askush nuk do të pranonte që të qeverisej prej saj. Sundimi dhe qarkullimi i elitës janë ligje që e përcaktojnë jetën shoqërore. Ajo mund të ndërrohet apo të zëvendësohet nga një klasë tjetër sunduese kur humbet vlera apo s’arrin të kryejë funksionin e saj qeverisës. Mekanizmi për zëvendësimin e klasës së vjetër drejtuese me një të re është një formulë më moderne dhe më e pranueshme politike.

Ashtu si Moska, edhe Pareto e ndante elitën në dy kategori. Për të, elita ndahet në “elitë qeverisëse” dhe “elitë jo qeverisëse”. E para përbëhet nga të gjithë influencuesit politikë, qoftë kur ata e ushtrojnë këtë influencë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë. Aty përfshihen anëtarët e qeverisë, partitë opozitare, industrialistët, udhëheqësit sindikalistë, personeli ushtarak apo ndonjë tjetër në shoqëri, për sa ata ushtrojnë ndikim në vendimmarrjen politike. Në lidhje me elitën qeverisëse, interesant është argumentimi i Paretos mbi rëndësinë që kanë faktorë si pasuria, prejardhja dhe korrupsioni. Ai pohon se shpesh janë këta faktorë që u japin “përparësi atyre me më pak aftësi për të arritur pozicione drejtuese, sidomos në veprimtari më pak teknike dhe racionale si politika¹⁸⁵”. Elitat joqeverisëse përbëhen nga udhëheqës në secilën nga veprimtaritë e shumta dhe të larmishme, por që nuk prekin çështjet politike¹⁸⁶. Ai pranon se: “...gjithandej ekziston një klasë qeverisëse e përbërë nga një numër relativisht i pakët individësh që qëndron në pushtet pjesërisht nëpërmjet forcës dhe pjesërisht me marrëveshjen e klasave të nënshtruara, që janë shumë më të mëdha në numër...¹⁸⁷”. Në punimin e tij, Mikels e formuloi si më poshtë tezën e elitistëve se kontrolli i elitës varet nga organizimi:

¹⁸⁴Gaetano Mosca, “The ruling Class” cituar në Eva Etzioni-Halevy, “Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim: lexime të zgjedhura”, Botimet Dudaj, Tiranë, 2009, fq. 83, shiko gjithashtu: G. Parry, fq. 53-55.

¹⁸⁵ Shiko: G. Parry, fq. 68.

¹⁸⁶ Shiko: G. Parry, fq. 53.

¹⁸⁷ Vilfredo Pareto, “The mind and Society”, cituar në Eva Etzioni-Halevy, vep.cit., fq. 79.

“Kush thotë organizim, thotë oligarki. Në çdo organizatë me çfarëdolloj përmase, udhëheqja bëhet e nevojshme për suksesin dhe mbijetesën e saj. Natyra e organizimit është e tillë që i jep pushtet dhe avantazhe grupit të udhëheqësve, të cilët pastaj nuk mund të kontrollohen nga pasuesit ose të mbajnë përgjegjësi para tyre”.

Me pak fjalë “ligji i hekurt i oligarkisë” shpjegon tendencën që të gjitha organizimet politike përdoren të jenë oligarkike. Mikels pretendon se shumica shfaq plogështi ndaj çështjeve politike dhe publike. Shumë njerëz shqetësohen për politikën vetëm kur ajo prek interesat e tyre private. Ata nuk kanë dijeni se si punon sistemi politik. E njëjta gjë ndodh me anëtarët e organizatave partiake. Ekziston një grup i vogël i brendshëm, që përbën partinë aktive dhe është vërtet ndikues. Kjo prirje ekziston më në mënyrë të pashmangshme, madje edhe strukturat pjesëmarrëse ose demokratike nuk arrijnë të kontrollojnë dominimin e organizatës nga një pakicë dominante. Ai pranon se tendenca demokratike e kufizon, por nuk mund ta pengojë tendencën oligarkike. Përtej kësaj veprimtarie të grupit, interesi dhe ndikimi në parti mund të paraqitet nga një piramidë¹⁸⁸. Mikels vëren se sa më e gjatë të jetë mbajtja e detyrës, aq më i madh bëhet ndikimi i liderit tek masa dhe aq më e madhe bëhet pavarësia e tij prej tyre, gjë e cila vlen për liderët e partive politike në Shqipëri. Më tej vazhdon “...se për pasojë, përsëritja e shpesh të zgjedhjeve është masa paraprake për të mbrojtur demokracinë nga virusi oligarkik¹⁸⁹”. Në vendet ish-komuniste vërehen disa fenomene, të cilat vënë theksin dhe maksimizojnë rolin e klasës politike. Nga ajo që trajtuam më lart rezulton se edhe vendet që kanë demokraci të konsoliduar kujdesen në mënyrë të vazhdueshme që “virusi oligarkik” të mbahet nën kontroll. Prirja për të dominuar, kontrolluar e komanduar është një prirje natyrale tek njerëzit, çështja shtrohet sesi të frenohet kjo prirje e dominimit “jashtë kontureve ligjore dhe institucionale” që mund të ndodhë tek sjelljet e elitave politike. Si t’i bëjmë mekanizmat demokratike të funksionjnë pikërisht në “vendet tranzitore”? Vëmendjen, padiskutim që na e tërheq gjendja negative në të cilën ndodhen disa shtete ish-komuniste ku shembullin më tipik e manifeston Rusia. Në Rusi, oligarkia tashmë nuk është një tendencë, por një regjim i vendosur qartë. Vende të tjera ish-komuniste ndodhen pranë situatave të ngjashme me Rusinë¹⁹⁰. Ajo që evidentohet edhe nga autorët e lartpërmendur është fakti që elitat e ‘pakontrolluara’ kërcënojnë rëndë vendosjen e demokracisë dhe krijimin e shtetit të së drejtës. Në këto raste, elitat politike paraqiten si të gjithëpushtetshme. Me veprimtarinë e tyre politike, ato frenojnë forcimin e shtetit dhe demotivojnë shoqërinë në luftën e tyre për institucionalizim të demokracisë.

¹⁸⁸Për sa më lart shiko: G. Parry, fq. 63-7; Eva Etzioni-Halevy, fq. 268-10; Andrew Heywood, “Politika”, Dudaj, Tiranë, 2008, fq. 277-79.

¹⁸⁹Robert Michels cituar në Eva Etzioni-Halevy, fq. 266.

¹⁹⁰Shiko: Jason Brownlee, “Authoritarianism after 1989; From regime types to transnational processes”, Harvard International Review, Winter, 2010, fq. 46-7.

Në pjesën që vijon do të trajtojmë pikërisht rolin dhe rëndësinë e elitave politike në tranzicion.

1.4.1 Elitat në tranzicion, formimi dhe roli i tyre

Në debatin e zhvilluar për politikën dhe pushtetin politik, një trajtesë të veçantë merr roli që luajnë elitat politike në përcaktimin ose udhëtimin që do të përcaktojë sistemin politik të një vendi. Elitat janë vendimmarrësit kryesorë të organizatave më të mëdha dhe më të rëndësishme të shoqërisë. Eksperienca e proceseve të ndryshimeve politike dhe ekonomike të vendeve ish-komuniste ka evidentuar edhe më tej rolin dhe rëndësinë e kësaj kategorie. Për shkak të historikut të këtyre vendeve, braktisja e komunizmit filloi me “*marrëveshjen e elitave*¹⁹¹”. Marrëveshja solli një shndërrim të madh të pozicionit të elitave politike që u bënë pjesë e saj. Në aspektin politik, “ajo” imponoi që elitat e vjetra politike jo vetëm që të linin pushtetin politik, por mbi të gjitha riformatimi i tyre të ishte i distancuar dukshëm nga identiteti komunist. Këtu vlen të theksojmë atë që ka thënë studiuesi Sharp se “rrezimi i një njeriu apo klike të caktuar nga pozicionet qeverisëse ka shumë gjasa që thjesht të bëjë të mundur për një grup tjetër të zërë vendin e tyre¹⁹²”, pra nga ana e përmbajtjes të mos evidentojmë ndryshime të dukshme të sistemit politik. Në aspektin ekonomik, marrëveshja e elitave në vendet ish-komuniste u bë nxitëse për ndryshime të mëdha të strukturës klasore ekonomike. Siç kemi argumentuar edhe më lart, transformimet e shumëfishta që po ndodhin në këto vende janë shumë më komplekse dhe të vështira; ato kanë rritur “artificialisht” rolin e klasës politike.

Çështja sesi klasa drejtuese politike (ose elita politike) reagon ndaj presionit për ndryshim (demokratizim) mund të analizohet nga instrumenta të ndryshëm të analizës politike-sociologjike. Kështu formimi, motivimi, cilësia e udhëheqësit, manaxhimi, interesat politike dhe ekonomike të drejtuesve politikë shpjegojnë deri diku performancat e ndryshme që kanë ndodhur në vendet ish-komuniste.

Studimet tregojnë që ekziston një lidhje shumë e fuqishme midis elitave kombëtare dhe llojit apo tipit të regjimit politik. Kompozimi dhe funksionimi i elitave politike, ndoshta është përcaktuesi më i rëndësishëm i tipit të regjimit që ekziston në një vend¹⁹³. Në këtë drejtim, një studim serioz është bërë nga Field, Higley dhe Burton. Modeli i parashtruar prej tyre thekson rëndësinë dhe mënyrën se si funksionojnë elitat kombëtare, dhe ndikimi i tyre në formën apo tipin e regjimit politik që vendoset si pasojë e sjelljeve dhe e veprimeve politike.

¹⁹¹Marrëveshja e elitave (një term i përdorur nga studiuesit Field, Higley dhe Burton) ka të bëjë me bisedimet që bënë komunistët më opozitarët e regjimit. Në Shqipëri elita opozitare përfaqësohej nga intelektualët dhe studentët, të cilët bënë marrëveshje për hapjen e vendit drejt pluralizmit.

¹⁹²Gene Sharp, fq. 19.

¹⁹³Dogan, Higley, “Elites, Crises and Regimes in comparative analysis”, cituar në Geraint Parry, fq. 10.

Sipas këtyre autorëve, struktura dhe funksionimi i elitave kombëtare ka dy përmasa të njëkohshme bazë:

1. *Nivelin e integritit strukturor* (që ka të bëjë me përfshirjen relative të rrjeteve formale dhe informale të komunikimit dhe ndikimit në persona, grupe dhe fraksione të elitave kombëtare).

2. *Nivelin e konsensusit të vlerave* (nënkupton marrëveshje mes këtyre personave, grupeve dhe fraksioneve për rregulla dhe kode formale apo informale të sjelljes politike, si dhe për vlerën e institucioneve politike ekzistuese).

Duke analizuar këto dy përmasa, ata rritën në një klasifikim më të përgjithshëm të elitave duke i ndarë në tri kategori të mëdha brenda të cilave ekzistojnë nënklasifikime (duke filluar nga ato më ekstremet, deri tek më të moderuarat). Një rëndësi të veçantë i kushtohet relacionit që ekziston midis konfigurimit të elitave dhe qëndrueshmërisë ose jo të regjimit politik. Sipas Field, Higley dhe Burton: “Qëndrueshmëria dhe paqëndrueshmëria e regjimit politik është një nga ndryshimet më të dukshme dhe më të rëndësishme të shoqërisë në botën moderne¹⁹⁴”. Duke mos dashur të hyjmë në thellësi të trajtimit që bëjnë këta autorë, ne po ndalemi vetëm tek tri konfigurimet bazë që marrin elitat kombëtare dhe regjimet, si pasojë e këtyre dy përmasave.

Konfigurimi i Elitave

Të përçara

Të bashkuara në mënyrë konsensuale

Të bashkuara ideologjikisht

Tipi i Regjimit

Të paqëndrueshme

Të qëndrueshme përfaqësuese

Të qëndrueshme jo përfaqësuese

Për analizën e elitës dhe regjimin politik në Shqipëri, konfigurimi i parë, pra “elita të përçara” i kombinuar herë pas here me dy tipe të regjimit politik: të paqëndrueshëm dhe të qëndrueshëm jo përfaqësues, rezulton të jetë ai më afër reales. Në hulumtimet tona, na rezulton që elita politike në Shqipëri gjatë këtyre viteve të periudhës së tranzicionit ka manifestuar më shumë tipare të kësaj kategorie.

Po çfarë nënkupton kjo kategori? Sipas këtyre autorëve ky konfigurim (elita të përçara) nënkupton *që integriti strukturor dhe konsensusi për vlerat janë minimale*, në kuptimin që komunikimi në rrjetet e ndikimit, pavarësisht përdorimit të metodave gjithëpërfshirëse, nuk i kapërcen kufijtë e fraksioneve. Fraksionet nuk bien dakort për rregullat dhe kodet e sjelljes politike dhe për vlerat e institucioneve ekzistuese. Prandaj, elitat kanë prirjen të mos e besojnë *njëra-tjetrën*, të mos i përfillin fare rezultatet e të tjerëve dhe t’i hyjnë një lufte të shfrenuar, shpeshherë të dhunshme, për dominim¹⁹⁵. Në bazë të analizës tonë, Shqipëria bën një përjashtim nga kombinimet klasike të modelit të dhënë nga këta autorë. Regjimi politik në Shqipëri pasqyron më tepër një kombinim të

¹⁹⁴ G. Lowell Field, John Higley, Michael G. Burton, “A new elite framework for political Sociology”, cituar në Eva Etzioni-Halevy, fq. 197.

¹⁹⁵ Ibid. (nënvizimi i autorit).

një elite të përçarë jo shumë të moderuar me një përzierje të një regjimi sa të paqëndrueshëm, aq edhe të një regjimi të qëndrueshëm jopërfaqësues duke anuar më tepër tek ky i fundit. Siç do të analizohet në kapitujt vijues, në Shqipërinë e këtyre 20 viteve tranzicion nuk ka munguar kapitullimi i shtetit si në vitin 1997, grushti shtetit në vitin 1998 dhe pretendimi nga disa për një tjetër të tillë në 21 janar të vitit 2011, kriza të vazhdueshme politike dhe lufta e ashpër për pushtet. Në tërësi, e gjithë kjo klimë politike ka patur në thelb deformimin e procesit zgjedhor dhe monopolizimin e tij nga forcat politike. Gjatë kësaj kohe, ka patur bojkotim parlamentar të vazhdueshëm, mosnjohje sistematike të zgjedhjeve (përfashtuar vitin 1992 dhe vitin 2005), standarde të ulta të proceseve zgjedhore, ndërhyrje të shpeshta në kodin zgjedhor etj. Kjo situatë ka prodhuar në Shqipëri një konfliktualitet dhe gjendje të rëndë politike duke deformuar dhe thelluar krizën e përfaqësimit. Partitë politike i janë larguar gjithnjë e më shumë luftës për përmbushjen e interesave dhe detyrimeve ndaj qytetarëve dhe janë fokusuar vetëm tek lufta për pushtet. Kështu, për përcaktimin e lartëpërmendur, ne bazohemi tek karakteristikat e paraqitura nga Field, Higley dhe Burton. Sipas tyre: “Regjim i paqëndrueshëm është ai ku pushteti legjislativ u nënshtrohet krizave sporadike, krizave të herëpashershme ose atyre të shkaktuara nga përdorimi i forcës. Tregues konkretë të një regjimi të paqëndrueshëm janë revolucionet, kryengritjet ose grushtet e shtetit që drejtohen kundër personalitetit që kontrollon pushtetin ekzekutiv dhe që nuk drejtohen nga forca të jashtme. Një regjim mund të konsiderohet i paqëndrueshëm në kohën kur kriza të tilla ndodhin, kur ato mbeten thjesht në tentativë ose kur konsiderohen të mundshme nga vëzhgues të informuar.

Gjithashtu, në rastin e vendit tonë hasen edhe tiparet e tipit të dytë të regjimit të qëndrueshëm dhe jopërfaqësues. Më konkretisht, në këtë tip regjimi institucionet përfaqësuese politike mund të ekzistojnë ose jo formalisht, por politikave përfaqësuese nuk praktikohen në mënyrë aktive. Edhe nëse mund të zhvillohen zgjedhje, ato nuk janë një garë serioze dhe rezultatet e tyre nuk përcaktojnë se kush do ta ketë pushtetin ekzekutiv ose kush do të ndikojë në linjat kryesore të politikave qeverisëse. Pushteti ekzekutiv transferohet tek individë ose grupe elitash nëpërmjet marrëveshjeve të fshehta të zyrtarëve më të lartë të regjimit¹⁹⁶.

¹⁹⁶ Për sa më lart, shiko G. Lowell Field, John Higley, Michael G. Burton, “A new elite framework for political Sociology”, në Eva Etzioni-Halevy, fq. 196-206.

KREU I DYTË

SHQIPËRIA NËN DREJTIMIN KOMUNIST 1945 – 1990.

“Njeriu është e vetmja qenie që jo vetëm e ka vuajtur historinë por edhe e ka krijuar atë”
Maria Zambrano¹⁹⁷

2.1 Një vështrim mbi lëvizjen komuniste shqiptare

Rrethanat të cilat favorizuan vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri janë komplekse dhe produkt i disa kushteve dhe faktorëve historikë, politikë, ekonomikë dhe socialë. Shumë studiues bien dakord që gërshetimi i kushteve primitive shoqërore, ekonomike, politike, si dhe pushtimi italian e më pas ai gjerman gjatë Luftës së Dytë Botërore ishin deri diku përcaktues për vendosjen e diktaturës pas luftës në vend.

Në traditën shqiptare, kreu i fisit luante një rol të rëndësishëm politik dhe shoqëror. Në pjesën veriore të Shqipërisë, e cila përbënte dy të tretat e popullsisë së përgjithshme ekzistonte një organizim fisnor, në të cilin bajraktari gëzonte si atributet shoqërore, ashtu edhe ato politike. Jugu i vendit përbëhej kryesisht nga fshatarë të varfër të cilët trajtoheshin si bujkrobër prej çifligarëve të ndryshëm feudalë.

Në këtë periudhë, 85% e shoqërisë jetonte në fshat dhe pjesa tjetër në qytet. Qytetet kryesore si Tirana, Shkodra, Korça, Durrësi, apo Vlora ngjasonin në njëfarë mënyre me qytetet evropiane. Përsa i përket shoqërisë fshatare, bujqësia dhe rritja e gjësë së gjallë përbënin punën e më shumë se 80% të popullsisë, ndërkohë që vetëm 11% e tokës ishte e punueshme. Tri të pestat e tokës së punueshme në Shqipëri ishin pronë e vetëm 150 çifligarëve. Të paktën 40% e fshatarëve ishin pa tokë dhe jetonin në varfëri. Teknikat bujqësore dhe të shumimit të bagëtisë mbeteshin të tipit mesjetar, plugjet e hekurit gjendeshin vetëm në jug të vendit dhe sistemet primitive të qarkullimit të drithërave kërkonin që 20% e tokës së punueshme të mbetej djerrë. Si rezultat, fshatarët shqiptarë ishin më pak produktivët e krejt fshatarëve të Ballkanit, të cilët nga ana e tyre ishin më pak produktivët e krejt fshatarëve të Evropës¹⁹⁸. Ky ishte pak a shumë mjedisi dhe kushtet në të cilat gjendej Shqipëria në vitin 1944.

Përgjithësisht komunizmi gjeti “terren pjellor” pikërisht në shoqëritë e prapambetura nga ana ekonomike, sociale dhe me mungesë të traditave demokratike. Struktura shoqërore Shqiptare e asaj kohe bashkë me prapambetjen dhe mungesën e një sërë mekanizmash institucionalë favorizonte, deri diku, instalimin e një regjimi

¹⁹⁷Op. cit në Tranzicione në Pasqyrë, “Një përjasje e krahasuar e proceseve të transformimit demokratik të Spanjës dhe Shqipërisë”, Ciencias y humanismo. fq. 19.

¹⁹⁸Shiko: Bernd. J. Fisher, “Shqipëria gjatë luftës, 1939-1945”, Çabej, Tiranë, 1999. fq. 62-63.

autokratik. Siç argumenton edhe Robert Dahl: "...shoqëria tradicionale fshatare, shfaq një prirje të natyrshme për pabarazi, hierarki dhe hegjemoni politike¹⁹⁹".

Megjithatë duhet pranuar se sidomos strategjia e ndjekur për marrjen e pushtetit nga drejtuesit komunistë ishte thelbësore si për krijimin, ashtu edhe për vazhdimin e pushtetit të Shqipërisë komuniste.

Marrja e pushtetit nga komunistët kishte një karakter unik, për dy arsye kryesore:

1. Komunistët, e propaganduan Luftën Nacionalçlirimtare të Shqiptarëve si një arritje krejtësisht të tyre, si gjatë edhe pas përfundimit të saj. Lufta që organizuan komunistët nuk do të mund të nisej pa frymën nacionaliste që bënte thirrje për bashkimin e njerëzve për çlirimin e atdheut nga pushtimi²⁰⁰. Duhet pranuar që komunistët ishin nga njerëzit më aktivë në luftën kundër fashizmit, por kjo luftë përfshiu një gamë të madhe njerëzish, ku pjesën më të madhe e bënin njerëzit pa përkatësi ideologjike. Mjafton të përmendësh faktin që nga 70,000 njerëz të përfshirë në këtë luftë rreth 2,800 – 3,000 vetë ishin komunistë²⁰¹ (anëtarë partie) domethënë më pak se 5% e tyre, fakt i pranuar edhe nga vetë historiografia komuniste.

2. Komunistët, ndryshe nga forcat nacionaliste kishin një ndihmë dhe mbështetje të madhe nga jashtë vendit. Ata u ndihmuan materialisht nga forcat anglo – amerikane, si dhe kishin mbështetjen e fuqishme të Moskës, mbështetje e cila ushtrohej në vend përmes emisarëve jugosllavë.

Me këto avantazhe, në prag të çlirimit të vendit, Partia Komuniste filloi luftën civile kundër kundërshtarëve të vet për marrjen e pushtetit. Njësoj si në Jugosllavi, qeveria e përkohshme komuniste e Enver Hoxhës nisi me larjen e hesapeve me "kriminelët e luftës" dhe bashkëpunëtorët e pushtuesve, ndërsa shumë shpejt u fshinë nga faqja e dheut të gjitha rudimentet e asaj që mund të quhej opozitë.²⁰² Brenda një periudhe të shkurtër komunistët e armatosur mirë i mundën grupet kundërshtarë më të dobëta dhe të organizuara keq, të cilat ishin mbledhur rreth Lëvizjes së Legalitetit, që luftonte për kthimin e mbretit Zog, dhe Ballit Kombëtar, i cili ishte për vendosjen e një republike demokratike²⁰³.

Siç vë re dhe studiuesi Fischer është interesant fakti që historikisht, në Shqipëri të huajt kanë mundur dhe kanë shfrytëzuar për qëllimet e tyre elementë vendas. Si rrallëherë në ndonjë vend tjetër Ballkanik apo edhe më larg, këtu mund të gjejmë njerëz që janë gati që për interesat e tyre të sakrifikojnë çështjen kombëtare. Fischer argumenton se tradhtia apo elementi kolaboracionist qëndron në primitivizmin e udhëheqësve shqiptarë si rezultat i mosnjohjes së moralit politik dhe vlerave perëndimore. Analiza e tij qëndron jo vetëm për periudhën e pushtimit, por edhe për aleancat që komunistët bënë gjatë sundimit të tyre.

¹⁹⁹Robert Dahl, "Poliarkia Pjesëmarrja dhe Opozita", Pegi, Tiranë, 2005. fq. 53.

²⁰⁰"Roli i miteve në historinë e shqipërisë", Revista Perpjekja, Nr. 15-16, 1999. fq. 145.

²⁰¹Për sa më sipër shiko: Valentina Duka, "Histori e Shqipërisë 1912-200", Kristalina-KH, Tiranë, 2007. fq. 231; Bernard Lory, "Europa Ballkanike; nga 1945 në ditët tona", Dituria, Tiranë 2007, fq. 38.

²⁰²Milovan Gjlasi, "Fytyra e Totalitarizmit", Fan Noli, Tiranë, 2006. fq. 257.

²⁰³Elez Biberaj, "Shqipëria në tranzicion, Rruga e vështirë drejtë demokracisë 1990-2010" AIIS, Tiranë, 2011, fq. 46.

Madje nuk e teprojmë po të themi që mbeturina të këtij mentaliteti janë ende prezent edhe sot. Ja si shprehet Fischer:

“Të mësuarit me sistemin e mitës dhe korrupsionit, i cili mbizotëronte gjatë sundimit nën perandorinë osmane dhe nën regjimin e Zogut, shumë prej shqiptarëve, të cilët s’kishin kurrfarë elementi të idesë perëndimore mbi moralin politik... duke e pranuar me shpirt filozofik pushtimin e vendit të tyre, shumë shqiptarë bashkëpunuan me pushtuesin pa e kuptuar aspak tradhtinë që po kryenin²⁰⁴”.

E parë nga kjo perspektivë mund të kuptohet bindja, nënshtrimi dhe lidhja e drejtuesve komunistë me ata jugosllavë. Madje mund të kuptohet edhe arsyeja që i çoi ata në veprime të njëpasnjëshme antikombëtare. Duke u nisur nga përfitimet personale ata nuk i konsideronin veprimet e tyre si tradhti apo krime kundër shoqërisë. Kjo psikologji justifikon edhe zhvillimin e një loje politike pa rregulla dhe moral me ekzekutime të njëpasnjëshme të figurave kryesore si jashtë ashtu edhe brenda vetë partisë së tyre.

Pavarësisht argumenteve të lartpërmendur që kanë të bëjnë me rrugën drejt pushtetit të komunistëve në periudhën 1944 – 1945 në vijim qëllimi kryesor i regjimit ishte konsolidimi i pushtetit dhe legjitimiteti i tij.

Për të arritur këtë objektiv komunistët ndërmoren masa në disa drejtime kryesore:

1) Përdorimi i LANÇ nga komunistët për qëllimet e tyre. Në këtë drejtim shërbyen krijimi i gjyqeve speciale për likuidimin e të ashtuquajturve “kriminelë lufte dhe bashkëpunëtorët me pushtuesin”. Më 15 dhjetor 1944 kryesia e KANÇ krijoi në Tiranë gjykatën speciale për gjykimin e kriminelëve të luftës dhe të bashkëpunëtorëve të armikut. Si rrjedhojë gjatë periudhës 1 mars – 13 prill 1945 në një gjyq special u dënuan 60 ish-drejtues e funksionarë të shtetit²⁰⁵. Të pandehurit ishin drejtuesit më të lartë të shtetit (ish kryetar parlamenti, ish ministra, profesorë etj).

2) Fushatë në popull kundër pluralizmit politik i cili sipas tyre dëmtonte interesat e vendit dhe se rruga e vetme dhe e vërtetë ishte rruga e Frontit Demokratik, dmth prej tyre.

3) Goditja e kundërshtarëve politikë potencialë duke shkatërruar shtresën e mesme dhe të lartë të shoqërisë shqiptare të cilët ishin dhe pjesa më e civilizuar dhe e aftë për të krijuar një opozitë serioze kundër komunistëve. Menjëherë pas luftës PKSH-ja shpalli si të jashtëligjshëm edhe institucionalisht organizatat “Balli Kombëtar” dhe “Legaliteti”, duke i konsideruar ato si organizata fashiste dhe bashkëpunëtore të pushtuesve. Të gjithë pjesëtarët e këtyre dy grupeve u shpallën tradhtarë.

4) Si pasojë e terrorit dhe dhunës kundër elementëve jokomunistë gjatë vitit 1944 ndodhi emigracioni politik ku rreth 1,500 – 2,000 veta, kryesisht anëtarë të krahut opozitar, u larguan jashtë Shqipërisë²⁰⁶.

²⁰⁴Bernd. J. Fisher, fq. 78.

²⁰⁵Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, “Historia e Shqipërisë, V.4. 1944-1975”, 8 Nëntori, Tiranë, 1983.fq. 24-5.

²⁰⁶Shiko: Kastriot Dervishi, “Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005”, Sh.B 55, Tiranë, 2006, fq. 627.

Një element i domosdoshëm për t'u përmendur është fakti që komunistët shqiptarë gëzonin mbështetje të pakursyer nga komunistët jugosllavë të cilët i ndihmuan në përmbushjen e qëllimeve të tyre politike në vitet e para të pasluftës. Një vit pas çlirimit të vendit, gjatë të cilit ishin eliminuar elementët opozitarë dhe rruga ishte e lirë drejt pushtetit, por edhe si pasojë e presionit të perëndimorëve duke mos njohur qeverinë e drejtuar prej tyre, komunistët më 2 dhjetor të vitit 1945 shpallën zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese. Fronti Demokratik (komunistët) fituan bindshëm me rreth 93%.

Këto rezultate ishin pasojë e disa arsyeve:

Së pari: Grupimi politik “Bashkimi Demokratik” nuk mundi të përfaqësohej ashtu siç duhej në zgjedhje. Shkak për këtë ishte: eliminimi i figurave politike kryesore, diskreditimi në popull si pasojë e bashkëpunimit me pushtuesit, pengesat dhe problemet që vinin nga komunistët etj.

Së dyti: Gegët në veri kishin mbështetur luftën e vëllezërve të tyre të Kosovës gjatë Luftës II Botërore. PKSH shihej si krijesë e jugosllavëve dhe, rrjedhimisht, si armike e interesave të shqiptarëve të Kosovës²⁰⁷. Për këtë arsye pjesa më e madhe e popullsisë së veriut nuk mori pjesë në zgjedhje, këtu duhet theksuar fakti që popullsia e pjesës veriore të Shqipërisë ishte në pjesën dërrmuese të saj antikomuniste.

Me marrjen “de jure” të pushtetit politik më 11 janar të vitit 1946 Shqipëria u shpall Republikë Popullore duke hequr edhe formalisht regjimin monarkik²⁰⁸. Në 12 janar të vitit 1946, Presidiumi i Asamblesë Kushtetuese zgjodhi Dr. Omer Nishanin president të parë të saj. Më 14 mars 1946, Asambleja Kushtetuese u shndërrua në Kuvendin Popullor, si dhe votoi Kushtetutën e Republikës Popullore të Shqipërisë. Kushtetuta e re, i shëmbëllente shumë kushtetutës së Jugosllavisë komuniste²⁰⁹.

Në të tilla kushte, PKSH u kthye në aktoren e vetme politike të vendit. Lufta politike nuk u zhvillua vetëm kundër kundërshtarëve, por edhe brenda radhëve të partisë. Ky element përputhej me vetë natyrën e partive komuniste të organizuara sipas modelit bolshevik.

2.2 Disa aspekte politike, ekonomike dhe sociale të Shqipërisë gjatë viteve 1945 – 1985

Ardhja në pushtet e Partisë Komuniste përcaktoi aspektet thelbësore të rrjedhës së ngjarjeve që ndodhën në fushës politike, ekonomike dhe sociale në vend. Në shumë aspekte, pushteti i marrë me luftë dhe drejtimi nga klasa politike e pas viteve ‘45 ka dëmtuar në tërësi shtetin, shoqërinë, ekonominë dhe kulturën në vend. Dëmtimi filloi me eliminimin e opozitës ende pa përfunduar lufta, fakt që ndihmoi partinë komuniste që të

²⁰⁷Misha Glenny, “Historia e ballkanit 1804-1999” Toena, Tiranë, 2007, fq. 563.

²⁰⁸Për më shumë shiko: Nikolla Pano. “Albania” The Columbia History of Eastern Europe in the twentieth century, New York: The Columbia University Press, 1991, fq. 35-40.

²⁰⁹Elez Biberaj, fq. 47 ; gjithashtu shiko: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, “Historia e Shqipërisë, V.4. 1944-1975”, 8 Nëntori, Tiranë, 1983, fq. 43-8.

fitonte zgjedhjet dhe të vinte në pushtet. Nën të ashtuquajturat “gryqe të popullit”, me qindra intelektualë dhe drejtues opozitarë u pushkatuan publikisht, kjo, pa asnjë procedurë të rregullt penale e ligjore²¹⁰. Me shkatërrimin e opozitës dhe vendosjen e shtetit të diktaturës së proletariatit, shumë aspekte të jetës në vend u orientuan me zhvillimet dhe ngjarjet që ndodhnin kryesisht brenda Partisë Komuniste. Në vija të përgjithshme, përsa u përket aspekteve politike u përcaktua orientimi përfundimtar i vendit drejt bllokut lindor, iu dha fund parlamentarizmit, u mohuan të drejtat politike e civile të qytetarëve shqiptarë, u zhvillua ashpër dhe në mënyrë të vazhdueshme lufta e klasave etj. Diktatura në Shqipëri u zhvillua si një diktaturë e drejtuar nga një kastë politike që gllabëroi pushtetin politik duke sakrifikuar interesat shoqërore në emër të interesave të saj vetjake. Realpolitika e aplikuar nga udhëheqja komuniste (marrja dhe mbajtja e pushtetit me të gjitha mjetet) përvijoi politikën 50 vjeçare të shtetit shqiptar.

Zhvendosja e madhe e pushteteve (në vitet 1945 – 1946), likuidimi i elitës së vjetër dhe e më pas e asaj të re të krijuar nën regjimin komunist, njësimi i shtetit me partinë, eliminimi i shtetit të së drejtës, vendosja dhe promovimi në krye të shtetit i njerëzve pa përvojë dhe eksperience, lufta e ashpër dhe permanente e klasave pati pasoja shumë të rënda për vendin. Si pasojë e politikës ekstreme, në Shqipëri u aplikuan format më të egra të dhunës dhe terrorit në shoqëri. Sistemi diktatorial u mbështet në atë ç’ka u quajt mentaliteti i gjendjes së rrethimit ose i shtetit-kazermë, i cili e vinte theksin mbi ekzistencën e grupeve armiqësore nga brenda dhe jashtë vendit. Kjo strategji e regjimit komunist ishte vazhdimisht në kërkim dhe shpikte grupime armiqësore, të cilat ose eliminoheshin fizikisht ose mbylleshin në kampe përqendrimi. Gjatë gjithë këtyre viteve sigurimi i shtetit morri përmasa shumë të mëdha. Si në Bashkimin Sovjetik edhe në Shqipëri, mjete të cilat shërbeu për të shtypur dhe përçarë shoqërinë ishte ndërtimi i një aparati gjigant të sigurimit dhe shembja e sistemit të drejtësisë.

Instalimi i sistemit stalinist, e më pas përfshirja e elementëve Maoistë e Enveristë, dhe ndjekja me besnikëri e këtij modeli nga nomenklatura komuniste bëri që Shqipëria të etiketohej si vendi më stalinist në Evropën Lindore. Zbatimi i kësaj forme qeverisëse siguronte fuqizimin e pushtetit personal të Enver Hoxhës dhe jetëgjatësinë e tij në pushtet. Metodot e spastrimeve nga radhët e komunistëve të atyre elementëve që mund të rrezikonin pushtetin i forcuan vazhdimisht pozitën e tij. Në këtë linjë, ideologjia u kthye në një strategji të rëndësishme për realizimin e luftës politike brenda gjirit të Partisë.

Në fushën ekonomike dhe sociale kemi zhvillimin e njëkohshëm të disa elementëve që dhanë rezultate të ndërsjella në fushat përkatëse. Kështu, ndryshimi i bazës shoqërore në vend pas luftës erdhi si rezultat i aplikimit të ashpër dhe të vazhdueshëm të luftës së klasave si dhe i reformave të ndërmarra për realizimin e transformimit të sistemit ekonomik. Transformimi i sistemit ekonomik konsistonte në bërjen e shtetit si pronarin e vetëm të pasurive të vendit, si dhe orientimi i vendit drejt industrializimit. Kështu, si në

²¹⁰Shiko: Arben Çejku, “Demokracia e Imponuar; esse”, Mbrothësia, Tiranë, 2000, fq. 41.

fshat dhe në qytet realizimi i shndërrimeve ekonomiko-shoqërore dhe reforma agrare konsistonte në shtetëzimin e çdo gjëje, pra, në kthimin total të pronës dhe të të gjitha degëve të ekonomisë në duart e shtetit si pronar i vetëm. Në këtë drejtim, ekonomia Shqiptare hodhi që në fillim bazat e një ekonomie socialiste të planifikuar sipas modelit sovjetik. Në vend u krijuan një sërë institucionesh ekonomike të cilat mundësonin kontrollin e plotë të ekonomisë nga ana e shtetit. Modeli ekonomik bazohej në industrializimin e shpejtë dhe të sforcuar. Me anë të këtij modeli do të realizoheshin dy procese themelore, së pari krijimin e klasës punëtore dhe së dyti ky model do ta çonte vendin drejtë pavarësisë ekonomike nga vendet e tjera. Në kuadrin e luftës së klasave me qëllim shkatërrimin e borgjezisë dhe shtresës së pasur, fillimisht u konfiskuan dhe shtetëzuan të gjitha pronat e emigrantëve dhe të bashkëpunëtorëve të pushtuesve, si dhe të gjitha fabrikat e punishtet që u takonin shoqërive italiane. U shtetëzuan bankat, burimet minerare, kullotat, pyjet transporti tregtia e jashtme, si dhe tregtia me shumicë²¹¹. Zhvillimet sociale udhëhiqeshin nga krijimi i një numri të madh organizatash shoqërore të masave, të cilat nën ndikimin e partisë-shtet, diktuan dhe kontrolluan çdo qelizë të jetës shoqërore në vend. Ky rrjet i gjerë organizatash profesionale kishte pushtet të kontrollonte aktivitetin e çdo individ. Parimi i kolektives dëmtoi rëndë sferën private të individit shqiptar. Gjatë gjithë kësaj kohe iu shpall luftë çdo gjëje të re e përparimtare, e cila binte ndesh me linjën e partisë-shtet. Roli i Partisë Komuniste u rrit ndjeshëm si pasojë e vendosjes së kriterit të anëtarësimit në Partinë Komuniste për t'u punësuar në administratën shtetërore. Kështu, baza e mbështetjes së komunistëve u bë burokratët komunistë, në pjesën më të madhe të paaftë, të cilët gëzonin shumë privilegje në këmbim të besnikërisë dhe mbështetjes pa rezerva²¹².

Në çështjen në vijim do të trajtohen disa nga momentet kryesore në aspektin politik, ekonomik, social dhe kulturor të realizuara nën sundimin e drejtuesit Enver Hoxha.

2.2.1 Tendencat politike nën drejtimin e Enver Hoxhës

Shqipëria doli nga zgjedha e pushtuesve të huaj, për të rënë nën sundimin e klasës politike komuniste. Që në krye të herës, në fushatën propagandistike të komunistëve, shteti u përkufizua si shprehje e qeverisjes së diktaturës së proletariatit, por e vërteta ishte se në Shqipëri nuk kishte ekzistuar ndonjëherë një klasë punëtore e mirëfilltë. Diktatura e proletariatit “de facto” shërbente si justifikim politik për të legjitimuar sundimin e vendit nga një grusht i vogël njerëzish. Siç e sqaron këtë koncept edhe z. Ngjela:

“Bolshevikët e konceptonin diktaturën e proletariatit të ngjashme me një formacion terrorist. Ata e konsideronin veten si të zgjedhurit e Zotit për të sjellë

²¹¹Valentina Duka, “Histori e Shqipërisë 1912-200”, Kristalina-KH, Tiranë, 2007. fq. 248.

²¹² Për më shumë shiko: Valentina, Duka.2007. “Histori e Shqipërisë 1912-200”, Tiranë. Kristalina-KH, fq. 230-9.

*paqen, zhvillimin dhe barazinë në një botë ku dominonte krimi, prandaj krimi duhej shmangur me krim, por për një qëllim të lartë*²¹³.

Në këtë linjë, ajo që zbatuan komunistët ishte krijimi i një formacioni shtetëror terrorist. Qysh në fillim, për të garantuar pushtetin, komunistët e vendosën vendin në gjendjen e shtetrrethimit. Kështu, fundi i luftës nuk pasoi me çmobilizimin e ushtrisë, përkundrazi numri i tyre u rrit ndjeshëm. Forcat shqiptare të sigurimit u rritën në 3.5% të numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe kostoja për mbajtjen e tyre kapte shifrën e 10 – 11% të produktit të përgjithshëm²¹⁴. Sipas historiografisë komuniste:

*“Përforcimi i gjendjes së brendshme, lufta kundër bandave reaksionare dhe puna bindëse dhe edukative me ato shtresa të popullsisë që mbanin një qëndrim jo dashamirës ose indiferent ndaj realitetit të ri në Shqipëri ishte detyrë e ngutshme kryesore e pushtetit popullor*²¹⁵”.

Në këtë drejtim, qysh para përfundimit të luftës, në 28 maj të vitit 1944, Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar kishte vendosur krijimin e një komisioni për zbulimin dhe vërtetimin e krimeve të pushtuesve dhe të bashkëpunëtorëve të tyre. Me vendim të këtij organi në 15 dhjetor të vitit 1944 u krijua në Tiranë edhe gjykata speciale për gjykimin e kriminelëve të luftës dhe bashkëpunëtorëve të armikut²¹⁶. Ndër të tjera, këto masa kishin për qëllim likuidimin e elementëve që përfaqësonin alternativa të tjera politike para se të mbaheshin zgjedhjet e përgjithshme.

Fitorja e luftës kundër fashistëve u shfrytëzua nga komunistët dhe, si rezultat, ata arritën që të vetëm të merrnin pushtetin politik. Glorifikimi dhe miti i luftës “legjitimoi” jo vetëm marrjen e pushtetit, por edhe qëndrimin e tyre gjatë në pushtet. Sipas studiuesit Fisher, përvoja e luftës përforcoi ksenofobinë tradicionale për të cilën shqiptarët janë legjendarë, një ksenofobi e përforcuar dhe e shfrytëzuar nga qeveria staliniste e Enver Hoxhës gjatë e pas luftës. Hoxha, kuptoi se përvoja shqiptare gjatë luftës ishte mjeti më i domosdoshëm për ruajtjen e pushtetit. Nën pushtetin e regjimit, u krijua dhe u mbajt gjallë miti i qëndresës së fuqishme, i cili ishte prezent në çdo aspekt të jetës në vend²¹⁷.

Në politikën e jashtme, Shqipëria e pasluftës realizoi aleanca aspak pozitive për vendin. Nën sundimin e Hoxhës tri aleancat kryesore që dominuan linjën e politikës së jashtme ishin, aleanca me Jugosllavinë, Bashkimin Sovjetik dhe Kinën²¹⁸. Aleanca me Jugosllavinë rezultoi të ishte më shkatërrimtarja si në planin politik, ashtu dhe në atë ekonomik. Kalimi i vendit në krahun e Lindjes u kushtëzua në një masë të madhe nga lidhja e liderve komunistë shqiptarë më ata jugosllavë. Ndikimi i jugosllavëve gjatë gjithë periudhës së luftës së Dytë Botërore e më pas ka qenë i dukshëm si në vendimmarrjen

²¹³ Spartak Ngjela, “Përkulja dhe Rënia e Tiranisë Shqiptare, 1957-2010”, UET, Press, Tiranë, 2011, fq. 193.

²¹⁴Op.cit, Fisher, fq. 326.

²¹⁵Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, “Historia e Shqipërisë, V.4. 1944-1975”, 8 Nëntori, Tiranë, 1983, fq. 12.

²¹⁶ Ibid., fq. 23-4.

²¹⁷Shiko:Fisher, fq.27-28.

²¹⁸Shiko: Pierre Cabanes., etj “Historia e Adriatikut”, SHL&K, Tiranë, 2005, fq. 504-6.

politike, ashtu dhe në orientimin e strukturave ushtarake në Shqipëri.²¹⁹ Intensifikimi i marrëdhënieve me Jugosllavinë pas luftës ishte vazhdim i një diktati politik brenda Partisë Komuniste Shqiptare, vendosur shumë përpara përfundimit të luftës. Qëllimi dhe mbështetja e Partisë Komuniste Shqiptare nga jugosllavët gjatë viteve të luftës e më pas ishte e qartë: nëpërmjet saj do të realizohej aneksimin jo vetëm i Kosovës, por edhe i Shqipërisë. Duhet theksuar fakti që në qëndrimin antiperëndimor të komunistëve shqiptarë pas luftës ka ndikuar dukshëm qeveria jugosllave, pasi i ka nxitur ata në qëndrime të skajshme. Qëllimi i tyre ishte izolimi ndërkombëtar i Shqipërisë dhe krijimi i varësisë së plotë të saj nga Jugosllavia. Në këto momente historike, Jugosllavia nuk mund ta arrinte këtë qëllim duke përdorur luftën, ndaj aleanca midis dy vendeve u pa rruga politike më e përshtatshme.

Kështu, i pari shtet që vendosi marrëdhënie me Shqipërinë, duke dhënë “një provë të re vllazërie” ishte Jugosllavia.²²⁰

Bazuar tek studiuesit e shumtë, faktet dhe argumentat në këtë drejtim tregojnë që aleanca e komunisteve shqiptarë me Partinë Komuniste Jugosllave ishte në kundërshtim me interesat kombëtare dhe vuri në rrezik konkret pavarësinë e brishtë të shtetit shqiptar të pasluftës. Që në krye të herës, një aleancë me një shtet fqinj më të fortë dhe me qëllim të qartë ekspansioni territorial do të përbënte një kërcënim të madh kombëtar. Sikundër edhe në të kaluarën, Serbia kishte tentuar të joste me aleanca drejtues të tjerë shqiptarë të cilët i ishin shmangur duke mos realizuar qëllimin e saj. Pjesë e mekanizmit jugosllav, tashmë ishin bërë drejtuesit më të lartë të Partisë Komuniste Shqiptare.

Sipas studiuesit Arshi Pipa: “Nga fundi i vitit 1947, Shqipëria ishte praktikisht një vend i qeverisur nga jugosllavët. Plane për bashkimin formal të Shqipërisë si republikë e shtatë e federatës jugosllave tashmë ishin vënë në zbatim.”²²¹

Marrëdhëniet e ngushta të varësisë gati pa kushte nuk vinin nga të gjithë drejtuesit komunistë. Brenda radhëve të tyre kishte njerëz që e shikonin me dyshim dhe nuk e dëshironin një afrim të këtyre përmasave. Grupi i intelektualëve të PKSH-së me në krye Nako Spiron mendonin se Shqipëria duhej të dilte nga izolimi ndërkombëtar dhe të bënte një politikë më të pavarur si në planin e jashtëm, edhe në atë të brendshëm, duke argumentuar se ajo rrugë që po ndiqej në atë kohë e çonte Shqipërinë në varësi ekonomike dhe më tej politike me fqinjin verior. Ata, dhe në mënyrë të veçantë intelektual i Nako Spiro, kundërshtuan planin jugosllav për shkrirjen e Shqipërisë brenda Jugosllavisë²²². Më herët edhe Sejfulla Malëshova kishte argumentuar se: “*Shqipërisë i duhej të bënte një politikë të jashtme të pavarur e cila të përfshinte lidhjet e ngushta me perëndimin*”²²³. Një tipar i dukshëm i luftës politike që zhvilloi Hoxha jo vetëm gjatë viteve të para, por edhe në vijim ishte eliminimi i elitës intelektuale në vend, e cila edhe

²¹⁹Ramiz Alia, Th.Benakis, “*Duke biseduar për Shqipërinë*”, Kurier Ekdotiki. Athinë, fq. 9.

²²⁰“Bashkimi”, 1 maj 1945 Op.cit Kastriot Dervishi, fq. 549.

²²¹Arshi Pipa, “*Stalinizmi Shqiptar*”, IKK&Princi, Tiranë, 2007, fq. 27.

²²²Miranda Vicker, fq. 269.

²²³Ibid, fq. 263.

nga politika sovjetike konsiderohej “si përkrahëse e frymës perëndimorë²²⁴”. Sipas studiuesit Tajar Zavalani: “Dëmi më i madh që i solli Shqipërisë aleanca e komunistëve me Jugosllavinë e Titos ishte sidomos në lëmin e marrëdhënieve ndërkombëtare²²⁵, shkëputja nga perëndimi ishte vepër e tyre, kjo, e ndikuar në një masë të madhe edhe nga incidenti i Korfuzit.

Në këtë situatë të krijuar, grupi projugosllav me në krye Koçi Xoxen ishin në pozita të forta. Ata ishin mbështetësit kryesorë për realizimin e planit jugosllav dhe ishin gati të pasfidueshëm edhe nga vetë Hoxha, madje ishin shumë pranë rrëzimit të këtij të fundit nga pushteti. Në këtë përplasje, grupi që triumfoi ishte ai projugosllav duke nxitur qeverinë dhe Kryetarin e saj në rrugën e thellimit të bashkëpunimit me Jugosllavinë. Në këtë drejtim, më 9 korrik të vitit 1946 mes të dy vendeve u nënshkrua Traktati i Miqësisë dhe i Bashkëpunimit duke bërë të mundur kështu realizimin e bashkimit mes dy vendeve. Nëse nuk do të kishte ndodhur konflikti midis Moskës dhe Beogradit, Shqipëria praktikisht do të ishte republika e shtatë e Konfederatës së Jugosllavisë. Denoncimi që i bëri Stalini –Titos për antisovjetizëm dhe revizionizëm pozicionuan përnjëherë drejtuesit komunistë Shqipëtarë në krahun e tij. Situata e krijuar (konflikti Stalin – Tito) u shfrytëzua nga Enver Hoxha jo vetëm që të eliminonte grupin projugosllav (që ishte një kërcënim serioz) por mbi të gjitha për të fuqizuar pozitat dhe pushtetin e tij. Një valë spastrimesh ndaj elementëve projugosllavë nga radhët e partisë dhe shtetit bënë që të rikonfigurohej Byroja Politike në të cilën Kongresi I-rë i Partisë zgjodhi njerëzit më besnikë të Hoxhës. Prishja e marrëdhënieve me Jugosllavinë në vitin 1948²²⁶ dhe afrimi me Bashkimin Sovjetik rriti varësinë e Shqipërisë ndaj këtij të fundit.

Nëse në aleancën me Jugosllavinë varësia ishte imponuar që në krye të herës me qëllim aneksimin e Shqipërisë nga jugosllavët, aleanca me Bashkimin Sovjetik ishte e një natyre tjetër. Ajo që e bënte atraktive dhe shpjegon interesin e udhëheqjes sovjetike për Shqipërinë ishte pozicioni i saj strategjik. Nëpërmjet aleancës me këtë vend të vogël dhe përdorimit të territorit nga ana e tyre, liderët sovjetikë lëshonin kërcënime kundrejt perëndimit për krijimin e një baze raketash. Gjithashtu, Shqipëria ishte rruga për në detin Mesdhe dhe porta më e afërt me perëndimin për Bashkimin Sovjetik. Zëvendësimi i varësisë u bë jo vetëm i kërkuar nga pala Shqiptare, por edhe si një kopje autentike e modelit të vendit aleat i radhës. Shqipëria vërtetë shpëtoi pa u bërë republika e shtatë e Jugosllavisë por pranoi të bëhej e varur nga Bashkimi Sovjetik gati me të njëjtat kushte si çdo republikë e Bashkimit Sovjetik. Një pikë interesante e politikës së drejtuesve komunistë shqiptarë ishte besnikëria dhe gadishmëria e skajshme ndaj direktivave të BS-së. Këtu, duhet thënë se Ambasada Sovjetike u bë zyra e re e protektoratit shqiptar. Tashmë vendimarrja politike shqiptare kalonte nga Moska përmes ambasadorit të saj në

²²⁴ Spartak Ngjela, “Përkulja dhe Rënia e Tiranisë Shqipëtare 1957-2010”, Vol. 1, UET Press, Tiranë, 2011, fq. 206.

²²⁵ Citimi është i përshtatur në gjuhën letrare nga autori, Tajar Zavalani, fq. 340.

²²⁶ Sqarim: Më 1 korrik të vitit 1948 u ndërpreu lidhjet midis dy vendeve si dhe u prishën të gjitha marrëveshjet ekonomike ndërmjet tyre.

Tiranë. Një armatë e tërë me ekspertë rusë nga të gjitha fushat u vendosën në Shqipëri për të ndihmuar në zbatimin e vijës sovjetike. Po të citojmë studiuesin Pipa do të thoshim se: *“Rusët janë padronët e padiskutueshëm të vendit. Qëndrimi i udhëheqësve shqiptarë ndaj bosëve të tyre është një bindje servile²²⁷”* duhet theksuar se kjo qasje e drejtuesve komunistë ndodh për sa kohë që pushteti i tyre nuk preket.

Përpikmëria e ndjekjes së modelit sovjetik nga pala shqiptare bëri që për një kohë të shkurtër Shqipëria të etiketohej si vendi më stalinist në Evropën Lindore.

Zbatimi i modelit stalinist në planin politik i siguroi jetëgjatësinë dhe fuqizimin e pushtetit personal të Enver Hoxhës. Ashtu siç vë re edhe studiuesia Vickers: *“Lufta midis fraksioneve në udhëheqjen shqiptare gradualisht u bë më komplekse dhe më e dhunshme...²²⁸”* duke theksuar elementët e skajshëm të përballjes ndërmjet tyre e deri në eliminimin fizik të kundërshtarit politik. Kjo favorizohej edhe nga strukturat e policisë sekrete dhe Sigurimit. Në një kohë shumë të shkurtër, aparati i Sigurimit të Shtetit dhe Policia Sekrete u bënë tejet të fortë. Rrjeti i informatorëve ishte në përmasa tepër të mëdha dhe pothuajse çdo celulë e shoqërisë kontrollohej prej tij. Detyra e policisë sekrete ishte evidentimi e më pas eliminimi ndaj çdo kundërshtimi që i adresohet qeverisë. Ky model organizimi ishte kopjuar nga rusët.

Gjithashtu, mund të themi se vendimmarrja në politikën e jashtme dhe të brendshme ishte kryesisht pasojë e pragmatizmit për ruajtjen e pushtetit personal të Hoxhës. Përdorimi i metodave staliniste për eliminimin e elementëve që mund të rrezikonin pushtetin e tij justifikonin stalinizmin e tepruar të Enver Hoxhës. Ishte ndjekja e këtyre metodave që forcuan edhe më tej pozitën dhe pushtetin e tij. Në këtë linjë, ideologjia Marksiste – Leniniste u kthye në një strategji të rëndësishme për realizimin e ekspansionit të klaneve të caktuara brenda gjirit të partisë. Me kohën, lufta për pushtet u realizua brenda partisë, kjo për të thyer tashmë klanin e konsoliduar Hoxha – Shehu i cili identifikonte veten dhe interesat e tij me interesat e komunistëve dhe atdheut²²⁹. Këtu gjendej edhe justifikimi përpara popullit për përdorimin e dhunës ndaj kujtdo që ngrihej kundër tyre. Një tipar ky i komunizmit Hoxhian ku përveç ideologjisë kishte edhe projektin kombformues të identifikuar me liderin (apo klanin) politik. Sipas këtij projekti Partia e Punës (dhe udhëheqësi i saj) ishte themeluesja dhe ndërtuesja e kombit modern shqiptar.

Gjatë viteve 1949 – 53, lufta politike në Shqipëri u zhvillua kundër grupimit të quajtur “titistët”. “Nga spastrimet antititiste, nga 39 antarë të Komitetit Qendror të PPSH-së 14 prej tyre u likuiduan dhe po kështu nga 109 deputetë të Kuvendit Popullor, 32 prej tyre patën të njëjtin fat. Ndërsa nga radhët e PPSH-së u përjashtuan rreth 12,000 antarë²³⁰”. Udhëheqja komuniste e hiperbolizonte komplotin e jashtëm (megjithatë ishte i vërtetë). Teprimi me armiq të jashtëm përdorej për të zbuluar armiqtë e brendshëm. Në

²²⁷ A.Pipa, fq. 30.

²²⁸ M. Vickers, fq. 269.

²²⁹ Shiko: V. Duka, fq. 254.

²³⁰ Ibid, fq. 256.

këtë drejtim nuk ka patur parti tjetër komuniste, që të ketë jetuar e të jetë mbajtur me dietën e spastrimeve ashtu si Partia e Punës e Shqipërisë.

Nga këto spastrime dhe përjashtime, klani i dyshes Hoxha – Shehu mbushi rradhët e tyre me besnikë duke eliminuar kundërshtarët dhe dhënë shëmbullin për të tjerët. Vdekja e Stalinit në 5 mars të vitit 1953 nuk pati ndikime të menjëhershme pasi rivaliteti brenda udhëheqjes sovjetike e shkëputi përkohësisht vëmendjen nga partitë e tjera komuniste brenda kampit. Më 14 dhjetor të vitit 1955, Shqipëria pranohet në OKB, një ngjarje që në të ardhmen i jep prestigj dhe interes reciprok në aleancën me Kinën. Në maj të vitit 1955, blloku sovjetik përfshin Shqipërinë në Traktatin e Varshavës një ngjarje kjo që forcoi edhe më tej sigurinë politike të drejtuesve komunistë.

Pas vitit 1955 kur pushteti i Hrushovit²³¹ ishte konsoliduar, filloi procesi i destalinizimit të jetës shoqërore e politike në BS. Ndër të tjera, ky proces synonte largimin e elementëve stalinistë dhe zëvendësimin e tyre me elementë më liberalë. Në vende si Polonia, Çekosllovakia, Bullgaria, Rumania e Hungaria tashmë liderët politikë të kohës së Stalinit ishin zëvendësuar. Padiskutim që situata e krijuar përcolli mesazhin e rrezikut të mundëshëm të humbjes së pushtetit të Hoxhës. Udhëheqja e re sovjetike kërkonte largimin e Hoxhës dhe zëvendësimin e tij me elementë më liberalë. Situata e krijuar ishte në disfavor të pozitive sunduese të Enver Hoxhës duke qenë se elementët prosovjetikë kishin ndikim të madh në politikën e vendit. Gjithashtu, nga pala sovjetike vinte një presion në rritje sidomos për përmirësimin e marrëdhënieve shqiptaro – jugosllave. Vlen të përmendet se po në këtë vit, Hrushovi vizitoi Beogradin. Politika shqiptare do të fokusohet në distancimin nga kursi i ri sovjetik dhe për këtë u morën masa për të kundërshtuar dhe eliminuar elementët brenda partisë që kërcënonin pushtetin. Në politikën e jashtme gjetja e një aleati të ri ishte urgjente.

Në kuadër të marrëdhënieve Shqipëri – BS, në maj të vitit 1959 në Shqipëri erdhi për një vizitë zyrtare disaditore udhëheqësi sovjetik Nikita Hrushovi. Kjo ishte vizita e parë e një udhëheqësi kaq të lartë të ardhur nga BS. Gjatë kësaj vizite, Hrushovi premtoi ndihma të tjera ekonomike dhe theksoi se Shqipëria mund t'i jepte një ndihmë më të madhe bllokut komunist nëse ajo zhvillonte më tej sektorin e bujqësisë. Specialistët sovjetikë të ekonomisë kishin sugjeruar që sektorit të bujqësisë t'i jepej një pjesë më e madhe buxheti sesa ajo që kishin planifikuar specialistët shqiptarë. Disa muaj pas vizitës së Hrushovit u thelluan divergjencat midis palëve. Rreth fillimit të viteve '60, Shqipëria u ndodh në një pozitë të vështirë brënda bllokut komunist, kjo si pasojë e reduktimit të ndihmave që vinin nga BS dhe nga shtetet e tjera komuniste të Evropës Lindore. Me ndërprerjen e të gjitha kredive që parashikoheshin nga marrëveshjet midis dy vendeve u realizua kështu një bllokadë e përgjithshme ekonomike, politike dhe ushtarake ndaj

²³¹Shiko: Xhelal Gjeçovi, Paskal Milo., *“Historia e popullit Shqiptar, IV Shqiptarët gjatë luftës së dytë botërore dhe pas saj 1939-1990”*, Toena, Tiranë, fq. 247.

Shqipërisë²³². Prishja e marrëdhënieve me BS dhe vendet e Evropës Lindore dëmtoi gjithashtu tregtinë e jashtme të Shqipërisë, e cila realizohej kryesisht me këto vende. Pas një periudhe të shkurtër kohe, më 3 dhjetor të vitit 1961 u zyrtarizua ndërprerja e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik.

Lufta brenda Partisë Komuniste këtë herë u drejtua ndaj antarëve prosovjetikë të Byrosë Politike duke filluar me një sërë spastrimesh në radhët e tyre. Ndër drejtuesit më të lartë të larguar mund të përmendim Liri Belishovën,²³³ e cila ishte anëtare e Byrosë Politike dhe Sekretare e Komitetit Qëndror dhe Koço Tashko kryetar i komisionit të kontrollit e të revizionimit, si dhe një sërë zyrtarësh të tjerë përfshirë edhe kundëradmiralin Teme Sejkon. Gjithashtu në këtë periudhë ishte krijuar një shtresë e re intelektuale, të cilët kishin studiuar në vendet e Evropës Lindore apo në Bashkimin Sovjetik. Ata, në një masë të konsiderueshme nuk binin dakort me vijën e ashpër politike që po ndiqte Hoxha. Ishte pikërisht kjo shtresë intelektuale e cila do të neutralizohej dhe goditej me mekanizma të ashpër rreth fundit të viteve '70.

Rreth viteve 60' nepotizmi dhe lidhjet familjare brenda klikës drejtuese ishin koklavitur aq shumë, sa shumica e tyre ishin bashkëpunorë dhe bashkëfajtorë në spastrimet e realizuara. Gjatë kësaj kohe, baza e regjimit u bë lidhja klanore e drejtuesve komunistë me njëri – tjetrin, gjë që përkonte edhe me kulturën dhe traditën shqiptare. Duhet theksuar fakti se në shtetin e diktaturës së proletarietit, ku udhëhiqte një parti e vetme politike, “të gjitha organet shtetërore në qendër dhe ato vendore, konsideroheshin leva të Partisë së Punës të Shqipërisë.”²³⁴

Si rezultat i politikës me dorë të hekurt dhe rezistencës edhe pas prishjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik në vitin 1961, Enver Hoxha më në fund konsolidoi pushtetin e tij, tashmë të palëkundur. Ai ishte i vetmi anëtar i Komitetit Qendror dhe themelues i PKSH-së ende gjallë dhe në pushtet. Edhe pas prishjes së marrëdhënieve me sovjetikët (aleancë që zgjati 12 vjet), stalinizmi vazhdoi të ishte filozofia kryesore për drejtimin e Shqipërisë, pasi kjo ishte rruga për ruajtjen e pushtetit nga sunduesi komunist. Nga Bashkimi Sovjetik, Shqipëria, përfitoi ndihma financiare, materiale e burime njerëzore shumë të mëdha. Periudha pas shkëputjes me sovjetikët u shoqërua me probleme të shumta ekonomike dhe rënie të nivelit të jetesës.

Aleanca me kinezët erdhi në kohën e duhur. Marrëdhëniet midis dy vendeve u intensifikuan gjatë gjysmës së dytë të vitit 1960. Në takimin e Bukureshtit, përfaqësuesit e lartë të Partisë së Punës të Shqipërisë nuk pranuan të ndiqnin politikën e liderit të ri sovjetik, Hrushovit, për të dënuar Partinë Komuniste të Kinës, veprim ky që do rëndonte edhe më tej presionin sovjetik ndaj Shqipërisë. Në kushtet e prishjes së marrëdhënieve

²³² Ibid, fq. 279.

²³³ Liri Belishova ishte ndër njerëzit më me influencë në Partinë Komuniste, kjo edhe si pasojë e raporteve tepër të ngushta që kishte me sovjetikët. Ajo kishte mbaruar studimet për Filozofi Marksiste në Moskë dhe ishte njohësja më e kualifikuar e marksizmit në udhëheqjen shqiptare, ndaj eliminimi i saj politik ishte imediat për Hoxhën, në kushtet kur ai kishte vendosur që vendin ta lidhte me Kinën.

²³⁴ Ismet Elezi, “*Me syrin e një juristi 20 vjet të qeverisjes moniste*”, Toena, Tiranë, 2004, fq. 9.

me sovjetikët dhe industrializimit të sforcuar ku ishte përfshirë ekonomia e vendit, ishte emergjente gjetja e një partneri që të mbushte deficitin financiar të lënë nga sovjetikët. Kina komuniste nuk ishte dakort me vijën politike të ndjekur nga Moska për interesa të tjera nga ato të palës Shqiptare, por që konvergonin në një pikë; siç thotë edhe shprehja e njohur e Mao Ce Dunit “Armiku i armikut tim është miku im” dhe kjo shpjegon më së miri këtë aleancë. Me kundërshtimin e vijës politike të ndjekur nga BS, Kina izolohej nga marrëdhëniet ndërkombëtare. Të dyja vendet si Kina dhe Shqipëria ndanin të njëjtin problem: politikën e ndjekur nga liderët sovjetikë pas vdekjes së Stalinit. Shqipëria tashmë ishte vend anëtar i OKB-së dhe mund t’i shërbente Kinës si një zëdhënëse e saj në këtë organizatë. Gjithashtu, nga ana tjetër, Shqipërisë i duhej një aleat i fuqishëm që jo vetëm të kontribuonte me ndihma ekonomike (aq imediate për zhvillimin e mëtejshëm të Shqipërisë) por gjithashtu që të siguronte pushtetin politik të Hoxhës. Edhe pse ishte e panatyrshme, si kombinim ky funksionoi për aq kohë sa palët kishin përfitime reciproke. Vlen të përmendet se rrethanat historike e shpëtuan edhe njëherë pushtetin e Enver Hoxhës.

Udhëheqja e politike komuniste shqiptare përvijoi ndjekjen e modelit të shtetit të ri aleat. Kështu, për interesa të politikës udhëheqëse shqiptare, si dhe me qëllim frenimin e rënies së disiplinës në sektorë të ndryshëm u kopjua modeli kinez i revolucionit kulturor, i cili në thelb ishte një luftë e brendshme për pushtet në radhët e Partisë Komuniste Kineze²³⁵. Në shkurt të vitit 1966 ndodhi revolucioni kulturor shqiptar, kopje e aleatit kinez. Qëllimi ishte: rivendosja e autoritetit të Partisë në organizatat lokale dhe zhburokratizimi i shtetit i cili mund të rrezikonte pushtetin. Revolucioni kulturor shqiptar nën parullën e luftës kundër disa tipareve borgjeze që po shfaqeshin në gjirin e shoqërisë shqiptare nuk u shoqërua me trazira pasi ishte nën kontrollin e udhëheqjes së Partisë. Kjo nismë e re e ndërmarrë nga udhëheqja komuniste ishte kamulfim ndaj vazhdimit të terrorit dhe luftës tashmë “kundër vetvetes, kundër sistemit dhe kundër bashkëpunëtorëve të tij”²³⁶. Regjimi politik doli me tezën e revolucionarizimit të të gjithë jetës së vendit duke marrë masat për thellimin e veprimeve ekstreme në shoqëri. Më 25 dhjetor 1965, Byroja Politike e Komitetit Qendror, nxori vendimin “Për revolucionarizimin e metodës e të stilit në punë në luftën kundër burokratizimit”. Direktivat e Komitetit Qendror përcaktonin një luftë të gjithanëshme kundër burokratizimit dhe shfaqeve të tij në sistemin e drejtimit administrativ, në organizimin e ushtrisë, në veprimtarinë e organeve të zgjedhura, në përpjestimin e pagave etj. Efekti i menjëhershëm i këtyre direktivave ishte shkurtimi i administratës në nivel qendror në masë 50% dhe shkurtimi i administratës lokale nëpër rrethe në masë 10% dhe rreth 15 – 25% në personelin e aparateve drejtuese të ndërmarrjeve ekonomike shtetërore. Nga këto masa, rreth 15 mijë kuadro të administratës

²³⁵ Xhelal Gjeçovi, Paskal Milo., “*Historia e popullit Shqiptar, IV Shqiptarët gjatë luftës së dytë botërore dhe pas saj 1939-1990*”, Toena, Tiranë, fq. 302.

²³⁶ S. Ngjela, fq. 359.

kaluan në prodhim²³⁷. Në ushtri u hoqën gradat dhe u njësua uniforma, hierarkia ushtarake u bazua vetëm në përgjegjësitë funksionale të kuadrove, si dhe u krye procesi i rifutjes së komisarëve politikë në drejtimin e ushtrisë, një element regresiv ky sepse legjitimonte vendimmarrjen politike sipas vijës së Partisë e jo mbi bazën profesionale tek ushtarakët profesionistë etj.

Në kuadër të këtij procesi u reduktua gjithashtu numri i ministrive nga 19 në 13 (u shkurtua edhe Ministria e Drejtësisë); shumë funksionarë të lartë të partisë dhe shtetit u dërguan nëpër rrethe në punë prodhuese në industri e bujqësi. Për juristin Ismet Elezi, ngjarjet e vitit 1966-1967 kishin si pikësynim shkatërrimin e shtetit ligjor, duke aneksuar bazën kushtetuese. Kjo u arrit me vendimin Nr.14/1966 i cili vlerësohej si Kushtetuta e Kushtetutave²³⁸. Farsa dhe aneksimi i strukturave shtetërore vërehet në modelin jointucional ku pavarësisht faktit që Këshilli i Ministrave kishte kompetenca të caktuara me Kushtetutë, ai në realitet vepronte sipas direktivave të partisë-shtet. Ky model politik ka lënë gjurmë në organizimin dhe drejtimin e institucioneve të shtetit shqiptar edhe pas rënies së diktaturës.

Po kështu, fjalimi i Enver Hoxhës i datës 6 shkurt të vitit 1967 nxiti përshkallëzimin e veprimeve likuiduese ndaj asaj shtrese intelektuale dhe shoqërisë në tërësi që kishte guxuar të diferencuhej intelektualisht nga ideologjia partiake, në fjalimin e tij ai theksonte “lartësimin e mendimit krijues të klasës punëtore, fshatarësisë punonjëse dhe inteligjencës popullore²³⁹” që në fakt ishte pjesa më e prapambetur e shoqërisë. Ky fjalim u bë shkas edhe për fillimin e një lufte të ashpër ndaj besimeve fetare dhe objekteve të kultit. Këto veprime përkonin me vazhdimin e shkatërrimit të kulturës, traditës dhe zakoneve në vend. Ato ishin pjesë e vazhdimin të revolucionit ideologjik që kishte për synim ndryshimin katërcipërisht të shoqërisë shqiptare, krijimit të njeriut të ri socialist dhe vendosjes së regjimit absolut në vend. Njeriu i ri socialist, në këtë aspekt, nuk duhet të kishte fe tjetër përveç ideologjisë zyrtare. Disa vite më vonë u arrit ndalimi me kushtetutë i ushtrimit të fesë dhe shpallja e Shqipërisë si vendi i vetëm ateist në botë. Në politikën e jashtme, ngjarjet e vitit 1968 në Çekosllovakia ndikuan në zbutjen e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave. Ndërhyrja ushtarake ruse u pa si një precedent që mund të përsëritej edhe në Shqipëri. Frika u shoqërua me një fazë të shkrirjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë.

Pas një periudhe qetësie dhe harmonie me Kinën në vitin 1971, kjo situatë ndryshoi për palën Shqiptare. Politika e jashtme kineze kishte njohur ndryshime në kursin e saj dhe si pasojë e kësaj politike, ajo u bë anëtare e OKB-së dhe e Këshillit të Sigurimit. Miqësia midis dy vendeve filloi të zbehej, ndër të tjera, edhe si pasojë e mungesës së interesit nga ana e kinezëve për Shqipërinë tashmë. Në këto kushte, ndihmat ndaj Shqipërisë filluan të

²³⁷ Shiko: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, “*Historia e Shqipërisë, V.4. 1944-1975*”,8 Nëntori, Tiranë, 1983, fq. 313-4.

²³⁸Shiko: Ismet Elezi, fq. 9-10.

²³⁹ Op.cit në Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, “*Historia e Shqipërisë, V.4. 1944-1975*”,8 Nëntori, Tiranë, 1983, fq. 310.

reduktohen deri sa ato u ndërprejnë përfundimisht më 7 korrik të vitit 1978. Pas prishjes me Kinën pati komente dhe mundësi reale në arenën ndërkombëtare për bashkëpunim me Shqipërinë si nga vendet perëndimore dhe SHBA, ashtu edhe nga vendet e Bllokut Komunist. Megjithëse ftesat për bashkëpunim nuk munguan nga të dy kampet, drejtuesit komunistë shqiptarë vendosën dhe zgjodhën rrugën e vetizolimit. Kjo taktikë e re politike do të çonte në situatë ekstreme gjendjen politike dhe ekonomike në vend.

Rreth viteve 1972-1975 ndodhën disa goditje partiake në rangjet e funksionarëve të lartë. Lufta tashmë nën ndikimin e revolucionit kulturor u drejtua kundër rinisë, inteligjencës, ushtarakëve dhe teknokratëve. Propaganda komuniste e kohës e quante këtë goditje si “thellim të revolucionit socialist në kushtet e rritjes së trysnisë imperialisto-revizioniste²⁴⁰” justifikim ky në funksion të mbajtjes me çdo kusht të pushtetit.

Në 28 dhjetor të vitit 1976, Kuvendi Popullor miratoi Kushtetutën e Re të Shqipërisë²⁴¹. Ndryshimet e bëra në këtë kushtetutë ishin të një fryme të ashpër staliniste. Në të, ndryshimet fillonin që me emërtimin e vendit (neni 1) duke e quajtur Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë. Në nenin 2 të kësaj kushtetute përcaktohej natyra e shtetit si më poshtë:

“Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë është shtet i diktaturës së proletarietit, që shpreh e mbron interesat e të gjithë punonjësve.

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë mbështetet në unitetin e popullit rreth Partisë së Punës së Shqipërisë...”

Përsa më lart, sanksionohej tashmë “shteti i partisë ose partia-shtet” dhe ndalohej kategorikisht pluralizmi politik. Një risi e pazakontë ishte edhe ndalimi me kushtetutë i praktikimit të fesë (neni 37) gjë që siç e thamë më sipër e bënte Shqipërinë vendin e parë ateist në botë. Ja, si ishte i shprehur në kushtetutë neni 37:

“Shteti nuk njeh asnjë fe dhe përkrah e zhvillon propagandën ateiste për të rrënjësuar tek njerëzit botëkuptimin materialist shkencor.”

Pika më interesante e kushtetutës ishte sanksionimi me ligj i parimit të mbështetjes në forcat tona, më konkretisht neni 14:

“Në ndërtimin e socializmit, Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë mbështetet kryesisht në forcat e veta.”

Sipas studiueses Vikers: “Shqipëria ishte tkurrur në një shkallë izolimi ideologjik dhe politik të vetëimponuar me të cilën është e vështirë të gjendet ndonjë krahasim bashkëkohor²⁴²”, izolimi dhe vitet e vështira që do të pasonin ishin edhe rezultat i kësaj

²⁴⁰ Op cit, Kastriot Dervishi, “*Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*”, Sh B55, Tiranë, 2006, fq. 729.

²⁴¹ Për në vijim shiko: Ibid, fq. 735-8.

²⁴² Vikers, fq. 317.

kushtetute. Gjithashtu në të u sanksionua edhe ndalimi i huave dhe kredive nga jashtë vendit. Kjo kushtetutë dhe prishja e marrëdhënieve me Kinën bënë që në fillim të viteve '80, Shqipëria të gjendej në kushte të vështira si politike, ashtu edhe ekonomike. Vazhdimi i industrializimit të sforcuar, duke qenë tashmë të vetëm, rëndoi dukshëm nivelin e jetës së qytetarëve shqiptarë. Në vitet në vazhdim, vendi do përballej me krizën më të thellë ekonomike, e cila reflektohej dhe prekej çdo ditë nga qytetari i thjeshtë duke filluar me mungesën e artikujve bazë ushqimorë. Si pasojë e degradimit të situatës ekonomike, vjedhja dhe shpërdorimi i pronës shtetërore u bënë fenomene mjaft të përhapura ndërsa dhënia e ryshfetit ishte kthyer në diçka të zakonshme.

Me rëndimin e gjendjes shëndetësore të Enver Hoxhës, lufta brenda partisë ishte e heshtur. Dilema lidhej me faktin se kush do të zëvendësonte Enver Hoxhën pas vdekjes. Eksperiencia e hidhur e Bashkimit Sovjetik ishte prezente në familjen Hoxha, ndaj pasardhësi duhej të ishte një njeri që të ruante trashëgiminë politike të udhëheqësit. Kandidatët më të mundshëm për të drejtuar vendin ishin kryeministri Mehmet Shehu dhe Ramiz Alia. Shehu ishte një figurë e fortë politike, bashkudhëtar me Hoxhën gjatë gjithë kësaj kohe. Ai i njëjtte shumë mirë problematikat e vendit dhe mbi të gjitha gëzonte mbështetje të madhe në bazë. Nga ana tjetër, Alia, kishte mbështetje të madhe nga çifti Hoxha. Pasardhësi u piketua që kur ishte gjallë Hoxha.

Ai gjeti momentin për të eliminuar numri dy të pushtetit, kryeministrin dhe bashkëpunëtorin e tij Shehun pasi ky i fundit me veprimet e tij politike i kishte ndezur paranojën e marrjes së pushtetit. Shehu kishte dhënë sinjale të hapjes së vendit me disa vende parëndimore duke u venë kështu nën objektivin e eliminimit të tij para se të vdiste Hoxha. Më 18 dhjetor të vitit 1981 Shehu u gjet i vdekur. Ka shumë hipoteza për shkaqet e vdekjes, por versioni zyrtar ishte ai i vetvrasjes²⁴³. Propaganda komuniste nisi një lum akuzash si poliagjent, tradhtar etj., si dhe u mohua çdo kontribut i tij gjatë luftës antifashiste dhe pas saj. Pas vdekjes së Shehut, kryeministër i vendit u emërua Adil Çarçani, i cili më parë kishte mbajtur postin e zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave.

Pas një viti e gjysmë filloi lufta kundër mbështetësve të tij. Pas vdekjes së Shehut tashmë pushteti iu garantua Alisë, që po të shprehemi me fjalët e studiuesit J. Rothschild mund ta quajmë “trashëgimtar i paracaktuar²⁴⁴”. Si pak presidentë në botë dhe si asnjë sekretar i parë i vendeve komuniste, Aia nuk e fitoi vetë karrigen numër një të shtetit, por ia përgatitën, ia lanë²⁴⁵. Ai përmbushte të gjitha kriteret e një pasuesi që do të garantonte trashëgiminë politike të Hoxhës. Ai ishte njeriu më i besuar i Enver Hoxhës, duke zbatuar politikën e jashtme dhe të brendshme të mësuesit të tij pa shprehur kurrë ndonjë mendim

²⁴³ Studiuesi Dervishi pohon se Mehmet Shehu është vrasë për më shumë shiko: fq. 753 po këtë qëndrim mban edhe studiuesi A. Pipa fq. 178-9 duke aluduar se: (Shehu gjoja bëri vetëvrasje)

²⁴⁴ Joseph Rothschild, “*Kthim në diversitet*”, Onufri, Tiranë, 1998. fq. 287.

²⁴⁵ Gazmend A. Baku, “*Shqipëria Politike*”, Pegi, Tiranë, 2010. fq. 397

të pavarur²⁴⁶. Për disa studiues shqiptarë dhe të huaj figura e Alisë është përshkruar shpeshherë si i bindur, i manovrueshëm dhe që mund të mbahej më lehtë nën presionin e klikës së besnikëve të Hoxhës. Ai ishte personi i duhur për të çuar më tej Shqipërinë enveriste.

Enver Hoxha vdiq më 11 prill të vitit 1985. Gjatë 41 vjetëve të Hoxhës në pushtet, “shtatë ministra të Brendshëm, të ngarkuar drejtpërdrejt me vënien në jetë të spastrimeve, janë spastruar vetë. Pas themelimit të saj më 1941, spastrimi i parë i madh i PKSHP nisi më 1942, duke krijuar kështu një model, i cili vazhdoi pa ndërprerje... një mekanizëm vetëriprodhues, i ushqyer nga paranoja e thellë e Hoxhës”²⁴⁷.

Dy ditë pas vdekjes së Enver Hoxhës, më 12 – 13 prill 1985, u mbledh Plenumi i KQ të PPSHP. Plenumi zgjodhi Ramiz Alinë në postin e Sekretarit të Parë të PPSHP. Në mbledhjen e Plenumit, Ramiz Alia u betua se do t’i qëndronte besnik rrugës dhe mësimëve të Enver Hoxhës dhe do të zbatonte me vendosmëri kursin e tij. Vazhdimësia e kësaj rruge u konfirmua edhe në Kongresin IX të PPSHP, që u mbajt më 2-8 nëntor 1986 e që u cilësua dhe si Kongres i vazhdimësisë.²⁴⁸ Me zgjedhjen e Alisë në postin e Sekretarit të Parë të Partisë së Punës, trashëgimia e Hoxhës ishte një hap larg fundit të saj.

2.2.2 Tendencat ekonomike, sociale dhe kulturore gjatë kësaj periudhe

Kur komunistët erdhën në pushtet, vendi ishte i rrënuar nga lufta dhe shumë degë të ekonomisë ishin të pazhvilluara. Sipas regjistrimit të popullsisë të realizuar më 30 shtator të vitit 1945, popullsia në vend arrinte në 1.122.044 persona, nga të cilët 21.3% jetonte në qytet dhe 78.7% jetonte në fshat. Mbi 80% e popullsisë ishte analfabet²⁴⁹. Financat e shtetit kishin prekur fundin. Kushtet ekonomike në të cilën gjendej vendi ishin më të vështirat ndër vendet e Evropës Lindore. Duhet theksuar se lufta dhe pushtimi nga ana e Boshtit nuk i ndryshoi në thelb kushtet ekonomike të Shqipërisë²⁵⁰. Historikisht baza e ekonomisë shqiptare ka qënë bujqësia dhe blegtoria, pasi rreth 80% e popullsisë së paraluftës merreshin me bujqësi e blegtori. Gjendja në këto veprimtari ishte e prapambetur dhe primitive. Në vitet e pasluftës gjendja e tyre mund të krahasohej me situatën e vendeve perëndimore gjatë periudhës së mesjetës. Me përjashtim të prodhimit të naftës dhe të kromit, Shqipëria nuk kishte ndonjë industri tjetër. Pushtimi italian përmirësoi rrjetin e komunikacionit, zgjeroi portet dhe u ndërtuan rrugë të reja që lidhnin

²⁴⁶Shiko: Elez Biberaj, “Shqipëria në tranzicion, Rruga e vështirë drejtë demokracisë 1990-2010”, AIIS, Tiranë, 2011. fq. 55.

²⁴⁷Misha Glenny, “Historia e ballkanit 1804-1999” Toena, Tiranë, 2007, fq. 561

²⁴⁸Shiko: Xhelal Gjeçovi, Paskal Milo., “Historia e popullit Shqiptar, IV Shqiptarët gjatë luftës së dytë botërore dhe pas saj 1939-1990”, Toena, Tiranë. fq. 323-4, si dhe Kastriot Dervishi, “Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005”, Sh B55, Tiranë, 2006. fq. 772-3.

²⁴⁹Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, “Historia e Shqipërisë, V.4. 1944-1975”, 8 Nëntori, Tiranë, 1983, fq. 29-30.

²⁵⁰Fisher, fq. 327-8.

zonat minerare me portet, por këto investime minimale nuk mjaftonin për zhvillimin e ekonomisë²⁵¹.

Me marrjen e pushtetit, komunistët, u treguan të kujdesshëm në realizimin e procesit të konfiskimit të pasurive dhe eliminimin gradual të pronës private në shtresa të caktuara të shoqërisë. Nga goditja e shoqërisë borgjeze dhe nga zhvillimi i luftës së klasave u siguruan burime financiare për shpenzimet administrative të pushtetit të ri. Në fillim, veprimet e tyre ishin deri diku të matura pasi ata druheshin nga reagimi i fshatarësisë dhe i anglo-amerikanëve, si për njohjen ndërkombëtare të vendit edhe për pushtetin e tyre. Konfiskimet dhe shtetëzimet nisën me më të pasurit, të cilët përfaqësonin vetëm një pjesë të vogël të popullit (shiko tabelën nr.2). Në këto rrethana kundërshtimi i këtij segmenti mund të shtypej pa vështirësi. Qëllimi i këtyre veprimeve ishte jo vetëm dobësimi i bazës së vjetër ekonomike, por edhe ndryshimi i raporteve klasore të shoqërisë Shqiptare.

Nëse analizojmë gjendjen e pronësisë bujqësore përpara reformës agrare të vitit 1945 do të vërejmë se shpërndarja e pronës bujqësore në vend nuk kishte përmasat e pabarazisë që pretendonin komunistët. Spekulimi masiv kishte për qëllim krijimin e një alibie të qëndrueshme për të realizuar shtetëzimin e krejt pronës private. Ky proces filloi gradualisht. Në situatën e krijuar edhe si pasojë e frikës, terrorit apo edhe e joshjes të një pjese të madhe të popullsisë nga premtimet e pushtetit komunist, reagimi kundërshtues shoqëror pothuajse mungonte dhe kjo justifikohet edhe me “faktin se shumica e saj ishte e varfër”²⁵².

Nëpërmjet propagandës agresive kundër klasave të caktuara, komunistët donin të bënin për vete shoqërinë, kryesisht atë fshatare, duke pretenduar se këto veprime ishin në interes të pjesës më të madhe të qytetarëve dhe në dobi të vendit. Në kuadër të eliminimit të pronës private u ndërmorën veprime arbitrare në drejtim të shpronësimit të pronarëve të mëdhenj, të mesëm, kundërshtarëve politikë, si dhe atyre që nuk e punonin vetë tokën.

Klasifikimi	Latifondistë	Pronarë të pasur	Pronarë të mesëm e të vegjël	Familje pa tokë	Shteti
	7 familje	4,713 familje	129,961 familje	21,544 familje	
Prona	14,554 ha (3.7%)	91,113 ha (23.16%)	237,668 ha ose 60.43%	13.88% të numrit të përgjithshëm të familjeve fshatare	50,00 ha

Tabela 2. Prona Bujqësore në vend përpara Reformës Agrare të vitit 1945.

Burimi: Historia e Shqipërisë, V.4. 1944-1975, fq.38

²⁵¹Biberaj, fq. 47.

²⁵² Shiko: Vickers, fq. 255-6.

Ja ,si e analizon studiuesia Duka këtë proces:

“Në kuadrin e luftës së klasave, pavarësisht se ekzistenca e pronës private ishte e sanksionuar me ligj, komunistët, me qëllim shkatërrimin e borgjezisë dhe shtresës së pasur, fillimisht konfiskuan dhe shtetëzuan të gjitha pronat e emigrantëve dhe të bashkëpunorëve të pushtuesve, si dhe të gjitha fabrikat e punishtet që u takonin shoqërive italiane. U shtetëzuan bankat, burimet minerare, kullotat, pyjet transporti, tregtia e jashtme, si dhe tregtia me shumicë”²⁵³.

Megjithëse komunistët dhunuan të drejtën e pronës dhe shkelën ligjin, këto veprime anti-ligjore nuk ndezën pakënaqësi në popull. Në kushtet e vështira ekonomike që ndodheshin shumica dërrmuese e popullsisë, pakkush mendonte nëse mekanizmi i konfiskimit ishte ligjor apo jo dhe deri ku do të shkonin këto veprime sekuestrive. Në janar të vitit 1945, qeveria vendosi tatimin e jashtëzakonshëm mbi fitimet e luftës, si dhe një dekret ku organet shtetërore fitonin të drejtën e marrjes nga privatët të çdo lloj materiali të nevojshëm për rindërtimin e vendit. Më 29 gusht 1945, Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar shpalli ligjin “Për reformën agrare”. Me anë të tij synohej që të gjitha tokat pronë private që kalonin një kufi të përcaktuar, t’u rishpërndaheshin fshatarëve që nuk kishin tokë. Procesi sekuestriv ishte masiv dhe u shtri në të gjithë vendin. Kështu, një klasë e re bujqish, me mirënjohjen për tokën që morën, u bënë mbështetës të zjarrtë të regjimit të ri, ndërkohë që bejlerët humbën fuqinë ekonomike që ata gëzonin më përpara, ndërsa e panë veten të izoluar politikisht dhe të taksuar në maksimum²⁵⁴. Gjithashtu, përmes reformës agrare, do të realizohej edhe eliminimi i mbeturinave të vjetra feudale dhe gjysmë feudale në shoqërinë shqiptare. Sipas studiuesit Fisher, deri në vitin 1947 ishte arritur gati 100% e shtetëzimit të prodhimit industrial, ishte kryer shpërbërja e ekonomisë arkaike të paraluftës dhe së fundi ishte shkatërruar ajo çfarë mbetej nga klasa e mesme e paraluftës²⁵⁵. Shtetëzimi i mjeteve të prodhimit përfshiu një proces radikal dhe të shpejtë, i cili u përmbyll brenda 2 viteve duke përfshirë si pronën e kapitalistëve të huaj, ashtu edhe atë vendase. Procesi i shtetëzimit u realizua pa kompensim financiar dhe në mungesë të plotë të respektimit të të drejtës së pronës²⁵⁶.

Një tjetër proces që godiste bazën ekonomike të klasës së vjetër ishte edhe grumbullimi me forcë i sasisë së arit që zotërohej nga një pjesë e mirë e popullatës që quhej ose jo si armike. Pas marrjes së pushtetit, komunistët gjetën në Bankën Kombëtare Shqiptare sasinë prej 90 kg ar²⁵⁷. Në një shkrim të një reviste të MPB-së thuhej se deri në fund të vitit 1948 ishin zbuluar “43.816.682 monedha ari, pa përmendur shufrat e stolitë e

²⁵³Valentina Duka “Histori e Shqipërisë 1912-2000”, Tiranë. Kristalina-KH 2007.fq. 248.

²⁵⁴ Vickers, fq. 260.

²⁵⁵ Op.cit Fisher, fq. 328.

²⁵⁶ Shiko: Xhelal Gjeçovi, Paskal Milo., “Historia e popullit Shqiptar, IV Shqiptarët gjatë luftës së dytë botërore dhe pas saj 1939-1990”, Toena, Tiranë. fq. 182-3.

²⁵⁷ Kastriot Dervishi, fq. 579.

florinjta dhe gurët e çmuar²⁵⁸”. Ka shumë dritëhije dhe spekulime në lidhje me sasinë e arit që u është konfiskuar shtetasve shqiptarë pas luftës, megjithatë mendohet që sasia e arit që gjendej në duart e popullatës në këtë kohë ishte disa dhjetra herë më e madhe sesa ajo që gjendej në rezervat e shtetit. Konfiskimi masiv nga pushteti i ri, përveç shkatërrimit shoqëror solli edhe pasojën e paevitueshme të shkatërrimit ekonomik duke i hequr vendit mundësinë e rimëkëmbjes ekonomike.

Kështu pas vlerësimit të situatës ekonomike në vend, komunistët vijuan me ndjekjen e strategjisë të zhvillimit afatgjatë si në vendet e tjera të Bllokut Komunist. Strategjia në sektorin ekonomik synonte kalimi nga një vend bujqësor i prapambetur në një vend modern industrial-bujqësor. Ky proces transformim do të arrihej nëpërmjet ndjekjes së modelit stalinist të planifikimit dhe menaxhimit të ekonomisë së centralizuar. Kjo strategji mbështetej në doktrinën Marksiste, ku theksohej se klasa puntorë ishte baza shoqërore e socializmit, madje ishte kjo klasë që stimulonte lindjen e socializmit, e më tej të komunizmit. Socializmi, në vetvete, konsiderohej një fazë tranzitore drejt komunizmit. Në këto kushte, duheshin krijuar instrumenta ekonomike që mundësonin kushtet për formimin e kësaj klase. Nga ky aspekt, Shqipëria, dhe ndoshta të gjitha vendet e lindjes, ishin vendet më të papërshtatshme për aplikimin e komunizmit. Në Shqipëri numri i klasës punëtore ishte i papërfillshëm.

Zbatimi i real socializmit kishte për objektiv industrializimin dhe urbanizimin masiv, nëpërmjet të cilit do të arrihej kompesimi i prapambetjes historike, si dhe lindja e klasës punëtore. Ashtu si në Moskë, drejtuesit e rinj komunistë shqiptarë besonin që kjo ishte mënyra e vetme dhe më e mira për zhvillimin e vendit. Modeli ekonomik bazohej në industrializimin e shpejtë dhe të sforcuar, në lënien në plan të dytë të industrisë së lehtë dhe në kolektivizimin e bujqësisë. Ndër të tjera, drejtuesit komunistë shqiptarë pretendonin se kjo rrugë do ta çonte vendin drejt pavarësisë ekonomike nga vendet e tjera. Pavarësisht kësaj, ata e dinin se kjo strategji nuk mund të realizohej pa ndihma dhe kredi financiare nga jashtë. Në vend u krijuan një sërë institucionesh ekonomike që do të mundësonin kontrollin e plotë të ekonomisë nga ana e shtetit. Reformat e realizuara në fushën ekonomike ndikuan në funksionimin e institucioneve të shtetit. Zgjerimi i ekonomisë së centralizuar u shoqërua me rritjen e rolit të shtetit në planifikimin dhe drejtimin e ekonomisë. Ndryshe nga linja e aleancave politike, drejtimi ekonomik i vendit mbeti më konsensus. Pavarësisht disa luhatjeve të vogla, modeli i zhvillimit sovjetik u ndoq me fanatizëm e rigorozitet nga drejtuesit komunistë shqiptarë, deri në fundin e viteve 1990.

Gjatë viteve 1945 – 1948 ekonomia shqiptare iu nënshtrua interesave të ekonomisë jugosllave, duke paraprirë bashkimin e mundshëm politik. Plani ekonomik dyvjeçar 1946 – 1947 praktikisht përcaktohet nga Beogradi. Kështu në 1 korrik të vitit 1946, në Beograd u nënshkrua marrëveshja “Mbi bashkëpunimin ekonomik në mes të RPSH dhe RFJ-së”. Në këtë marrëveshje vendosej që të dyja vendet të organizonin

²⁵⁸ Ibid, op.cit, fq. 580.

shoqëri mikse shqiptaro – jugosllave të organizuara sipas principit të paritetit, për një periudhë kohore 30 vjeçare qysh nga data e nënshkrimit. Kjo marrëveshje i hapi rrugën krijimit të 27 shoqërive mikse²⁵⁹. Fushat e bashkëpunimit përfshinin ndërtimin e hekurudhave, nxjerrjen dhe fabrikimin e naftës, elektrifikimin, lundrimin detar, veprimtari tregtare, import – eksportin, si dhe krijimin e një banke shqiptaro – jugosllave²⁶⁰. Në datën 9 korrik të vitit 1946 u nënshkrua “Traktati i miqësisë dhe ndihmës reciproke” midis dy vendeve. Intensifikimi i marrëdhënieve u pasua me marrëveshjen “Mbi koordinimin e planeve ekonomike, bashkimin doganor dhe barazimin e monedhave në mes RPSH-së dhe RFJ-së”, e cila i hapte rrugë konkretizimit dhe krijimit të organeve të koordinimit ekonomik midis vendeve. Marrëveshja u nënshkrua në Beograd më 27 nëntor të vitit 1946 dhe parashikonte që brenda një muaji që nga data e nënshkrimit të saj, të hiqeshin “kufijtë doganorë dhe doganat në mes të të dy vendeve duke krijuar kështu një territor doganor unik”, sipas sistemit dhe tarifave doganore jugosllave²⁶¹. Nga kjo marrëveshje, ekonomia Shqiptare ndjeu menjëherë pasojë të rënda. Njësimi i monedhës jugosllave me atë vendase bëri që nga vendi të largoheshin në drejtim të Jugosllavisë një sasi e konsiderueshme ari dhe produkte e mallra të ndryshme. Ndryshe nga pjesa tjetër e vendeve në Ballkan, në Shqipëri gjendeshin rezerva të konsiderueshme bujqësore, blektorale, ar e argjend, si dhe mallra të ndryshëm të përfutuara nga aktiviteti tregtar sidomos me Italinë. Sipas Vickers: “Ata (jugosllavët) e shfrytëzuan vendin ekonomikisht duke paguar çmime tejet të ulta për lëndën e parë që merrnin nga Shqipëria”.²⁶² Nën ndikimin e Jugosllavisë, ekonomia e vendit pësoi humbje të mëdha jo vetëm si pasojë e politikës ekonomike të ndjekur, por gjithashtu edhe nga mosmbajtja e premtimeve Jugosllave për kredi ndaj Shqipërisë.

Gjatë viteve 1946 – 1948 kemi zhvillime pozitive edhe në drejtime të tjera sidomos në fushën e arsimit. Kështu në 17 gusht të vitit 1946 shpallet ligji mbi reformën e arsimit. Sistemi arsimor përcaktohej me arsimin fillor katërvjeçar dhe arsimin unik shtatë vjeçar, atë profesional dhe për të rritur, duhet theksuar se arsimi fillor u bë i detyrueshëm për të gjithë fëmijët e moshës 7 deri 14 vjeç. Brenda vitit 1948 rreth 93.7 % e fëmijëve në mbarë vendin frekuentonin shkollën fillore²⁶³. Fushata e luftës kundër analfabetizimit deri në vitin 1948 u krye mbi baza vullnetare²⁶⁴. Shumë kurse kualifikimi u realizuan për të përgatitur punonjës të sektorëve të ndryshëm, gjithashtu një sërë specialishtësh u dërguan jashtë vendit për thellimin e studimeve të tyre. Arritja në fushën e arsimimit të popullatës shoqërohet me një kontroll të rreptë të zhvillimit të kulturës dhe letërsisë. Të gjitha organet e propagandës u vunë nën drejtimin e partisë-shtet. Sipas studiuesit Brzhezinski,

²⁵⁹Bernard Lory, “Europa Ballkanike; nga 1945 në ditët tona”, Dituria, Tiranë 2007, fq. 57.

²⁶⁰“gazeta zyrtare” 10 janar 1947, op cit në Kastriot Dervishi, fq. 584 .

²⁶¹“gazeta zyrtare” 23 janar 1947,op cit në Kastriot Dervishi, fq. 585-6.

²⁶² Ibid., fq. 262.

²⁶³ Shiko: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, “Historia e Shqipërisë, V.4. 1944-1975”,8 Nëntori, Tiranë, 1983, fq. 82.

²⁶⁴ Xhelal Gjeçovi, Paskal Milo..., “Historia e popullit Shqiptar, IV Shqiptarët gjatë luftës së dytë botërore dhe pas saj 1939-1990”,Toena, Tiranë, fq. 220.

“Alfabetizmi bëri të mundur përhapjen e ideve politike. Por ai nënkuptonte gjithashtu që, nëpërmjet ideologjisë dhe propagandës, idetë politike të redukttoheshin në nocione të thjeshta²⁶⁵”, e thënë ndryshe arsimimi i shërbente partisë për të bërë të mundur dhe efikase propagandën e shkruar. Po në këtë linjë edhe studiuesi Pipa mendon se: “Edukimi fillestar për të gjithë njerëzit është një objektiv kryesor: ata duan që të gjithë shqiptarët të lexojnë gazetat e tyre dhe broshurat e propagandës.²⁶⁶” Një moment kryesor në zhvillimin e arsimit ishte krijimi i Universiteti Shtetëror i Tiranës në vitin 1957. Gjatë sundimit politik të Hoxhës fusha të tilla si arsimit dhe shëndetësia patën arritje të mëdha duke siguruar mbulimin e plotë të popullatës me këto shërbime. Fenomene të tilla si analfabetizmi apo gjakmarrja pothuajse u eliminuan krejt. Një aspekt interesant i këtij regjimi në fushën sociale është tendenca për ta bërë shoqërinë uniforme duke shmangur lokalizmat, gjë që mund të konsiderohet e dështuar. Gjatë regjimit komunist megjithë pretendimet e tyre se kishin ulur ndjeshëm ndikimin e dallimeve krahinore, “në disa aspekte të jetës, ky dallim u bë më i mprehtë pikërisht për shkak të politikave të regjimit²⁶⁷”. Ndryshimet në rendin ekonomik dhe shoqërorë do të shoqëroheshin me lëvizjen e kontrolluar të forcës punëtore nga fshati në drejtim të qytetit. Kështu gjatë viteve 1945-1960 popullsia e qyteteve ishte rritur mbi dy herë ku gjysma e kësaj shtese përbëhej nga popullsia e shpërngulur nga fshati në drejtim të qytetit²⁶⁸.

Një fenomen, produkt i regjimit, ishte aktivizimi dhe mobilizimi i shoqërisë për të realizuar punë vullnetare. Kjo qasje e re e regjimit ndaj qytetarëve do të ekzistojë gjatë gjithë sundimit komunist. Kështu, vetëm për tharjen e kënetës së Maliqit gjatë vitit 1946 u angazuan rreth 22 mijë vullnetarë²⁶⁹.

Në korrik të vitit 1947, Enver Hoxha zhvilloi takimin e parë me Stalinin duke nisur kështu afrimin e drejtpërdrejtë me Moskën. Në këto bisedime, qeveria sovjetike ra dakord për plotësimin e kërkesave për kredi, pajisje bujqësore dhe ndërtimin e objekteve industriale²⁷⁰. Intensifikimi i marrëdhënieve Shqipëri – BS vijoi me vizitën së dytë të Enver Hoxhës në periudhën mars-prill të vitit 1949 në Moskë. Gjatë kësaj vizite u nënshkrua marrëveshja e kredisë për furnizimin e Shqipërisë me pajisje për ndërmarrje komplete dhe materiale të tjera²⁷¹. Me orientimin politik drejt Moskës, të gjitha fushat e veprimtarisë së vendit krijuan varësi të plotë nga Bashkimi Sovjetik. Imponimi i modelit ekonomik ndikoi në vendosjen e kontrollit sovjetik në vend. Gjatë viteve '50 dhe si pjesë e planit të parë 5 vjeçar, Shqipëria ndërmoi një program ambicioz por jo real të

²⁶⁵ Zbigniew Brzezinski, “*Jashtë Kontrollit, trazira që përfshiu botën në prag të shekullit XXI*”, Elena Gjika, Tiranë, 1995, fq. 30-1.

²⁶⁶ Arshi Pipa, fq. 34-5.

²⁶⁷ Enis Sulstarova, “*Ligjërimi Nacionalist në Shqipëri*”, Afërdita, Tiranë, 2003, fq. 141.

²⁶⁸ Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, “*Historia e Shqipërisë, V.4. 1944-1975*”, 8 Nëntori, Tiranë, 1983, fq. 287.

²⁶⁹ Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, “*Historia e Shqipërisë, V.4. 1944-1975*”, 8 Nëntori, Tiranë, 1983, fq. 59.

²⁷⁰ Ibid fq. 114.

²⁷¹ Shiko: Xhelal Gjeçovi, Paskal Milo., “*Historia e popullit Shqiptar, IV Shqiptarët gjatë luftës së dytë botërore dhe pas saj 1939-1990*”, Toena, Tiranë, fq. 245-7.

industrializimit dhe elektrifikimit të vendit. Në dhjetor të vitit 1949 u vendos një sistem pagash bazuar në parimin secili sipas punës, duke marrë parasysh përveç sasisë dhe cilësisë së prodhimit edhe vështirësitë e punës, kualifikimin, shkallën e arsimit dhe vjetërsinë në punë të punonjësve²⁷². Në sektorin e bujqësisë gjëndja ishte e rëndë. Ndër objektivat e planit të parë pesë vjeçar ishte kolektivizimi sa më i shpejtë i ekonomisë fshatare. Thatësitat që ndodhën gjatë viteve 1951-1952 reduktuan ndjeshëm në vend prodhimet bujqësore dhe gjënë e gjallë duke ndaluar përkohësisht procesin e kolektivizimit. Vlen të përmendim se frenimi i procesit u bë edhe si pasojë e efekteve negative të aplikimit të kolektivizimit në Moskë. Kolektivizimi në Shqipëri u shty për në mesin e viteve '50, por në këtë kohë realizimi i tij u krye në mënyrë të pamëshirshme dhe pa marrë parasysh pasojat. Frikësimi ndaj kulakëve ia kaloi për egërsi edhe fushatës në Rumani²⁷³. Kolektivizimi synonte likuidimin përfundimtar të pronës private pavarësisht madhësisë së saj, si dhe vënien nën kontroll nga shteti të shpërndarjes së mallrave ushqimore. Gjithashtu përqëndrimi në dobësimin e interesave ekonomike të fshatarëve synonte nënshtrimin e tyre ndaj pushtetit të ri politik. Me ngritjen e kooperativave në sektorin e bujqësisë u realizua edhe ngritja e ndërmarrjeve shtetërore. Kolektivizimi e vite më vonë edhe tufëzimi e zhveshi totalisht fshatarin e ri socialist nga mundësia e sigurimit të ushqimeve bazë, për pasojë, ai u bë po aq i varur sa qytetari që jetonte në qytet. Këto masa patën si rezultat forcimin e radhëve të partisë dhe të shtetit me klasën e re të burokratëve dhe aparatçinjeve komunistë. Kështu në rendin e ri socialist, punonjësit e fshatit duhej të pranonin pozitën e dorës së dytë. Puna e tyre ishte të prodhonin për të plotësuar nevojat për ushqim të proletarietit, numër ky që sa vinte dhe shtoej. Ky rregull u zbatua në mbarë vendet komuniste ballkanike dhe udhëheqësit partiakë shpejtuan për të mbytur çdo veprimtari politike të pavarur në fshat. Në fillim ata urdhëruan shtypjen me forcë të lëvizjeve fshatare me peshë asokohe në gadishull, të cilat përbënin rrezikun më serioz për monopolin e komunistëve në pushtet. Gjatë gjithë këtyre viteve bujqësia ishte sektori më i dobët i ekonomisë Shqiptare. Një nga arsytet për mos zhvillimin e sektorit të bujqësisë na e jep studiuesit Meksi kur pohon se: “..kostoja e industrializimi artificial do të përballohej në masë të madhe nga shfrytëzimi i paprecedent i ekonomisë fshatare, nëpërmjet transformimit të saj në forcë punëtore në shërbim të shtetit: kolektivizimit²⁷⁴”. Ky proces u realizua në masën më ekstreme duke rrënuar sektorin e bujqësisë dhe nivelin e jetesës së qytetarëve dhe fshatarëve gjatë gjithë sundimit komunist.

Me ndryshimet në drejtimin politik të BS (pas vdekjes së Stalinit) edhe në planin e dytë pesëvjeçar, prioritet i ekonomisë shqiptare vijoi të ishte industrializimi i sforcuar i vendit. Investimet përfshinin ndërtimin e objekteve industriale, ku kërkesa për materiale e ekspertizë teknike merrte pjesën më të madhe të buxhetit të shtetit. Në frontin ekonomik, programi i Hrushovit për “ndarjen socialiste të punës”, i hartuar në fund të viteve '50,

²⁷² “Historia e Shqipërisë, V.4. 1944-1975”, fq. 123.

²⁷³ Misha Glenny, “Historia e ballkanit 1804-1999” Toena, Tiranë, 2007, fq. 564.

²⁷⁴ Sofokli Meksi “Mbi disa aspekte të trashëgimisë totalitare gjatë periudhës së tranzicionit shqipëtarë” Tiranë Jehona, 2008, fq. 43.

kërkonte që Shqipëria të përqendrohej në prodhimin bujqësor, gjë e cila u shpërfill nga drejtuesit shqiptarë. Për udhëheqjen, ajo u komentua si një orvatje për të frenuar arritjet e saj në lëmin e industrisë. Acarimi i marrëdhënieve politike me Rusinë do të ndihej shumë në realizimin e planin të tretë pesë vjeçar 1961 – 1965, i cili ishte hartuar pikërisht duke u bazuar nga ndihmat që do të merrte nga Bashkimi Sovjetik. Presionet dhe bllokimi i ndihmës ekonomike do ta vinte në vështirësi shumë të mëdha ekonominë shqiptare. Ndërhyrja e ndihmave kineze ishte shpëtimi i pushtetit politik dhe garancia e vijimit të ekonomisë së centralizuar sipas ideologjisë staliniste. Në planët pesëvjeçarë që vijuan, tendenca e zhvillimit mbeti po e njëjtë, ajo e industrializimit edhe pas prishjes me Bashkimin Sovjetik edhe militarizimi i vendit. Një ndër arritjet e kësaj periudhe përveç ndërtimit dhe vënies në punë të një sërë veprash industriale ishte edhe elektrifikimi i plotë i vendit i përfunduar më 25 tetor të vitit 1970²⁷⁵. Programet ekonomike ishin ndërtuar duke mos u bazuar në gjendjen reale dhe mundësitë alternative të zhvillimit të vendit. Gjatë këtyre viteve shumë degë të ekonomisë kishin vështirësi në realizimin e planit të kërkuar. Po kështu, në përpjekje për të eliminuar plotësisht pronën private rreth viteve 60 – 70 qeveria ndërmoi masa për të kufizuar e më pas likuiduar plotësisht oborrin kooperativist, një akt ky që përkeqësoi ndjeshëm gjendjen socio-ekonomike të shoqërisë. Drejtimi i ashpër, dogmatik e ideologjik i udhëheqjes komuniste në fushën ekonomike dha rezultate tepër negative për zhvillimin e vendit. Për dështimet në sektorët e ndryshëm të ekonomisë sistemi fajsonte dhe justifikohej me veprimtarinë e “armikut të brendshëm”. Miti i sabotatorit apo i armikut si shkaktar i problemeve shoqërore do të jetë një nga trashëgimitë më të fuqishme staliniste në aspektin e mendimit kolektiv. Partia dhe ideologjia ishin të pagabueshëm, ndaj miti i sabotatorit ishte alibia e përkryer për adresimin e të gjitha problemeve²⁷⁶. Vështirësitë ekonomike ashpërsuan edhe më tej luftën e klasave duke rritur ndjeshëm numrin e të persekutuarve dhe të dënuarve politikë. Edhe në planin e zhvillimit të letërsisë, artit dhe kulturës, ideologjia komuniste kristalizoi tiparet e realizmit socialist. Orientimi i krijimtarisë letrare e artistike bëhej bazuar në direktivat e Pleniumeve të Komitetit Qëndrorë të Partisë-Shtet. Zhvillimi në këtë drejtim ishte pasqyrimi i realitetit të ri historik e politik që po përjetonte populli nën udhëheqjen e Partisë, si dhe luftë të ashpër tendencave borgjeze-revizioniste. Një numër i madh gazetash dhe revistash dolën në qarkullim. Në vitin 1965 botoheshin 12 gazeta dhe 30 revista, si dhe u botuan mbi 500 libra me një tirazh të përgjithshëm prej 1,850,000 copë²⁷⁷. Politika e centralizimit prekte edhe këtë fushë duke përcaktuar dhe planifikuar jo vetëm numrin, por edhe tematikë e krijimtarive letrare dhe artistike. Ndërkohë, që nga 29 prill i vitit 1961²⁷⁸ kishte nisur trasmetimi televiziv i TVSH duke mundësuar një

²⁷⁵ Shiko: Xhelal Gjeçovi, Paskal Milo., “*Historia e popullit Shqiptar, IV Shqiptarët gjatë luftës së dytë botërore dhe pas saj 1939-1990*”, Toena, Tiranë. fq. 275-278.

²⁷⁶ S. Meksi fq. 20.

²⁷⁷ Shiko: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, “*Historia e Shqipërisë, V.4. 1944-1975*”, 8 Nëntori, Tiranë, 1983, fq. 300-2.

²⁷⁸ K. Dervishi, fq. 670.

zhvillim të mëtejshëm të jetës shoqërore në vend. Pavarsisht faktit që si radioja, ashtu dhe televizioni ishin nën tutelën e Partisë, hapja e tyre mund të konsiderohej, nga shumë aspekte, një arritje e madhe.

Pas përfundimit të aleancës me sovjetikët, udhëheqja shqiptare lidhi marrëdhënie tepër të ngushta me Kinën, e cila bëri të mundur zbutjen e problemeve ekonomike shqiptare. Kina u tregua e gatshme që të ndihmonte Shqipërinë me ndihma e hua për të vazhduar projektet ambicioze në fushën e industrializimit. Zhvillimet ekonomike të kësaj periudhe shënonin ngritje, kjo si pasojë e subvencionimit të defiçitit buxhetor nga ana e qeverisë kineze. Me gjithë problemet e mëdha që kishte ekonomia kineze, ajo përballoi edhe barrën e rëndë të industrializimit të Shqipërisë. Ndikimet negative nga kopjimi i revolucionit kulturor sipas modelit kinez do të ndiheshin në të gjitha fushat e veprimtarisë shtetërore e shoqërore. Pas shkëputjes me Bashkimin Sovjetik, regjimi kishte treguar një farë indiference ndaj ndikimeve perëndimore, të cilat vinin kryesisht nga kanalet televizive italiane. Në shoqërinë e kryeqytetit dhe qytetet kryesore të vendit ekzistonte një lirshmëri intelektuale, kjo nëpërmjet librave që lejoheshin të lexoheshin, filmave artistikë etj. Zhvillimet aq pozitive që kishte njohur krijimtaria letrare dhe ajo artistike në fillim të viteve '60 u smbrapsën si pasojë e masave në kuadër të revolucionarizimit të jetës në vend²⁷⁹. Në atë kohë u propagandua se “vendi po hynte në një etapë të re më të lartë të zhvillimit të tij politik, ekonomik, ideologjik e kulturor...partia e cilësonte të domosdoshëm thellimin e vijës së masave dhe luftën për revolucionarizimin e mëtejshëm të saj, të aparatit shtetëror dhe të të gjithë jetës së vendit²⁸⁰”. Marrja e masave konkrete duke filluar me ç’burokratizimin e mandej me goditjen e institucioneve fetare kishin për qëllim frikësimin dhe izolimin e shoqërisë shqiptare nga bota Perëndimore. Në të gjitha fushat e veprimtarisë krijuese u ndje trysnia e aplikimit të kësaj filozofie të re nga pushteti qeverisës. Nga kjo pikënisje u justifikuan veprimet e ashpra që ndërmori Partia për likuidimin e shtresës së intelektualëve, të cilët manifestonin tendenca liberale.

Pas vitit 1971 u krijuan mosmarrëveshje ideologjike midis dy vendeve, si pasojë e ftohje të marrëdhënieve ndërmjet tyre, Shqipëria do haste vështirësi të mëdha në fushën ekonomike duke sjellë pasoja të rënda në realizimin e planit të gjashtë pesëvjeçarë. Në kushtet e izolimit të plotë, ekonomia shqiptare po kalonte situata shumë të vështira, jo vetëm për mosrealizime planesh dhe parashikime, por edhe për shkak të përkeqësimit të kushteve dhe nivelit të jetesës. Kushtetuta e vitit 1976 institucionalizoi idenë e mbështetjes së ekonomisë dhe zhvillimit të vendit tërësisht në forcat tona, gjithashtu ajo ndaloi marrjen e huave dhe kredive të huaja²⁸¹.

Në fund të viteve '80, vendi po ndjente vështirësitë e para ekonomike. Për drejtuesit e lartë të Partisë u be e qartë së pa një mbështetje financiare nga jashtë, projektet e industrializimit vështirë se do të vazhdoheshin. Edhe pse ekonomia e vendit

²⁷⁹ Shiko: Ngjela, fq. 358-382.

²⁸⁰ Ibid., fq. 309.

²⁸¹ Enis Sulstarova, “*Ligjërimi Nacionalist në Shqipëri*”, Afërdita, Tiranë, 2003. fq. 63.

ishte në një situatë shumë të vështirë dhe kishte nevojë për politikë tjetër në shumë sektorë, drejtuesit komunistë vendosën që të vazhdonin politikat ekonomike po në të njëjtën linjë si më parë. Në këto kushte, politikat e gabuara ekonomike vijuan të thellonin varfërinë në popullatë. Shqiptarëve gjithnjë e më shumë u mungonin artikujt ushqimorë dhe të veshjes. Rrënimi i ekonomisë ishte ndër të tjera përcaktuesi kryesor i kolapsit të sistemit politik në të gjitha vendet ish-komuniste, por megjithëse Shqipëria ishte vendi më i varfër ndër to, ajo rezistoi deri në fund si pasojë e një politike ekstreme. Ajo çfarë u krijua nën sundimin e Hoxhës ishte e destinuar të dështonte jo vetëm se sundimi i tij ishte produkt i një terrori dhe dhune të pashembullt shtetërore, i skllavërimit e keqtrajtimit të shoqërisë në tërësi, por mbi të gjitha nga shkatërrimi sistematik i inteligjencës dhe elementëve përparimtarë të shoqërisë.

Ndryshe nga Kina komuniste, e cila reformoi sistemin ekonomik për të mbajtur gjallë sistemin politik Enver Hoxha dhe drejtues të tjerë të lartë politikë vazhduan me këmbëngulje izolimin e tejskajshëm duke refuzuar marrëdhëniet tashmë me krejt botën mbarë.

Gjatë katër dekadave që Enver Hoxha sundoi Shqipërinë pavarësisht përpjekjeve dhe ndryshimeve në shumë fusha, Shqipëria gjatë kësaj periudhe ishte dhe mbeti vendi më i varfër i Evropës. Me gjithë ndryshimet dhe transformimet që pësoi shoqëria në brendësi, (ajo) gjatë këtyre viteve mbeti një shoqëri konservatore dhe dallohej për aparatën gjigand burokratik dhe militarizimin e shtetit. Socializmi etatist i tipit sovjetik e “shndërroi njeriun në subjekt prodhues ku gjithçka e dikton shteti dhe nuk merren parasysh interesat dhe kërkesat e tij. Stimuli material gati u mohua dhe në plan të parë dolën stimujt moralë²⁸²”.

Si pasojë fenomene si nepotizmi, servilizmi, spiunimi dhe vjedhja e pronës shtetërore haseshin (kryesisht gjatë viteve të fundit të sistemit) në të gjitha strukturat partiake e shtetërore. Ato ishin disa nga tendencat që lindën sidomos me degjenerimin e pushtetit dhe regjimit komunist shqiptar.

Modeli i lidhjes së Partisë me Shtetin pati ndër të tjera rezultate negative në përzgjedhjen e kudrove të shtetit. Për aparatën e ri partiak e shtetëror mjafton ta përshkruajmë me fjalët e G. Sartorit: “Të jemi të qartë për faktin se duke zhvlerësuar meritokracinë, ne fitojmë thjesht një jomeritokraci, se duke zhvlerësuar përzgjedhjen ne fitojmë thjesht keqzgjedhjen, dhe se duke zhvlerësuar barazinë në meritë në fitojmë thjesht barazinë në jomeritë²⁸³”. Nën drejtimin e Hoxhës, klasa e inteligjencës në vend pësoi humbje të pariparueshme. Me shkatërrimin e elitës intelektuale qysh nga marrja e pushtetit e në vijim, sistemi bëri të mundur nënshtrimin e veprimtarive krijuese e mendore ndaj diktateve të partis- shtet. Udhëheqja komuniste jo vetëm që jepte porositë se si duheshin shkruar poezitë, romanet, sesi duheshin realizuar filmat dhe pikturat, por ajo shkonte edhe më tej duke përcaktuar edhe konceptet e reja për shijen, sjelljen dhe

²⁸² Adem Mezini, “*Shekulli XX*”, EXTRA-R, Tiranë, 2010, fq. 58-9.

²⁸³ Giovanni Sartori, “*Edhe një herë për Teorinë e Demokracisë*”, Dituria, Tiranë, fq. 247.

mënyrën e jetesës duke synuar kështu edukimin e plotë dhe të gjithanshëm të njeriut të ri komunist.

Në këto vite, ky sistem politik dhe ekonomik krijoi, stimuloi, zhvilloi dhe mbështeti antivlerat njerëzore dhe shoqërore duke imponuar një ideologji që i kthente njerëzit në robër të Partisë duke transformuar identitetin e individve deri në atë pikë, sa dhe fëmija arrinte të spiunonte prindin e vet. Sistemi i frikës dhe terrorit i ndërtuar nën drejtimin e Hoxhës është cilësuar pothuajse nga të gjithë studiuesit dhe historianët një tragjedi kombëtare.

2.3 Shqipëria nën drejtimin e Ramiz Alisë (vitet 1985 – 1991)

“Vdekja e diktatorit nuk garanton lindjen e demokracisë”
Samuel Hungington ²⁸⁴

Ramiz Alia erdhi në krye të shtetit shqiptar pothuajse në të njëjtën kohë kur Gorbaçovi erdhi në krye të Bashkimit Sovjetik. Megjithëse që të dy erdhën në krye të pushtetit në të njëjtën kohë (në pranverë të vitit 1985) dhe u përballën me probleme dhe dilema të ngjashme, Alia dhe Gorbaçovi nuk patën kurrfarë bashkëveprimi. Ndryshe nga Alia, ardhja në pushtet e Gorbaçovit solli ndryshime në politikën e Bashkimit Sovjetik. Platformën e tij, ai e parashtrroi në Kongresin e parafundit të Partisë Komuniste të mbajtur nga datat 25 shkurt – 6 mars 1986. Reformat e quajtura “Gllasnost” (Transparenca) “Perestrojka” (Ristrukturimi) dhe Uskorenje (Ndezja e Zhvillimit Ekonomik²⁸⁵), synonin ndryshime thelbësore në perandorinë komuniste. Në atë kohë, regjimi i Tiranës, i konsideroi lëvizjet politike të Gorbaçovit si revizioniste dhe antimarksiste²⁸⁶. Pavarësisht faktit që të gjitha vendet e bllokut komunist ishin zhytur në një krizë të thellë ekonomike dhe nevoja për reforma ishte imediate, Alia as që e përfilli perestrojkën duke e konsideruar si krejtësisht të papërshtatshme për një vend si Shqipëria²⁸⁷. Sipas tij, Shqipëria, kishte shumë vite që bënte një rrugë të ndarë politike dhe ekonomike nga vendet e tjera të kampit komunist. Ajo i kishte qëndruar besnike ideologjisë leniniste – staliniste, ndaj vendi nuk kishte lidhje me krizën që po kalonin vendet e Evropës Lindore dhe Bashkimi Sovjetik. Një konstatim ky i pavërtetë, pasi në kohën kur Ramiz Alia u bë numri një i regjimit, veçanërisht gjendja ekonomike ishte tejet e rënduar në Shqipëri. Trashëgimia politike dhe ekonomike e lënë nga Hoxha ishte gati e mjerë. Vendi kishte sistemin më të egër politik në të gjithë bllokun komunist. Lufta e klasave ishte zbatuar në mënyrë permanente dhe në format më ekstreme. Shoqëria shqiptare ndodhej në varfëri të

²⁸⁴ Samuel Hungington, “*Vala e trete*”, AHS, Tiranë, 2011, fq. 7.

²⁸⁵ <http://www.revistadrini.com/2013/10/pirro-prifti-a-eshte-demokracia-shqiptare-nje-peng-i-katovices/>

²⁸⁶ V. Duka, fq. 315.

²⁸⁷ J. Rothschild, fq. 287.

madhe dhe vendi po ndjente dita-ditës krizën ushqimore, papunësinë dhe kriminalitetin në rritje duke degraduar sistemin në tërësi.

Në planin politik, lideri i ri i vendit, u zgjodh pikërisht që të vazhdonte përpara trashëgimia politike e ish-udhëheqësit Hoxha. Ai nuk bëri ndryshime domethënëse në elitën qeverisëse të vendit. Edhe nën drejtimin e tij, kryeministër mbeti përsëri Adil Çarçani, dhe po kështu edhe anëtarët e Byrosë Politike mbetën po ata. Që nga koha e Luftës Nacionalçlirimtare kur në njësitë partizane ai kishte pasur funksione politike²⁸⁸, Alia ishte bërë pjesë e strukturës më të lartë drejtuese duke u ngritur dalëngadalë në pozicione të ndryshme, derisa, më në fund, vetëm dy ditë pas vdekjes së Hoxhës, ai zgjidhet Sekretar i Parë i PPSH-së. Me aktivitetin e tij politik, besnikërinë e madhe dhe bindjen e patundur ndaj Hoxhës, ai arriti të bëhej një ndër bashkëpunëtorët më të afërt të tij.

Alia, u lind në Shkodër në 18 tetor të vitit 1925. Në vitin 1943, anëtarësohet në Partinë Komuniste dhe në vitin 1948 zgjidhet anëtar në Komitetin Qendror të Partisë. Në vitin 1954, Alia, përfundon studimet e avancuara në Bashkimin Sovjetik. Nën patronazhin e çiftit Hoxha, ai u emërua në poste të ndryshme si Ministër i Arsimit dhe Kulturës në vitet 1955-1958, anëtar i Byrosë Politike dhe Sekretar i KQ PPSH-së për ideologjinë dhe propagandën, deputet etj²⁸⁹.

Me ardhjen e tij në pushtet, ruajtja e vijës së Hoxhës u bë kryefjala e çdo politike. Ai theksonte se: “besnikëria ndaj mësimëve dhe rrugës së Enver Hoxhës do të ishin garanci për përparimin dhe mbrojtjen e pavarësisë së vendit²⁹⁰”. Kulti i diktatorit u ngrit më shumë se kurdoherë pas vdekjes së tij. Për të lartësuar veprën dhe kontributin e Hoxhës në mbledhjen e Komitetit Qendror të datës 13 Prill 1985, pas emërimit të Alisë si Sekretar i Parë i KQ të PPSH, u miratua vendimi për ngritjen e përmendoreve të diktatorit në disa vende të Shqipërisë²⁹¹. Në këtë drejtim, një rol të madh luajtën besnikët e vijës konservatore të Partisë me në krye gruan e diktatorit duke mbikëqyrur çdo hap të udhëheqësit të ri. Që në fillim, Alia ishte nën presion si të elementëve konservatorë, ashtu edhe të elementëve më liberalë që ndodheshin brenda Partisë. Shumë njerëz dhe intelektualë kishin shpresa të mëdha tek lideri i ri i vendit. Ai ishte njeriu që e njihte dhe e dinte më mirë gjendjen në të cilën ndodhej vendi.

Situata në të cilën ndodhej Alia (po të supozojmë që ai do të donte të vepronte ndryshe) ishte pasojë e *pushtetit të cekët që ai gëzonte*. Në këtë kontekst, Rothschild shkruan se:

Fare mirë Alia mund të mëtonte për një legjitimitet më të madhpor duke i thirrur arsyes, ai nuk mund të mohonte faktin se drejtonte një vend në kushtet

²⁸⁸ Xhelal Gjeçovi, Paskal Milo., “*Historia e popullit Shqiptar, IV Shqiptarët gjatë luftës së dytë botërore dhe pas saj 1939-1990*”, Toena, Tiranë, fq. 348.

²⁸⁹ Shiko: <http://www.britannica.com/EBchecked/topic/15352/Ramiz-Alia>

²⁹⁰ Xhelal Gjeçovi, Paskal Milo., “*Historia e popullit Shqiptar, IV Shqiptarët gjatë luftës së dytë botërore dhe pas saj 1939-1990*”, Toena, Tiranë, fq. 348.

²⁹¹ Përmendoret do të ngriheshin në qytetin e Tiranës, Gjirokastrës e Korçës për më shumë shiko: Kastriot Dervish, fq. 768.

*anormale dhe irracionale të një tejcentralizimi krejtësisht joproduktiv, të një korrupsioni alarmant e në përmasa të pakonceptueshme, si dhe të shkeljeve nga më brutalet të të drejtave të njeriut.*²⁹²

Pas vitit 1988, intelektualët dhe elementët liberalë gjithnjë e më shumë po jepnin shenja pakënaqësie. Edhe pse vendi ndodhej në situatë tejet të vështirë, Alia nuk ishte mbështetës i idesë për të ndërmarrë reforma të thella për nxjerrjen e vendit nga kriza ekonomike. Nën drejtimin e tij u bënë përpjekje të ngadalta për ndryshimin apo përmirësimin e situatës politike dhe ekonomike të vendit. Në shtator të vitit 1986, me një dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor u bënë ndryshime në aplikimin e masave administrative e penale, efektet kishin të bënin me reduktimin e kohës së internimit dhe masat për thyerjen e ligjeve të shtetit²⁹³.

Strategjia që do të ndiqte Alia në politikën e jashtme u bë e ditur në fjalimin e mbajtur në nëntor të vitit 1986 në Kongresin e 9-të të Partisë së Punës²⁹⁴. Ndër të tjera Alia theksonte faktin që politika e jashtme e Shqipërisë udhëhiqej nga:

*“...parimet e barazisë, mosndërhyrjes në punët e brendshme, integritetit territorial dhe sovranitetit kombëtar, vendi ynë ka marrëdhënie normale me shumicën e vendeve evropiane dhe përpjeket t’i zhvillojë ato në favor të interesave të përbashkëta*²⁹⁵”.

Kështu, pavarësisht retorikës politike staliniste – enveriste, antiamerikane dhe antisovjetike, Alia pas vitit 1987 lejoi zhvillimin e marrëdhënieve me vende të tjera duke braktisur politikën e mospërfshirjes së vendit në marrëdhënie shumëpalëshe²⁹⁶. Kështu, në vitin 1987, Shqipëria vendosi marrëdhënie diplomatike me Republikën Federale Gjermane, normalizoi marrëdhëniet me Greqinë. Këtu vlen të ndalemi për të qartësuar atë që në marrëdhëniet me Gjermaninë Perëndimore njihet si “shansi i humbur” i Shqipërisë²⁹⁷. Shpeshherë, Alia është kritikuar për faktin që refuzoi jo vetëm ndihmën financiare të Republikës Federale Gjermane, por edhe shansin për hapjen e sistemit përpara të gjitha vendeve të tjera të lindjes. Vetë Alia, në kujtimet e tij, e anashkalon analizën lidhur me shansin e humbur të Shqipërisë, megjithatë ai pranon se përpjekjet nga ana e RFGJ ishin intensive dhe me qëllimin e mirë për ta ndihmuar Shqipërinë që të zhvillohej, jo vetëm ekonomikisht²⁹⁸. Kështu, pas vizitës së parë të Shtrausit në vitin 1984 (Kryeministri i Landit të Bavarisë), Gjermania bëri përpjekje serioze për të vendosur marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë (e cila ishte vendi i vetëm në Evropë me të cilën ajo nuk i kishte këto raporte). Ndër të tjera, pala shqiptare i shtroi RFGJ për

²⁹² J. Rothschild, fq. 288.

²⁹³ Ibid., Xhelal Gjeçovi, fq. 350.

²⁹⁴ Kongresi i IX i PPSH u cilësua ndryshe dhe si Kongresi i vazhdimësisë duke konfirmuar kështu vazhdimin e kursit politik të ndjekur nga Hoxha.

²⁹⁵ Op.cit M. Vickers, fq. 329.

²⁹⁶ V. Duka, fq. 314.

²⁹⁷ Afrim Krasniqi, “*Fundi i Siberisë Shqiptare, Lëvizja studentore: dhjetor 1990 dhe shkurt 1991*”, albin, Tiranë, 1998, fq. 14.

²⁹⁸ Shiko: Ramiz Alia, “*Jeta Ime, Kujtime*”, Toena, Tiranë, 2010, fq. 309-11.

zgjidhje çështjen e reparacioneve të luftës, me pretendime monetare tepër të mëdha, të cilat u refuzuan nga pala gjermane, duke ofruar alternativa të tjera në vend të reparacioneve. Për këto çështje dhe të tjera, bisedimet midis dy vendeve u zhvilluan nga takimet e nivelit më të lartë e deri në bisedime në rang ekspertësh. Takimet në nivel specialistësh u zhvilluan gjatë viteve 1985, 1986 e 1987 në Vjenë, Romë dhe Bon²⁹⁹. Sipas të dhënave, Shtraus dhe qeveria Federale Gjermane e Kolit bënë përpjekje të mëdha për të bindur qeverinë shqiptare që të bëhej pjesë e një projekti të veçantë me objektiv anëtarësimin e përsheptuar të Shqipërisë në Komunitetin Evropian, duke shfrytëzuar faktin që Shqipëria ishte e shkëputur prej vendeve të Bllokut Lindor. Kjo do të thoshte që Shqipëria të hapte ndaj një kursi të ri politik dhe ekonomik, gjë e cila u refuzua kategorikisht nga pala shqiptare³⁰⁰. Marrëdhënie u vendosën edhe me vende të tjera si psh: Kanadanë, Italinë, Francën, Suedinë, Holandën etj. Marrëdhëniet me Jugosllavinë mbetën të tensionuara për shkak të ngjarjeve në Kosovë. Megjithatë, në shkurt të vitit 1988, Shqipëria mori pjesë në Konferencën e Ministrave të Jashtëm të Ballkanit të mbajtur në Beograd. Ky ishte takimi i parë zyrtar i gjashtë vendeve ballkanike pas pesë dekadash³⁰¹. Pjesëmarrja e Shqipërisë në takime të këtij niveli dëshmonte për një politikë bashkëpunimi që do të ndiqte Shqipëria me fqinjët e saj. Në vitin 1988, Shqipëria kishte marrëdhënie me rreth 110 vende. Kjo hapje e Shqipërisë ishte vetëm për shkëmbime tregtare. Arsyeja kryesore e suksesit jo të vogël të kësaj strategjie të dyfishtë ishin burimet minerare si kromi, nikeli, energjia elektrike etj., të cilat kërkoheshin shumë nga industrialistët dhe shtetet e industrializuara pa u ndikuar nga “kampi ideologjik” i Shqipërisë³⁰². Regjimi ishte shumë i kujdesshëm që të mos kishte ndërhyrje të kulturës perëndimore dhe të çdo gjëje që cënonte bazat e pushtetit komunist.

Në lidhje me vazhdimin e trashëgimisë politike në fushën ekonomike tri ishin parimet kryesore që do vijonin të ndiqeshin nga Alia:

1. Ndalimi i kredive të huaja (me kushtetutën e vitit 1976).
2. Vazhdimi i të njëjtës vijë ekonomike duke u mbështetur kryesisht/tërësisht në burimet e vendit.
3. Balancimi i eksportit me importin³⁰³.

Kështu, plani i ri pesëvjeçarë 1986-1990 vijoi me ndjekjen e të njëjtës strategji zhvillimi. Pavarësisht retorikës pozitive të artikuluar nga drejtuesit më të lartë të vendit për t'i kushtuar vëmendje më të madhe industrisë së lehtë dhe bujqësisë përsëri në planin e VIII (tetë) pesëvjeçar pjesa më e madhe e investimeve iu caktua industrisë së rëndë. Objektivat do të realizoheshin duke u mbështetur tërësisht në forcat e brendshme pa asnjë ndihmë e kredi nga jashtë.

²⁹⁹ Ibid., fq.310

³⁰⁰ Shiko: B. Fevziu, fq. 221-2.

³⁰¹ M. Vickers, fq. 330.

³⁰² Shiko: J. Rothchild, fq. 287-91.

³⁰³ Shiko :V. Duka, fq. 307.

Përveç vazhdimit me të njëjtën platformë ekonomike, kishte edhe faktorë të tjerë të cilët vazhdonin të ndikonin në përkeqësimin e situatës ekonomike të vendit. Këtu mund të përmendim: vazhdimin e subvencionimit të atyre uzinave apo fabrikave, të cilat dilnin me humbje, mungesa e teknologjisë së avancuar si dhe punësimi gati i plotë i popullsisë etj. Si pasojë e mungesës së vazhdueshme të zhvillimit dhe investimit në ata sektorë të ekonomisë siç ishte industria e lehtë dhe bujqësia (sektorë që ndikojnë drejtpërdrejt në ngritjen e mirëqenies dhe nivelin e jetesës) në mesin e viteve ‘80 niveli i jetesës dhe gjendja e qytetarit shqiptar ishte mjerisht e keqe. Rënia e standardit të jetesës u bë edhe më e dukshme nga mungesa e reformave dhe masave konkrete për parandalimin e krizës ekonomike. Mungesa e reflektimit (nga udhëheqja komuniste) si dhe mospranimi i krizës reale të vendit pati si pasojë vazhdimin e politikave ekonomike të industrializimit të sforcuar duke çuar në thellimin e problematikave të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë shqiptare.

Sipas historianes Duka:

“Mosmenaxhimi si duhej i burimeve kapitale dhe njerëzore u kthye në gangrenën e sistemit. Besnikët e vijës së ashpër, të cilët ishin të shumtë në të gjitha nivelet e administratës dhe organeve shtetërore, dukeshin të vendosur që të mos ndryshonin as edhe një presje nga porositë e udhëheqësit të vdekur... ky grup që e lidhte pozitën dhe privilegjet e tij me regjimin, ishte i gatshëm t’i mbronte ato me çdo kusht³⁰⁴”.

Burokratët komunistë ishin shkëputur nga realiteti i mjeruar i vendit. Ata përfitonin dhe gëzonin më të mirën nga sistemi dhe ishin ata më konservatorët për ruajtjen e tij. Korrupsioni (i pandëshkuar) në radhët e zyrtarëve ishte i madh dhe njerëzit ishin të zhgënjyer nga mosrealizimi i premtimeve për një jetë më të mirë, zhvillim dhe barazi ndërmjet tyre. Ndryshimin që ata e shikonin çdo ditë midis jetës së tyre dhe bllokmenëve ishin shkëndijat e para të një pakënaqësie popullore në rritje. Në këtë situatë serioze, në shumë raste paaftësia dhe abuzimi i zyrtarëve të lartë justifikoheshin nga regjimi me besnikëri të verbër ndaj filozofisë qeverisëse. Mungesa e profesionalizmit, papërgjegjshmëria dhe ndjekja me verbëri e dogmës politike ishin disa nga arsyet kryesore të thellimit edhe më të madh të krizës. Sipas studiuesit Pipes: “Më 1980, edhe elita sovjetike e kishte humbur besimin tek komunizmi, ndërsa shikonte botën e jashtme të ecte shumë më përpara në çdo fushë, përveç asaj ushtarake dhe konsumit të alkoolit³⁰⁵”. Pra, në këtë situatë ku elitat drejtuese të vendeve komuniste ndjenin dështimin e projektit komunist për prosperitet dhe zhvillim të popujve dhe vendeve të tyre, Tirana zyrtare bënte retorikë triumfuese të sistemit të saj “të përsosur” dhe të paprekur nga kriza e paevitueshme ekonomike e modelit komunist.

Në këto kushte, Alia ndërmori disa iniciativa ekonomike gjatë viteve 1988 – 1989, për nxjerrjen e vendit nga kriza, si:

³⁰⁴ Ibid. fq. 310.

³⁰⁵ Richard Pipes “Komunizmi, Historik i shkurtër”, fq. 68.

1. Decentralizim i pjesshëm i planifikimit duke zgjeruar sferën e vendimmarrjes nga ana e drejtorëve dhe administratorëve të fabrikave.
2. Fshatarët u lejuan të mbanin në oborrin privat bagëti të imta dhe shpendë si dhe prodhimet që nxirrnin nga oborri i tyre. Mbiprodhimi i fshatarëve do të dorëzohej me ato të kooperativave duke u shitur në shtet.
3. Nxitja e punëtorëve nëpërmjet stimujve materialë.

Duhet thënë se ndryshimet që vendosi të ndërmernte Ramiz Alia synonin të shpëtonin komunizmin duke e modifikuar dhe përmirësuar atë. Reformat që u ndërmorën rezultuan sipërfaqësore dhe të destinuara për një varg arsyesish që të dështonin në përmirësimin e situatës. Konservatorizmi dhe burokratët ishin pengesa kryesore për zvarritjen dhe mosrealizimin e reformave. Si rezultat, gjendja ekonomike dhe financiare e viteve 1988 – 1989 ishte shumë e keqe dhe kapërcimi i krizës realizohej vetëm me ndihma nga jashtë. Në vitin 1989, Evropa Lindore u përfshi nga të ashtuquajturat revolucione të kadifenjta. Edhe në Shqipëri do të ndihej frika e ndryshimit të mundshëm nga drejtuesit e lartë politikë. Pavarësisht komenteve nga ana e drejtuesve komunistë për këto ngjarje, tashmë ishte e qartë se që të ruhej pushteti politik duhej zbutur kriza nëpërmjet reformave të thella ekonomike. Kryengritja e përgjakshme antikomuniste në Rumani (25 dhjetor 1989 ku u ekzekutua N. Çausheku dhe bashkëshortja e tij), e detyroi Ramiz Alinë të ndërmernte disa reforma më të thella në funksion të forcimit të regjimit dhe përmirësimit të imazhit të tij.

Në historinë e Shqipërisë, viti 1990 ka qenë një vit i mbushur me ngjarje tepër të rëndësishme. Që në ditët e para të vitit 1990, organet e sigurimit ishin vënë në dijeni për protesta të mundshme kundër regjimit³⁰⁶. Reagimi i parë masiv qytetar ndaj diktaturës nisi në Shkodër më 14 janar³⁰⁷. Për herë të parë u realizua demonstrata e parë kundër pushtetit komunist. Ngjarjet e Shkodrës dhanë sinjal të qartë se situata në vend nuk do të ishte më e qetë derisa të merreshin në konsideratë nga pushteti qeverisës pakënaqësitë e qytetarëve. Më 22 janar të vitit 1990 u mbajt Plenumin i IX të KQ-së të PPSH-së ku u analizuan ngjarjet që kishin përfshirë Evropën Lindore. Në fjalimin e tij përpara Komitetit Qendror, ndër të tjera, Alia fajësoi vendet perëndimore si nxitëse të ndryshimeve që po ndodhnin brenda bllokut Lindor. Ja, si shprehej ai:

“Vendet perëndimore po i nxisin ndryshimet politike në Evropën Lindore. Nën thirrjet për zgjedhje të lira e pluralizëm politik, për krijimin e sa më shumë partive e grupeve të ndryshme, ata kërkojnë të shkatërrohet çdo gjë që mund të kujtojë socializmin. Në propagandën borgjeze, ideali socialist është shpallur anakronik.”³⁰⁸

Alia pranoi se ishin bërë gabime në politikën e ndjekur nga PPSH dhe se këto gabime ishin pasojë e zbatimit të përvojave sovjetike dhe kineze ndaj duheshin realizuar reforma

³⁰⁶ Shiko: B. Fevziu, fq. 227.

³⁰⁷ Afrim Krasniqi, “Fundi i Siberisë Shqiptare, Lëvizja studentore: dhjetor 1990 dhe shkurt 1991”, albin, Tiranë, 1998, fq. 19

³⁰⁸ Gazeta “Zëri i Popullit”, 25 janar 1990.

të pjesshme për demokratizimin e socializmit. Fajësimi dhe gabimet politike të PPSH-së iu faturuan aleancave duke hequr çdo përgjegjësi nga vetja dhe Enver Hoxha. Në këtë kontekst, qëllimi i reformave të ndërmarra ishte vazhdimi i regjimit dhe shmangia e situatave që kishin ndodhur në vendet e tjera komuniste.

Tashmë dalja nga kriza që kishte kapur vendin ishte gati e pamundur dhe ndihmat për Shqipërinë kushtëzoheshin mbi të gjitha nga ndryshime drastike të sistemit politik dhe ekonomik. Përmirësimi i imazhit të vendit kërkonte ndryshime të thella për përfitimin e këtyre ndihmave. Tendenca liberale u shfaqën edhe në shtypin e shkruar duke lënë hapësirë për shkrime që në mënyrë të tërthortë kritikonin regjimi. Kështu, personalitete të njohur si Ismail Kadare, Ylli Popa, Sali Berisha etj. artikulonin nevojën për liberalizim të sistemit dhe kërkesën për më shumë të drejta dhe liri për qytetarët³⁰⁹.

Në sesionin e 7-të të Kuvendit Popullor gjatë datave 7 dhe 8 maj 1990 u miratuan raportin për përsosjen e mekanizmit ekonomik të prezantuar nga kryeministri Adil Çarçani dhe raportin mbi disa ndryshime në Kodin Penal të prezantuar nga zëvendëskryeministri dhe kryetar i Komisionit të Kontrollit të Shtetit Manush Myftiu. Reformat ekonomike ishin sipërfaqësore. Ato synonin më shumë autonomi dhe vetfinancimin e ndërmarrjeve shtetërore. Ndryshimet në legjislacionin penal dhe të tjera i paraprinë ardhjes së vizitës zyrtare të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së Perez De Kuelar. Ato kishin të bënin me shfuqizimin e nenit 55 të kodit penal që kishte të bënte me dënimin për agjitacion e propagandë kundër Pushtetit Popullor dhe ndryshimi i nenit 64 ku tashmë arratisja jashtë Shqipërisë nuk konsiderohej më si “tradhti ndaj atdheut” por quhej “Kalim i kundërligjshëm i kufirit”³¹⁰. Duhet theksuar se nga të dhënat e vitit 1991 rreth 93% e të dënuarve ishin të dënuar politik³¹¹. Gjithashtu, u lejua ushtrimi i fesë, u rikrijua Ministria e Drejtësisë, si dhe institucioni i avokatit.

Më 11 maj 1990, Shqipërinë e vizitoi Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së Perez De Kuelar. Në takim, pala shqiptare shprehu interes për të marr pjesë në mbledhjet e takimet për sigurimin e bashkëpunimit evropian KSBE. Sipas Alisë, “*ne po hidhnim një hap drejt Konferencës së Helsinkit, të cilën deri në atë kohë e kishim refuzuar me vendosmëri.*”³¹² Pavarësisht marrjes së këtyre masave, situata në vend ishte e rënduar. Për historianen Duka, këto lëvizje politike kërkonin të mbanin në këmbë sistemin ekzistues. Ajo shprehet se: “Alia nuk synonte vendosjen e pluralizmit politik dhe të ekonomisë së tregut, madje ai i urrente ato. Reformat e tij ishin një përpjekje për të reformuar stalinizmin dogmatik të trashëguar nga paraardhësi i tij. Vet Alia ka pranuar se “ato (reformat) asnjëherë e në asnjë rast s’i kam konceptuar, si masa që të mund të çonin në zëvendësimin e sistemit, synimi im ka qenë jo përmbysja, por shpëtimi i sistemit”³¹³”. Për rrjedhojë, reformat ramiziste me drejtim nga lart ishin të pjesshme. Kjo është edhe arsyeja pse ato

³⁰⁹ Shiko: Blendi Fevziu, fq. 229-30.

³¹⁰ Shiko:Gazetën “Zëri i Popullit” datë 8 dhe 9 Maj, 1990

³¹¹ Op.cit B Fevziu, fq. 230.

³¹² R. Alia, fq. 335.

³¹³ Op. cit, G. Bakiu. fq. 398.

dështuan³¹⁴.” Kriza ekonomike dhe moszgjidhja e saj çuan vendin drejt ndryshimeve të shumanshme. Në ditët e para të korrikut, vendi u përfshi nga ngjarje të rënda, të cilat tronditën më tej regjimin komunist. Më 2 Korrik, në orët e mbrëmjes, qindra qytetarë kishin rrethuar dhe një pjesë e tyre arritën të hynin në Ambasadën Gjermane. Turma u shpërnda me dhunë nga forcat e rendit³¹⁵. Ky incident u bë precedent që në tri - katër ditët që pasuan mbi 5 mijë qytetarë të Tiranës dhe rrethete të tjera u dyndën në ambientet e ambasadave të vendeve evropiane si të Italisë, Francës, Republikës Federale Gjermane etj. Kriza e ambasadave ishte krisja e parë e madhe që mori regjimi në fuqi.

Në këto rrethana, më 6 korrik u mbajt Plenumi i XI i KQ të PPSH-së. Vendimet e tij rezultuan të padobishme duke agravuar edhe më tej situatën politike në vend. Tensioni social ishte rritur shumë. Në përpjekje për të dalë nga gjendja e rëndë, Alia organizoi më 10 gusht takimin me përfaqësues të inteligjencës së kryeqytetit dhe tri ditë më pas me specialistë të problemeve ekonomike³¹⁶. Mbledhjen me intelektualët, Alia e kërkoi “për të diskutuar me ta mbi zhvillimin e ngjarjeve të kohës, për proceset demokratizuese që po zbatoheshin në vend, si dhe mbi situatën në përgjithësi³¹⁷”. Sipas Alisë, “..asnjë nga intelektualët pjesëmarrës në takim, nuk e shtroi as në parim, jo më për veprim konkret, nevojën e pluripartitizmit³¹⁸”. Ky fakt dëshmon për frikën dhe mungesën e besimit nga përfaqësuesit e inteligjencës së vendit duke ditur shumë mirë se me çfarë regjimi represiv kishin të bënin. Sipas të dhënave, konkluzioni kryesor i takimit ishte vazhdimi i mëtejshëm dhe pa pengesa i masave demokratizuese. Duhet pranuar se pritshmëritë e inteligjencës kundrejt Alisë ishin të mëdha. Një pjesë e tyre besonin se si reformator, Alia, do të vepronte, pa e çuar shoqërinë në tensionet ekstreme drejt pluralizmit politik dhe ekonomisë të tregut. Në atë kohë, vetë Alia pohon se udhëheqja as që nuk e mendonte fare vendosjen e pluralizmit³¹⁹. Mungesa e ndryshimeve në vijën politike rriti zhgënjimin, aq sa shkrimtari i njohur Ismail Kadare vendosi që më 25 tetor të largohej përfundimisht nga vendi duke kërkuar strehim politik në Francë³²⁰. Në deklaratën e tij, ai pranon se nevojat për demokratizimin e thellë dhe të plotë të vendit ishin urgjente dhe se premtimet e dhëna nga Alia nuk u mbajtën duke rritur zhgënjimin dhe pakënaqësinë tek shumë shqiptarë³²¹. Me largimin e Kadesës, opinion publik u nda me dysh; një pjesë e mbështeti veprimin e Kadesës, ndërsa një pjesë tjetër e dënoi atë. Ky qëndrim vuri në dukje krisjen e madhe që po kristalizohej brenda shoqërisë shqiptare. Përkeqësimi i situatës në vend gjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 1990 kishte rritur dukshëm presionin

³¹⁴ V. Duka, fq. 311.

³¹⁵ Për të ndaluar turmën e qytetarëve që të mos hynte në ambasadë policia qëllon me armë zjarri, si pasojë humbi jetën një djalë 16-vjeçarë dhe 6 të tjerë mbetën të plagosur rënd, shiko: B.Fevziu fq. 233.

³¹⁶ Xhelal Gjeçovi, Paskal Milo..., “Historia e popullit Shqiptar, IV Shqiptarët gjatë luftës së dytë botërore dhe pas saj 1939-1990”, Toena, Tiranë, fq. 357.

³¹⁷ Ramiz Alia, “Jeta Ime, Kujtime”, Toena, Tiranë, 2010, fq. 341-2.

³¹⁸ Ibid., fq. 343.

³¹⁹ Shiko: B. Fevziu, fq. 237.

³²⁰ Ibid, fq. 238-40.

³²¹ Shiko: Gazeta “Rilindja Demokratike” datë 5 Janar 1991.

mbi drejtuesit komunistë. Në këto rrethana, regjimi komunist po humbte gjithnjë e më shumë autoritetin në popull. Me gjithë situatën e krijuar dhe incidentet e ndodhura, regjimi komunist e mori goditjen më të madhe nga protestat studentore.

Më 8 dhjetor 1990, studentët e Universitetit të Tiranës nisën protestën e parë në qytetin “Studenti”. Fillimisht, protesta nisi me pretendime ekonomike dhe kushte më të mira në mjediset ku ata jetonin. Në mbremje vonë, një përfaqësi e grupit të studentëve kishte kërkuar takim me numrin një të regjimit z. Ramiz Alia. Kërkesa e tyre u pranua dhe takimi u realizua rreth orës 01.30³²². Gjatë bisedimeve me Alinë, ata shfaqën shqetësimet e tyre, ndërkohë që u ra dakort që të zgjidhej një përfaqësi, e cila do të takohej me të për bisedime të mëtejshme ditën e hënë pasdite, me kusht që ata të shkonin në shkollë. Pas përfundimit të takimit, përfaqësia studentore arriti tek protestuesit. Ndërkohë ministri i Brendëshëm kishte dhënë urdhër për shpërndarjen e protestës duke shënuar një incident dhune. Kjo ngjarje bëri që situata të acarohet më tej. Protesta e studentëve u përshkallëzua dhe brenda “natës”, ajo kaloi në kërkesa politike duke insistuar për lejimin e pluralizmit politik në vend. Kjo ishte një lëvizje që kundërshtoi hapur politikën e shtetit dhe të Partisë, ndaj dhe roli i saj ishte i madh.

Më 9 dhjetor, si pasojë e vijimit të protestës, Alia kërkoi të takonte mjekun Sali Berisha³²³. Sipas dëshmisë së Alisë, kontaktin e parë me Berishën e ka patur në spitalin e Parisit ku ai ndodhej me grupin e mjekëve tek H. Kapo. Në takimin e datës 9 dhjetor me Sali Berishën në shtëpinë e tij (rreth orës 18.00-19.00), sipas Alisë, ai i kërkoi që ky i fundit të vijonte bisedimet me studentët duke qënë se 2 ose 3 prej përfaqësuesve të studentëve ishin nga Tropoja³²⁴ dhe ndoshta Berisha mund ta gjente më lehtë gjuhën e dialogut me ta.

Por, këtë argument e hedh poshtë Shinasi Rama, një nga protagonistët kryesorë të Lëvizjes Studentore, kur pohon se:

“Kjo është një përrallë që i duhej Sali Berishës dhe Ramiz Alisë për me justifikue lojën e tyre e në rradhë të parë, futjen e Berishës në lojë, kinse si ndërmjetësi i Ramiz Alisë me “tropojanët” sepse, për to, ne të tjerët nuk duhej të ekzistonim. Prandaj, edhe e kanë trumbetuar pa u lodhur tash sa vjet³²⁵”.

Në mbremje, midis tyre pati një takim të dytë, i cili sipas Alisë “... ishte takimi i fundit me S. Berishën si ish-anëtar i Partisë së Punës³²⁶. Sipas regjistrit hyrës të KQ, ky takim i dytë midis Alisë dhe Berishës ndodhi të nesërmen rreth orës 11.00 dhe jo sipas rrëfimit të Alisë³²⁷.

³²² Shiko: intervista me titull “Une Ramiz Alia, dëshmoj historinë time”. Në Sokol Balla, “33, Tranzicioni në Intervistë”, UET Press, Tiranë, 2010, fq. 153.

³²³ Shiko: B. Fevziu, fq. 246.

³²⁴ Ramiz Alia, “Jeta Ime, Kujtime”, Toena, Tiranë, 2010, fq. 361.

³²⁵ “Gazeta Shqiptare”, 5, Nëntor, 2006, fq. 18.

³²⁶ Ibid, (Alia).

³²⁷ Cituar në: B. Fevziu, fq. 247.

Nga protagonistët dhe materialet për zbardhjen e atyre ngjarjeve, ata që kanë dëshmuar i kanë mëshuar pak a shumë versionit të sipërpërmendur. Por ka edhe nga ata që tregojnë version ndryshe të ngjarjeve. Pa vënë në diskutim rëndësinë e kësaj lëvizjeje, pikëpyetja që lidhet me këto ngjarje është fakti nëse ka qenë ose jo i implikuar regjimi në organizimin dhe përdorimin e studentëve? Studenti i dhjetorit z. Shinasi Rama aludon se lëvizja studentore ka qenë e orkestruar dhe e organizuar nga regjimi. Ja si shprehet ai:

“..Pika kyçe këtu është se studentët atë natë nuk e dinin se çfarë të kërkonin. Ato u takuan në mes të natës për një orë me presidentin Ramiz Alia por nuk kishin as edhe një kërkesë të mirëfilltë politike për t'i parashtruar. Për më tepër ato ishin kaq të nënshtruar dhe me respekt karshi tij sa që Alia e ndjeu të nevojshme të jepte urdhrat që të rriheshin mirë në mënyrë që fitonin ndërgjegjësimin e nevojshëm politik por jo me shume se duhej. Qëllimi ishte, natyrisht që t'i shtynte studentët që të fillonin të mendonin ndryshe, intelektualët të fitonin kohë, dhe që mekanizmat të viheshin në punë si duhet. Pra, udhëheqja më e lartë e partisë, e cila çuditërisht kishte ndenjur zgjuar gjithë natën, e dinte se studentët ishin konfuzë dhe nuk dinin se çka donin...”³²⁸”

Nga sa më lart, një gjë dihet me siguri se mosndërhyrja e forcave të rendit që në fillimet e kësaj proteste lë shteg për të menduar se këto veprime në atë kohë dhe për atë regjim ishin të pajustificueshme.

Më tej, analiza e Ramës vazhdon duke implikuar edhe figura politike, të cilat në këto 23 vite kanë qenë protagonistët kryesorë të tranzicionit në Shqipëri. Ja, si shprehet ai:

“..Gjithashtu, shumë kujdes u tregua për të kultivuar disa njerëz të besueshëm si udhëheqës të studentëve. Në fakt, zgjedhjet ishin bërë me kohë se kush do të ishin “liderët” e studentëve dhe kjo ishte krejtësisht në rrjedhën normale të gjërave. Disa pedagogë të rinj filluan të përziheshin por shumica qëndruan në konviktet e tyre të bindur se kjo ishte “loja” për të cilën flitej tash një muaj. Në mënyrë direkt dhe të drejtpërdrejtë, Sali Berisha, i dërguar aty prej Xhelil Gjonit dhe i shoqëruar nga një i punësuar në Institutin e Studimeve Marksiste-Leniniste të Nexhmije Hoxhës, e njëkohësisht sekretar i KQ të BRPSH, Besnik Mustafaj, u dërguan që të qëndronin mbrapa ndërtesës së tashme të Ambasadës të SHBA. Berisha duhej të merrte udhëheqësinë e studentëve dhe të bëhej lideri intelektual për të cilin regjimi kishte kaq shumë nevojë. Jo vetëm që këto të dy nuk u arrestuan por ruheshin edhe me operativë civile në distancë.”³²⁹”

³²⁸Shinasi Rama tregon ndryshe Lëvizjen Studentore të '90-s, <http://www.shqipëria.com/lajme/lajm/nr/9375/Shinasi-Rama-tregon-ndryshe-Lëvizjen-Studentore-të-90-s>

³²⁹ Ibid.

Një ditë më pas, lëvizjes studentore iu bashkuan edhe shumë kryeqytetas si dhe të ardhur nga qytete si Shkodra e Kavaja. Tashmë, nëse nga drejtuesit komunistë nuk veprohej shpejt, situata mund të dilte jashtë kontrollit. Studentët kërkonin takim me Alinë, në të kundër kërcënonin me grevë dhe protesta. Takimi me një përfaqësi të gjerë studentësh u la më 11 dhjetor në orën 18:00 në Pallatin e Brigadave. Po atë ditë u mbajt Plenumi i XIII i Komiteti Qendror të PPSH-së ku ndër të tjera, u miratua vendimi për shpalljen e pluralizmit politik në pikën e 5-të të vendimit si mëposhtë:

“Plenumi shprehu mendimin se, është në dobi të demokratizimit të mëtejshëm të jetës së vendit dhe të pluralizmit, krijimi i organizatave politike të pavarura, në përputhje me ligjet në fuqi³³⁰”

Vendimet e marra në Plenum iu bënë të ditura përfaqësisë të studentëve në takim. Ky vendim i hapte rrugë ndryshimeve të mëdha shoqërore, sepse nëpërmjet formimit të subjekteve të tjera politike bëhej i mundur kalimi nga rendi socialist drejt rendit të demokracisë liberale. Regjimi komunist nuk kishte lejuar për 45 vite asnjë formë organizimi përtej strukturave partiake dhe shtetërore. Shqipëria ishte ndoshta i vetmi vend në Evropën Qendrore dhe Lindore që nuk kishte asnjë formë sado primitive të disidencës apo mendimit të lirë. Ky vendim i dha fund monizmit në vend. Një ditë më pas, më 12 dhjetor 1990 u formua Partia Demokratike. Në programin e saj minimal parashikohej pluralizmi politik, reforma drejt ekonomisë së tregut, pavarësi të pushteteve, garantimi i lirive dhe të drejtave të njeriut dhe çka është më e rëndësishmja bashkëpunim të ngushtë me vendet e Evropës Perëndimore dhe SHBA dhe aderimin e vendit në organizma ndërkombëtarë si Komuniteti Evropian (BE) sot, Këshillin e Evropës, dhe në NATO³³¹. Me gjithë veprimet e ndërmarra nga partia në pushtet, gjendja ishte tejet e rënduar. Vendi nisi të përfshihej nga një valë e gjatë trazirash dhe demonstratash qytetare duke çuar brenda një kohe të shkurtër në rrëzimin nga pushteti të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Mënyra e ndërrimit të sistemit politik në Shqipëri ka ndezur përherë diskutime. Çështja që ngrihet këtu lidhet me faktin nëse ky ndryshim erdhi si rezultat i organizimit dhe drejtimit të tij nga lartë apo si pasojë e protestave qytetare nga poshtë? Duke pranuar faktin që regjimi komunist shqiptar ishte një regjim i izolimit ekstrem asnjë nga të dy kushtet e lartëpërmendura në rastin Shqiptar nuk mund të qëndrojë i vetëm. Pse? Sepse që ndërrimi i sistemit politik të ishte pasojë e protestave spontane duhej që të paktën të kishte element disident dhe intelektualë reformatorë në gjirin e shoqërisë së saj. Nga të gjitha vendet e bllokut ish-komunist, vetëm Shqipëria nuk kishte një lëvizje disidente, madje dhe hapësira për shkrime kundër regjimit (gjatë vitit 1990) u ‘improvizua’ nga vetë regjimi, që, duke parë ndryshimet e pakthyeshme në vendet e Lindjes kërkoi që të manaxhonte si hapjen e sistemit dhe kanalizimin e protestës qytetare. Nga ana tjetër, ndërrimi i sistemit politik në Shqipëri nuk ishte vetëm produkt i drejtuar nga lartë. Po

³³⁰ R. Alia, fq. 363.

³³¹ Xhelal Gjeçovi., fq. 361-2.

kështu, duke pranuar faktin që regjimi komunist shqiptar ishte një nga regjimet ekstremisht të egër e brutal, urrejtja dhe kundërshtimi ekzistonin në shumë shtresa të shoqërisë, të cilat prisnin vetëm rastin për të shpërthyer. Në rastin e Shqipërisë, të dyja këto forma ndikuan dhe bënë të mundur pluralizmin politik në vend.

2.3.1 Shqipëria në prag të viteve ‘90, fundi i regjimit komunist

“Komunizmi doli nga skena, por jo sfiduesit e rrezikshëm të demokracisë”³³²”

Ngjarjet që përshkuan dhjetorin e vitit 1990 ishin të një rëndësie të madhe historike. Jehona e këtyre ngjarjeve dhe zhvillimet pozitive në vend, nuk mbetën jashtë vëmendjes së ndërkombëtarëve. Arritja e pluralizmit politik dhe krijimi i Partisë Demokratike, të të parës parti opozitare në vend dhe subjekteve të tjera politike nxorri në pah ëndrrën evropiane të shqiptarëve. Më 9 janar, Komisioni Politik i Bashkimit Evropian mbajti rezolutën e parë lidhur me ngjarjet e ndodhura në Shqipëri. Në këtë dokument, Bashkimi Evropian “përshëndet studentët dhe lëvizjen e tyre, legalizimin e partive politike dhe dëshirën për të ecur drejt demokracisë”, si dhe theksonte “mbështetjen ndaj proceseve demokratike në vend”³³³. Dhënia e këtij lajmi nga mjetet zyrtare të informimit publik pothuajse u shmang krejt. Pavarsisht kësaj, ky akt mbetet përpjekja e parë e BE-së drejt “popullit të harruar dhe të lënë jashtë vëmendjes në më të shumtën e herës, ku shkak ka qënë vetizolimi i tij i gjatë i imponuar nga regjimi në fuqi”³³⁴.

Fillimi i vitit 1991 e gjeti Shqipërinë të mbërthyer nga grevat në të gjitha minierat dhe sektorët e transportit publik³³⁵. Të dhënat tregojnë se sektorët e ekonomisë ishin tërësisht drejt falimentimit dhe se problemet socio politike ishin bërë shumë të mprehta. Vendimi për grevë të përgjithshme u mor nga Sindikatat e Pavarura, të cilat ishin krijuar pas shpalljes së pluralizmit politik. Që në muajin dhjetor të vitit 1990, ishte caktuar data 10 shkurt për zgjedhjet e përgjithshme të Kuvendin Popullor, dhe mbajtja e grevave e kishte rënduar edhe më shumë gjendjen politike. Për opozitën e re, koha në dispozicion ishte e pamjaftueshme për realizimin e fushatës zgjedhore, ndaj, ajo kërkoi shtyrje të datës së zgjedhjeve. Në rastin se, kjo kërkesë nuk do të merrej parasysh, opozita kërcënonte me mospjesëmarrje në zgjedhje. Në këto kushte, qeveria u detyrua të ndryshonte datën e tyre duke i caktuar përfundimisht më 31 mars³³⁶.

³³² Robert Kagan, *“Rikthimi i historisë dhe fundi i ëndrrave”*, Dudaj, Tiranë, 2008.fq. 65.

³³³ Op.cit në Afrim Krasniqi, *“Fundi i Siberisë Shqiptare, Lëvizja studentore: dhjetor 1990 dhe shkurt 1991”*, albin, Tiranë, 1998.fq.191-2

³³⁴ Ibid.

³³⁵ M. Vickers, fq. 341.

³³⁶ Ibid.

Në 14 shkurt 1991, në Partinë Demokratike u zhvilluan zgjedhjet për kryetarin e partisë. Në garën për kreun e PD-së ishin katër kandidatura, Sali Berisha, Gramoz Pashko, Aleksandër Mexsi dhe Azem Hajdari. Brenda Partisë Demokratike lufta për pushtet ishte bërë e ashpër. Pas votimit, kryetar i Partisë Demokratike zgjidhet Sali Berisha me 9 vota ndërsa kandidatët e tjerë morën përkatësisht: Pashko 5 vota, Mexsi 4 vota dhe Hajdari 1 votë³³⁷. Polemikë që shoqëruan këtë ngjarje kanë qenë të mëdha. Gjatë gjithë këtyre viteve ka patur shumë zëra se Berishën në krye të Partisë Demokratike e “vendosi” Alia dhe se rezultati ishte i paracaktuar. Sipas dëshmisë së Alisë ky hamendësim “është një absurditet, një fantazi e njerëzve naivë³³⁸” duke e mohuar një hipotezë të tillë. Por, duhet thënë se nga ana tjetër, ai pranon se:

“Duke pasur parasysh, se Berisha ishte njeri me kulturë, unë mendoja se ai, në rradhën e drejtuesve të tjerë të PD-së, mund të ishte njeriu me të cilin mund të bisedoje dhe të merreshe vesh... Unë besoja se ai nuk do lejonte që PD të shkonte pas “rrugës”, por do ndihmonte që tranzicioni, të kalonte me sa më pak dhimbje... Por, jeta tregoi se u gabova.”³³⁹

Dilema dhe paqartësi rreth hipotezave të kësaj natyre do të mbeten ende. Ajo që dimë me siguri është, se ndërkohë, Alia kishte nisur reformimin e Partisë së Punës. Në këtë rast është pranuar se ishte Alia, ai, që përzgjodhi figurën e Fatos Nanos në krye të PPSH-së. Ja, si shprehet vetë Alia për figurën e Nanos: *“F. Nano ka qënë një nga kuadrot e rinj, të cilin e kam vlerësuar, e kam mbajtur pranë dhe i kam besuar në misionet që i kam ngarkuar... kam parë tek F. Nano një kuadër të aftë dhe të përgatitur. Dhe për këtë arsye, e kam mbajtur pranë dhe më pas, edhe e kam “rekomanduar” në poste të larta qeveritare...”³⁴⁰*. Në fillim Nano, një ekonomist i spikatur, u emërua Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe brenda gjashtë muajsh ai do bëhej figura kryesore e trashëgimisë së Alisë³⁴¹.

Në javën e parë të shkurtit, vendi u përfshi nga trazira të tjera të mëdha. Fillimisht, studentët e Institutit të Lartë Bujqësor e më pas studentët e Universitetit të Tiranës bojkotuan mësimin duke paraqitur disa kërkesa ekonomike. Bojkotimi i mësimit do të vazhdonte deri në plotësimin e kërkesave të paraqitura, në të kundërt ata do të përshkallëzonin qëndrimin e tyre deri me grevë urie. Gjithashtu, studentët e UT shtuan edhe kërkesën për heqjen e emrit të “Enver Hoxhës” nga Universiteti i Tiranës. Nga këto zhvillime të reja reagimi i drejtuesve të PPSH-së ishte heshtja. Më 18 shkurt, studentët e Tiranës filluan grevën e urisë në ambjentet e Kinoteatrit Studenti³⁴². Ky akt, tërhoqi vëmendjen e të gjithë opinionin publik dhe brenda dy ditëve, grevës së studentëve iu shtuan për solidarizim edhe grupe të tjera si nxënës të shkollave të mesme, puntorë të

³³⁷ Blendi Fevziu, *“Piedestale pa statuja, 8 dhjetor 1990-31 mars 1991”*, UET Press, Tiranë, 2011, fq. 143.

³³⁸ R. Alia, fq. 373.

³³⁹ Ibid.

³⁴⁰ R. Alia, fq. 405.

³⁴¹ Shiko: B. Fevziu, (100 vjet, 1912-2012), fq. 252.

³⁴² B. Fevziu, fq. 253.

kryeqytetit si dhe të ardhur nga Kavaja, Durrësi etj. Më 20 shkurt, mbi 100 mijë vetë³⁴³ kishin braktisur punën dhe ishin bashkuar së bashku në një miting në mbështetje të studentëve. Kjo ishte dhe dita kur u përmbys monumenti i diktatorit Enver Hoxha, i vendosur në qendër të kryeqytetit. Si pasojë e këtyre ngjarjeve, qeveria nxori vendimin për heqjen e emrit të “Enver Hoxhës” nga Universiteti duke përfunduar në këtë mënyrë edhe greva e urisë. Më 21 shkurt, Presidenti Alia, shpërndau qeverinë e Adil Çarçanit dhe kryemistër u vendos Fatos Nano. Situata deri në fund të shkurtit vijoi e tensionuar, mitingjet e opozitës pasoheshin nga antimitingjet e pozitës.

Sërish, edhe muaji mars filloi me një ngjarje të rëndë që në histori njihet si eksodi i marsit. Vendi ndodhej në prag të kolapsit ekonomik. Statistikat tregonin se në fillim të viteve 90’ papunësia arrinte në 113.000 vetë ose 7,24% e numrit të përgjithshëm të punonjësve³⁴⁴. Varfëria dhe kushtet mjerane në të cilat ndodhej pjesa dërrmuese e popullsisë kishte rritur dukshëm pakënaqësinë. Mjafton të përmendim faktin se 3.182.417³⁴⁵ banorë që kishte vendi në vitin 1989 jetonin në 441,236 apartamente dhe banesa të ngritura në të gjithë vendin, për të kuptuar padurimin e këtyre njerëzve për t’u larguar nga atdheu³⁴⁶. Vetëm brenda pak ditëve nga data 6 deri në datën 8 mars u larguan nga vendi në drejtim në Italisë e gjetkë rreth 25 mijë qytetarë. Ndër të tjera, arsyet që i detyronin shqiptarët për t’u larguar nga vendi vinin dhe si pasojë e destabilizimit dhe pasigurisë në rritje.

Ashtu siç ishte vendosur edhe më parë, më 31 mars 1991 u mbajtën zgjedhjet e përgjithshme për në Kuvendin Popullor. Ato do të realizoheshin sipas sistemit mazhoritar ndërsa vendi ishte ndarë në 250 zona elektorale. Për herë të parë pas më shumë se gjysmë shekulli, në vend po zhvilloheshin zgjedhje pluraliste. Gjatë gjithë muajit mars, fushata zgjedhore midis subjekteve politike u zhvillua e ashpër. Premtimet, mitingjet, aktivistët partiakë kishin krijuar një polarizim ekstrem të elektoratit³⁴⁷.

Pikat kryesore të fushatës së Partisë Demokratike zhvilloheshin rreth sulmit ndaj së kaluarës dhe sundimit komunist, premtime për ndryshimin e standardeve dhe kushteve të jetesës, anëtarësimin e vendit në Këshillin e Evropës etj. Në fushën ekonomike, Partia Demokratike do të punonte për krijimin e mekanizmave të ekonomisë së tregut. Kjo përcaktohej në fund të nenin 6 të Programit Minimalist ku ndër të tjera thuhej: “*Ajo lufton për reforma të thella ekonomike duke ristrukturuar ekonominë në një ekonomi tregu me një shumëllojshmëri formash prone të sanksionuara me ligj dhe integrim sa më të shpejtë të ekonomisë së vendit në Bashkësinë Evropiane.*”³⁴⁸

³⁴³ Ibid, fq. 254.

³⁴⁴ Shiko: Ilir Gadeshi, Hekuran Mara., (1999) “*Emigrimi i Elitës intelektuale nga Shqipëria gjatë periudhës së tranzicionit*”, Luarasi, Tiranë, fq. 14-5.

³⁴⁵ sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 1989, burimi INSTAT

³⁴⁶ VJETARI STATISTIKOR I R.P.S. TË SHQIPËRISË, Tiranë, 1989, fq. 103, (shifra e dhënë është llogaritur duke bërë totalin e të dhënave deri në vitin 1988)

³⁴⁷ Blendi Fevziu, “*Piedestale pa statuja, 8 dhjetor 1990-31 mars 1991*”, UET Press, Tiranë, 2011, fq. 222.

³⁴⁸ Aleksandër Meksi, “*Dhjetor ’90 Dokumente dhe Materiale*”, UET Press, Tiranë, 2010, fq. 91.

Në votime morën pjesë rreth 97% e 1.9 milion shqiptarëve me të drejtë vote³⁴⁹. Nga rezultati përfundimtar i zgjedhjeve fituese doli sërish Partia e Punës me 169 deputetë ose 67.6%. Ky rezultat ishte pasojë e mbështetjes që gëzonte kjo forcë kryesisht nga fshatarësia e vendit. Pothuajse të gjitha qendrat urbane u fituan nga Partia Demokratike e cila kishte marrë 75 deputetë ose 30%. Në kryeqytet, pothuajse të gjitha mandatet e deputetëve ishin fituar prej Partisë Demokratike, përjashtuar këtu zonën ku kandidonte Kryeministri Nano, i cili e fitoi mandatin në raundin e dytë të zgjedhjeve. Nga subjektet e tjera pjesëmarrëse në zgjedhje Omonia fitoi 5 deputet ose 2% dhe veteranët 1 deputet. Presidenti i vendit, Ramiz Alia, humbi në zonën e tij elektorale, ndërsa kryetari i PD-së fitoi në qytetin e Kavajës me 83% të votave³⁵⁰. Vëzhguesit ndërkombëtarë raportuan se zgjedhjet ishin të ndershme dhe se mashtrimet dhe manipulimet ishin minimale. Ata arritën në përfundimin se “fitorja e PPSH-së ishte më së shumti pasojë e mungesës së një kulture politike të zhvilluar dhe informimit³⁵¹.”

Realizimi i zgjedhjeve nuk e qetësoi situatën përkundrazi ngjarjet që pasuan e përkeqësuan edhe më tej atë. Shumë prej mbështetësve të Partisë Demokratike u zhgënjyen nga rezultati i zgjedhjeve, pasi pritshmëritë për fitore ishin të mëdha. Në shenjë proteste, më 2 prill në qytetin e Shkodrës u organizua një manifestim proteste kundër PPSH duke pretenduar se zgjedhjet nuk kishin qenë të rregullta³⁵². Situata kishte precipituar dhe policia kishte përdorur armët e zjarrit mbi turmën duke vrarë 4 vetë dhe plagosur shumë të tjerë. Ngjarja e Shkodrës tensionoi situatën politike në vend. Më 10 prill u zhvillua seanca e parë parlamentare dhe deputetët e Partisë Demokratike e bojkotuan atë, si kusht vunë zbulimin e shkaktarëve të vrasjeve të 2 Prillit. Bojkoti i parlamentit vijoi për dy javë. Më 25 prill, me iniciativë të Partisë Demokratike u zhvleftësua Kushtetuta e vitit 1976, dhe tashmë jeta në vend do të rregullohej nga Paketa Kushtetuese deri në miratimin e Kushtetutës së Re. Më 30 prill, Kuvendi Popullor me 2/3 e votave³⁵³ zgjodhi President të Republikës Ramiz Alinë, opozita votoi kundër. Në përputhje me paketën kushtetuese, Alia tashmë president, dha dorëheqjen nga postet që gëzonte në Partinë e Punës. Më 13 maj, kuvendi votëbesoi F. Nanon si kryeministër dhe kabinetin e tij. Pak ditë më vonë Sindikatat e Pavarura të Shqipërisë ashtu siç kishin paralajmëruar më herët nisnin një grevë të përgjithshme. Situata në vend u acarua së tepërmi. Ndër kërkesat e tjera si rritje pagash 100% apo kushte më të mira pune, grevistët kërkonin edhe dorëheqjen e kabinetit Nano. Në këto kushte më 4 qershor 1991, qeveria Nano dha dorëheqjen³⁵⁴. Ky veprim i hapi rrugë bashkëpunimit me forcat opozitare ku për të mirën e vendit u krijua një qeveri me bazë të gjërë e cilësuar si “Qeveria e Stabilitetit”. Si pasojë e situatave të reja politike në vend, udhëheqja më e lartë e PPSH

³⁴⁹ M. Vicker, fq. 347.

³⁵⁰ Shiko: B. Fevziu (100 vjet, 1912-2012), fq. 262-3.

³⁵¹ Vicker, fq. 348.

³⁵² R. Alia, fq. 390.

³⁵³ Sqarim: Në këtë votim deputetët e kuvendit votuan pro kandidaturës së R. Alisë me 172 vota dhe për kandidaturën e N. Dokles vetëm dy vota.

³⁵⁴ R. Alia, fq. 408.

do të duhej që të vendoste përfundimisht nëse kjo parti do të reformohej për t'iu përgjigjur sfidave të reja apo do shpërndahej e të largohej nga jeta politike e vendit. Kësaj dileme iu dha zgjidhje gjatë punimeve të Kongresit të X të Partisë së Punës të Shqipërisë në datat 10 deri më 13 qershor 1991. Punimet e këtij Kongresi u shoqëruan me diskutime të ashpëra ndërmjet reformatorëve që kërkonin ndryshime rrënjësore dhe konservatorëve, të cilët i refuzonin ato. Në këtë kongres u morën vendime shumë të rëndësishme sidomos për distancimin nga trashëgimia e Hoxhës. Mes shumë diskutimesh, më 12 qershor 1991, kongresi miratoi vendimin për ndryshimin e emrit të Partisë së Punës në Partia Socialiste e Shqipërisë, me statut dhe programi të ri.

Qeveria e Stabilitetit ishte rezultat i marrëveshjes midis forcave politike për bashkëqeverisje deri në stabilizimin e vendit. Partia e Punës mbajti 12 postet ministore, Partia Demokratike 7 poste dhe 5 poste ministore u ndanë ndërmjet Partisë Republikane, Partisë Socialdemokrate dhe Partisë Agrare³⁵⁵. Kryeministër i saj u zgjodh Ylli Bufi ndërsa zëvendëskryeministër Gramoz Pashko. Në hapat e para të tranzicionit, vështirësia kryesore ishte ekonomia. Për nxjerrjen e vendit nga kriza, qeveria e re do të përkrahte propozimin e Gramoz Pashkos për aplikimin e “Terapisë së shokut”³⁵⁶. Qeveria, shpalli një program reformash, që parashikonte privatizimin e ndërmarrjeve të vogla, liberalizimin e çmimeve, heqjen e shumë kufizimeve në tregtinë e jashtme dhe zhvillimin e një sistemi të ri financiar³⁵⁷. Ndër vendimet e para të qeverisë ishin rritja e pagës së punonjësve shtetërorë me 15-18 %, rihetim për vrasjet e 2 Prillit etj³⁵⁸. Qeveria e stabilitetit funksionoi për një periudhë 6 mujore dhe ndikimet e saj për përmirësimin e situatës në vend ishin minimale. Ka patur shumë kritika dhe akuza për mënyrën se si u menaxhua dhe u qeveris vendi gjatë këtyre muajve. Sipas Biberajt:

Në kohën e qeverisë së koalicionit ishin privatizuar rreth 30,000 njësi të vogla. Por shumica e këtyre njërive ishin bërë pronë e anëtarëve të nomenklaturës, të cilët kishin ditur të shfrytëzonin postet, lidhjet, aftësitë dhe përvojën për të shtënë në dorë pasurinë shtetërore kur filloi qeveria e Ylli Bufit procesin e privatizimit. Ndërsa po humbnin gradualisht pushtetin politik, komunistët po siguronin pushtetin ekonomik. Ishte shumë e përhapur pakënaqësia që nomenklatura po pasurohej në kapitalizëm³⁵⁹.

Pjesa më e madhe e programit mbeti e pazbatuar, ndaj Shqipëria nuk mundi të ecte përpara drejt reformës. Mungesa e rendit dhe e sigurisë në vend vijoi të ishte një shqetësim. Vendi u përfshi nga një valë shkatërrimesh në shkallë të gjerë e pronës publike, ndërsa qeveria u tregua e paaftë që të ndalonte çrregullimin e përgjithshëm. Më 6 dhjetor 1991, kryeministri Ylli Bufi dha dorëheqjen si pasojë e daljes nga koalicioni i Partisë Demokratike. Më herët, Këshilli Kombëtar i Partisë Demokratike (26 nëntor)

³⁵⁵ Ibid.

³⁵⁶ Fevziu (100 vjet, 1912-2012), fq. 264.

³⁵⁷ Elez Biberaj, fq. 166-7.

³⁵⁸ Ibid., (Vikers)

³⁵⁹ Elez Biberaj, fq. 174.

kishte vënë kushte për vijimin e mëtejshëm të bashkëqeverisjes me socialistët. Ndër kërkesat kryesore të PD-së mund të përmendim: përcaktimi i zgjedhjeve të parakohëshme brenda muajit shkurt, vënia përpara drejtësisë e vrasësve të 2 Prillit, si dhe arrestimi i Nexhmije Hoxhës etj. Koha për përmbushjen e këtyre kërkesave u la data 4 dhjetor. Në mesditën e 4 dhjetorit, Kryetari i Partisë Demokratike zyrtarizoi vendimin për largimin nga koalicioni qeverisës. Drejtimi i vendit deri në zgjedhjet e parakohëshme të 22 marsit do të bëhej nga një qeveri teknike e drejtuar nga Vilson Ahmeti. Deri në atë datë ndryshimi i pushtetit ishte vetëm një hap larg.

2.4 Dallime dhe përbashkësi të regjimit komunist shqiptar me Bllokun Lindor

Një krahasim midis komunizmit shqiptar me komunizmin e vendeve të tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore paraqitet i mundshëm, edhe pse, sipas pikëvështrimit tonë, ky krahasim nuk kryen tjetër funksion përveç evidentimit edhe më tepër të tipareve dalluese të diktaturës në Shqipëri. Përse shihet e udhës një analizë e tillë? Siç vë re edhe profesor Angjeli, fillimi i tranzicionit e gjeti Shqipërinë një vend me tipare të ngjashme me vendet e bllokut lindor, veçanërisht me vendet komuniste që sot njihen si vendet e Evropës Juglindore, pavarësisht kësaj, *“Shqipëria shfaqti edhe veçori që e dallojnë atë nga vendet e tjera ish-komuniste, si vendi më pak i përgatitur nga pikëpamja ekonomike, politike, sociale e kulturore për të ndërmarrë reforma rrënjësore drejtë ekonomisë së tregut.”*³⁶⁰

Duke mbajtur në konsideratë faktin që zbatimi i ideve socialiste u realizua në vende me nivele të ndryshme zhvillimi ekonomike, dhe karakteristika të veçanta historike e politike, rrugëtimi drejtë komunizmit nuk do të ishte i njëjtë. Kështu, në rrugën socialiste u futën vende të mëdha si Bashkimi Sovjetik apo Kina dhe vende të vogla si Shqipëria, vende të zhvilluara nga pikëpamja industriale si Çekosllovakia dhe vende ku bujqësia përbënte sektorin kryesor të ekonomisë, vende me një nivel kulturor të përparuar dhe vende ku analfabetizmi ishte masiv etj³⁶¹.

Në këtë kontekst, tiparet e përbashkëta midis këtyre vendeve gjenden në natyrën thelbësisht të përbashkët të totalitarizmit socialist. Regjimet e vendeve të bllokut të lindjes karakterizohen nga politizimi i tejskajshëm i shoqërisë, politika e dhunës dhe terrorit, monopoli politik i partisë komuniste apo të punës, shtetëzimi pothuajse total i mjeteve të prodhimit, politika ekonomike e prodhimit e planifikuar, armiqësia me vendet e perëndimit dhe tendencat e izolimit si mjet represiv i brendshëm etj. Pikat e përbashkëtat, në fakt, janë tepër të pakta po të analizojmë veçantitë e secilit vend në mënyrën e zbatimit praktik të ideologjisë komuniste. Duke qenë se kjo trajtesë nuk është

³⁶⁰ Anastas Angjeli, *“Ditari i Tranzicionit Ekonomik”*, Toena &UMSH Press, Tiranë, 2013, fq. 26

³⁶¹ Alia, R. Benakis, Th. *“Duke biseduar për Shqipërinë”*, Kurier Ekdotiki, Athinë,

objektiv i kësaj teme, por na shërben në analizën tonë, ne gjujkojmë të ndalemi shkurtimisht në disa prej tyre.

Së pari: *Embrionizmi stalinist i komunizmit shqiptar*.

Ndryshe nga vendet e tjera të lindjes ku stalinizmi u imponua dhunshëm, në vendin tonë ai shfaqet si fenomen që në themelimin e Partisë Komuniste, dhe vijoi deri në largimin e saj nga pushteti. Kjo tezë, bazohet në eliminimet sistematike të figurave më të larta të Partisë ndër vite. Është fakt, që asnjë nga antarët që themeluan Partinë Komuniste, përveç Enver Hoxhës, nuk arriti të mbijetonte. Eliminimi pothuajse i plotë i kuadrove të Luftës Nacional-çlirimtare, dëshmon qartë për rrugëtime të ngjashme të Stalinit dhe Hoxhës drejt pushtetit. Eliminimi i zërave ndryshe brenda partisë komuniste bëhej nëpërmjet etiketimeve demaskuese si: fraksionist, oportunist i djathtë, deviacionist, trockist, sektarist i majtë etj. Ky shembull tregon aplikimin dogmatik stalinist. Ndryshe nga udhëheqja komuniste ruse, e cila metoda të tilla i zbuti pas vdekjes së Stalinit (në vitin 1953), shoqëruar kjo me de-mitizimin e figurës së tij, madje fajësim për krimet dhe dështimet në politikë, në Shqipëri, drejtuesit komunistë bënë të kundërtën, ata vijuan thellimin e politikave staliniste. Ashpërsimi i kësaj politike bëri edhe më të skajshme luftës politike brenda llojit. Sistemi i terrorit të pashembullt kontrollonte dhe parandalonte çdo kundërshtimi të mundshëm. Diktatura e Enver Hoxhës ishte regjimi socialist më stalinist në Evropë dhe së bashku me atë të Rumanisë, më brutali.

Së dyti: *Natyra thellësisht fshatare e komunizmit shqiptar*. Lëvizja komuniste shqiptare kishte një natyrë thellësisht fshatare, si në fillimet e saj dhe në vazhdim. Rreth 80% e anëtarëve të Partisë Komuniste ishin fshatarë. Kjo ishte dhe arsyeja pse ajo u vetëquajt Partia e Punës së Shqipërisë³⁶². Natyra rurale e komunizmit shqiptar përbën një dallim nga lëvizja komuniste evropiane dhe nga pjesa tjetër e vendeve të lindjes, në të cilat ajo ishte kryesisht urbane³⁶³. Konservatorizmi, mungesa e zhvillimit dhe prapambetja në shumë drejtime e fshatarëve shqiptarë do t'i jepnin trajta ekstreme komunizmit në Shqipëri. Nga ky tipar, komunizmi shqiptar mund të krahasohet me Kinën dhe Kamboxhian. Për 50 vite me radhë, popullsia rurale u kthye në një proletariat rural. Deviza partiake përcaktonte si prioritet vendosjen e kuadrove nga radhet e klasës punëtore fshatare. Në Shqipëri, aneksimin i kuadrove profesioniste dhe intelektuale nga vendimarrja në të gjitha nivelet drejtuese të vendit u bë në formë brutale dhe me pasoja të rënda për vendin. Popullsia rurale mbeti në kuota shumë të larta gjatë gjithë regjimit komunist. Kontrolli i rreptë i lëvizjes së popullsisë ishte arsyeja kryesore që në prag të viteve '90, numri i popullsisë fshatare ishte pak a shumë në nivelet e pas-luftës. Në këtë aspekt vështirë së gjen ndonjë vend të Evropës Qendrore dhe Lindore të krahasueshëm me rastin e vendit tonë.

³⁶². Në vitin 1947 ideologu kryesor i stalinizmit sovietik Zhdanov sygjeroi ndryshimin e emrit të Partisë Komuniste Shqiptare në Parti të Punës.

³⁶³. Për sa më lartë shiko: Sofokli Meksi, "Mbi disa aspekte të trashëgimisë totalitare gjatë periudhës së tranzicionit shqipëtarë". Jehona, Tiranë, 2008, fq. 20-44

Së treti: *Idealizimi ekstrem i liderit komunist*. Nisur nga dy veçoritë e lartpërmendura rrjedh një dallim thelbësor i komunizmit shqiptar. Ndryshe nga vendet e tjera, komunizmi shqiptar diktohet nga prania e një lideri mesianik, profetik ku autoriteti dhe ndikimi politik formëzoi natyrën enveriste të komunizmit shqiptar. Ai përcaktohej si burimi i dijes absolute, i autoritetit suprem, i një profeti që gëzonte të drejtën për udhëheqjen e shqiptarëve drejt formimit të Shqipërisë së re socialiste. Në këtë drejtim, regjimi arriti të ndërlihte ideologjinë partiake me çdo aktivitet politik, ekonomik dhe shoqëror duke kushtëzuar shkencën, dijen, kulturën, artin etj.

Së katërti: *Lufta e egër e klasave e shtrirë dhe e zgjatur në breza*. Shqipëria ka patur luftën e klasave më të egër në krejt kampin komunist. Në 50 vjet të aplikimit të diktaturës së proletariatit u ekzekutuan për motive politike rreth 5037 burra dhe 450 gra, u dënuan me burgime rreth 16.788 burra dhe 7367 gra, u internuan 48.217 burra dhe 10.792 gra. U dëbuan nga qytetet kryesore dhe nga zonat kufitare 11.536 familje etj³⁶⁴. Burgjet dhe kampet e përqendrimit u mbushën jo vetëm me ata që akuzoheshin për “agjitacion dhe propagandë”, por edhe me familjarët e tyre dhe anëtarë të tjerë të fisit. Me mijëra njerëz u ndanë nga të afërmit e tyre, duke i mohuar në rastin më të mirë, dhe duke i spiunuar, në skenarin më të keq.

Së pesti: *Diktatura personale*. Në sistemin komunist shqiptar nuk kemi të bëjmë me kontrollin e një partie nga një elitë, por me kontrollin total prej saj të krejt shoqërisë. Mekanizmat dhe institucionet e shtetit drejtohen nga ana e një prijësi që shpërfaqet si interpretues i një ideologjie të konceptuar në vetvete si gjithëpërfshirëse³⁶⁵. Nëse vitet e para pas çlirimit, në vend u instalua një sistem politik njëpartiak, më vonë Shqipëria përfundoi në diktaturë personale të Enver Hoxhës. Sipas studiuesve “*Ndryshimi midis formës së diktaturës personale dhe një regjimi njëpartiak është thelbësor për sa u takon marrëdhënieve midis shtetit dhe shoqërisë...në regjimin me sistem njëpartiak lejohet qoftë edhe minimalisht “një lloj negociimi” për kontratën midis shoqërisë dhe shtetit, ndërsa në diktaturat personale, siç është edhe rasti Shqipërisë, nuk ndodh një gjë e tillë*³⁶⁶”. Shteti nuk është më mjet i shoqërisë, është shoqëria që kthehet në mjet të shtetit. Ky kalim mundësohet vetëm nëpërmjet ideologjisë që duke përdorur shtetin drejton shoqërinë³⁶⁷.

Së gjashti. *Ideologjia në planë të parë*.

Komunizmi shqiptar, ndryshe nga vendet e tjera, ishte ekstremisht i orientuar nga dogmat ideologjike dhe aplikimi i tyre në shoqëri. Nën ndikimin e regjimit ranë të gjitha fushat e veprimtarisë jetësore. Ideologjizimi ishte kudo; ai përfshihej në hapësirën më të madhe të krijmtarisë letrare dhe asaj artistike. Qëllimi kishte të bënte me manipulimin dhe

³⁶⁴ op.cit, Kastriot Dervishi, fq. 616.

³⁶⁵ Sofokli Meksi, “*Mbi disa aspekte të trashëgimisë totalitare gjatë periudhës së tranzicionit shqiptarë*”. Jehona, Tiranë, 2008, fq. 11.

³⁶⁶ Shqipëria njëzet vjet pas rënies së komunizmit: Reflektime për shtetin dhe demokracinë, (2011) AIIS. Tiranë

³⁶⁷ Ibid. (Meksi) fq. 17-8.

tjetërsimin e jetës politike, ekonomike, intelektuale, të historisë dhe vlerave të shoqërisë. Dogmatizmi i tejskajshëm në shkencë, kulturë, art do ta kthente inteligjencën dhe krejt shoqërinë në vegël të regjimit Hoxhist. Si pasojë e ideologjizimit ekstrem në fushën e shkencës dhe artit, regjimi komunist shqiptar zhvilloi specifikat e veta. Ideologjizimi i plotë i botës akademike dhe rekrutimi i tyre në strukturat partiake i kthehu akademikët në burokrat, në ekzekutorë të direktivave partiake. Fusha e mendimit shkencor, teknokracia iu nënshtrua plotësisht ideokracisë. Shpeshherë, udhëheqësi apo kuadro të tjerë të lartë të nomenklaturës komuniste shqiptare kanë bërë rolin e arbitrit, të korrigjuesit dhe herë të shkencëtarit që hap shtigje të reja kërkimi.

Së shtati. *Ekstremizim në zhvillimin e sektorit të industrisë.*

Ndryshe nga vendet e tjera të lindjes, *modeli ekonomik shqiptar karakterizohej nga eliminimi i të gjitha formave të pronës private nëpërmjet shtetëzimit të plotë të industrisë, tregtisë në shumicë dhe pakicë dhe të kolektivizimit ekstrem të bujqësisë*³⁶⁸. Në këtë drejtim Shqipëria zbatoi shumë ashpër modelin sovjetik të industrializimit dhe ekonomisë së planifikuar. Zhvillimi i vendit përmes industrisë së rëndë me ngritjen e fabrikave dhe uzinave çoi në mjerimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë, kryesisht atë të industrisë së lehtë, turizmit dhe bujqësisë. Zbatimi i këtij modeli zhvillimi u bë pa marrë fare parasysh kushtet specifike të Shqipërisë dhe prapambetjen e saj të madhe.

2.5 Trashëgimia komuniste

Rënia e regjimit diktatorial në Shqipëri la pas vetes shumë probleme të mprehta politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Në vitet e para të tranzicionit politik u ndien edhe efektet më të forta të trashëgimisë komuniste. E kaluara e afërt do të ndikonte dukshëm në një fillim tejet të vështirë të proceseve demokratike në vend. Ne po parashtrijmë disa prej tyre si më poshtë:

Së pari: Regjimi komunist la një model të keq-qeverisjes. Regjimi komunist krijoi “një elitë pa ndjenjën e përgjegjësisë ndaj komunitetit, me frikën ndaj pushtetit të më të fuqishmit, të paafte për ti rezistuar të keqes...”³⁶⁹. duke mbajtur parasysh faktin së drejtuesit e rinj politikë të pas viteve ‘90 “kishin dalë tërësisht nga elita e kohës së komunizmit”³⁷⁰, përvojat dhe njohuritë e tyre në pluralizëm reflektonin ndikimet nga modeli i kaluar politik. Siç vë re edhe studiuesi Sharp: “anëtarë të regjimit të vjetër... mund të pretendojnë se e kanë eliminuar diktaturën, por në fakt kërkojnë thjesht të

³⁶⁸ Anastas Angjeli, “Ditari i Tranzicionit Ekonomik”, Toena &UMSH Press, Tiranë, 2013, fq. 27.

³⁶⁹ Fatos Lubonja, “Tranzicion apo Kalbëzim” në “Tranzicione në Pasqyrë, Një përjasje e krahasuar e proceseve të transformimit demokratik të Spanjës dhe Shqipërisë” Ciencias y humanismo, fq. 231.

³⁷⁰ Piro Misha, “Roli i trashëgimisë historike në tranzicionin pas-komunist Shqiptar” në “Tranzicione në Pasqyrë, Një përjasje e krahasuar e proceseve të transformimit demokratik të Spanjës dhe Shqipërisë” Ciencias y humanismo, fq. 143.

vendosin një model të ri të luter me bojë të asaj të vjetrës³⁷¹”. Gjithashtu, elementë të kulturës politike komuniste vihen re edhe në zhvillimet e jetës politike në vend. Pas viteve ’90, subjektet politike zhvilluan një luftë të ashpër dhe të dhunshme për pushtet. Për politologun Kajsiu retorika anti-komuniste e përdorur nga forcat e djathta “*sfidonte një rend simbolik brenda të cilit ishin formësuar një sërë identitetesh dhe subjektesh sociale të cilat ndiheshin të rrezikuar nga eliminimi i tij*³⁷²”. Ky rend simbolik kishte të bënte me ngjizjen me kast të identitetit shqiptar me atë komunist. Përmbysja e sistemit bëri që kjo pjesë e shoqërisë (kryesisht mbështetësit e regjimit komunist) të bëheshin pengesë për pranimin e shumë koncepteve të reja politike, ekonomike dhe shoqërore të botës perëndimore. Edhe në vendet e tjera të Evropës Lindore, pas revolucionit të vitit 1989 lufta politike kishte tone të ashpra, por ato nuk mund të krahasoheshin me Shqipërinë për nga shkalla e dhunës.

Së dyti: Nga ish-regjimi komunist, vendi trashëgoi një plagë të rëndë shoqërore, viktimat e luftës së klasave. Lufta e klasave e kishte ndarë popullin si kurrë më parë në historinë e tij. Statistikat flasin për “8,500 vetë të ekzekutuar dhe për 400,000 vetë të internuar në kampet e përqëndrimit³⁷³”. Sipas Çejkut: “*Midis të djathtës dhe të majtës shqiptare, pavarësisht kushteve të reja historike, duhet pranuar se qëndron një hon i madh ndarës dhe i frikshëm – kujtesa historike për luftën civile, shkeljen e normave demokratike të zgjedhjeve të vitit 45-së, shfarrosja sistematike për 50 vjet e inteligjencës shqiptare, zhdukja e pronës dhe vjedhja e saj, uzurpimi i pushtetit me forcë, burgosja e opozitës, vrasjet pa gjyq, përndjekjet dhe internim-dëbimet*,³⁷⁴”. Në këtë kontekst, koncepti i kombit si një masë e tërë ishte shkatërruar. Polarizimi politik reflektonte polarizimin që ekzistonte në shoqërinë shqiptare.

Së treti: Vijimi i modelit Parti – Shtet në drejtimin e vendit. Pothuajse gjatë gjithë periudhës 20 vjeçare të pluralizmit partiak, administrata dhe institucionet shtetërore kanë vuajtur vijimin e modelit parti-shtet. Lëvizjet në administratën publike kanë dobësuar institucionet shtetërore dhe kanë prodhuar një shtet të dobët, të varur nga partitë në pushtet. Lëvizjet me motive politike janë realizuar nga të gjitha partitë që kanë qenë në pushtet. Mbushja e administratës publike me militantë partiakë është një fenomen shumë i përhapur. Arbitrariteti i heqjes nga puna të stafit profesionist dëshmohet nga numri i lartë i gjyqeve të fituara nga nënpunësit e larguar pa të drejtë. Koncepti i drejtimit të shtetit dhe vendit nga partitë që marrin pushtetin është i deformuar dhe kjo ka bërë që shteti dhe institucionet e tij të varen nga politika dhe jo e kundërta. Kjo qasje e gabuar e manaxhimit dhe drejtimit të vendit nga forcat politike vijon të reflektojë trashëgiminë komuniste të kapjes së shtetit nga partia në pushtet. Po kështu, si pasojë e rolit primar të partisë *mbi* shtetin dhe strukturat shtetërore, shqiptarët trashëgjuan mosbesimin; ndërkaq,

³⁷¹ Gene Sharp, fq. 88.

³⁷² Op.cit Blendi Kajsiu *Vdekje Politikës, Liri Popullit!-Kriza e Përfaqësimit në Shqipëri*, Revista Polis nr. 5 fq. 9

³⁷³ Shiko: Mezini, fq. 225.

³⁷⁴ Agim Çejku, fq. 44.

zhdukja e kulturës së shtetit ligjor dëmtoi rëndë shoqërinë. Kjo mungesë besimi dhe respekti për ligjin dhe shtetin, bashkuar me traditën e dikurshme historike ka si produkt një sjellje primitive të vetërregullimit ose më saktë ringjallje të veprimeve autoritare, vetëgjyqësisë, shtimin e krimit etj.

Së katërti: Në fushën ekonomike trashëgimia komuniste ishte gati e mjerë. Vendi kishte trashëguar një industrinë të rëndë të falimentuar, një sektor bujqësor të prapambetur dhe një faturë të gjatë me borxhe. Shqipëria ishte vendi më i prapambetur dhe më i varfër i Evropës. Varfëria ishte pasojë direkte e keqmanaxhimit 50 vjeçar të burimeve kapitale, monetare dhe njerëzore. Hartimi i politikave ekonomike bazuar mbi ideologjinë dhe direktivat partiake kishte krijuar një hendek të madh në mungesën e njohjes së gjëndjes reale, të nevojave dhe kërkesave të qytetarëve. Rreth viteve '90, kjo gjendje kishte rritur në mënyrë të pashmangshme tensionet sociale në vend. Zhgënjimi i shoqërisë ndaj ish-regjimit ishte shumë i lartë.

Së pesti: Në shoqërinë post-komuniste rrënimi i shtetit nuk ishte vetëm institucional, por edhe vleror. Ai përfaqësonte simbolin e represionit dhe të dhunës mbi popullin, duke u kthyer dukshëm në një antivlerë kombëtare. Tendenca për të shkatërruar, plaçkitur dhe poseduar pronën publike u kthye në fenomen shqetësues. Shoqëria shpalsi një urrejtje të vazhdueshme për çdo gjë që ishte shtetërore. Vjedhja e pasurisë së shtetit nuk konsiderohej e pamoralshme. Ajo justifikohej dhe nxitej shpeshherë nga nevoja për mbijetesë. Dëshira për të zotëruar është e lindur, respekti për zotërimet e të tjerëve mësohet, ndaj mungesa e respektit për pronën e tjetërit lidhet drejtëpërdrejtë me tjetërsimin e vlerave shoqërore nga regjimi komunist. Krahas të tjerave, shoqëria shqiptare shpalsi një kundërshtim të ashpër edhe ndaj atyre praktikave qytetare që në thelb nuk kishin të bënin fare me regjimin e mëparshëm, por me qytetarinë. Nuk mund të lëmë pa përmendur mosadministrimin e ambjenteve të përbashkëta dhe mbeturinave urbane. Sot, Shqipëria ka probleme të rënda ekologjike edhe si pasojë e mosruajtjes madje e dëmtimit të ambjentit nga hedhja e pakontrolluar e plehrave në çdo vend. Varfëria dhe mungesa e strukturave shtetërore çoi drejt degradimit pyjet dhe çdo pronë të përbashkët shoqërore. Parë në këtë prizëm, mund të kuptohet antikonformizmi qytetar në sistemin e ri shoqëror. Degradimi i mega-shtetit dhe shoqërisë në tërësi manifestoi fenomene negative si dembelizmi, joprofesionalizmi, keqpërdorimi, korrupsioni, mungesa e përgjegjësisë dhe shkatërrimi e vjedhja e pronës shtetërore.

Së gjashti: Trashëgimi e mjerë në fushën kulturore. Në këtë drejtim, regjimi komunist shqiptar kishte ndjekur me fanatizëm aplikimin e doktrinës së Realizmit Socialist. “Realizmi Socialist” u bë doktrina estetike zyrtare në Rusi në vitin 1932. Kjo doktrinë kërkonte prej shkrimtarëve dhe artistëve, të trajtonin të sotmen “sikur nuk ekzistonte dhe e ardhmja, sikur tashmë ishte arritur.”³⁷⁵ Nën ndikimin e kulturës së realizmit socialist, shqiptarët u mësuan të jetonin në një botë imagjinare duke qenë të ndërgjegjshëm për të kundërtën e saj. Këto politika të gabuara zhvilluan fenomene

³⁷⁵ Richard Pipes, “Komunizmi, Historik i shkurtër”, fq. 56.

negative shoqërore. Si pasojë e kësaj politike, shprehet Pipes: “*Gënjeshtra u bë mjet mbijetese dhe nga gënjeshtra tek mashtrimi shtrihej një hapsirë tepër e ngushtë. Etika sociale, e cila bën të mundur një shoqëri të qytetëruar, ishte shkatërruar. Regjimi, i cili donte që secili të sakrifikoje privilegjet e veta për të mirën e përbashkët, përfundoi në një situatë ku secili kujdesej vetëm për veten, sepse nuk i besonte askujt*”³⁷⁶.

Nga një analizë e shkurtër konkludojmë që e kaluara komuniste ka prodhuar në fazat e para të tranzicionit më shumë probleme nga sa mund të mendojmë. Zhvillimet e vështira në këto 20 vite tranzicion dhe rrugëtimit të mundimshëm drejt Bashkimit Evropian i atribuohen pa mëdyshje edhe trashëgimisë komuniste, sikundër, edhe gabimeve të bëra nga klasa politike e pas viteve '90, gabime këto të cilat nuk janë të pakta. Pikërisht analiza e zhvillimeve politike dhe orientimi drejtë BE-së nën drejtimin e klasës politike të pas viteve ‘90 do të trajtohet në kapitujt vijues.

³⁷⁶ Ibid.

KREU I TRETË

ZHVILLIME POLITIKE TË TRANZICIONIT SHQIPTAR

“Anëtarë të regjimit të vjetër... mund të pretendojnë se e kanë eliminuar diktaturën, por në fakt kërkojnë thjesht të vendosin një model të ri të lyer me bojë të asaj të vjetrës”.

Gene Sharp³⁷⁷

3.1 Situata politiko – ekonomike në vend dhe zgjedhjet e 22 marsit 1992

Periudha e viteve ‘90 e në vazhdim, rezultoi një sfidë e vështirë për drejtimin e vendit si në aspektin politik, ashtu dhe në atë ekonomik dhe shoqëror. Sipas politologut Kajsiu: *“Ajo që po luhej në 1991-shin nuk ishte thjesht fati i një rotacioni politik, por e ardhmja e të gjithë rendit simbolik, brenda të cilit ishte formësuar shoqëria shqiptare”³⁷⁸*. Në vitet e para të pluralizmit, klasa politike dhe shoqëria shqiptare në përgjithësi e manifestuan demokracinë si antikomunizëm. Kjo qasje, përvijoi veprime politike të ashpra dhe të dhunshme, veçanërisht kundër çdo mbetjeje të regjimit të mëparshëm. Siç analizon dhe studiuesi Çejku,

... për shkak se emri i Enver Hoxhës ishte gjithandej, gjithçka e vjetër përfaqësonte Tiranin. Njerëzit filluan të shkatërronin fabrikat që regjimi i kishte kaq shumë përzemër, infrastrukturën bujqësore dhe hekurudhat nëpërmjet të cilave diktatura u kishte hequr njerëzve edhe të drejtën e një dite pushim në javë. Nga sendet, shkatërrimi iu kthye vlerave. Njerëzit filluan të përçmonin kuadrot e administratës, mësuesit, ushtarët dhe forcat e rendit që për masën simbolizonin të vjetrën...³⁷⁹

Gjuha dhe retorikat e ashpra politike jo vetëm që rritën tensionet në vend, por thelluan ndasitë midis grupeve të ndryshme shoqërore që tashmë identifikoheshin si demokratë ose socialistë. Ky binom politik, rezultoi shumë i rrezikshëm sidomos në zhvillimin e një lufte politike pa përmbajtje (bazuar në akuza të ndërsjella dhe jo luftë mbi programet qeverisëse), në ndërtimin e një shteti dhe administrate të paqendrueshme dhe në fragmentarizimin e mëtejshëm të jetës sociale në vend. Kriteri politik vijoi të ishte elementi dominues i zhvillimeve socio-ekonomike të shoqërisë shqiptare. Instrumentat që duhet të siguronin paqen sociale dhe kalimin sa më të butë të pushtetit ishin në dorën e klasës politike. Në tërësinë e tyre, ngjarjet që kishin përfshirë vendin ishin të një rëndësie

³⁷⁷ Gene Sharp, fq. 88.

³⁷⁸ Blendi Kajsiu, *Vdekje Politikës, Liri Popullit! – Kriza e Përfaqësimit në Shqipëri*, Revista Polis, Nr. 5, fq. 9.

³⁷⁹ Sofokli Meksi, *“Mbi disa aspekte të trashëgimisë totalitare gjatë periudhës së tranzicionit shqiptar”*, Jehona, Tiranë, 2008, fq. 7.

kombëtare dhe si të tilla, ato duhej të trajtoheshin përtej ambicjeve politike. Në këtë kontekst, rotacioni politik ishte i domosdoshëm, por mënyra sesi e arriti realizimin i tij klasa politike pati pasojë, të cilat ndikuan në destabilizimin e vendit dhe në thellimin e mëtejshëm të krizës ekonomike.

Një hap politik i shumëpërfolur në këtë drejtim ka qenë largimi nga koalicioni qeverisës i Partisë Demokratike. Pavarësisht kritikave mbi qeverisjen e kabinetit Bufi, akti i bashkëpunimit midis forcave politike në të mirën e vendit ishte një hap pozitiv si për uljen e tensioneve sociale, ashtu edhe për frymën e re politike në vend. Vendimi për prishjen e bashkëqeverisjes u ndërmorr nga kryetari i PD-së, Sali Berisha, dhe gjeti mbështetjen e grupit të saj parlamentar. Brenda PD-së pati edhe zëra kundër, të cilët kritikuan largimin nga bashkëqeverisja, madje kjo situatë kristalizoi edhe fraksione dhe largime në gjirin e të djathtës. Ka versione të ndryshme në lidhje me shkaqet dhe arsyet e këtij vendimi. Disa japin versionin se PD-ja e prishi marrëveshjen pasi qeveria nuk po reagoonte me energjitë e duhura për zgjidhjen e problemeve dhe situatave që po përballonte vendi³⁸⁰. Për ish-presidentin Alia, kritikën e PD-së ndaj Qeverisë së Stabilitetit “*nuk kishin lidhje me rezultatet e punës së saj, por lidheshin me paragjykime të karakterit politik*”³⁸¹. Të tjerë pohojnë se ky vendim ishte një taktikë e PD-së për arritjen e zgjedhjeve të parakohshme duke parë dështimin e sigurt të socialistëve në to³⁸². Cilado që të kenë qenë arsyet e vërteta, mbetet fakt që mosvijimi i bashkëpunimit përkeqësoi situatën në vend. Qeveria e Stabilitetit u shpërbë dhe vendi u drejtua nga një qeveri teknike me kryeministër Vilson Ahmetin³⁸³. Kjo qeveri, e cila përbëhej nga intelektualë të pavarur e drejtoi vendin deri në realizimin e zgjedhjeve të parakohshme të 22 marsit. Nevojë imediate për qeverinë e re të drejtuar nga Ahmeti ishte rivendosja e rendit dhe e qetësisë në vend.

Destabiliteti politik kishte bërë që brenda një viti (mars 1991-1992) të ndërroheshin katër qeveri³⁸⁴. Situata e acaruar midis forcave politike paralizoi aktivitetin normal të shtetit duke shfaqur efekte negative në çdo drejtim. Siç argumenton studiuesja Muço “..paqendrueshmëria politike është padyshim një përcaktues i fortë për rrugën e tranzicionit ekonomik³⁸⁵” dhe për rastin e Shqipërisë, ky korelacion lidhet edhe me mungesën e një strategjie të qartë të klasës politike, gjë, e cila përkeqësoi situatën edhe më tej.

Për pasojë, në këtë kohë, gjendja e përgjithshme ekonomike karakterizohej nga një sërë parametrash negative. Deficiti buxhetor arriti shifra alarmante; në vitin 1990, ai kapte shifrën e 15.3% të GDP-së ndërsa gjatë vitit 1991 u rrit në mbi 25% të GDP-së.

³⁸⁰ Elez Biberaj, fq. 180.

³⁸¹ Alia, fq. 423.

³⁸² Shiko: Fevziu (*100 vjet, 1912-2012*) fq. 266.

³⁸³ Për përbërjen e Qeverisë Teknike shiko: A. Meksi, fq. 171.

³⁸⁴ Shënim: Qeveritë u etiketuan si :Nano 1, Nano 2, Qeveria e Stabilitetit, Qeveria Teknike

³⁸⁵ Marta Muço, “*Economic transition in Albania: political constraints and mentality barriers*”, NATO Individual Fellowship Program 1995-1997, June, 1997, fq. 20.

Ndër të tjera, kjo rritje ishte pasojë e transaksioneve të gabuara valutore të realizuara nga Banka e Shqipërisë, si dhe nga kthimi në një dukuri masive e pagesës së 80%-shit për punëtorët e papunë³⁸⁶. Inflacioni ishte kthyer në një fenomen shqetësues. Kështu, në vitin 1991, ai kapi vlerën e 104.1, ndërsa në vitin 1992 arriti vlerën 236.6³⁸⁷. Të dhënat tregojnë për një ulje shumë të theksuar të prodhimit industrial. Konkretisht, në vitin 1991, prodhimi industrial ra me -42% ndërsa në vitin 1992, shifrat arritën në -51.2%. Ndërkaq, degë të tëra të industrisë u paralizuan krejtësisht. Në sektorin bujqësor, në vitin 1991, prodhimi ra me -17.4%. Kjo rënie ishte pasojë e degradimit të sistemit shtetëror të furnizimit me lëndë të para dhe të tregtimit të produkteve bujqësore. Në këtë rënie ndikoi edhe shpërbërja e kooperativave shtetërore (shiko tab.1). Si rezultat i paralizimit të sektorëve prodhues, në vitin 1991, papunësia u rrit në përmasa alarmante: rreth 140 mijë njerëz figuronin të papunë³⁸⁸. Për punonjësit e papunë u aplikua pagesa e 80% -ëshit. Shpërbërimi për kohën e ndërprerjes së punës, kur kjo ndodh për faj të punëdhënësit, ka ekzistuar vazhdimisht (parashikohej në kodin e punës), por më 9 korrik 1990 masa e shpërbërimit u rrit nga 50% në 80% të pagës. Përmes kësaj mase, qeveria tentoi të ulte tensionet sociale në vend. Si rezultat i masivizimit të fenomenit të papunësisë dhe kohës së papërcaktuar për aplikimin e mekanizmit të 80%-it, financat e vendit u përkeqësuan ndjeshëm. Përveç efektit negativ në financat e shtetit, 80%-i ndikoi në paralizimin e ekonomisë, në uljen e interesit për punën, në rritjen e inflacionit dhe në zhvlerësimin e lekut. Për gati 2 vjet, kjo kosto u përballua nga buxheti i shtetit³⁸⁹.

Tabela 3. Rritja vjetore e prodhimit të brendshëm bruto.

	viti 1990	viti 1991	viti 1992	viti 1993	viti 1994	viti 1995	viti 1996	viti 1997	viti 1998	viti 1999
Industria	-14.2	-42.0	-51.2	-10.0	-2.0	6.0	13.6	-5.6	4.1	6.4
Bujqësia	-5.4	-17.4	18.5	10.4	8.3	13.2	3.0	1.0	5.0	5.0
Ndërtimi	-12.0	-30.0	7.0	30.0	15.0	21.2	18.5	-6.3	21.0	15.0

Burimi: INSTAT, *Vjetari Statistikor 1991/1999*, fq.335(botim i vitit 2002)

Situata e brishtë politike, ekonomike dhe institucionale krijoi predispozita negative për shfaqjen e një sërë aktivitetesh të paligjshme dhe fenomenesh të ndryshme negative, mes të cilave mund të përmendim papunësinë, emigrimin klandestin, trafikimin, dhunimin dhe vjedhjen e pronës shtetërore etj.

Duke u gjendur në këtë situatë të rënduar, vendi po shkonte drejt zgjedhjeve të parakohshme. Palët ranë dakort për një ligj të ri elektoral ku të reflektoheshin kritikrat

³⁸⁶ Gazeta; “*Rilindja Demokratike*”, E premte 26 nëntor 1993, fq. 3. Artikulli: “*Programi afatmesëm i qeverisë për zhvillimin ekonomik të shqipërisë 1993-1996 paraqitur në Kuvendin Popullor më 24.11.1993 nga Kryeministri Meksi*”.

³⁸⁷ European Bank for Reconstruction and Development, “*Transition Report 1999, Ten years of transition*”, 9 Nov 1999, fq. 76.

³⁸⁸ INSTAT, *Vjetari Statistikor 1991/1999*, botim i 2002-it; fq. 96.

³⁸⁹ Shiko: Anastas Angjeli, fq. 121-6.

rreth procedurave zgjedhore të ndjekura deri në atë kohë. Ligji i ri elektoral u miratua më 4 shkurt 1992. Ai parashikonte një sistem zgjedhor miks, bazuar në modelin gjerman. Ligji, e ndante vendin në 100 zona elektorale nga ku do të zgjidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë 100 deputetë, ndërsa 40 deputetë, do të zgjidheshin nga votat e grumbulluara në shkallë vendi³⁹⁰.

Zgjedhjet e 22 marsit 1992 shënuan rotacionin politik dhe ardhjen e të djathtës në pushtet. Fitorja e demokratëve ishte e një shumice absolute. Nga 140 vende në parlament, Partia Demokratike mori 92 deputetë, nga të cilët 90 fituan që në raundin e parë. Partia Socialiste doli forca e dytë kryesore, por me një kurrje drastike të elektoratit. Ajo arriti të merrte vetëm 38 deputetë, 6 prej të cilëve fituan direkt. Subjekte të tjera politike që arritën të hynin në parlament ishin PSD-ja me 7 deputetë, PPDNJ, 2 deputetë dhe PR me 1 deputet. Pjesëmarrja në zgjedhje ishte mbi 90%³⁹¹. Pavarësisht situatës jo normale në të cilën u zhvilluan, “zgjedhjet e vitit 1992 ishin shumë më të rregullta sesa ato të vitit të mëparshëm dhe ndoshta të vetmet zgjedhje vërtet të lira në historinë e Shqipërisë³⁹².”

Rezultati i zgjedhjeve ndikoi edhe në largimin nga skena politike e presidentit Alia, i cili dha dorëheqjen më 3 prill 1992. Parlamenti i ri, më 9 prill zgjodhi president Sali Berishën.

Kështu, Shqipëria nën drejtimin e demokratëve u fut në rrugën e gjatë dhe të mundimshme të transformimeve të shumanshme të vendit.

3.2 Kursi i ri politik, proceset e shndërrimit të shtetit, institucioneve dhe shoqërisë; vitet 1992 – 1994

Krahasuar me të gjitha vendet ish-komuniste, Shqipëria dukej më pak e përgatitur për kalimin e dhimbshëm nga diktatura, në demokracinë pluraliste dhe në ekonominë e tregut³⁹³. Në vitet e para të tranzicionit, por edhe në vazhdim, shteti në Shqipëri u karakterizua nga institucione të dobëta dhe nga përdorimi i administratës nga partia në pushtet. Partia Demokratike erdhi në pushtet pas zgjedhjeve plebishitare të 22 marsit 1992. Premtimet elektorale nga të dyja forcat politike ngjanin më shumë si dëshira spontane sesa si angazhime serioze politike. Në betejën elektorale, demokratët artikuluan dhe premtuan të parët integrimin e vendit drejt strukturave Euro-Atlantike. Euforia e zgjedhjeve kishte rritur artificialisht pritshmëritë e qytetarëve, aq sa mund të kishte edhe nga ata që besonin se vetëm rotacioni politik do të mjaftonte për ta nxjerrë vendin nga kriza e gjithanshme. Pavarësisht entuziazmit të fitores, realiteti në vend nuk ishte aspak

³⁹⁰ Shiko: Verner Vajdenfeld, “Demokracia dhe Ekonomia e Tregut në Europën Lindore”, L&M/Soros, Tiranë, 1999, fq. 239-40.

³⁹¹ Shiko: *Fletoren Zyrtare*, Nr.2, (maj 1992), fq. 99-100.

³⁹² Biberaj, fq. 187.

³⁹³ Biberaj, fq. 205.

premtues. Parlamenti i ri me kryetar Pjetër Arbnorin dhe qeveria e re e Aleksandër Meksit duhej të përballeshin me problematika ligjore, ekonomike dhe sociale tejet të mprehta. Në ushtrimin e aktivitetit të saj, kompetencat e qeverisë ishin të kufizuara. Në raport me institucionin e parlamentit dhe të presidentit, ekzekutivi gëzonte një pozicion institucional më të dobët³⁹⁴. Në seancën e parë të parlamentit të ri (më 9 prill, përpara zgjedhjes së presidentit Berisha), kompetencat e institucionit të presidentit u rritën ndjeshëm nga miratimi i ndryshimit të Dispozitave Kushtetuese³⁹⁵.

Në situatën e krijuar, përveç vendosjes së rendit dhe qetësisë në vend, sfida më e madhe e qeverisë së A. Meksit ishte kalimi nga një ekonomi tërësisht joproduktive dhe e mbajtur nga ndihmat emergjente dhe ushqimore të bashkësisë ndërkombëtare, drejt zhvillimit dhe zbatimit të një programi me reforma konkrete dhe të shumanshme. Demokratët ndërmorën reforma radikale, të cilat që nga ajo kohë e deri më sot kanë ndryshuar në mënyrë të pakthyeshme dhe tërësore raportet socio-ekonomike të shoqërisë shqiptare. Në këtë drejtim, qeveria e re paskomuniste do të haste disa vështirësi:

Së pari : Mungesë ekspertize dhe eksperience. Duke qenë produkt i të njëjtit sistem politik, drejtuesit e rinj politikë shqiptarë hasnin vështirësi dhe kufizime sa i takon eksperiencës, njohurive dhe ekspertizës për sistemin e demokracisë liberale, si dhe mekanizmave të ekonomisë së tregut, të kulturës politike perëndimore e shumë aspekteve të tjera. Vështirësi do të haseshin sidomos në krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur. Mungesa e traditës dhe kuadrove në këtë drejtim ishte një pengesë kryesore. Aktiviteti politik i tranzicionit të hershëm ishte, në një masë të madhe, më shumë improvizim sesa realizimi i një programi dhe strategjie politike të mirëmenduar.

Së dyti: Administratë publike e politizuar. Qeverisë do t'i duhej të ndërmernte reforma për ndryshimin e administratës shtetërore, e cila në një masë të madhe përbëhej nga burokratët komunistë. Një ndikim negativ në reformimin e administratës publike pati edhe emigrimi i një mase të konsiderueshme intelektualësh. Nëse i referohemi një studimi të realizuar nga një grup autorësh shqiptarë,³⁹⁶ vetëm gjatë periudhës 1990-1997 rezultojnë të kenë emigruar 895 punonjës shkencorë dhe pedagogë, ndërkohë që numri i përgjithshëm i kësaj kategorie sipas burimeve të INSTAT-it ishte 2,500 individë. Studimi tregon se rreth 28.49% (255 persona) ishin kuadro e specialistë të kualifikuar me grada e tituj shkencorë, një shifër e konsiderueshme për një popullsi kaq të vogël. Largimi i gjithë kësaj mase intelektualësh të kualifikuar, një pjesë e mirë e të cilëve kishin realizuar specializime jashtë vendit ishte një humbje shumë e madhe për elitën e dijes, e cila do të kishte qenë një faktor shumë pozitiv dhe kontribues si në hartimin dhe në zbatimin e reformave, ashtu edhe duke qenë një oponencë e fuqishme dhe bindëse ndaj vendimeve apo veprimeve të ekzekutivit, kjo edhe për faktin se siç shprehet M.

³⁹⁴ Shiko: Vajdenfeld, fq. 241.

³⁹⁵ Shiko: Servet Pëllumbi, "Dritëhije të tranzicionit", Rinia 2000, Tiranë, 2000, fq. 83.

³⁹⁶ Punimi është realizuar nga Dr. Ilir Gadeshi, Prof. Hekuran Mara, Prof. Rolanda Dhimitri dhe Dr. Ksenofon Krisafi me titull: "Emigrimi i elitës intelektuale nga Shqipëria gjatë periudhës së tranzicionit", Tiranë, Luarasi, 1999.

Bogdani: "...inteligjenca luan një rol të rëndësishëm në lindjen dhe zhvillimin e elitave politike, kulturore dhe të dijeve të një vendi dhe ç'është më e rëndësishmja në vendosjen dhe konsolidimin e demokracisë liberale³⁹⁷".

Së treti: Probleme të rënda financiare. Vendi kishte një ekonomi tejet të dobët dhe vetëm borxhet kapnin vlerën e mbi 600 milion USD. Shqipëria kishte një industri të rëndë të falimentuar dhe një bujqësi të prapambetur, një papunësi alarmante dhe kapital njerëzor të pakualifikuar etj. Në këto kushte, Shqipëria nuk gëzonte besueshmëri për marrjen e huave apo kredive, të cilat qenë aq të domosdoshme. Pikërisht situata e rëndë ekonomike krijoi një varësi tejet të lartë të qeverisë shqiptare nga organizmat monetarë e financiarë ndërkombëtarë si FMN dhe BB. Roli dhe ndikimi i këtyre institucioneve ishte vendimtar në realizimin e reformave ekonomike. Konkretisht, doktrina e njohur ndryshe si "Terapia e Shokut", e cila nuk ishte një shpikje shqiptare, u zbatua nën kushtëzimin detyrues të pikërisht këtyre institucioneve. Ekspertiza e ofruar për qeverinë shqiptare në fushën ekonomike nuk bazohej në studimin e mundësive reale të rimëkëmbjes ekonomike. Ajo ofrohej si paketë reformash, por pa marrë në konsideratë efektet dhe perspektivën e zhvillimit në planin afatgjatë. Përpos kësaj, drejtuesit politikë shqiptarë treguan një gadishmëri të zellshme për të zbatuar çdo rekomandim apo udhëzim të ekspertëve ndërkombëtarë. Vlen të theksojmë se eksperiencia e vendeve më të zhvilluara ka dëshmuar se pluralizmi politik dhe ekonomia e tregut qëndrojnë bashkë dhe nga bashkëveprimi i këtyre elementëve varet niveli i demokracisë dhe i mirëqenies të çdo vendi. Në këtë vështrim, rëndësi të veçantë, merr zgjedhja e politikave ekonomike dhe e modeleve të zhvillimit ekonomik dhe social, në mënyrë që të arrihen rezultate dhe përparim në vend.

Në funksion të reformimit, ndryshimet do të preknin kuadrin ligjor dhe institucional, qeverisjen dhe tërë shoqërinë.

Në këtë kontekst, objektivat kryesore të qeverisë së A. Meksit për vitin 1992-1993 ishin:

1. *Stabilizimi i prodhimit në vitin 1993;*
2. *Arritja e një përparimi të dukshëm drejt stabilitetit makro-ekonomik;*
3. *Zgjerimi i rrjetit të asistencës sociale për të mbështetur grupet e popullsisë me të ardhura nën një nivel të caktuar;*
4. *Ndërmarrja e ndryshimeve të thella strukturore më prioritare, reforma e plotë e sistemit të çmimeve dhe këmbimeve;*
5. *Kryerja e hapave vendimtare në reformën e bujqësisë, të ndërmarrjeve, të sektorit financiar dhe administrimit fiskal³⁹⁸.*

Për zbatimin e këtij programi u siguroa ndihmë e konsiderueshme financiare nga jashtë duke përfshirë huanë e dhënë nga Banka Botërore, marrëveshjen "Standby" me Fondin Monetar Ndërkombëtar, mbështetjen në bilancin e pagesave, si dhe *asistencën emergjente*

³⁹⁷ M. Bogdani, fq. 102.

³⁹⁸ "Programi afatmesëm i qeverisë për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë më 1993-1996, paraqitur në Kuvendin Popullor më 24.11.1993 nga Kryeministri Meksi", Gazeta "Rilindja Demokratike", E premte 26 nëntor 1993, fq. 3.

të koordinuar nën kujdesin e Komunitetit Evropian³⁹⁹. Pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike në 1991 midis Shqipërisë dhe Komuniteti Ekonomik Evropian, në 11 maj 1992 u bë nënshkrimi i Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit. Marrëveshja hyri në fuqi më 1 dhjetor 1992, duke bërë që Shqipëria të përfitonte nga fondet e programit PHARE. Ky ishte një hap i rëndësishëm në drejtim të ristrukturimit të asistencës së BE-së ndaj Shqipërisë në një sërë fushash që përkonin me reformat e ndërmara. Po në këtë periudhë, Shqipëria përfshihet në Sistemin e Përgjithshëm të Preferencave (GSP), i cili përfaqësonte një regjim të përgjithshëm preferencash tregtare që BE-ja u ofronte një numri të gjerë vendesh me të cilat ajo kishte marrëdhënie kontraktuale⁴⁰⁰. Në politikën e jashtme, e djathta e kishte shprehur me kohë ambicjen e saj për ta bërë Shqipërinë vend anëtar të Bashkimit Evropian. Intensifikimi i marrëdhënieve me vendet evropiane ishte pjesë e kësaj agjende politike.

Në gjashtëmuorin e dytë të vitit 1992 u ndërmorën reformat e para stabilizuese dhe strukturore në ekonomi. Në kuadër të reformimit të financave të vendit, për të balancuar pagesat dhe për të lehtësuar buxhetin, qeveria realizoi mbylljen dhe privatizimin e shumë ndërmarrjeve jo-rentabël. Këto masa ndikuan negativisht për shoqërinë në dy drejtime: së pari, në dyfishimin e të papunëve (sipas statistikave zyrtare, numri i të papunëve në vitin 1992 ishte rreth 394 mijë⁴⁰¹); së dyti, në uljen e nivelit të punësimit (niveli i punësimit në vitin 1993, krahasuar me vitin 1989 u ul me mbi 18%⁴⁰²). Në përgjithësi, për realizimin e reformave ekonomike më tepër u improvizua sesa u zbatuan me të vërtetë parimet e ekonomisë së tregut. Ndër këto reforma, liberalizimi i çmimeve dhe ndërprerja e 80%-it për të papunët ishin ndër masat që patën ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e nivelit të jetesës së qytetarëve. Rritja e çmimeve ishte disa me dhjetra herë dhe të gjitha kursimet e qytetarëve shqiptarë u zhvlerësuan brenda “natës”.

Privatizimi i sektorit shtetëror dhe krijimi i pronës private shikohej si mënyra e vetme e ecjes përpara për ekonominë e vendit. Në lidhje me procesin e privatizimit, qeveria do të vepronte në dy drejtime:

Së pari, në krijimin e veprimtarive të reja private në gjithë sektorin e ekonomisë pa kufizim.

Së dyti, në privatizimin e pronës shtetërore.

Përsa i përket krijimit të veprimtarive të reja private gjatë viteve 1993-1994, aktiviteti privat filloi të merrte ritme të shpejta zhvillimi duke zgjeruar ekonominë e tregut të lirë⁴⁰³. Po kështu, brenda 8 muajve u bë privatizimi i 220 mijë apartamenteve shtetërore,

³⁹⁹ Ibid. (shkronjat e pjerrëta janë në origjinal)

⁴⁰⁰ Shiko: <http://shqiperiadhebe.blogspot.com/p/mardheniet-shqiperi-be.html> dhe <http://www.mie.gov.al/> aksesuar më 12.5.2013.

⁴⁰¹ Vjetari Statistikor, 1991-1999, fq. 96.

⁴⁰² Ibid., fq. 92.

⁴⁰³ Ibid., fq. 253.

të cilat kaluan në pronësi të banorëve⁴⁰⁴. Ndërkohë, me miratimin e ligjit 7501, në korrik të vitit 1991 ishin privatizuar sipërfaqe të tëra bujqësore.

Procesi i privatizimit, në tërësi, ishte delikat. Krijimi i kuadrit ligjor për operacione të tilla ishte i vështirë. E drejta e pronësisë kishte mbi 45 vjet që u ishte mohuar qytetarëve shqiptarë. Praktikisht, krijimi i pronës private dhe të drejtave mbi pronësinë do të ishin një produkt politik. Hartimi i kuadrit ligjor dhe reforma agrare e ndërmarrë me miratim e ligjit 7501 të vitit 1991 nuk u bazua mbi respektimin e të drejtës së pronës, por mbi të drejtën e marrjes së pronës nga artificat politike. Parlamentarët dhe politika në tërësi la hapësirë ligjore dhe shpeshherë krijoi mundësi për spekulim dhe abuzim me të drejtën e pronarëve të tokës, të cilët në këto 23 vite janë etiketuar pa të drejtë si ish-pronarë. Eksperimenti i kthimit dhe kompesimit të ish-pronarëve mund të quhet një proces i dështuar dhe që ka patur pasoja dhe kosto të lartë për shoqërinë tonë.

Në planin e politikës së brendshme, qeverisja e demokratëve krijoi shenja pakënaqësie në disa drejtime:

Së pari, në mos përgatitjen e elektoratit për efektet negative që do të kishin reformat ekonomike dhe koha që do të duhej për të marrë rezultate nga këto nisma të qeverisë. Në muajt e parë, siç është trajtuar edhe më lart, parametrat makroekonomikë ishin në nivel negativ.

Në përputhje me programin e stabilizimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, vetëm pak ditë para zgjedhjeve lokale, qeveria ngriti çmimet e artikujve të konsumit të gjerë⁴⁰⁵. Zhgënjimi i elektoratit nga problemet e krijuara si pasojë e reformave të forta ekonomike sa vinte dhe rritej. Ky zhgënjim u reflektua në rezultatin e zgjedhjeve lokale të 26 korrikut 1992, ku partia në pushtet pati tkurrje të theksuar të mbështetësve të saj. Nga këto zgjedhje, më shumë se gjysma e përkrahësve të demokratëve kishin votuar për përfaqësuesit e Partisë Socialiste. Në votime morën pjesë rreth 70,7% e qytetarëve me të drejtë vote dhe PS-ja mori 40.9%, ndërsa PD-ja 43.3 % të votave në shkallë vendi⁴⁰⁶. Ky ishte një sinjal i fortë i pakënaqësisë qytetare ndaj qeverisjes së djathtë.

Së dyti, pati pakënaqësi brenda kampit demokrat. Divergjencat brenda grupit të Partisë Demokratike kishin filluar që pas daljes së saj nga Qeveria e Stabilitetit, por humbja në zgjedhjet lokale i thelloi problemet brenda partisë. Kundërshtimet e figurave të njohura si, Pashko, Imami, Zogaj etj. ndaj Berishës përkeqësuan raportet ndërmjet tyre. Në këto kushte u mbajt Konferenca e Jashtëzakonshme e Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike ku u përjashtuan Gramoz Pashko, Arben Imami, Preç Zogaj dhe Arben Demeti, anëtarë të kryesisë së partisë dhe disa anëtarë të Këshillit Kombëtar. Të përjashtuarit krijuan një parti të re të quajtur Aleanca Demokratike me në krye Neritan Cekën. Nga këto zhvillime politike, numri i deputetëve të PD-së në Parlament ra me gjashtë deputetë.

⁴⁰⁴ Fevziu, fq. 273.

⁴⁰⁵ Biberaj, fq. 215.

⁴⁰⁶ Vajdenfeld, fq. 256.

Së treti, lëvizjet politike agresive ndaj kampit socialist krijuan tensione të tepërta politike. Antikomunizmi i Partisë Demokratike u shpërfaq si një doktrinë kundër çdo gjëje që përfaqësonte rendin e vjetër. Që në ditët e para të pushtetit dhe në mënyrë të heshtur, demokratët larguan nga varrezat e Dëshmorëve të Kombit ish- diktatorin Hoxha dhe ish-funksionarë të lartë të regjimit komunist. Ata u rivarrosën në varrezat e zakonshme. Ky akt, ndezi akuza dhe irritim në radhët e mbështetësve të ekstremit të së majtës, të cilët nuk ishin të pakët në numër dhe u bënë shumë agresivë ndaj qeverisë. Po kështu, reformimi i administratës qendrore, i ushtrisë, i sistemit informativ dhe dikastereve të tjera nga elementët komunistë rriti pakënaqësinë dhe ashpërsoi luftën politike. Një akt që ashpërsoi edhe më tej klimën politike ishte arrestimi i Fatos Nanos, në korrik të vitit 1993. Ai u dënua me 12 vjet burg, për korrupsion dhe shpërdorim detyre. Arrestimi i Nanos dhe gjyqi i tij e “ashpërsoi edhe më shumë qëndrimin militant të Partisë Socialiste dhe e bëri udhëheqësin socialist martir politik⁴⁰⁷. Nga ana tjetër, shtresat e persekuara nga regjimi komunist kërkonin gjykimin e ish-pushtetarëve dhe dëmshpërblimin financiar dhe moral për vuajtjet e tyre. Presioni shoqëror mbi qeverinë, i ardhur nga të gjitha drejtimet, ishte shumë i madh.

3.3 Konfigurimi post-komunist i elitës politike shqiptare; tiparet e saj

Duke mbajtur në konsideratë transformimet problematike të ndodhura gjatë këtyre viteve tranzicion, konfigurimi i elitës politike shqiptare pas ndryshimeve rrënjësore të sistemit politik merr një vlerë të veçantë. Momenti më i rëndësishëm në kristalizimin e figurave të reja politike është padyshim momenti i evidentimit dhe lidhjes së këtyre figurave me lëvizjen studentore të viteve ‘90. Nga shumë studiues, politikanë dhe protagonistë të lëvizjes studentore, rëndësia e saj në realizimin e ndryshimeve politike në vend është tejet e lartë. Lëvizja, në vetvete, identifikonte dëshirën e heshtur të shqiptarëve për ndryshimin e regjimit politik në Shqipëri. Trajtesa dhe kanalizimi i fuqisë së lëvizjes studentore nga ish-regjimi mbetet ende një temë e nxehtë. Në tërësi, ky fakt lidhet me dy mangësi të shoqërisë shqiptare:

Së pari, mbështetja e lëvizjes studentore nuk erdhi në mënyrë natyrale nga intelektualë, të cilët të kundërshtonin hapur regjimin për shkak të kultivimit të tyre me vlerat e demokracisë së vërtetë. Pas spastrimeve të vazhdueshme ndaj intelektualëve, regjimi komunist kishte arritur që në Shqipërinë e viteve ‘90, më në fund, të krijonte një inteligjencë vendase të arsimuar dhe të përshtatur për sistemin e saj politiko-ekonomik. Kjo pjesë e shoqërisë shqiptare, e cila rëndom njihej si ajka e saj ishte formuar në kohën e degradimit moral dhe të vlerave të sistemit politik dhe në kushtet më të këqija ekonomike, humane dhe kulturore të tij. Për shumë arsye, kjo shtresë pseudo-intelektuale (përveç problemeve të mungesës së formimit) ishte njëkohësisht e paaftë për t’iu

⁴⁰⁷ Ibid., fq. 221.

kundërvënë sistemit. Si një produkt i saj, intelektualët, ishin kultivuar *me të gjitha mekanizmat* për të garantuar respekt ndaj udhëheqjes dhe regjimit në tërësi. Shumica e intelektualëve gëzonin status, privilegje dhe lidhje të ngushta me pushtetarët e regjimit, të cilët i kishin promovuar shpeshherë për besnikëri e devotshmëri ndaj Partisë dhe jo për shkak të meritës dhe vlerave. Këtu na lind problemi i *intelektualëve të lançuar*⁴⁰⁸ në krye të kundërvënies ndaj regjimit, të atyre figurave që qetësuan studentët dhe kauzën e tyre për liri dhe demokraci, të elementëve të cilët jo vetëm u bënë protagonistët kryesorë të ndryshimit, por përvijuan jetën politike të vendit për më shumë se dy dekada. Siç pohon dhe studiuesi Rama “*Në qoftë se rrjedha e ngjarjeve në Shqipëri do të ishte në normalitetin e zhvillimit evropianolindor, bota nuk do të çuditej aspak nëse intelektualët tanë do të ishin në krye të opozitës së sotme demokratike*”⁴⁰⁹. Duke qenë regjimi më i egër në krejt vendet ish-komuniste, ai shqiptar ishte unik edhe për mungesën pothuajse të plotë të një disidence intelektuale, e domosdoshme kjo për të mobilizuar shoqërinë në luftën për mposhtjen e regjimit. Pikërisht kushtet paradoksale në të cilat ndodhej Shqipëria dhe shqiptarët e bënë të pamundur një ndryshim politik jashtë kontrollit të nomenklaturës së vjetër. Duke qenë në dijeni të ndryshimeve që po ndodhnin në të gjithë bllokun komunist, nomenklatura e lartë komuniste vështirë të besohet se ka qenë e papërzier në rrjedhën e ngjarjeve të ndodhura në vitet 1990. Nga zhvillimet e këtyre 22 viteve pluralizëm, një nga tezat që ka më shumë argumenta është teza sipas të cilës drejtuesit e lartë komunistë jo vetëm monitoruan ndryshimin (lëvizjen studentore), por ndoshta arritën ta vinin nën kontroll atë e madje t’u imponoheshin edhe drejtuesve të rinj politikë. Për vetë historikun e raporteve të regjimit me intelektualët vihet në pikëpyetje dhe urrejtja e tyre për të përmbysur një orë e më parë regjimin e vjetër. Ka shumë gjasa që, në një masë të madhe, reagimi i ashpër i *intelektualëve të lançuar* kundërshtoi regjimit të ishte një urrejtje e sajuar. Vështirë të besohet që tek njerëzit në moshë madhore, brenda disa orëve apo qoftë edhe ditëve, mund të shëmben përnjëherë bindjet dhe vlerat politike të krijuara për një jetë të tërë. Morali dhe bindja politike është një proces i ngadaltë dhe vështirësisht i ndryshueshëm, pasi edukimi i marrë ndër vite i ka bërë individët të paaftë apo të papërgatitur që të konceptojnë ndryshe ekzistencën e tyre, domethënë si njohës apo përkrahës të kulturës demokratike perëndimore. Nga kjo premisë, vështirë të pranohet që njerëz të cilët i kanë shërbyer apo kanë gëzuar privilegje e të mirat materiale të atij regjimi politik të tjetërsohen në parimet dhe vlerat e tyre politike aq shpejt dhe egër, sa që nga komunistë të ktheheshin në demokratë. Kjo nuk ka të bëjë me procedurën në vetvete pasi me procedurë njeriu mund të zgjedhë t’i përkasë cilëndo partie. Këtu, çështja shtrohet në ndryshimin e sistemit të vlerave dhe besimeve që kanë individët e aq më tepër vlerat dhe besimet e individëve intelektualë që përfshihen në politikë. Tashmë nuk ka dyshim se besueshmëria rreth iluminimit të tyre me vlera demokratike brenda një kohe të

⁴⁰⁸ Termi *intelektualë të lançuar* përfshin intelektualët, të cilët u përfshinë në lëvizjet politike të ish-presidentit Alia, qoftë përmes takimit të intelektualëve, qoftë me pedagogët e dërguar për të negociuar me studentët. Ne i përmbahemi tezës se nisma e intelektualëve ishte e organizuar nga regjimi.

⁴⁰⁹ Shinasi A. Rama, “Probleme Politike Shqiptare 1”, ISKSH, Shkodër, 2006, fq. 4.

shkurtër ka qenë minimale, për të mos thënë inekzistente. Nëse i qëndrojmë kësaj linje argumentimi, arrijmë në konkluzionin se pengesa kryesore e fillimit të tranzicionit demokratik është krijimi i stisur i drejtuesve të rinj politikë. Të gjitha gjasat dëshmojnë për një konfigurim politik problematik, në të cilin aktorët e rinj të politikës ishin aty jo për shkak të idealit dhe aspiratave liridashëse. Drejtuesit e partive të krijuara pas shpalljes së pluralizmit rezultuan në shumë drejtime si të lidhur ngushtë me ish-regjimin. Nga kjo premisë evidentohen disa tipare të elitës politike të pas viteve '90 si më poshtë:

1. Elitat e pas viteve '90 udhëhiqeshin jo nga respektimi dhe zbatimi i ligjit, por nga tendenca për të qenë mbi ligjin. Ky model i të drejtuarit deformati, së pari, partitë si institucione dhe së dyti, drejtimin e shtetit dhe të institucioneve të tij.

2. Një tipar i evidentuar që me krijimin e demokracisë në vend është klanizimi i elitës politike. Elita e re vijoi me mbështetjen e pushtetit të vetë në bazë klanesh dhe krahinorizmash. Baza e deformuar e legjitimitetit thelloi edhe më tej këtë tipar. Për pasojë, përçarja e klasës politike vijoi të prodhonte probleme si në drejtimin e vendit, ashtu edhe në mesazhet negative që përçoheshin në popullatë. Një efekt i kësaj politike ishte formimi i një shërbimi civil sipas vlerave të elitës drejtuese duke forcuar sundimin e ri me mekanizmat shtetërorë. Sipas studiueses M. Bogdani "*Dobësia e vazhdueshme e shtetit ka krijuar një mjedis të favorshëm për kultivimin e mentalitetit të abuzimit me pushtetin*⁴¹⁰". Pikërisht zhvillimet shtetformuese nën politikën e elitës së re ishin faktori kryesor për krijimin dhe thellimin e këtij tipari gjatë viteve. Ende sot, politika e klaneve vijon si në qarqet politike, ashtu edhe në administratën shtetërore e në promovimin e individëve aty.

3. Vijoi një luftë të ashpër për pushtet si ndaj kundërshtarit politik, ashtu edhe brenda partive të tyre. Gjendja e konfliktualitetit të vazhdueshëm për marrjen dhe gëzimin e sa më shumë pushteti bëri që drejtimi i organizatave politike në fillim (dhe i shtetit në vijim) nga liderët e rinj të realizohej me disiplinë dhe autoritarizëm të lartë. Pothuajse në të dyja partitë kryesore, eliminimi i mendimit ndryshe dhe vijimi me politika përçarëse krijoi një lojë politike të pabarabartë, sidomos brenda radhëve të partisë, duke eliminuar figura të reja polenciale për drejtimin e mëtejshëm të saj.

4. Monopolizim të pushtetit (partiak dhe ekzekutiv). Drejtuesit e partive vijuan me modelin e njëshit të padiskutueshëm. Ata mbanin qëllimisht pranë vetes individë që nuk mund të ishin konkurrentë të denjë duke lënë përshtypjen se ata dhe vetëm ata mund të drejtonin. Ky tipar ka bërë që drejtuesit politikë të pas viteve '90 të qëndrojnë shumë gjatë në pushtet, qoftë edhe pas shumë dështimeve në politikë.

5. Dëshira për pasurim. Në kushtet e reja dhe duke njohur fuqinë e pushtetit, drejtuesit e rinj politikë dhanë të parët shembullin e abuzimit me pronën shtetërore dhe deformimin institucional duke qëndruar, vetë ata dhe interesat e tyre personale, mbi shtetin, ligjin dhe rregullin.

⁴¹⁰ M. Bogdani, fq. 95.

Së dyti: Në Shqipëri, dëshira për ndryshimin e regjimit politik erdhi nga mjerimi ekonomik. Shumë studiues pranojnë se faktori kryesor i dështimit të regjimit komunist ishte dështimi i politikave ekonomike. Problemet ekonomike në Shqipëri ishin të përmasave të jashtëzakonshme. Siç është trajtuar edhe më lart, kolapsi ekonomik i Shqipërisë kishte çuar në varfëri ekstreme pothuajse krejt popullatën. Problemi është se gjatë ish-regjimit “gjendja materiale ka qenë aq e keqe, dhe shtypja ka qenë aq ndrydhëse, sa çdo gjë që mund të ndodhte mbas vitit 1990, do të ishte një përmirësim i pakrahasueshëm⁴¹¹”. Në këtë kuptim, ndryshimet që do të vinin pas viteve ‘90 nuk ishin rezultat i mirëqeverisjes, përkundrazi ishin rezultat i punës së palodhur të shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit. Në këtë kontekst, klasa e re politike jo vetëm shfrytëzoi mjerimin ekonomik të shqiptarëve, por dhe dëshirën e tyre për rimëkëmbje dhe zhvilloi një lojë të pandershme politike, duke deformuar vlerat demokratike dhe, rrjedhimisht, edhe dëshirën e shqiptarëve për një Shqipëri evropiane.

Duke ardhur pothuajse në një masë të madhe në krye të partive politike nëpërmjet influencës së ish-regjimit, drejtuesit e rinj vijonin zbatimin e një politike të mbushur me demagogji, pa moral dhe aspak realiste. Vështirësitë e jetës së përditshme shoqëruar me frikën dhe pasigurinë për të ardhmen ia morën klasës politike entuziazmin dhe aftësinë fillestare për të mbajtur në lartësinë e duhur rolin e saj për realizimin e proceseve transformuese. Njëkohësisht, shkarja drejt zhgënjimit apo besimit fanatik në partitë politike, e ka penguar shoqërinë shqiptare që të transformojë vetveten. Ajo ka ndjekur ritmin e transformimit të bërë nga klasa politike pa realizuar funksionin e saj të përfshirjes reale në proceset e ndryshimit dhe transformimit të vendit. Mosmarrja në konsideratë e realizimit të një analize të thellë dhe të plotë për vlerësimin e kapaciteteve të vendit për rimëkëmbjen e ekonomisë do të bënte që drejtuesit e rinj politikë të anashkalojnë mbajtjen e përgjegjësive për thellimin e krizës në vend, madje edhe pas ndryshimeve politike. Pikërisht ky fakt, pra, shthurja e sistemit si pasojë e dështimit të ekonomisë së centralizuar dhe gjendjes në të cilën ndodhej vendi do të ndikonte negativisht jo vetëm në ndërtimin dhe funksionimin e elitës së re politike, por mbi të gjitha në mungesën e llogaridhënies dhe moralit përpara zgjedhësve. Elementët potencialë dhe realisht kontribues, shumë shpejt nuk do ta gjenin më veten në mjedisin e ri politik. Kundër politikave të gabuara të drejtimit të shtetit prej klasës së re politike mungonte opoenca e intelektualëve dhe ekspertëve të paanshëm. Bashkë me largimet masive të popullatës kishin lënë vendin një numër i madh profesionistësh duke krijuar boshllëk në shumë drejtime në fushën ekonomike, politike dhe shoqërore. Në këtë pikë mund të themi se vështirësitë ekstreme ekonomike kontribuan në formimin e një elite politike problematike. Decentralizimi i ekonomisë së vendit u pa si mundësi për përfitim personal dhe jo si një mundësi reale për rimëkëmbjen e qytetarëve dhe vendit. Asnjëra nga të dyja partitë kryesore në vend nuk e menaxhoi si duhet mjerimin ekonomik që kishte pllakosur vendin. Ata shfrytëzuan çdo mundësi për të përfituar nga prona

⁴¹¹ Shinasi A. Rama, “Përrallat e tranzicionit shqiptar”, fq. 19.

shtetërore duke lënë ende të pazgjidhura probleme të mprehta të pronësisë. Këto probleme mbeten të tilla edhe sot.

3.4 Shqipëria dhe orientimi drejt Komunitetit Evropian

Për më shumë se 45 vjet, në shoqërinë shqiptare është ushtruar një propagandë e fuqishme antiperëndimore, por pavarësisht këtij fakti, ajo që triumfoi tek ne si popull ishte bindja se e vetmja rrugë për ta çuar vendin përpara ishte integrimi dhe bashkimi me familjen e madhe evropiane. Populli dhe politikanët e Shqipërisë, qysh në krye të herës dëshiruan modelin e një Shqipërie Evropiane. “E duam Shqipërinë si gjithë Evropa⁴¹²” ishte parrulla më e përfaqshme nga shqiptarët në fillim të viteve ‘90. Për ta, Evropa përfaqësonte mirëqenie, zhvillim, begati, bollëk, liri, të drejta etj. Pavarësisht dëshirës, integrimi nuk rezultoi të ishte një proces i lehtë. Integrimi ka të bëjë me zhvillimin e brendshëm të vendit bazuar në burimet ekonomike, demografike, kulturore etj.

Në këtë kontekst, pluralizmi politik ishte akti fillestar i një transformimi rrënjësor që duhej të bënin shteti, ekonomia dhe shoqëria shqiptare për të shkuar drejt Evropës. Nga ana tjetër, ardhja në pushtet e demokratëve, rriti ndjeshëm mbështetjen e ndërkombëtarëve për Shqipërinë. Në vitet e para “*Shqipëria u bë përfituesja më e madhe e ndihmës Perëndimore për frymë në Evropën Lindore*⁴¹³”.

Shumë besonin se entuziasmi dhe mbështetja e vendeve të Evropës Perëndimore dhe Amerikës ndaj këtyre ndryshimeve do të shërbente si garanci për lehtësimin e procesit dhe mbi të gjitha për një shpëtim sa më të shpejtë nga trashëgimia dhe prapambetja komuniste. Politika shqiptare ia arriti të kishte “*suksese të konsiderueshme në kërkimin e partneritetit me Evropën*⁴¹⁴. Komuniteti Evropian si në atë kohë, ashtu edhe sot (BE-ja) nuk ka kursyer ndihmën ndaj Shqipërisë. Që nga viti 1991, Bashkimi Evropian i kishte dhënë Shqipërisë një ndihmë në vlerën e 671,600.000 \$, duke u bërë donatori kryesor për vendin⁴¹⁵.

Çështja e orientimit drejt Evropës lidhet me projektimin që kishin shqiptarët për rolin e tyre në këtë proces. Këtë qasje fillestare të shoqërisë shqiptare, studiuesi Rama e ka përmbledhur si më poshtë:

“Shpresa, apo më mirë bindja kolektive, ishte se, tani që do të ndryshohej sistemi, bota e huaj do të bëhej njerka që do të kujdesej përjetë për shqiptarët, sepse këta “përmbysën” komunizmin. Këta njerëz, nga ana e tyre, dukej se nuk e mendonin

⁴¹² Vep.cit. Blendi Kajsio, “Vdekje Politikës, Liri Popullit! – Kriza e Përfaqësimit në Shqipëri”, Revista Polis, Nr.5, fq. 9.

⁴¹³ Biberaj, fq. 206.

⁴¹⁴ Karen Dawisha and Bruce Parrott (editor) “*Politics, Power, and the Struggle for Democracy in South-East Europe*”, Cambridge University press, second edition, 1999, fq. 338.

⁴¹⁵ Human Rights Watch, “*Human Rights in Post-Communist Albania*”, raport, New York, March 1996, fq. 175.

asnjëherë se të nesërmen e përmbysjes së sistemit, ata duhej të shkonin në punë e se jeta e përditëshme do të vazhdonte, pak a shumë, në hulli të njohura për ta. Karrocieri nuk mund të bëhej bankier brenda natës e kooperativisti nuk bëhej dot fermer⁴¹⁶”.

Në fillim, angazhimi drejt Komunitetit Evropian nuk u perceptua me rëndësinë e duhur. Për një masë të madhe të shoqërisë, kjo nuk nënkuptonte faktin që orientimi drejt Komunitetit Evropian ishte një rrugë e gjatë, e cila përmbante probleme të zhvillimit dhe përshtatjes me një shoqëri shumë herë më të zhvilluar.

Siç është trajtuar edhe më herët në këtë punim, pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe Komuniteti Ekonomik Evropian, në 11 maj 1992 u bë nënshkrimi i Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit. Shqipëria ishte vendi i parë në rajon që nënshkroi një marrëveshje të tillë⁴¹⁷. Marrëveshja kishte si qëllim “*të rregullonte marrëdhëniet ekonomike tregtare midis Shqipërisë dhe BE-së dhe për afrimin e legjislacionit ekonomik shqiptar me atë komunitar*”⁴¹⁸. Ndër të tjera, marrëveshja përmbante një klauzolë që linte të hapur mundësinë e thellimit të mëtejshëm të marrëdhënieve midis tyre. Në të përcaktohej se: “*Marrëveshja do të kontribuojë në çuarjen drejt objektivit për një marrëveshje asocimi, në një kohë të përshtatshme, kur të plotesohen kushtet, si edhe në zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve midis tyre*”⁴¹⁹.

Që nga viti 1991, Shqipëria përfitoi ndihma ekonomike nga Komuniteti Evropian. Një pjesë e kësaj ndihme ishte në formën e një kredie për investime, dhe një pjesë tjetër në formën e një granti për çështjet më emergjente. Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë, kjo e fundit u bë përfituese e Programit PHARE. Ky program ndihmonte vendet candidate në forcimin e kapacitetit të tyre institucional duke i bërë ato të afta për të përmbushur sfidat e anëtarësimit në BE. Gjatë periudhës 1991-2000, shuma totale e fondeve PHARE për Shqipërinë arriti vlerën e 631.5 milion Euro⁴²⁰.

Në këtë kohë, një moment i rëndësishëm në marrëdhëniet e Shqipërisë me BE-së u duk se do të shënohej pikërisht në vitin 1995. Në mars të vitit 1995, Bashkimi Evropian deklaroi se do të ndihmonte Shqipërinë në procesin e demokratizimit dhe respektimit nga qeveria të të drejtave të njeriut. Pavarësisht shkeljeve të vazhdueshme të të drejtave të njeriut kryer nga qeveria, Shqipërisë iu dha gjatë atij viti një ndihmë e madhe. Në 26 tetor program PHARE i BE akordoi një ndihmë prej 275,600,000 \$ dhe në 22 dhjetor u shtua edhe një shumë prej 32,500,000 \$ ndihmë për infrastrukturën⁴²¹.

⁴¹⁶ Shinasi Rama “*Përrallat e tranzicionit shqiptarë*”, Tiranë, Botimet Princ, 2012, fq. 83.

⁴¹⁷ <http://www.punetejashme.gov.al/al/misioni/integrimi-ne-be/marredheniet-shqiperi-be>

⁴¹⁸ “*Manuali i Procesit të Integrimit Evropian, Roli dhe rëndësia e institucioneve*”, European Movement in Albania, Tiranë, Shkurt 2009. fq. 29.

⁴¹⁹ Shiko materialin me temë “*Aktorët negociues, aftësitë dhe teknikat negociuese dhe lobizimi me BE në kuadrin e MSA. Monitorimi i procesit të angazhimeve të mara.*” Përgatitur nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, fq. 1.

⁴²⁰ <http://www.em-al.org/?fq=artikuj&gj=gj1&bir=26> aksesuar më 6.10.2012

⁴²¹ Raporti: *Human Rights in Post-Communist Albania*, fq. 175.

Nga një sondazh i Komisionit Evropian dhe bazuar në katër treguesit klasikë (drejtimi i vendit, mbështetja për ekonominë e tregut, kënaqja me demokracinë dhe të drejtat e njeriut) të Eurobarometrit për vendet e Evropës Qëndrore dhe Lindore, shqiptarët rezultojnë më optimistët nga të pyeturit⁴²². Perceptimi i tyre për mënyrën se si po drejtohej vendi ishte pozitiv. Nga këndvështrimi ekonomik, Eurobarometri theksonte se për të dytin vit radhazi, Shqipëria kishte rritje pozitive, në vitin 1995 arrinte në 6 %⁴²³. Vendi kishte shënuar disa suksese të dukshme në disa sfera të jetës ndërkohë që kishte arritur, gjithashtu, të bëhej anëtar i Këshillit të Europës më 13 korrik të vitit 1995, organizatës më të vjetër politike të Evropës⁴²⁴. Në vitin 1995, Shqipëria tentoi të hapte negociatat për një marrëveshje klasike asociimi me Bashkimin Evropian. Megjithëse në atë kohë, Shqipëria kishte bërë progres të dukshëm krahasuar me të gjitha vendet e rajonit, rezultatet nuk ishin ende aq pozitive sa për të bërë të mundur këtë hap. Ky vendim ishte rezultati i disa ngjarjeve që kishin vënë në pikëpyetje proceset demokratizuese në vend. Kështu, zgjedhjet parlamentare të mbajtura në maj të vitit 1996 kishin shkelur shumë standarde të një procesi normal zgjedhor. Ato ishin kundërshtuar nga opozita duke krijuar një precedent mjaft problematik edhe për vitet në vijim. Cenimi i zgjedhjeve së bashku me krizën e thellë financiare dhe sociale që pasoi në fillim të vitit 1997 nga rënia e skemave piramidale, shkaktuan ngrirjen e marrëdhënieve të vendit tonë me BE-në. Ngjarjet e rënda kishin shkatërruar shtetin dhe ekonominë e vendit dhe do të nevojiteshin vite për t'i ngritur në një nivel më të lartë marrëdhëniet kontraktuale Shqipëri - BE . Raportet midis tyre do të rivendoseshin kur gjendja politike dhe situata e përgjithshme të ishte më e favorshme.

3.5 Klasa politike dhe ngjarjet e viteve 1994 – 1997; raportet me Bashkimin Evropian

Gjatë vazhdimit të qeverisjes nga demokratët, vitet 1994-1997 u karakterizuan nga një sërë ngjarjesh politike, pika kulmore e të cilave ishte revolta popullore të vitit 1997. Kjo periudhë konsiderohet nga shumë analistë dhe studiues si shanci i humbur i Shqipërisë për të thelluar angazhimin me Bashkimin Evropian. Pas tranzicionit të paqshëm të pushtetit në vitin 1992, shumë kishin shpresuar se e keqja më e madhe kishte kaluar dhe se demokratizimi i Shqipërisë ishte në rrugën e duhur. Pritshmëritë nga të gjithë aktorët ndërkombëtarë ishin të larta. Kjo u duk në mbështetjen financiare që iu dha programit të qeverisë demokratike, për zbatimin e të cilit, gjatë viteve 1992-1995, ndihma

⁴²² European Commission, “*Central and Eastern Eurobarometer, public opinion and the European Union (19 countries' survey)*” no.6 March 1996, fq. 24, *burimi online*:

http://www.ab.gov.tr/files/ardb/evt/1_avrupa_birligi/1_6_raporlar/1_4_eurobarometers/CENTRAL_AND_EASTERN_EUROBAROMETER_PUBLIC_OPINION_AND_THE_EUROPEAN_UNION_19_COUNTRIES_SURVEY_March_1996.pdf

⁴²³ Vep.cit, fq. 28.

⁴²⁴ “*Manuali Informativ mbi Institucionet Shqiptare*”, European Movement in Albania, Tiranë, Shkurt 2010, fq. 31.

e huaj ishte afërsisht “1 miliard dollarë amerikanë US \$⁴²⁵”. Në këtë kohë, nën drejtimin e demokratëve u ndërmorën reforma të thella politike, ekonomike dhe shoqërore.

Siç rrodhën ngjarjet gjatë viteve 1994-1997, vendi jo vetëm u largua nga angazhimi për integrimin drejtë BE-së, por, mbi të gjitha, u largua nga rruga e proceseve demokratizuese. Cilat ishin arsytet që e çuan politikën e vendit drejt anarkisë? A ishte kjo e vetmja rrugë apo gjërat mund të kishin ndodhur ndryshe nëse do të kishte më shumë maturi nga drejtuesit politikë? Për këdo që tenton të analizojë sot zhvillimet e tranzicionit të hershëm është e lehtë që të ketë dhe të bëhen vërejtje apo kritika, të ketë rezerva dhe pakënaqësi ndaj klasës politike, por ka shumë aspekte të tjera që dalin jashtë mundësisë apo ndikimit të kësaj të fundit.

Në analizën tonë, ne do të fokusohemi në tri ngjarje kryesore: në mosmiratimin e kushtetutës “presidenciale” të vitit 94, në zgjedhjet e 26 majit 1996 dhe në krizën e firmave piramidale.

Mosmiratimi i kushtetutës: Detyra për ta bërë vendin me kushtetutë të re kishte qenë një nga ato çështje që sipas liderëve demokratë do të realizohej shumë shpejt pas ardhjes së tyre në pushtet. Ndër të tjera, domosdoshmëria për miratimin e kushtetutës erdhi edhe si një kërkesë e Bashkësisë Evropiane afati i të cilës ishte 30 dhjetor 1994⁴²⁶. Rrënimimi i shtetit të diktaturës kishte nxjerrë në pah nevojën urgjente për reformimin e tij me institucione të cilat do të ishin garantët e sistemit të ri politik. Lënia e vendit pa kushtetutë deri në vitin 1994 kishte krijuar probleme të rënda institucionale. Mbivendosja e pushteteve si pasojë e mungesës së kushtetutës dhe vakumi institucional i krijuar u la mundësinë drejtuesve të rinj politikë që të vijonin me modelin partiak të drejtimit të vendit. Ata nuk u shkëputën dot nga tradita e dikurshme, pra, që tashmë, partia në pushtet të mos ishte mbi ligjin dhe shtetin. Situata paraqitej me dy anët e saj kritike, nga njëra anë kemi çmontimin e shtetit dhe nga ana tjetër ndërtimin e tij jo mbi baza të shëndosha kushtetuese. Thënë ndryshe kemi të bëjmë me pasivitetin e klasës politike në realizimin e reformave demokratizuese, gjë që u duk që me vonesat e hartimit të Kushtetutës së re, me militantizmin në administratën shtetërore dhe pandëshkueshmërinë e korrupsionit që sa vinte dhe rritej në radhët e zyrtarëve të rinj. Ndonëse viti 1993 kishte shënuar disa suksese për qeverinë, viti 1994 rezultoi më i vështirë në shumë drejtime. Sipas studiueses Vickers “viti 1994 filloi si një vit ogurzi për politikën shqiptare pasi qeveria e PD-së po akuzohej rëndë për korrupsion dhe autoritarizëm patriarkal, duke përdorur gjithnjë e më shumë metodat kundërvënëse me opozitën⁴²⁷”. Sipas Biberajt, në vitin 1994, “u dukën shenja se demokratët nuk po i mbanin premtimet që kishin bërë për zhvillimin e demokracisë. Berisha po shfaqte prirje për t’i drejtuar të gjitha punët vetë, duke përqendruar pushtetin përherë e më shumë në duart e veta dhe duke mbajtur një qëndrim të papajtuësëm ndaj opozitës dhe atyre që nuk ishin në një mendje me të në partinë e

⁴²⁵ Bernd J. Fischer, “Shqipëria që prej vitit 1989: trashëgimia hoxhaiste”, në “Shqipëria në dhjetë vitet e ardhshme – vështrim drejt së ardhmes” botim i AIIS, Tiranë, 2012, fq. 62-3.

⁴²⁶ Shiko: M. Vickers, fq. 372.

⁴²⁷ M. Vickers, fq. 368.

tij”⁴²⁸. Tendenca për të grumbulluar sa më shumë pushtet në duart e presidentit u pa edhe në projekt-kushtetutën e vitit 1994. Projekt-kushtetuta nuk u miratua dhe hasi kundërshti të forta për disa arsye.

Së pari, hartimi i projekt-kushtetutës u bë shpejt dhe pa pjesëmarrjen e gjerë të forcave politike të vendit. Situata e acaruar politike dhe armiqësitë ndërmjet dy forcave kryesore i kishin shtyrë palët në mungesë totale të bashkëpunimit. Mospërfshirja e palëve në procesin e hartimit rezultoi një minus i madh jo vetëm sepse vendi u la pa kushtetutë, por mbi të gjitha për frenimin e ndërtimit të demokracisë dhe shtetit të së drejtës në vend.

Së dyti, projekt-kushtetuta haste kundërshti përsa i takonte pushtetit që duhej të kishte institucioni i Presidentit.

Së treti, luftën e vet politike, socialistët e bazuan në diskreditimin e kushtetutës dhe në burgosjen e padrejtë të liderit të tyre Fatos Nanos⁴²⁹. Sipas Çejkut “*opozita e majtë e shfrytëzoi fushatën antikushtetutë për qëllime të mirëfillta politike duke i shkaktuar vendit një vonesë në procesin e demokratizimit*”⁴³⁰.

Së katërti, deformimi i procedurës për miratimin e kushtetutës. U shmang institucioni i parlamentit ku projekt-kushtetuta duhej të miratohej paraprakisht dhe më pas të kalonte për referendum popullor. Shmangia e parlamentit ishte pasojë e mungesës së 2/3-ve të deputetëve. Si socialdemokratët, ashtu edhe deputetët e Aleancës Demokratike, apo deputetët e minoritetit grek ishin deklaruar kundër miratimit të kushtetutës. Në këto kushte, maxhoranca nuk gëzonte numrin e domosdoshëm prej 94 deputetësh për miratimin e saj në parlament⁴³¹.

Si rrjedhim edhe i sa më sipër, rezultati i referendumit të mbajtur më 6 nëntor 1994 do të ishte negativ. Në votime morën pjesë rreth 84.43% e zgjedhësve nga të cilët 53.9% votuan kundër Projekt-Kushtetutës dhe 41.7% e tyre votuan pro saj. Për udhëheqësit dhe ligjvënësit shqiptarë, tentativa e dështuar për ta bërë vendin me kushtetutë rezultoi një problem që nuk mori zgjidhje gjatë periudhës së qeverisjes së shtetit nga ana e Partisë Demokratike. Mosmiratimi i Kushtetutës dëshmoi për pakënaqësi të elektoratit jo vetëm për mënyrën sesi u konceptua Kushtetuta, por edhe për mënyrën me të cilën po drejtohej vendi. Impakti negativ i mosmiratimit të kushtetutës u ndje sidomos në rritjen e autoritarizmit nga ana e presidentit të vendit Sali Berisha.

Qysh nga zgjedhja e tij si president, Berisha kishte arritur të kishte shumë pushtet dhe praktikisht institucionet e shtetit ishin nën diktatin e tij. Përveç ekzekutivit, gjyqësori pësoi deformime të rënda. Ai jo vetëm krijoi varësi nga institucioni i Presidentit, por brishtësia e tij prodhoi mungesën e ndëshkueshmërisë për zyrtarët abuzues dhe dhënien e drejtësisë për qytetarin e thjeshtë. Klasa politike e këtyre viteve u shqua jo për krijimin e sistemit të drejtësisë, por për rrënimin e tij, duke filluar me trupën e gjyqtarëve dhe

⁴²⁸ E. Biberaj, fq. 224.

⁴²⁹ Shiko: A. Çejku, fq. 97.

⁴³⁰ A. Çejku, fq. 116.

⁴³¹ Shiko: *Ngjela: Biseda me Azem Hajdarin për Kushtetutën e vitit 1994*, Revista MAPO online: <http://mapo.al/2013/06/17/ngjela-biseda-me-azem-hajdarin-per-kushtetuten-e-vitit-1994/>

prokurorëve, të cilët u diplomuan në këtë fushë vetëm me kurse 6-mujore dhe u arrit deri në emërimin apo shkarkimin e tyre mbi baza aferash politike⁴³². Mungesa e traditës në këtë drejtim ia lehtësoi punën klasës drejtuese, e cila minoi krijimin e shtetit të së drejtës vetëm për interesat e saj të ngushta. Që nga ajo kohë, sistemi i drejtësisë ka qenë shënjestër për vënie nën kontroll nga të gjitha forcat politike që kanë qenë në pushtet. Ngritja e një drejtësie problematike e largoi edhe më tej vendin nga standardet e domosdoshme të demokracisë dhe rriti artificialisht dhe bëri të paprekshëm pushtetin e politikanëve.

Sipas anaizës së studiuesit Fischer, regjimi politik i vendosur gjatë këtyre viteve ishte më tepër një *“iluzion demokracie”*, kjo si pasojë jo vetëm e autoritarizmit të Berishës, por edhe e ekzistencës së një opozite tejet të dobët dhe të drejtimit të shtetit nga *“një aparat gjerësisht i politizuar”*⁴³³. Për analistin Baze, i cili ishte gjithashtu një nga bashkëpunorët më të afërt të Presidentit Berisha në atë kohë, modeli i qeverisjes së presidentit sipas tij kishte si tipar kryesor *“qeverisjen me dy institucione, me ato formale dhe ato reale”*⁴³⁴. Baze pohon më tej se: *“Për të (Berishën) nuk ka ministri, gjykatë, shërbim informativ, prokurori apo media, por ka njerëz. Ata janë institucioni real dhe nuk kanë asnjë lidhje me institucionin formal”*. Më këtë, ai nënkuptonte individë *“të caktuar brenda këtyre institucioneve, që ekzekutojnë politikën e tij [shënimi im – E.Z.]”* duke qenë ata pushteti real në zyrat e shtetit. Kjo formë qeverisjeje bënte të mundur jo vetëm mbajtjen dhe mosdelegimin e pushtetit, por mbi të gjitha kontrollin e plotë të tij. Në këtë linjë argumentimi merr kuptim agresiviteti i shfaqur për të vënë nën kontroll ato institucione *“që i rezistojnë këtij modeli”*⁴³⁵. Rrjedhimisht, për atë kohë mund të pranohet ajo që shpreh analisti Gumbell, se *“Presidenti Berisha dhe qeveria e tij kanë mëse dy vjet që kanë humbur popullaritetin. Reputacioni i mëparshëm, si kampionë të demokracisë dhe të tregut të lirë, është njollosur tani nga represioni në rritje kundër opozitës politike, kundër shtypit të pavarur dhe kundër institucioneve shtetërore duke filluar nga organet e drejtësisë”*⁴³⁶. Kjo situatë politike krijoi probleme duke çuar në ndërtimin e një shteti të dobët dhe të kapur nga politika. Gjatë këtyre viteve hedhin rrënjë, gjithashtu, dy nga fenomenet më negative që do ta shoqërojnë gjatë zhvillimin e demokracisë: manipulimi dhe kontestimi i zgjedhjeve dhe vënia *de facto* e gjyqësorit në varësi të politikës.

Analiza e zgjedhjeve parlamentare të 26 majit 1996 është e një rëndësie të madhe jo vetëm për mënyrën sesi u zhvilluan ato, por edhe për mënyrën sesi e përdori dhe shfrytëzoi këtë moment klasa politike e të gjithë spektrit. Rëndësia evidentohet së paku për dy arsye. Së pari: *zgjedhjet parlamentare të 26 majit ishin një test i rëndësishëm i*

⁴³² Shiko: Bernd J. Fischer, *“Shqipëria që prej vitit 1989: trashëgimia hoxhaiste”*, në *“Shqipëria në dhjetë vitet e ardhshme – vështrim drejt së ardhmes”* botim i AIIS, Tiranë 2012, fq. 66.

⁴³³ Ibid, (Fischer) fq. 67.

⁴³⁴ Mero Baze, *“Viti ‘97 Prapaskenat e krizës që rrënuan shtetin, Toena , Tiranë, 2010, fq. 352.*

⁴³⁵ Ibid.

⁴³⁶ Andrew Gumbell *“Regjim gangsterësh që ne finançojmë”* The Independent 14 shkurt 1997, botuar në Revista Përpjekja, Nr. 11-12, Tiranë shtator – dhjetor, 1997, fq. 14.

angazhimit të klasës politike ndaj demokracisë dhe integritit; dhe së dyti: për pasojat e rënda që pësoi demokracia shqiptare për shkak të prekjes së votës së lirë.

Organizimi i zgjedhjeve të rregullta, të lira dhe të ndershme ishte jo vetëm një detyrë, por do të shërbente si garanci themelore për të dëshmuar se sistemi i ri politik po funksiononte. Polarizimi, kontradiktat dhe përçarja e klasës politike shqiptare deri në ekstrem kishte krijuar një gjendje mosbesimi tejet të lartë në të gjitha partitë politike. Mesa mundën, të gjithë aktorët politikë po kontribuonin në manipulimet “e pritshme” që do të ndodhnin në zgjedhjet parlamentare të 26 majit. Nga njëra ana, zgjedhjet e vitit 1996 ishin një test i fortë për politikën e ndjekur gjatë atyre katër viteve nga Berisha dhe demokratët dhe, nga ana tjetër, ishin një test i fortë për politikën që kishin ndjekur socialistët si opozitë. Të gjitha sondazhet tregonin për një fitore të sigurt të demokratëve. Në exit poll-in e zhvilluar në ditën e zgjedhjeve, Instituti Ndërkombëtar Republikan parashikonte fitoren e demokratëve në shifrën e 56%, ndërsa socialistët pritej të fitonin rreth 22%⁴³⁷.

Si në planin e brendshëm, ashtu dhe në planin e jashtëm dështimi në përmbushjen e testit (pra, moszhvillimi i zgjedhjeve të lira dhe të drejta) i kushtoi shumë Shqipërisë. Disa studiues argumentojnë se manipulimi i zgjedhjeve të 26 majit nuk ishte diçka e paparashikuar apo e ndodhur aty për aty, përkundrazi, ato zgjedhje ishin një produkti final që ishte planifikuar me kohë, por thjesht nuk ishte parashikuar përmasa e fenomenit e si rezultat situata doli jashtë kontrollit. Veprimet e maxhorancës, si për shembull, miratimi i ligjit të Gjenocidit, ligji mbi verifikimin e figurës, ndryshimet mbi ligjin e zgjedhjeve, censura në media e veprime të tjera si këto ishin sinjale të forta që tregonin për pasigurinë e demokratëve në fitoren e sigurt. Nga ana tjetër, edhe socialistët po bënin të gjitha përpjekjet që këto zgjedhje të ishin një dështim. Në arenën ndërkombëtare, ata kishin dhënë alarmin për prekjen e procesit zgjedhor. Pak a shumë, të dyja palë ishin fajtores pasi disa e parashikuan situatën, ndërsa të tjerët sepse e vunë në zbatim, pra, e bënë të ndodhte ajo situatë.

Ajo çfarë ndodhi në 26 maj nuk ishte vetëm dështim në realizimin e një procesi normal zgjedhor; precedenti i krijuar me ato zgjedhje ishte shumë i rëndë. Manipulimi dhe bojkoti rezultuan akte që dëmtuan thelbin e demokracisë, pasi jo vetëm që u prek legjitimiteti, por u deformua mekanizmi që zgjedh politikëbërësit. Në këtë kontekst, përpjekjet për fitore me çdo kusht ndikuan në realizimin e zgjedhjeve të manipuluar. Rezultatet e zgjedhjeve të 26 majit tregonin për një fitore më të thellë të demokratëve sesa në zgjedhjet e vitit 1992. Nga 140 vendet e parlamentit të ri, Partia Demokratike kishte fituar 122 deputetë (87 përqind), pra, mbi dy të tretat e vendeve të parlamentit. Partia Socialiste kishte fituar 10 deputetë ose 20.4 përqind, një reduktim i ndjeshëm krahasuar me 32 deputetët e fituar në zgjedhjet e vitit 1992. Ndërkohë, Partia Republikane dhe Bashkimi për të Drejtat e Njeriut fituan nga 3 deputetë secili, Balli Kombëtar 2 deputetë. Partia Socialdemokrate dhe Aleanca Demokratike nuk arritën të

⁴³⁷ IRI, *Observation Report on the Albanian Parliamentary Elections of May 26, 1996*, fq. 30-31.

hynin në parlament⁴³⁸. Ky rezultat i Partisë Demokratike u vu në pikëpyetje të madhe mbi të gjitha nga bojkotimi i bërë nga Partia Socialiste. Pak orë para se të mbylleshin qendrat zgjedhore, socialistët u tërhoqën nga zgjedhjet me pretendimin se kishte parregullsi të mëdha në procesin e votimit. Ata deklaruan se nuk do t'i pranonin rezultatet dhe nuk do të njihnin parlamentin e ri. Në këtë rast, *“nëse opozita nëpërmjet bojkotit deshi t’i diktonte pushtetit humbjen, pushteti nëpërmjet mbifitores deshi t’i diktonte opozitës fitoren”*⁴³⁹. Zgjedhjet parlamentare rezultuan një triumf dhe tragjedi njëherësh, si për Presidentin Berisha e Partinë Demokratike, ashtu edhe për tranzicionin e Shqipërisë drejt demokracisë. Ai ishte një triumf për faktin se një fitore bindëse e demokratëve përbënte një riafirmim të shkëputjes nga komunizmi, por ishte dhe një tragjedi për faktin se fushata e hidhur dhe e kontestuar kulmoi në parregullsi serioze gjatë zgjedhjeve. Këto bënë që Bashkimi Evropian, OSCE-së, Shtetet e Bashkuara, dhe organizata e respektuar për të drejtat e njeriut Helsinki Watch të vinin në pikëpyetje integritetin e votimit dhe të ngrinin shqetësime lidhur me perspektivën e demokratizimit të vendit⁴⁴⁰. Për Biberajn, *“Zhvillimi i diskutueshëm i zgjedhjeve tregonte se elitat politike të Shqipërisë paskomuniste nuk kishin përvetësuar rregulla të pranueshme lidhur me zgjedhjet dhe demokracinë procedurale në përgjithësi. Si Partia Demokratike në pushtet, ashtu edhe opozita, sidomos Partia Socialiste, ishin përgjegjëse për parregullsi zgjedhore”*⁴⁴¹. Për analistin Baze *“Historia e rrënimit të zgjedhjeve në Shqipëri është trauma më e madhe që ky vend ka pësuar pas rënies së komunizmit”*⁴⁴². Sipas tij *“Te rrënimi i tyre duhen kërkuar sot rrënjët e shumë prej problemeve të mëdha që ka vendi, siç është mosreformimi i klasës politike, mbetja në pushtet e dy-tre emrave të politikës shqiptare, lidhjet e tyre me krimin e organizuar dhe nëntokën e mafias rajonale dhe botërore dhe, mbi të gjitha, vazhdimi i traditës së zgjedhjeve të vjedhura.”*⁴⁴³

Një moment tejet kritik i klasës politike ishin edhe ngjarjet e rënda të vitit 1997. Kriza shqiptare filloi me falimentimin e parë të firmave financiare në nëntor të vitit 1996 dhe më pas, në fillim të marsit 1997, shndërrohet në një revoltë të armatosur⁴⁴⁴. Ëndrra e një tranzicioni të qetë dhe të suksesshëm u prish dhunshëm dhe dhimbshëm. Kriza e vitit 1997 nxorri në pah për politikën shqiptare defekte të mëdha të procesit të zhvillimit të ekonomisë së tregut të lirë, të një shteti të pafuqishëm, si dhe të një paqëndrueshmërie të lartë institucionale. Nga ky këndvështrim mund të shpjegohet degjenerimi i situatës politike në vend drejt anarkisë totale. Për Çejkun, *“terreni që gjetën forcat regresive për të*

⁴³⁸ Ibid.(IRI), fq.33.

⁴³⁹ A. Çejku, fq. 156.

⁴⁴⁰ Nicholas Pano *“The process of democratization of Albania”* botuar në Karen Dawisha and Bruce Parrott (editor) *“Politics, Power, and the Struggle for Democracy in South-East Europe”*, Cambridge University Press, second edition, 1999, fq. 340.

⁴⁴¹ E. Biberaj, fq. 416.

⁴⁴² Mero Baze, *“Viti ‘97 Prapaskenat e krizës që rrënuan shtetin”*, Toena, Tiranë, 2010, fq. 5-6.

⁴⁴³ Ibid.(Baze)

⁴⁴⁴ Roberto Morozzo Della Rocca, *“Shqipëria Rrënjët e Krizës”*, Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, Tiranë, 2000, fq. 7.

kthyer një protestë ekonomike në një “*kryengritje popullore për demokraci*”, apo “*revolucion demokratik të vonuar*”⁴⁴⁵ lidhet me keqfunksionimin e demokracisë në vend. Siç konstaton me të drejtë edhe Kadare, në ngjarjet e vitit 1997 “*...ndërtesa e shtetit shqiptar u shemb*”⁴⁴⁶. Për Carothers: “*Në situata të caktuara, demokratizimi ka nevojë të presë për ndërtimin e shtetit. Kur një shtet është shembur tërësisht ose ka dështuar nga goditja e një lufte civile ose nga fatkeqësi të tjera të akumuluar apo akute, të shkuarit me shpejtësi drejt zgjidhjeve dhe konkurrencës së hapur politike nuk ka kuptim. Shteti do të duhet të ketë të paktën kapacitetet minimale funksionale, si dhe diçka e cila të ketë ngjashmëri me një monopol të forcës para se një vend i tillë të mund të shkojë në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm pluralist politik*”⁴⁴⁷. Nga kjo qasje, shfrytëzimi politik që u bëri opozita pasojave që erdhën nga falimentimi i firmave piramidale rezultoi një zgjedhje e keqe. Në situata të tilla të rënda, nga e gjithë klasa politike pritet më shumë bashkëpunim dhe kapërcim të interesave të ngushta partiake në emër të së mirës së përbashkët. Problemet e rënda me të cilat përballej vendi, si dhe zhvillimi i një lufte të ashpër politike kishin larguar vëmendjen nga parandalimi i fenomeneve negative me të cilat shoqërohet një tranzicion i atyre përmasave. Politika nuk po merrej me gjërat thelbësore që i duheshin vendit për të ndërtuar një regjim demokratik të sigurt. Mungesa e shtetit u bë më e rëndë pikërisht kur firmat piramidale të tipit Ponzi falimentuan. Ato kishin shpërthyer në përmasa të jashtëzakonshme gjatë vitit 1996 dhe falimentuan në janar të vitit 1997 duke thithur më shumë se 1 miliard dollarë⁴⁴⁸.

Viti 1996 pati zhvillimet e veta negative. Në fushën politike, ato lidheshin me manipulimin dhe kontestimin e zgjedhjeve, me bojkotimin e parlamentit nga opozita, ndërsa në fushën ekonomike zhvillimet negative kishin nisur me shpenzimet e mëdha buxhetore për qëllimet elektorale, rritjen e pabazuar të pagave, shtyrjen e futjes së TVSH-së në paketën fiskale, si dhe zgjerimin galopant të skemave piramidale. Për studiuesin Rama, një nga arsyet e lulëzimit të këtyre firmave piramidale lidhej me *mungesën e rezultateve reale ekonomike në vend*. Sipas studiuesve, në shumë tregues makroekonomikë, kriza u shfaq qartë që në fund të vitit 1996 dhe treguesi më i dukshëm ishte trefishimi i inflacionit, i cili kapi shifrën e 17.4%⁴⁴⁹. Po sipas Ramës, një faktori i dytë lidhet me implikimin e spektrit politik me këto firma. Të dyja partitë kryesore të vendit kishin përfituar nga lulëzimi i firmave piramidale. Për njërën palë përfitohej nga sponsorizimet për fushata elektorale ndërsa për palën tjetër kontributet vinin nga implikimi i përkrahësve të kësaj force në administrimin e këtyre firmave⁴⁵⁰. Për këto dhe

⁴⁴⁵ Shiko: A. Çejku, fq. 10.

⁴⁴⁶ Ismail Kadare dhe të tjerë “Ballkani i Jugut: Perspektiva nga Rajoni” Onufri, Tiranë, 2001, fq. 23.

⁴⁴⁷ Thomas Carothers, “How Democracies Emerge” *Journal of Democracy January 2007, Volume 18, Number 1* fq. 19 burimi online: <http://www.journalofdemocracy.org/articles/gratis/Carothers-18-1.pdf>

⁴⁴⁸ Vep. cit. në Shinasi Rama, “*Probleme Politike Shqiptare*”, fq. 52.

⁴⁴⁹ Shiko: Shkëlqim Cani, Sulo Hadëri, “*Sistemi Financiar Shqiptar në Tranzicion: Progres apo brishtësi?*”, Banka e Shqipërisë në dekadën e dytë të tranzicionit, fq.9 punimi gjendet online : http://www.bankofalbania.org/web/pub/cani_haderi_shq_204_1.pdf

⁴⁵⁰ Shiko: Shinasi Rama, fq. 53-4.

arsye të tjera, politika ishte e papërgatitur në manaxhimin e fenomenit dhe pasojave të tij. Serioziteti i shfaqjes së krizës së piramidave të fajdeve nuk ishte parashikuar as nga qeveria dhe as nga institucionet ndërkombëtare financiare, pavarisht disa paralajmërimeve të FMN-së dhe BB-re rreth tetorit të vitit 1996⁴⁵¹. Rënia e firmave piramidale njëra pas tjetrës do të sillte pasoja të rrezikshme për vendin. Në shkallë kombëtare llogaritet që rreth 70% e familjeve shqiptare të kenë humbur kursimet në këtë mashtrim të madh⁴⁵². Falimentimi i tyre u shoqërua me revolta dhe urrejtje armiqësore, masivizimi i të cilave lidhej me përfshirjen e një pjese të madhe të shoqërisë shqiptare në huadhënie. Shembja e skemave piramidale nxiti revoltën e armatosur dhe izoloi vendin nga zhvillimet demokratike bashkëkohore. Revolta e armatosur solli shkatërrimet masive, por plaga më e rëndë ishte ndarja antagonistike e shoqërisë. Për analistin Baze, kriza që preku shtetin dhe shoqërinë shqiptare ka dy pikëvështrime kryesore, të cilat kanë ndarë jo vetëm politikën shqiptare, por dhe atë evropiane e amerikane rreth krizës. *Shumë vende evropiane ishin të gatshme ta shikonin atë si një krizë të skemave piramidale, prodhuar nga padija e drejtuesve të rinj të qeverisë shqiptare. Përballë tyre ishte teza solide dhe e qartë e politikës amerikane, se e gjitha ishte një krizë e zhvillimit të demokracisë⁴⁵³*. Për ne, qasja amerikane shkon më afër arsyes dhe argumentimit të saktë mbi fenomenin. Skemat piramidale nuk ishin arsye, por pasojë. Në një shoqëri normale ku funksionon shteti dhe ligji, firma të kësaj natyre nuk mund të ekzistojnë, prandaj ne i qëndrojmë mendimit se mungesa e një shteti ligjor është arsyeja e vërtetë e lindjes së krizës. *Kjo mund të quhet krizë e demokracisë, për aq kohë sa shihet se nuk ka ndjekur ligjësitë e demokracisë⁴⁵⁴*. Në lidhje me situatën e krijuar, Tonino Perna shprehet:

“Shqipëria është vendi i ekstremizmave. Ishte ekstremist marksizmi i saj dhe është ekstremist procesi i saj i tranzicionit... Brenda pak vitesh, ekonomia shqiptare kaloi nga kolektivizimi i shfrenuar në një ekonomi të plaçkitjes moderne, ku sfera e qarkullimit monetar mbizotëron mbi ekonominë reale, në të cilën pasuritë e mëdha krijohen e shemben nëpërmjet lojës financiare, korrupsionit politik e paligjshmërisë. Ky njihet si kapitalizmi kazino⁴⁵⁵”.

Fillimi i vitit 1997 ishte tejet i vështirë; situata në të gjithë vendin ishte destabilizuar. Si pasojë e revoltës popullore për humbjen e kursimeve, qeveria nuk po arrinte të manaxhonte situatën e krijuar.

Presioni ndërkombëtar ishte në rritje sidomos pas vendosjes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe dorëheqjes së qeverisë Meksi më 2 mars 1997. Humbja e kontrollit të qeverisë mbi pjesën më të madhe të vendit dhe agravimi i situatës drejt një lufte civile nuk mund të ndryshonte nëse në uljen e tensioneve nuk përfshihej e gjithë klasa politike.

⁴⁵¹ M. Vickers, fq. 380.

⁴⁵² Della Rocca, fq. 19.

⁴⁵³ Mero Baze, “Viti ‘97 Prapaskenat e krizës që rrënuan shtetin”, Toena, Tiranë, 2010, fq. 351.

⁴⁵⁴ Ibid.

⁴⁵⁵ Revista *Përpjekja*, Nr. 11-12, fq. 9.

Protagonisti kryesor i atyre ngjarjeve, ish-Presidenti Berisha, pranon se me acarimin e situatës ai i kishte ofruar opozitës më 1 mars një marrëveshje me tri pika si më poshtë:

1. *Dënimin e dhunës bashkërisht.*
2. *Asnjë qeveri s'mund të sigurojë kthimin e parave të humbura nga piramidat.*
3. *Zgjedhje të reja brenda 45 ditëve*⁴⁵⁶.

Sipas dëshmimeve, kjo marrëveshje iu propozua Gjinushit, Mejdanit dhe Dokles dhe përmbante edhe 2 pika të tjera, të cilat Berisha nuk i përmend. Dy pikat e tjera kishin të bënin me:

(4) *Formimin e një qeverie socialiste duke përfshirë edhe lirimimin e Fatos Nanos ose (5) një qeveri e PD-së ku kontrollin e shtetit dhe të financave ta kishte opozita*⁴⁵⁷.

Liderët e PS-së e refuzuan marrëveshjen e lartpërmendur (pa arsye apo motive të ditura për opinionin publik dhe vetë drejtuesit e PD-së). Nëse do të ishte rënë dakort për këtë marrëveshje, vendi do kishte shpëtuar nga katastrofa. Edhe njëherë, forcat politike kryesore në vend nuk treguan se ishin në gjendje të vepronin shpejt dhe me efikasitet. Pas kësaj tentative të dështuar, më 9 mars, me ndihmën e ndërkombëtarëve u arrit nënshkrimi i *Marrëveshjes së Pajtimit Kombëtar* nga 10 forcat politike të vendit. Ndryshe nga marrëveshja e propozuar nga demokratët, marrëveshja e 9 marsit “*parashikonte krijimin e një qeverie të pajtimit kombëtar, amnistinë e përgjithshme për rebelët, dorëzimin e armëve brenda një jave dhe zgjedhje parlamentare në qershor 1997*”⁴⁵⁸. Për ish-Presidentin Berisha, dorëzimi i pushtetit ishte “*rrjedhojë e pamundësisë së Partisë Demokratike për të qeverisur vendin*”⁴⁵⁹. Në mars 1997, Berisha kishte humbur simpatinë e publikut si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Bashkëqeverisja do ta çonte vendin deri në prag të zgjedhjeve të parakohëshme. Çështja më problematike e diskutuar gjatë këtyre negociatave ishte mbajtja e zgjedhjeve më 29 qershor. Për këtë pikë, drejtuesit më të lartë politikë shfaqnin mungesë besimi dhe vullneti politik, kjo edhe për shkak të rrethanave të veçanta dhe ekstreme në të cilën ndodhej vendi. Kushtet aspak të përshtatshme nuk garantonin as elementet minimale për një proces zgjedhor normal. Krerët më të lartë të politikës në vend, nuk dukej se do ta arriinin gjuhën e kompromisit dhe bashkëpunimit pa ndërmjetësim. Marrëveshja e 9 marsit ishte produkt i ndërhyrjes vendimtare të bashkësisë ndërkombëtare dhe veçanërisht i rolit të OSBE-së. Nënshkrimi i marrëveshjes ishte një sukses i madh i bashkësisë ndërkombëtare, e cila ia arriti ta transformonte “*konfliktin e armatosur në një përplasje politike*”⁴⁶⁰ dhe ta vinte situatën në linjat e normalitetit. Arritja e një bashkëpunimi gjithëpërfshirës rezultoi një sfidë dhe arritje për ndërkombëtarët, sikundër mungesa e

⁴⁵⁶ Intervistë e Sali Berishës në Sokol Balla, “33, *Tranzicioni në Intervistë*”, UET Press, Tiranë, 2010, fq. 37.

⁴⁵⁷ Ibid.

⁴⁵⁸ Vep. cit. në Elez Biberaj, fq. 437.

⁴⁵⁹ Ibid. fq. 39.

⁴⁶⁰ Shinasi A. Rama, fq. 66.

aftësisë për kompromis e klasës politike vendase dëshmoi qartë për *krizën e vërtetë shqiptare*.

Për studiuesin Della Rocca, ekstremizimi i situatës mund të ishte shmangur “*nëse Berisha do t’i kishte ofruar menjëherë opozitës mundësinë për të hyrë në një qeveri koalicioni... mbase protesta nuk do të ishte shndërruar në një kryengritje të armatosur*⁴⁶¹”.

Pas ngjarjeve shkatërrimtare të vitit 1997, Shqipëria mund të klasifikohet si një shtet i dështuar, pasi institucionet shtetërore pushuan së funksionuari, kurse policia dhe forcat e armatosura u shpërbënë. Zgjedhjet e 29 qershorit ishin më shumë një disfatë për Berishën sesa një fitore për socialistët. Ajo çfarë ndodhi në muajt e parë të vitit 1997 rezultoi një fatkeqësi e rëndë për shqiptarët dhe një mundësi që segmente të caktuara të klasës politike që të arrinin pushtetin. Padurimi për marrjen e pushtetit shoqëruar me mosbesim dhe lojë të pandershme politike e kishin bërë të qartë për këdo se mendësia e vjetër politike ishte e pranishme në klasën e re politike me të gjitha trajtat e veta. Nga këto ngjarje, Shqipëria humbi rrugën e mbarë të demokratizimit dhe të proceseve të afrimit me Bashkimin Evropian.

3.6 Rikthimi i “komunistëve të moderuar”, stabiliteti i vendit 1998 – 2005

Vitet e para të tranzicionit kishin rezultuar sa me suksese dhe “mrekulli ekonomike”, aq edhe me dështime dhe rrënim të shtetit dhe demokracisë shqiptare. Përkundër sfidave serioze, Shqipëria doli nga kriza e firmave piramidale brenda një periudhe kohore relativisht të shkurtër. Zgjedhjet e parakohshme të 29 qershorit 1997 bënë të mundur kalimin e pushtetit nga demokratët tek socialistët në mënyrë, deri diku të pranueshme. Partia Socialiste arriti të fitonte 52 përqind të votave kundrejtë 26 përqind të votave për demokratët⁴⁶². Megjithë parregullsitë e hasura, pranimi i rezultatit të zgjedhjeve ishte pjesë e marrëveshjes së 9 marsit 1997 dhe në një farë mase ajo u pranua si nga faktori vendas, ashtu edhe nga ai ndërkombëtar. Ardhja e socialistëve në pushtet pas një kohe të shkurtër nuk është vetëm një dukuri shqiptare. Fenomeni i rishfaqes së partive ish-komuniste të rimodeluara është karakteristikë thuhet për të gjitha vendet në tranzicion⁴⁶³. Në Shqipëri, Partia Socialiste erdhi në pushtet nga zgjedhje të parakohëshme dhe në situatë jo normale, por arriti ta mbante pushtetin për dy mandate të njëpasnjëshme. Gjatë periudhës 1997-2005, Partia Socialiste ka patur monopolin e pushtetit politik si në shkallë kombëtare, ashtu edhe në atë vendore.

Në planin ekonomik, viti 1998 njihet ndryshe si viti i kthesës. Prodhimi i përgjithshëm bruto në vitin 1998 arriti në vlerën e 8% dhe inflacioni u vu plotësisht nën

⁴⁶¹ Della Rocca, fq. 9.

⁴⁶² James Pettifer, Miranda Vickers, “*Çështja Shqiptare, Reformësimi i Ballkanit*”, Bota Shqiptare, 2007, fq. 132.

⁴⁶³ Shiko: Revista Polis, Nr.5/2008, fq. 78-88.

kontroll në qershor të vitit 1999⁴⁶⁴. Riaktivizimi i biznesit u duk që në vitin 1998 kur rreth 30 mijë ndërmarrje ushtruan aktivitetin e tyre ekonomik. Aktiviteti tregtar përbënte rreth 52% të këtyre ndërmarrjeve, ndërsa 20% i përkisnin sektorit të shërbimeve. Një karakteristikë e kësaj veprimtarie është fakti se rreth 92% e ndërmarrjeve i përkisnin biznesit të vogël me 1 deri në 4 të punësuar⁴⁶⁵. Të dhënat tregojnë se lëvizja e lirë dhe e pakontrolluar e popullsisë ndikoi në ndryshimin e raportit të popullsisë qytetare me atë fshatare. Në fund të vitit 1999, popullsia qytetare arriti në 45.9%, çka përbënte një zhvendosje të madhe krahasuar me 35.7% që ishte në vitin 1989⁴⁶⁶. Lëvizjet e brendshme migratore të popullsisë prekën qendrat më të mëdha urbane të vendit. Këto lëvizje sollën probleme të urbanizimit, pronësisë, të integritit, probleme sociale etj. Ndikimi i stabilitetit *relativ* politik dha rezultate pozitive në ekonomi.

Tabela 4. Indikatorët kryesorë të zhvillimit makroekonomik (1997 – 2004).

	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004
PBB në %	-7.0	8.0	7.3	7.8	6.5	4.7	6.0	6.0
Inflacioni në % (CPI)	42.07	20.6	0.39	0.1	3.1	5.4	3.3	2.2
Papunësia në %	14.9	17.7	18.0	16.9	14.6	15.8	15.2	14.8
Deficiti buxhetor në/ % PBB	-12	-10.4	-11.49	-9.27	-8.57	-6.2		-4.9

Burimi: Bertelsmann Transformation Index 2003, fq.14 (të dhënat për vitet 1997-2002)

Bertelsmann Transformation Index 2006, fq.17(të dhënat për vitet 2003-2004)

Gjatë viteve 1999-2002, indikatorët makroekonomikë të Shqipërisë dëshmojnë qartë se ekonomia dhe financat e vendit vijuan të kishin qëndrueshmëri dhe rritje.

Riorganizimi i shtetit rezultoi pozitiv gjatë vitit 1998 e në vazhdim. Detyra imediate e qeverisë së re ishte të rivendoste ligjin dhe rendin në pjesën më të madhe të vendit. Rindërtimi i institucioneve dhe rimëkëmbja ekonomike paraqisnin gjithashtu sfida si për ekzekutivin, ashtu dhe për administratën shtetërore. Një fenomen që po përsëritej edhe me ardhjen e socialistëve në krye të qeverisjes ishin spastrimet në administratë. Në të gjitha nivelet e institucioneve shtetërore ndodhën largime të shumta. Kjo politikë largimesh bazuar vetëm në shkaqe politike u dha një goditje të fortë institucioneve shtetërore dhe solli keqpërdorim të tyre nga politika.

Destabiliteti politik vijoi gjatë gjysmës së parë të mandatit qeverisës të socialistëve, kohë në të cilën u ndërruan tri kabinete qeveritare. Politika vijoi e acaruar si brenda kampit socialist, ashtu edhe në marrëdhënie me opozitën. Të dyja palët manifestuan agresivitet të lartë politik. Lufta politike e opozitës iu largua institucioneve duke marrë formën e protestave në rrugë dhe bojkotin e parlamentit. Strategjia e ndjekur

⁴⁶⁴ Transition Report 1999, EBRD, fq. 182.

⁴⁶⁵ *Vjetari Statistikor 1998-2007*, INSTAT, Tiranë, 2009 fq. 224.

⁴⁶⁶ *Vjetari Statistikor 1990-1999*, INSTAT, Tiranë, 2002 fq. 28.

nga të dyja kampet politike largoi besimin për dialog e bashkëpunim ndërmjet tyre. Vrasja e Azem Hajdarit më 12 shtator 1998, deputet dhe një nga themeluesit e Partisë Demokratike ishte një ngjarje e rëndë. Instrumentalizimi politik që iu bë kësaj ngjarjeje shkaktoi trazira që çuan në një tentativë për grusht shteti. Përkeqësimi i klimës politike dhe rritja e presionit mbi qeverinë Nano bëri që ai të jepte dorëheqjen në nëntor të po atij viti dhe vendin e tij ta zinte Pandeli Majko.

Një nga ngjarjet më të rëndësishme politike të vitit 1998 ishte miratimi i Kushtetutës. Ajo arriti të miratohej në parlament me 2/3 e votave të socialistëve dhe aleatëve të saj, ndërkohë që opozita bojkotoi si procesin e hartimit, ashtu edhe atë të votimit të saj. Referendumi popullor u mbajt më 22 nëntor 1998. Pavarësisht pjesëmarrjes së ulët në votime, Kushtetuta u aprovua nga vota popullore. Mungesa e një procesi gjithpërfshirës për hartimin e dokumentit themelor të vendit do të shikohej si mangësi dhe do të bëhej pretekst nga forcat politike për ndërhyrjet që do të bëheshin më tej në Kushtetutë. Kushtetuta e re i jepte më shumë funksione dhe një rol më të rëndësishëm institucionit të parlamentit. Kompetencat parlamentare cenuan në mënyrë indirekte kompetencat presidenciale, të cilat u reduktuan. Presidenti tani merrte përgjegjësitë e një presidenti simbolik në një republikë parlamentare⁴⁶⁷. Nga institucionet e Bashkimit Evropian, Kushtetuta e vitit 1998 është konsideruar “një kuadër i përshtatshëm për të mbështetur zhvillimin demokratik të Shqipërisë⁴⁶⁸”.

Viti 1999 ishte po ashtu problematik për vendin. Si rezultat i luftës në Kosovë, vendi pati një fluks masiv refugjatësh, duke shkaktuar probleme për Shqipërinë, e cila ishte ende me shtet të dobët dhe ekonomi të brishtë. Në planin politik, ngjarjet në Kosovë ndikuan në afrimin e përkohshëm të aktorëve politikë në vend. Roli i qeverisë Majko në përballimin e krizës u vlerësua pozitiv si për mbështetjen që u dha rreth 500 mijë refugjatëve kosovarë, ashtu edhe për bashkëpunimin me NATO-n dhe bashkësinë ndërkombëtare për parandalimin e një katastrofe humanitare⁴⁶⁹. Institucionalizimi i jetës politike u arrit me hyrjen në parlament të Partisë Demokratike pas një bojkoti gati një vjeçar. Por edhe maxhoranca në vetvete nuk ishte e qetë. Problemet dhe divergjencat brenda vetë Partisë Socialiste “penguan çdo përpjekje serioze për të luftuar korrupsionin dhe krimin në vend”⁴⁷⁰. Si rezultat i kontradiktave dhe përplasjeve për pushtet, në nëntor të vitit 1999, në krye të qeverisë erdhi Ilir Meta.

Situata konfliktuale në Ballkan ndikoi edhe në miratimin e një nisme të re për këtë rajon nga ana e Bashkimit Evropian. Në maj të vitit 1999, Bashkimi Evropian miratoi një iniciativë të re për pesë vendet e rajonit të Evropës Juglindore (Shqipëri, Kroaci, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Bosnje-Hercegovinë, dhe RFJ), të quajtur Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit. Konkluzionet e Raportit të Fizibilitetit (nëntor 1999) për

⁴⁶⁷ Afrim Krasniqi, “Sistemet politike në Shqipëri, 1912-2008”, Botimi i dytë, Ermal, Tiranë, fq. 261-2.

⁴⁶⁸ “Shqipëria, Raporti i Stabilizimit Asociimit 2003”, Komisioni i Komuniteteve Evropiane, Bruksel 26.3.2003, fq. 3 burimi online <http://www.mie.gov.al/>

⁴⁶⁹ Shiko: <http://www.freedomhouse.org/report/freedom-world/1999/albania>

⁴⁷⁰ Ibid.

hapjen e bisedimeve me Shqipërinë, të prezantuara nga Komisioni Evropian, ishin negative. Komisioni arriti në përfundimin se në këtë kohë Shqipëria nuk i plotësonte ende kushtet për një marrëveshje të tillë⁴⁷¹.

Kalvari i zgjedhjeve të kundërshtuara vazhdoi edhe me qeverisjen e socialistëve. Konfliktualiteti politik vijoi edhe në zgjedhjet e 24 qershorit 2001. Në shumë aspekte dhe në parregullsitë që u shfaqën, zgjedhjet e vitit 2001 ngjasonin me zgjedhjet e vitit 1996. Socialistët morën më shumë mandate sesa u dhanë zgjedhësit⁴⁷². Prekja e zgjedhjeve cenoi rëndë zhvillimet politike në vend. Për pasojë, demokratët i kontestuan ato dhe bojkotuan Parlamentin. Tendencat e dominimit të parlamentit nga një forcë e vetme politike i ka shtyrë të dyja partitë kryesore të vendit drejt cenimit të standardeve të zgjedhjeve duke prodhuar, kështu, destabilitet politik dhe duke cënuar vetë thelbin e demokracisë në vend.

Partia Socialiste dhe aleatët e saj fituan 88 deputetë ose rreth 62% të votave. Bashkimi i opozitës në koalicionin “Bashkimi për Fitore” fitoi 46 deputetë.

Tabela 5. Zgjedhjet parlamentare të vitit 2001.

Subjekte Politike	Nr/Deputetë
PSSH	73 deputetë
PD	32 deputetë
PR	5 deputetë
BLD	2 deputetë
PDR	6 deputetë
PSD	4 deputetë
PBK	3 deputetë
PLL	4 deputetë
PBDNJ	3 deputetë
PAA	3 deputetë
PAD	3 deputetë
I Pavarur	2 deputetë
Total	140 deputetë

Pavarësisht se nga raportet e organizmave ndërkombëtare “zgjedhjet shënuan një progres ndaj zgjedhjeve të kaluara, vëzhguesit ndërkombëtarë identifikuan një numër parregullsish të izoluara, por serioze”⁴⁷³, fenomeni i manipulimit dëmtoi imazhin e demokracisë në vend (shiko: tab. nr. 5 dhe nr. 8). Ndërkaq, një shembull i mirë i bashkëpunimit midis forcave politike ishte edhe zgjedhja e presidentit konsensual në qershor të vitit 2002. Në parim, zgjedhja e Presidentit konsensual rriti stabilitetin e institucioneve demokratike. Që nga ajo kohë nuk ka ndodhur një bashkëpunim politik për të vijuar me traditën e presidentit konsensual.

Një rol të madh në arritjen e zgjedhjes së një Presidenti konsensual luajti presioni ndërkombëtar dhe në veçanti ai i Bashkimit Evropian.

Bashkëpunimi midis palëve u cënua si pasojë e zgjedhjeve lokale të vitit 2003. Pavarësisht përshtatjeve që iu bënë kodit të ri zgjedhor bazuar në rekomandimet e bëra nga bashkësia ndërkombëtare, zgjedhjet vendore nuk arritën standardet e kërkuara. Procesi zgjedhor nuk arriti të tregonte përparim në zbatimin e rekomandimeve të bëra në kod. Kjo situatë reflektohet edhe në konstatimet e bëra në Progres Raportin e vitit 2004

⁴⁷¹ Punimi: “Stabilization and Association Process in Albania and Institutional Framework”, Valbona Kuko, fq. 2 online: http://pdc.ceu.hu/archive/00002096/01/dec_2003_V_Kuko.pdf aksesuar më 12.6.2012

⁴⁷² Afrim Krasniqi, “Partitë Politike në Shqipëri, (1920 - 2006)”, EDLOR, Tiranë, 2006, fq. 222.

⁴⁷³ Raporti i Stabilizim Asocimit 2003, fq. 4.

ku theksohet se: “*Nevojitet më shumë **vullnet politik** për të siguruar zgjedhje të lira dhe të ndershme*”⁴⁷⁴.

⁴⁷⁴ Progres Raporti 2004, fq. 2.

Tabela 6. Konstatime në Progres Raporte (2003 – 2005).

FUSHAT				
	Demokracia	Shteti i së Drejtës	Sistemi Gjyqësor	Administrata publike
Për vitin 2003 ⁴⁷⁵	Shqipëria ka ende një demokraci të re dhe të pastabilizuar.	Zbatimi i shtetit të së drejtës mbetet i mangët sidomos si pasojë e zbatimit të dobët të ligjit nga institucionet përgjegjëse, nga kapacitetet e pamjaftueshme të administrates, korrupsioni dhe krimi i organizuar.	Sistemi gjyqësor shqiptar vazhdon të mbetet i dobët.	Janë shënuar disa progrese në administratën publike, por fatkeqësisht ato janë penguar nga disa raste të emërimit politik dhe nga nepotizmi në disa fusha kyçe.
Për vitin 2004 ⁴⁷⁶	Shqipëria mbetet një demokraci e re dhe relativisht e paqëndrueshme, Interesat afatmesme të vendit shpesh sakrifikohen përballë interesave afatshkurtra dhe të ngushta politike.	Shteti ligjor në Shqipëri vazhdon të ketë mangësi. Organet e zbatimit të ligjit nuk garantojnë ende një zbatim të plotë të ligjit sipas standardeve ndërkombëtare. Përparimet në drejtim të respektimit të përgjithshëm të shtetit ligjor janë të pakta. Shteti ligjor vazhdon të jetë i ndikuar negativisht nga dobësitë e sistemit gjyqësor dhe të administratës pulike, si edhe nga krimi i organizuar dhe korrupsioni,	Ndonëse janë bërë disa përmirësime të vogla, sistemi gjyqësor shqiptar mbetet i dobët. Rekomandimet e bëra në raportin e PSA-së 2003 janë zbatuar vetëm pjesërisht.	Janë bërë disa përparime në reformën e administratës publike, por nevojiten ende përpjekje të qëndrueshme. Pavarësisht nga këto hapa, problemet e kahershme si korrupsioni, ndërhyrja politike, mungesa kronike e burimeve njerëzore të përshtatshme, ndryshimet e shpeshta të njerëzve dhe zbatimi i pamjaftueshëm i kuadrit ligjor që lidhet me administratën publike, vazhdojnë të jenë pengesë për konsolidimin e një shërbimi civil profesional dhe të pavarur.
Për vitin 2005 ⁴⁷⁷	Shqipëria ka shënuar progres në institucionet demokratike, gjyqësore dhe të administratës publike, por i duhet t'i vërë në zbatim më me vendosmëri strategjitë dhe ligjet, në mënyrë që të përmirësohet më tej funksionimi i tyre.	Raporti konstatoi se ligji në Shqipëri vazhdonte të ishte i brishtë; korrupsioni dhe krimi i organizuar cilësoheshin kërcënime serioze për përparimin e vendit	Progres është arritur edhe në përmirësimin e funksionimit të sistemit gjyqësor shqiptar. Trajnimet për gjyqtarët dhe prokurorët janë përmirësuar dhe duhet të pasohen nga hapa të mëtejshme që sigurojnë pavarësinë e tyre dhe kushte më të mira pune për personelin tjetër gjyqësor.	Shqipëria ka përmirësuar përzgjedhjen, rekrutimin dhe trajnimin e administratës publike dhe ka marrë masa për forcimin e kuadrit të vet ligjor.

⁴⁷⁵ “Shqipëria, Raporti i Stabilizim Asocimit 2003”, Komisioni European, Bruksel 26.3.2003.

⁴⁷⁶ “Shqipëria, Raporti i Stabilizim Asocimit 2004”, burimi online <http://www.mie.gov.al/>

⁴⁷⁷ “Shqipëria, Progres Raporti 2005”, Komisioni European Bruksel, 9 nëntor 2005.

Në vitin 2002, Transparency International indeksoi për herë të parë perceptimin e korrupsionit në Shqipëri. Të dhënat tregojnë për një opinion negativ lidhur me shkallën në të cilën perceptohet se ekziston korrupsioni në mesin e politikanëve dhe zyrtarëve publikë në Shqipëri. Ky perceptim negativ ka ardhur duke u rritur (Tabela nr.7). Po ashtu, sipas një studimi të realizuar nga Instituti i Studimeve Ndërkombëtare del se: “*Qeverisja socialiste gjatë viteve 1997-2005 u karakterizua nga një rritje e rëndësishme e numrit të kandidatëve të pasur nga sektori privat dhe një fshirje e vijës ndarëse mes biznesit dhe politikës*”⁴⁷⁸.

Nga analiza e Progres Raporteve të Bashkimit Evropian kushtuar Shqipërisë, roli i klasës politike del në pah për mungesën e arritjeve që ka Shqipëria në shumë fusha. Sipas raportit të vitit 2004, “*Klima politike nuk ka lejuar kryerjen e reformave të thella*”⁴⁷⁹. Raporti thekson se pavarisht stabilitetit të brishtë politik të arritur në vitin 2002, ku palët arritën të zgjidhnin një president konsensual, fryma e bashkëpunimit nuk vijoi më tej. Tensionet politike u ndjenë si ndërmjet partive politike kryesore, ashtu edhe brenda Partisë Socialiste. Politika konfliktuale ndikoi negativisht në stabilitetin e qeverisë dhe në mosrealizimin e programit të reformave. Për rrjedhojë, shumë nga mosarritjet e vëna në dukje në Raportin e Grupit Drejtues të Nivelit të Lartë të vitit 2001, në progres raportet e vitit 2002 dhe 2003, si edhe gjatë procesit të dialogut politik me autoritetet shqiptare, nuk janë zgjidhur. Zvarritja e reformave lidhet në një masë të madhe me konfliktualitetin e lartë midis partive politike dhe me mungesën e vullnetit politik. Situatat politike brenda të majtës ndryshuan rrënjësisht në vitin 2004. Për herë të parë, Partia Socialiste në pushtet pësoi ndarje. Në shtator, një grup i deputetëve të udhëhequr nga Ilir Meta themeluan Lëvizjen Socialiste për Integrim. Përçarja e së majtës ndikoi në masë të konsiderueshme në humbjen e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005.

Tabela 7. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit sipas Transparency International (2002 – 2005).

	Renditja e Shqipërisë	Pikët e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit (CPI)	Shtrirja e lartë, e ulët (0-shumë i korruptuar – 10- shumë i ndershëm)
Viti 2002 ⁴⁸⁰	81	2.5	1.7 - 3.3
Viti 2003 ⁴⁸¹	92	2.5	1.9 - 3.2
Viti 2004 ⁴⁸²	108	2.5	2.0 - 3.0
Viti 2005 ⁴⁸³	126	2.4	2.1 - 2.7

⁴⁷⁸ Forcimi i Demokracisë. AIIS fq. 45.

⁴⁷⁹ Shqipëria, *Raporti i Stabilizimit dhe Asociimit 2004*, fq. 1.

⁴⁸⁰ Transparency International Corruption Perceptions Index 2002, http://archive.transparency.org/policy_research/surveys_indices/cpi/2002

⁴⁸¹ Transparency International Corruption Perceptions Index 2003, http://archive.transparency.org/policy_research/surveys_indices/cpi/2003

⁴⁸² Transparency International Corruption Perceptions Index 2004, http://archive.transparency.org/policy_research/surveys_indices/cpi/2004

Tabela 8. Të dhënat e organizatës Freedom House për Shqipërinë 1998-2005.

Viti	Statusi	Freedom Rating / Vlerësimi i Lirisë	Civil Liberties / Të drejtat civile	Political Rights / Të drejtat politike
1998	<i>Partly free</i> / Pjesërisht i lirë	4,5	5	4
1999	Pjesërisht i lirë	4,5	5	4
2001	Pjesërisht i lirë	4,5	5	4
2002	Pjesërisht i lirë	3,5	4	3
2003	Pjesërisht i lirë	3	3	3
2004	Pjesërisht i lirë	3	3	3
2005	Pjesërisht i lirë	3	3	3

Burimi: Raportet e Freedom House⁴⁸⁴ për Shqipërinë

3.7 Trashëgimia politike dhe drejtuesit e rinj

Është pranuar gjerësisht se tensionet politike të ndryshimit të pushteteve kanë qenë të pranishme në të gjitha vendet në tranzicion dhe, në një masë të madhe, ato janë shoqëruar me probleme sociale dhe ekonomike. Çelësi i një tranzicioni demokratik sa më të butë dhe me sa më pak kosto për qytetarët e vendeve në tranzicion lidhet ngushtë me politikën që ndjek e gjithë klasa politike. Suksesi i tranzicionit demokratik në disa vende dhe dështimi apo zvarritjet tek disa të tjerë shpjegohet në një masë të konsiderueshme me rolin që kanë luajtur elitat e vjetra dhe ato të reja në gjetjen e kompromisit për realizimin e një kalimi sa më të qetë dhe në interesin më të lartë të vendit. Nga kjo premisë, edhe tranzicioni i hershëm politik në Shqipëri (duke mos lënë mënjanë faktin që ishte vendi me regjimin më të egër komunist në rajon) mund të konsiderohet i vonuar, por ai përgjithësisht u realizua i qetë. Një element i rëndësishëm këtu është mungesa e një marrëveshjeje midis eliteve politike shqiptare për paqe sociale. Ishte pikërisht polarizimi

⁴⁸³ Transparency International Corruption Perceptions Index 2005, online http://archive.transparency.org/policy_research/surveys_indices/cpi/2005

⁴⁸⁴ Burimi online: (tek linku për të dhënat vjetore ndryshon vetëm viti). <http://www.freedomhouse.org/report/freedom-world/2005/albania>

politik ai që e ndau shoqërinë shqiptare duke bërë të pamundur arritjen e paqes sociale, të këtij elementi thelbësor për krijimin e kushteve të favorshme të ndërtimit të një demokracie të shëndoshë. Studiuesi Lamentovic argumenton se për vendet ish-komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore, elitat që përbëjnë demokracinë e re nën ndikimin e traditave historike shtyhen që *“të thellojnë dhe më tej konceptin “luftë për liri” në vend të atij “të ndërtojmë lirinë”*. *Aftësia e tyre për të shkatërruar, çka është e pranishme, është shumë më e spikatur sesa urtësia e nevojshme për ngritjen e institucioneve të reja dhe të qëndrueshme*⁴⁸⁵”.

Analiza e trashëgimisë politike na ndihmon të kuptojmë më mirë ecurinë e ndryshimeve të ndodhura në Shqipëri gjatë viteve të tranzicionit. Ajo hedh dritë mbi modelin e zhvillimit të shtetit, institucioneve, qasjen e partive politike dhe drejtuesve të tyre në drejtimin e shtetit, hedh dritë mbi aftësinë e shoqërisë shqiptare për të ndërtuar ose jo një model të një shoqërie të hapur, të lirë dhe demokratike. Për studiuesin Diamond, *“Disa probleme janë të qarta për t’u kuptuar më shumë nga perspektiva e kulturës politike, sesa nga burimet apo domosdoshmëria për të këmbëngulur për demokraci dhe konsolidim*⁴⁸⁶”. Po kështu, teoritë e shquara të demokracisë, pohojnë se *“demokracia kërkon një grup të veçantë të vlerave politike dhe orientimeve nga qytetarët e saj*⁴⁸⁷”. Politika ndërtohet mbi bazë principesh, konceptesh dhe vizionesh dhe prej këtej lind pyetja: çfarë trashëgimie politike mbeti për tek drejtuesit e rinj shqiptarë? Më konkretisht, cilat ishin premiset nga ku do të nisnin udhëtimin drejt procesit të transformimit politik drejtuesit e rinj shqiptarë? Koncepte politike të tilla si demokracia, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut, pjesëmarrja politike, pluralizmi politik janë procese që marrin kohë, nuk ndërtohen me fjalë por me veprime dhe besim në to. Shoqëritë demokratike mbartin një sërë vlerash dhe traditash, të cilat janë kultivuar përmes proceseve shumë dinamike të zhvillimit të vetë shoqërisë. Kërkesa për vlera demokratike lidhet ngushtë me përpjekjet e shoqërisë për t’i arritur këto vlera.

Nëse i referohemi traditës politike në Shqipëri, ajo ka një mangësi të madhe përsa u përket elaborimit të vlerave dhe kulturës demokratike. Studiuesit nuk evidentojnë ndonjë proces të mirëfilltë të demokratizimit të elitës politike dhe të shoqërisë shqiptare në gjithë rrjedhën e ekzistencës së Shqipërisë si shtet.

Një pikënisje interesante në tentativën për të kuptuar klasën e sotme të drejtuesve politikë është sistemi i tyre i vlerave dhe besimit. A besojnë drejtuesit e rinj në demokraci, në shtetin e së drejtës, në respektimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve? Faktet empirike na vënë në mëdyshje dhe nuk na lejojnë të shprehemi prerë, pozitivisht apo negativisht.

⁴⁸⁵ Shiko: Vojtek Lamentovic *“Paqëndrueshmëria politike në Evropën Lindore dhe Qendrore. Rreziqet e brendshme politike të integritetit dhe të sigurisë evropiane”*, Verner Vajdenfeld *“Demokracia dhe Ekonomia e Tregut në Evropën Lindore”*, L&M/Soros, Tiranë, 1999, fq. 70.

⁴⁸⁶ Larry Diamond, *Political Culture and Democratic consolidation*, June 1998 fq. 2 online: http://www.march.es/ceacs/publicaciones/ëorking/archivos/1998_118.pdf

⁴⁸⁷ Ibid

Demokratizimi i vendit pas përmbysjes së regjimit komunist shkaktoi një ndryshim të rëndësishëm të elitës politike. Politikanët shqiptarë të pasviteve 1990 nuk kishin ose kishin mangësi të theksuara në përvetësimin e normave qytetare dhe juridikoshtetërore sipas kërkesave të kohës për orientimin e ri politik – ekonomik të vendit. Kjo mangësi e formimit të drejtuesve të rinj politikë u plotësua me vijimin e traditës së vjetër, sipas të cilës në vend të nënshtrimit ndaj sistemit dhe respektimit të ligjit e shtetit, drejtuesit dolën mbi sistemin dhe krijuan një shtet të ndryshëm dhe institucione të varura nga politika.

Pipes ka thënë se kur udhëheqësit komunistë të pushonin së besuari te komunizmi, ata do të pushonin së besuari në çdo gjë. Sipas këtij pohimit, trashëgimia politike e lënë nga ish drejtuesit komunistë përkthehet ndryshe si mungesë besimi në çdo gjë dhe rrjedhimisht dhe si mungesë besimi në demokraci. Mungesa e besimit do të ishte diçka e vogël krahasuar me mungesën e vlerave politike. Demokracia bazohet në respektimin e qartë të rregullave të saj. Nëse në një shtet demokratik zhvillohen zgjedhje, të gjithë e dinë dhe kanë besim që ato do të jenë të rregullta dhe të ndershme, pasi ata besojnë se sistemi i tyre funksionon pikërisht sepse ky mekanizëm ekziston i paprekur. Mungesa e vlerave politike e demokratike është një mangësi e rëndë pasi në demokraci nuk ka rregulla “sikur”. Mungesa e besimit të drejtuesve të rinj politikë në normat dhe vlerat demokratike përbënte një ngërç të rëndë për vendosjen e demokracisë së vërtetë.

Në Shqipëri, historia e këtyre viteve tranzicion ka dëshmuar me fakte e argumenta se zbrazëtia apo mungesa e ideologjisë të ish-komunistët u përkthye shumë shpejt dhe në një masë të konsiderueshme në një pragmatizëm të tipit ekstrem. Në mungesë të ideologjisë apo besimit në ndonjë platformë bindëse politike, drejtuesit e rinj u vunë në ndjekje të interesave të tyre personale. Në vitin 1991, Shqipëria iu fut një rruge ku e shkuara nuk e ndihmonte dot. Për të realizuar procesin e vështirë dhe kaq shumë të rëndësishëm të tranzicionit nga totalitarizmi në demokraci ishte elita ish-komuniste ajo që mori monopolin e procesit, e vetmja elitë politike dhe intelektuale e mundshme për kohën, por që ishte produkt i pashmangshëm i regjimit të kaluar. Në kohën e ndryshimit të sistemeve, rreth 75 % e popullsisë së vendit ishte nën moshën 40 vjeç, moshë e re e popullsisë tregonte se çdo tre në katër shqiptarë kishin lindur gjatë viteve të periudhës komuniste, duke mos njohur asnjë përvijë tjetër në jetë⁴⁸⁸. Problemi i reformimit të shoqërisë shqiptare do të ishte i mundur edhe me këto shifra aspak të favorshme, por vetëm nëse politika shqiptare do të kishte dëshmuar distancim konkret dhe zbatimin me korrektësi të praktikave dhe sjelljeve demokratike. Në trajtesën e deritanishme të tranzicionit të hershëm, por edhe më pas, argumentat dhe faktet flasin për një vazhdim të traditës komuniste në zhvillimet politike nga ana e drejtuesve të rinj. Argumenti bazë i

⁴⁸⁸ Piro Misha, “Roli i trashëgimisë historike në tranzicionin pas-komunist shqiptar” në *Tranzicione në Pasqyrë*, “Një përjasje e krahasuar e proceseve të transformimit demokratik të Spanjës dhe Shqipërisë”, *Ciencias y humanismo*. fq. 143.

vijueshmërisë së trashëgimisë politike haset në modelin e ndërtimit të partive politike pas pluralizmit në Shqipëri.

Partitë politike janë mjete përfaqësimi, ato artikulojnë interesat, nevojat dhe vlerat e qytetarëve. Duke qenë të tilla, krijimi i tyre zgjon interes të veçantë në realizimin e analizave politike.

Zanafilla e formimit të partive në Shqipëri pas viteve '90 na shpjegon pse partitë politike janë konfiguruar në këtë mënyrë dhe përse kanë mbetur deri diku peng i të shkuarës. Përse elitat drejtuese kanë shtypur me ç'të mundin mendimin ndryshe dhe eliminimin e tij nga partia? Përse lideri i partisë vijon me traditën mesianike të liderit të pazëvendësueshëm që edhe kur largohet, deri edhe vetëm emri i tij mundet të sjellë trazira në parti? Udhëheqja me dorë të fortë e partive politike ka reflektuar udhëheqje me shumë duar në qeverisje. Dëshira për të pasur sa më shumë pushtet është shfaqur nga të dyja kahet e partive politike që kanë qenë në drejtim të vendit. Tendenca e monopolizimit të pushtetit ka deformuar jo vetëm partinë, por mbi të gjitha institucionet dhe shtetin të tërësi. Nëse për Partinë Socialiste, drejtimi i centralizuar ishte në natyrën e saj, Partia Demokratike nuk evoluoi në këtë drejtim. Nëse shumica e udhëheqësve të PS-së, i përkasin kastës së ish-burokratëve komunistë dhe kjo ishte një e metë, nga ana tjetër Partia Demokratike, e cila lindi si një oponente kundër regjimit komunist mbeti për një kohë relativisht të gjatë peng i këtij misioni, duke mos përmbushur dot qëllimin për të qenë një parti realisht demokratike. Ajo bashkoi "*individë dhe grupe sociale nga më të ndryshmet, të cilët nuk kishin kohezion ideologjik apo interes tjetër të përbashkët përveç kundërshtisë së tyre të fuqishme ndaj komunizmit*"⁴⁸⁹. Trashëgimia politike do të luante një rol të rëndësishëm në vitet e hershme të tranzicionit, sidomos në sjelljen politike të aktorëve të rinj. Antikomunizmi ishte një qëllim i përbashkët i shumë njerëzve që në kushte të tjera do të ndanin interesa të ndryshme. Ndaj për t'i mbajtur dhe përdorur sa më gjatë këta njerëz, lufta kundër komunizmit u bë mjete dhe justifikimi që shkatërronte çdo gjë.

Lufta politike në Shqipëri, nuk është çliruar plotësisht, nga elementët e urrejtjes reciproke, të cilët jehojnë që nga e kaluara dhe rrezikojnë të sotmen e demokracisë.⁴⁹⁰ Për E. Biberajn:

"...shumica e tyre (drejtuesve të rinj⁴⁹¹) kishin përqaftuar pa rezerva vlerat e Partisë Komuniste dhe kishin dalë si demokratë, duke hedhur poshtë ideologjinë komuniste, vetëm pasi regjimi i vjetër kishte humbur aftësinë për të mbajtur pushtetin. Komunizmi ka krijuar një kulturë intolerance dhe ka ndaluar zhvillimin e aftësive të tilla politike që janë të domosdoshme për krijimin e koalicioneve, arritjen e marrëveshjeve dhe pranimin e kompromiseve. Derisa të

⁴⁸⁹ Forcimi i demokracisë AIIS .fq. 23.

⁴⁹⁰ Arben Çejku, "Demokracia e Imponuar; ese", Tiranë, "Mbrothësia", 2000, fq. 6.

⁴⁹¹ Shënim i autorit.

*vazhdojnë të qeverisin udhëheqësit e tanishëm, jeta shoqërore dhe politike do të mbetet thellësisht e politizuar*⁴⁹²”

Nga ana tjetër, nëse militantët e Partisë Socialiste kishin shërbyer në aparatin e shtetit të diktaturës dhe formimi i tyre kulturor e profesional ishte i ndërtuar dhe zhvilluar sipas një tradite pune të përshtatshme për ato struktura shtetërore, militantët e Partisë Demokratike ose ishin pa përvojë ose ishin të konvertuar si të tillë. Ekziston një dallim i madh midis burokracisë dhe makinës burokratike në demokraci e në totalitarizëm. Burokracia në demokraci i përgjigjet zbatimit të ligjit, ekuilibrave shoqërorë dhe ç’është më e rëndësishmja, interesit kombëtar nëpërmjet mbrojtjes së shtetit nga kontradiktat politike. Aktiviteti i saj mbikqyret (por nuk ndërhyhet në të) nga institucionet politike të zgjedhura. Burokracia e regjimit komunist pasqyron të kundërtën e kësaj tradite; ajo mësohet dhe shpërblehet që të shërbejë pa kushte ndaj partisë dhe udhëheqjes së saj. Modeli i të shërbyerit jo shtetit, por partisë është një element i hasur ndjeshëm te të dyja partitë kryesore gjatë periudhës që ato kanë qenë në pushtet. Modeli i shpërblimit të militantit me vende pune nuk është një rast sporadik, përkundrazi të dyja partitë kryesore e kanë mbajtur në jetë fuqimisht këtë traditë të vjetër.

Fragmentarizimi i spektrit politik është shoqëruar me mungesë të dialogut, të tolerancës, të mendimit ndryshe, me monopolizim të vendim-marrjes, identifikim të partisë me liderin etj. Për studiuesin Biberaj, partitë politike në Shqipëri janë kryesisht “vegla të udhëheqësve të tyre”⁴⁹³. Pothuaj pa përjashtim, ata që nuk mendonin njëloj si udhëheqësit kanë dështuar në përpjekjet për të kundërshtuar udhëheqjen, janë mënjeluar ose janë detyruar të krijojnë parti të tjera. Vijimi me modelin e njëshit autoritar është tipar i vijimit të modelit të shkuar politik. Një nga trashëgimitë më të spikatura është fakti që kur politika dështon në krijimin e një shteti të bazuar në institucione dhe politika të qëndrueshme, atëherë ai fillon siç pohon dhe studiuesja Bogdani “të mbështetet në personalitetet”⁴⁹⁴. Mund të themi se në Shqipëri, partitë politike nuk realizojnë funksionet e tyre bazë; së pari, sepse nuk sigurojnë një shumicë të qëndrueshme në parlament dhe së dyti sepse nuk hartojnë programe në lidhje me nevojat e vendit për transformim, zhvillim ekonomik dhe demokratizim. Si rezultat, këto funksione u kalojnë qeverive të njëpasnjëshme duke patur si produkt përfundimtar uljen e besueshmërisë së qytetarëve tek partitë politike. Për pasojë, politika shqiptare sot është në krizë morale, në krizën e përfaqësimit kundrejt qytetarëve dhe mbi të gjitha në krizën e mosrealizimit substancial të proceseve transformuese të sistemit politik drejt demokracisë. Ajo ia ka arritur të dalë mbi sistemin, mbi shtetin dhe qytetarin. Kjo është kultura e re politike, një kulturë që nga tranzitore po bëhet dominante, një model i ri i shtetit dhe qytetarit të varur sërish nga politika.

⁴⁹² Ibid.

⁴⁹³ Elez Biberaj, fq. 475.

⁴⁹⁴ Mirela Bogdani, fq. 97.

KREU I KATËRT

ZHVILLIMET POLITIKE DHE ROLI I KLASËS POLITIKE NË MARRËDHËNIET ME BASHKIMIN EVROPIAN

4.1 Bashkimi Evropian dhe mekanizmi⁴⁹⁵ i Kushtëzimit Demokratik, ndikimet në Shqipëri

Rënia e regjimeve politike në *vendet e bllokut ish-komunist* u shoqërua me sfida dhe përpjekje për të kapërcyer problemet e mëdha me të cilën ato ballafaqoheshin. Në këtë situatë të re gjeopolitike vendet ish-komuniste përballeshin me shumë vështirësi të njëkohëshme. Këtu vlen të përmendim që ndër problemet urgjente që ato kishin, ishin vështirësitë e mëdha ekonomike dhe orientimi i një kursit të ri politik. Të dy këto elementë nuk mund të realizoheshin pa ndihmën dhe mbështetjen e institucioneve ndërkombëtare, vendeve të Komunitetit Evropian (sot BE) dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ato u orientuan *spontanisht* drejt modelit perëndimor i cili kishte në themel: regjime demokratike, institucione të pavarura, shtet të së drejtës dhe ekonomi të lirë të tregut.

Ndërmjet aktorëve ndërkombëtarë të interesuar në procesin e demokratizimit të vendeve ish-komuniste, Bashkimi Evropian ka luajtur rolin kryesor⁴⁹⁶. Rritja e influencës së BE-së në këtë proces ka ardhur edhe si një detyrim i vendeve aspirante për përmbushjen e kushteve të anëtarësimit për në Bashkimin Evropian. Hulumtimet parashtrajnë se ka marrëdhënie të qarta shkakore në përdorimin e kushtëzimit nga ana e BE-së për të siguruar rezultate politike apo institucionale tek vendet që duan të integrohen. Kushtëzimi demokratik ka të bëjë me pranimin e anëtarëve të rinj vetëm e vetëm pasi ata të kenë përmbushur të gjitha kërkesat e parashtruara nga BE-ja. Bazuar mbi modelin e kushtëzimit, në aspektin politik integrimi në Bashkimin Evropian nënkupton se afrimi me BE-në njehsohej me demokratizimin.

⁴⁹⁵ Grabbe i ka cilësuar “mekanizma” proceset të cilat kanë ndikuar në transformimin institucional dhe politik në vendet EQL. Mekanizmin e kushtëzimit demokratik ai e ndan në 5 kategori: 1. Ofrimin e modeleve (templates) legjislativ dhe institucionale, 2. Para të dhëna në ndihma dhe asistencë teknike, 3. Vlerësim dhe monitorim, 4. Këshilla dhe Binjakëzim, 5. Qasje në negociata dhe fazat e mëtejshme në procesin e pranimin, Heather Grabbe, “*Europeanisation Goes East: Power and Uncertainty in the EU Accession Process*” The Politics of Europeanisation, Oxford: Oxford University Press. 2002 (Chapter to appear in K. Featherstone and C. Radaelli (eds.), fq.9

⁴⁹⁶ Shiko: Arolda Elbasani, “*Albania in Transition: Manipulation or Appropriation of International Norms?*”, Southeast European Politics Vol. V, No. 1, June 2004 fq. 24

Studimet rreth kushtëzimit të Bashkimit Evropian nisen nga një premisë themelore e cila thekson se: *“Kushtëzimi funksionon për shkak se ekziston një asimetri pushteti e cila i mundëson Komisionit imponimin dhe adaptimin me acquis-n, si parakusht për hyrjen e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore në Bashkim⁴⁹⁷”*. Përgjatë dy dekadave të transformimit politiko-ekonomik të vendeve të bllokut ish-komunist, në mënyrë natyrale BE-ja ka ndërthurur dëshirën, vullnetin, përpjekjet dhe përkushtimin e këtyre vendeve në realizimin e integritit dhe demokratizimit përmes mekanizmit të Kushtëzimit Demokratik sipas Grabbe mekanizmi i kushtëzimit funksionon pasi *“Asimetria e pushtetit ndërmjet vendeve aspirante dhe Bashkimi i jep BE-së më shumë rrugë detyruese të ndikimit në procesin e hartimit të politikave të brendshme të vendeve aplikante se në vetë BE-në, pasi vendet candidate përballen me kushte shtesë që anëtarët e tanishëm nuk i bëjnë⁴⁹⁸”*. Perceptimi i pushtetit asimetrik midis BE-së dhe vendeve candidate lidhet edhe me faktin se bashkëveprimi dhe marrëdhëniet e pushtetit ndërmjet tyre janë të bazuara në kushtet për anëtarësim apo siç njihet ndryshe kushtëzimi i zgjerimit.

Studimet mbi Kushtëzimin e BE-së janë përqendruar kryesisht në kontekstin e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore të cilat janë më të përparuara në zhvillimin e tranzicionit drejt demokracisë. *Ndërsa roli pozitiv i stimujve të BE-së për kalimin të demokracisë dhe ekonomisë së tregut ka qenë i njohur gjerësisht në rastin e vendeve të lartpërmendura, instrumenti i kushtëzimi të BE-së nuk ka rezultuar efikas në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor⁴⁹⁹* pjesë e të cilës është edhe vendi ynë.

Politika e zgjerimit të BE-së drejtë vendeve të lindjes është një temë që has diskutim të gjerë. Pikëpyetjet rreth zgjerimit lidhen sa me mundësin e BE-së për absorbimin e anëtarëve të rinj aq edhe me mundësinë e përshtatjes së tyre me vetë BE-në, ne nuk do ndalemi në analizën e argumentave pro apo kundër zgjerimit por vetëm në strategjinë e ndjekur nga BE-ja për afrimin e këtyre vendeve drejt saj. Bazat e këtij angazhimi gjenden në Traktatin e Mاستrihtit në të cilën theksohet se: *“Çdo shtet evropian mund të aplikojë për t’u bërë anëtar i Bashkimit...⁵⁰⁰”*, artikulli i kriterit gjeografik jepte shpresë për mundësi anëtarësimi tek vendet e EQL. Deri në vitin 1993 nga ana e Bashkimit nuk ka patur një strategji konkrete për ndikimin që do të kishte BE në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Një zhvillim i rëndësishëm politik u ndërmor nga Bashkimi gjatë samitit të Kopenhagenit në qershor të vitit 1993, ku Këshilli Evropian mori vendimin historik për të hapur BE-në ndaj vendeve të EQL duke përcaktuar kushtet e pranimit për këto shtete. Kushtet, që gjerësisht njihen me termin “Kriteret e Kopenhagenit⁵⁰¹” përcaktojnë kriteret që duhet të përmbushë një vend kandidat për në

⁴⁹⁷ James Hughes ..etj *“Conditionality and Compliance in the EU’s Eastward Enlargement: Regional Policy and the Reform of Sub-national Government”*, JCMS 2004, Volume 42. Number 3. fq. 523

⁴⁹⁸ Heather Grabbe, fq. 2.

⁴⁹⁹ Shiko: Judith Hoffmann, fq. 55.

⁵⁰⁰ Neni 49 i traktatit të Mاستrihtit që njihet ndryshe si traktati i themelimit të Bashkimit Evropian

⁵⁰¹ Shiko: *Bashkimi Evropian*, QNK “Arbnori” Tiranë, 2010 fq. 21

BE. Kriteri politik i Kopenhagenit theksojnë se vendi kandidat duhet të ketë *institucione të qëndrueshme që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut si dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve*. Kriteri ekonomik ka të bëjë me *ekzistencën e një ekonomie tregu që funksionon si dhe aftësinë për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian*. Kriteri i tretë ka të bëjë me *përshtatjen e *acquis communautaire*, e cila përfshin detyrimet që derivojnë nga statusi përfshirë edhe besnikërinë ndaj tendencës për bashkime politike, ekonomike dhe monetare të vendit anëtar*⁵⁰².

Diskutimi rreth arritjeve të evropianizimit të vendeve ish-komuniste, shtrohet jo vetëm në rolin e stimujve të BE-së për promovimin e demokracisë dhe ekonomisë së tregut, por edhe të elementëve që frenojnë apo nxisin vendet që të arrijë rezultate në procesin e demokratizimit. Njëpërmjet mekanizmit të “kushtëzimit demokratik” Bashkimit Evropian ka ofruar një model standard asociimi për çdo vend kandidat. Studiuesit evidentojnë dallimin ndërmjet dy kategorive kryesore të mekanizmit të kushtëzimit demokratik; kushtëzimin formal dhe kushtëzimi joformal. Kushtëzimi formal, nënkupton parakushtet e lartpërmendura të kriterëve të Kopenhagenit dhe kornizën ligjore të *acquis-it*, ndërsa kushtëzimi joformal përfshin presionet operative dhe rekomandimet e dhëna nga aktorët brenda Komisionit për të arritur rezultate të veçanta gjatë ndërveprimit me aktorët politikë të VEQL përsa i përket mundësisë së zgjerimit⁵⁰³, kjo nuk do të thotë se të dyja llojet e kushtëzimit janë të qarta dhe dallohen gjithmonë pasi ato shpesh veprojnë në bashkëpunim.

Arsyet e suksesit në vendet EQL dhe mospërmbushjes në vendet e Ballkanit Perëndimor lidhen së pari me arritjet e këtyre vendeve në fushën e demokratizimit. Fuqia asimetrike dhe ndikimi i BE-së në përmbushjen e kushteve politike bëhet i mundur kur *politika vendase orientohet nga praktikat demokratike të qeverisjes*. Në vendet me demokraci të brishtë siç është edhe Shqipëria zbatimi i normave demokratike has shpesh herë kundërshti pasi ato bien ndesh me interesin qeverisës të drejtuesve politik të kujtdo force politike. Të dhënat empirike veçanërisht për vendin tonë, theksojnë se kushtëzimi joformal duket se luan një rol të rëndësishëm sidomos në mospërmbushjen e kriterit politik të Kopenhagenit. Në Shqipëri, kushtëzimi joformal lidhet me vullnetin që shfaq ose nuk shfaq klasa politike për funksionimin e akteve formale të ndërmarra si pasojë e angazhimit për anëtarësim në BE. Mungesa e rezultateve në këtë drejtim ka vënë në dukje faktorët që varen nga vetë vendet candidate.

Për vetë dinamikat historike, rajoni i Ballkanit ka turbulluar jo rrallëherë perëndimin me problemet e tij. Pas viteve ‘90, si pasojë e shpërbërjes së dhunshme të ish-Jugosllavisë, shtetet e Ballkanit kanë qënë të përfshira në luftra dhe konflikte të

⁵⁰² Për kriteret e Kopenhagenit shiko gjithashtu: Ermelinda Meksi, Auron Pasha “*Kur mbaron Tranzicioni? Teoria kundrejt realitetit në Shqipëri*” fq. 5 burimi online: (aksesuar më 6.7.2012) http://www.bankofalbania.org/web/pub/c_25_Fjalimi_Meksit_Pashes_790_1.pdf

⁵⁰³ Kjo ndarje është bërë nga James Hughes, Gwendolyn Sasse dhe Claire Gordon në artikullin e lartpërmendur fq. 526

vazhdueshme. Përveç problemeve me kufijt dhe pakicat etnike, vendet e Ballkanit janë vendet më të varfra dhe të pazhvilluara të Evropës. Lufta e Kosovës dhe ndërhyrja e bashkësisë ndërkombëtre për zgjidhjen e konfliktit i dha një perspektivë të re rajonit. Në dekadën e parë pas viteve '90 axhenda politike e BE-së për këtë rajon ka qënë e pamjaftueshme. Nisma e parë e rëndësishme e BE-së dhe bashkësisë ndërkombëtare për Ballkanin ishte Pakti i Stabilitetit, i miratuar në qershor 1999. Objektivi strategjik i të cilit ishte integrimi më i plotë i mundshëm i këtyre vendeve në rrjedhën politike dhe ekonomike të Evropës⁵⁰⁴. Në këtë kuadër integrimi i vendeve të Ballkanit mori një hov të ri në axhendën politike të BE-së në Samitin e mbajtur në Feira në qershor 2000⁵⁰⁵. Në këtë samit, krerët e vendeve të Bashkimit Evropian pohuan se ishin për *“integrimin e plotë të vendeve të Ballkanit Perëndimor në bashkësinë politike dhe ekonomike të Evropës nëpërmjet procesit të Stabilizim – Asociimit, dialogut politik, liberalizimit të tregtisë dhe bashkëpunimit në Drejtësi dhe Çështje të Brendshme. Të gjitha shtetet e interesuara janë kandidatë potencialë për anëtarësim në BE⁵⁰⁶”*. Plani i quajtur *The Stabilization and Association Process* (SAP), përcaktonte kushtet specifike që Shqipëria dhe vendet e tjera të Ballkanit duhej të përmbushnin për t'u futur në BE. Ky proces kishte të bënte me modelin e kushtëzimit që BE-ja i ofronte Shqipërisë dhe krejt rajonit për mundësinë e demokratizimit duke iu përmbajtur kushteve për anëtarësim në BE. Politika e BE-së vijoi më tej me thellimin e angazhimit në Ballkan në samitin e Selanikut në qershor 2003 duke përforcuar procesin e Stabilizim – Asociimit me instrumenta të reja në mbështetje të reformave dhe përpjekjeve të këtyre vendeve për integrimin evropian⁵⁰⁷.

Pavarsisht mbështetjes me mekanizma të njëjta ndihme nga BE-ja, vendet e Ballkanit Perëndimor ndodhen në stadi të ndryshme zhvillimi në raport me procesin e integritit drejt BE-së. Luhatjet në proceset e integritit lidhen me progresin e këtyre vendeve si në fushën ekonomike atë politike dhe legjislativë. Një nga eksperiencat më pozitive ndër këto vende është Kroacia e cila tashmë është anëtare më e ri e Bashkimit Evropian. Kroacia e sotme ndryshon dukshëm nga vendi ku para 22 viteve gjendej në luftë për pavarësinë e saj. Perspektiva Evropiane i dha shtysën e domosdoshme kroatëve dhe krejt popujve të Ballkanit për të ndryshuar të ardhmen e tyre.

Ritmi i procesit të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian ka patur uljet dhe ngritjet e tij. Nëse në mesin e viteve '90, Shqipëria dhe Kroacia ishin në etapa të përafërta të integritit të tyre në BE, si pasojë e zhvillimeve politike vendi ynë nuk arriti dot të ndiqte ritmet e Kroacisë. Elita politike dhe shoqëria kroate në tërësi i ka shfrytëzuar më mirë ndihmën financiare, asistencën teknike dhe orientimet e dhëna nga BE-ja për arritjen e standarteve të pranimit nga Unioni edhe si pasojë e trashëgimisë së saj historike. Ndërkohë që kroatët shijojnë suksesin e arritjeve të tyre, Shqipëria dhe shqiptarët *“e gjejnë veten bashkë me Kosovën dhe Bosnjë-Hercegovinën në lidhje me*

⁵⁰⁴ Iva Zajmi, “E drejta Europiane”, Tiranë 2010, fq.216-7

⁵⁰⁵ Strategjia e Zgjerimit 2005, Komisioni Evropian, Brussels, 9.11.2005, Fq.6.

⁵⁰⁶ Cituar në: Progres Raporti 2005, fq.3

⁵⁰⁷ Ibid (Progres Raporti 2005, fq.3)

*perspektivën e integritit evropian, jo tërësisht jashtë loje, por gjithsesi shumë të distancuar*⁵⁰⁸”.

Po cilat kanë qënë disa nga arsyet që e kanë bërë mekanizmin e kushtëzimit demokratik të BE-së joefikas në Shqipëri?

Së pari: Ecuria dhe zhvillimet politike të Shqipërisë në drejtim të realizimit të axhendës së integritit nga klasa politike nuk kanë shkuar në të njëjtën linjë me aspiratën e qytetarëve, madje pavarësisht faktit se çështjet e integritit kanë përcaktuar axhendën politike të dy partive kryesore dështimet në këtë drejtim kanë përforcuar bindjen e qytetarëve se vetëm Evropa mund të rregullojë diçka në këtë vend. Nëse i referohemi sondazheve të realizuara si nga faktori vendas edhe ai ndërkombëtar, raporti i besimit dhe mbështetja e shqiptarëve kundrejt integritit të Shqipërisë në BE ka mbetur një bindje e qëndrueshme (shiko tab 9).

Tabela 9. Mbështetja e qytetarëve shqiptarë për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Viti	2008	2009	2010
Mbështetja në %	83,1%	88,1%	80%

Burimi: Gallup Balkan Monitor

Sipas sondazhit të vitit 2008 të zhvilluara nga Gallup Balkan Monitor, Bashkimi Evropian ka një ndikim të madh pasi, “*shumica e shqiptarëve i besojnë institucioneve të Bashkimit Evropian dhe se 83% besojnë se anëtarësimi në BE do të ishte i mirë për Shqipërinë*⁵⁰⁹. Po kështu sipas sondazhit të vitit 2010 rreth 93% e shqiptarëve do të votonin në favor të bashkimit të vendit me BE-në⁵¹⁰”.

Bashkimi Evropian është bërë drejtimi i retorikës politike shqiptare pasi klasa politike nëpërmjet saj kërkon mbështetjen e elektoratit dhe njëkohësisht përfitimet që derivojnë nga raportet me BE-në. Orientimi pro evropian i qytetarëve shqiptarë ka diktuar qasjen e partive politike të cilat pa përjashtim kanë përdorur “tezën e integritit” jo si qëllim në vetvete por si një element atraktiv për të gëzuar mbështetje në elektorat. Në këtë optikë duket sikur qëllimi i orientimit drejt BE-së nuk është demokratizimi dhe evropianizimi i vendit por përkundrazi përveç retorikës pro evropiane i gjithë aktiviteti politik i klasës drejtuese, opozitës dhe administratës shtetërore shkojnë në linjë të kundërt me të. Mungesa e bashkëpunimit nga aktorët e spektrit politik shqiptar për të ndërmarrë reformat e diktuar jo vetëm nga nevojat e demoratizimit të vendit por edhe si

⁵⁰⁸ Robert C. Austin, “*Fillime të para dhe të dyta: Shqipëria pas Luftës së Parë Botërore dhe komunizmit*”, “*Shqipëria në dhjetë vitet e ardhshme –vështrim drejt së ardhmes*” botim i AIIS, Tiranë 2012 fq. 79

⁵⁰⁹ Gallup, *Balkan Monitor, Insights and Perceptions, Voices of the Balkans*, 2008 Summary of Findings, fq. 8.

⁵¹⁰ Gallup, *Balkan Monitor, Insights and Perceptions, Voices of the Balkans*, 2010 Summary of Findings, fq. 7.

kusht për plotësimin e standarteve të BE-së dëshmojnë qartë se jo vetëm që integrimin nuk është në përputhje me aspiratën e qytetarëve por as edhe një qëllim primar.

Në këtë optikë, mungesa e rezultateve të dëshiruara kundrejt procesit të integrimit nga partitë që kanë qenë në pushtet ka ndikuar në humbjen e mbështetjes në elektorat. Humbja e të majtës në vitin 2005 erdhi edhe si pasojë e mungesës së rezultateve të mëtejshme në drejtim të integrimit e cila pas hapjes së negociatave në vitin 2003 nuk pati ndonjë zhvillim domethënës deri në fund të mandatit qeverisës. E njëjta analizë vlen edhe për largimin e të djathtëve, ku pas refuzimit për herë të dytë të kërkesës për marrjen e statusit të vendit kandidat, procesi i integrimit nuk përparoi më tej. Arsyeja e lidhjes së suksesit të një force politike me axhendën e integrimit në Bashkimin Evropian lidhet edhe me perceptimin që kanë shqiptarët për integrimin dhe vet Bashkimin Evropian. Sipas politologut Kajsiu: *“kërkesa e shqiptarëve për t’u bërë anëtarë të Bashkimit Evropian nuk shënon thjesht aktin formal të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Përkundrazi, ajo shënon dhe përfaqëson një sërë kërkesash, si kërkesën për punësim, zhvillim, modernizim, krenari⁵¹¹”*. Me anëtarësim nga shoqëria shqiptare nënkuptohet fundi jo vetëm i tranzicionit por i të gjithë problemeve që ka sot vendi. Në këtë kontekst dështimi i aktorëve politikë në zhvillimin e etapave të integrimit të vendit drejt BE-së për qytetarët është në thelb dështimi për *“...zhvillim, modernizim, punësim, energji elektrike 24 orë, jetë cilësore, liri, zbavitje...⁵¹²”*. Mungesa e koherencës midis aktorëve politikë dhe vullnetit të popullit shfaqet edhe si një krizë e përfaqësimit të aspiratës për integrim nga njëra anë dhe zhgënjimit të vazhdueshëm në mosrealizimin e saj nga ana tjetër.

Së dyti: Shqipëria vijon të mbetet një demokraci e brishtë, me një klasë politike të polarizuar, një vend i varfër, me probleme të mëdha përsa i përket korrupsionit të lartë shtetëror, krimin të organizuar, trafikëve të paligjshme, institucioneve dhe shtetit të dobët. Klasifikimi i statusit të Shqipërisë si një vend *“Pjesërisht i lirë⁵¹³”* apo *“Regjim Hibrid”* për vite e vite me radhë nga institucione prestigjioze ndërkombëtare nënkupton se pavarësisht angazhimeve më serioze të vendit qoftë me nënshkrimin e MSA-së në 2006 apo si vend anëtar i Nato-s në 2009 nuk kanë ndodhur ndryshime cilësore në fushën e demokratizimit. Sipas politologut Kajsiu *“Sot është e lehtë të konstatohet që afrimi i Shqipërisë me BE-në nuk ka prodhuar domosdoshmërisht më shumë demokraci⁵¹⁴”*. Ashtu siç është argumentuar më lart në këtë pjesë, në vende me karakteristika të këtilla pra me demokraci të brishtë dhe klasë politike e cila nuk e identifikon aktivitetin politik me normat dhe vlerat demokratike mekanizmi i kushtëzimit i përdorur nga BE nuk jep rezultate të qëndrueshme. Një rast që mund të përmendim këtu ishte zgjedhja e presidentit

⁵¹¹ *“Vdekje Politikës, Liri Popullit! - Kriza e Përfaqësimit në Shqipëri”*, Blendi Kajsiu, Polis Nr.5, 2008, fq. 7.

⁵¹² Ibid. (Kajsiu), fq. 8.

⁵¹³ Shiko raportet e Freedom House ndër vite si dhe për klasifikimin ‘Regjim politik hibrid’ shiko The Economist Intelligence Unit’s index of democracy nga viti 2007 e në vijim

⁵¹⁴ *“Europa? E pse na duhet?! A ka vend për të dyshuar për procesin e integrimit tonë në BE? Ja si përgjigjen katër euroskeptikë”*, nga Skender Minxhozi në Revista Java aksesuar më 13-02-2012 burimi online: <http://www.revistajava.al/kryesore-ne-kopertine/2012213/europa-e-pse-na-duhet>

konsensual Alfred Moisiu në qershor të vitit 2002. Arritja e konsensusit midis partive politike u ndikua në një masë të konsiderueshme nga opinionet e shprehura nga BE-ja dhe komuniteti ndërkombëtar. Marrja në konsideratë e opinionit të dhënë nga institucionet e BE-së dhanë rezultate të pëlqyeshme por jo afatgjata. Zgjedhja e presidentit konsensual shmangu destabilitetin politik, përmirësoi klimën politike në vend, por problemet e hasura në zgjedhjet lokale të vitit 2003 e ndërprejnë bashkëpunimin politik midis palëve që nuk rezultoi të ishte bashkëpunim mbi bazë vlerash dhe maturie politike, por në përmbushje të një interesi të përbashkët (për të gjithë klasën politike) dhe kërkesë të parashtruar nga organizmat ndërkombëtarë për t'u plotësuar. Sipas raportit të vitit 2004 thuhej se për sa kohë që Shqipëria dëshiron të ecë përpara në rrugën e saj drejt BE-së, është e domosdoshme që ajo të tregojë vullnetin politik, vendosmërinë dhe aftësinë për t'i trajtuar pa vonesë çështjet kyçe të identifikuar⁵¹⁵. Ashtu siç ka thënë Klaus-Diter Borçard “Rëndësia e vërtetë e rekomandimeve dhe opinioneve (të institucioneve të BE-së) është politike dhe morale⁵¹⁶”. Po kështu mekanizmi i kushtëzimit demokratik ndikoi te ekzekutivi socialist për realizimin e zgjedhjeve të pakontestueshme, por jo pa probleme në korrik të vitit 2005, gjë e cila nuk vazhdoi si traditë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009 ku i njëjti mekanizëm nuk dha rezultat në ekzekutivin demokrat pasi u rikthye kontestimi i zgjedhjeve. Përsa më lart, ndikimi i rekomandimeve dhe opinioneve të dhëna nga institucionet e Bashkimit Evropian janë rezultate kur ato merren në konsideratë nga forcat politike dhe nuk bien ndesh me interesin e tyre politik. Në këto kushte, nevojiten masa të mëtejshme shtrënguese sidomos në adresë të faktorit politik në mënyrë që strategjia politike dhe kontributi i BE-së të japi rezultate afatgjata në Shqipëri.

4.2 Vullnet politik apo demokratizim institucional, qasja e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian

Gjatë këtyre 20 viteve tranzicion klasa politike shqiptare ka luajtur në shumë raste rol frenues në konsolidimin e pavarësisë së institucioneve. Qasja e demokratizimit institucional ka rezultuar e vështirë dhe në një masë të madhe e papërmbushur pikërisht si pasojë e mungesës së vullnetit politik që është bërë faktor frenues për realizimin e reformave dhe të proceseve demokratike aq të domosdoshme për integrimin e vendit në rastin e Shqipërisë modeli i demokratizimit institucional nuk ka rezultuar efikas⁵¹⁷.

⁵¹⁵ Raporti i Stabilizim Asocimit 2004, fq. 1.

⁵¹⁶ Klaus-Diter Borçard, “ABC – ja e të Drejtës të Bashkimit Evropian”, Bashkimi Evropian, 2010, fq. 96 burimi online:

http://eeas.europa.eu/delegations/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/documents/more_info/publications/abc_of_european_laë_sq.pdf

⁵¹⁷ Pjesë të këtij punimi janë botuar në artikullin me të njëjtin titull nga Elda Zotaj në Revista “Diskutime”, Vitit I, Nr 1-2, Nëntor, 2012 fq. 246-254.

Procesi i integritit drejt Bashkimit Evropian është thellësisht i lidhur me demokratizimin e sistemit politik, ekonomik e social të vendit. Në demokracitë kushtetuese moderne, ndarja dhe balancimi i pushteteve është tipari bazë ku padiskutim edhe vendosja e kufizimeve specifike mbi kompetencat e shtetit kundrejt individit janë elementë thelbësorë të demokracisë⁵¹⁸. Ekzistenca e shumë pushteteve brenda shtetit, të cilat funksionojnë si të pavarura nga njëri-tjetri është jetike për zhvillimin e institucioneve demokratike dhe forcimin e shtetit. Elementët bazë të një shteti demokratik mund të formulohen në mënyra të ndryshme, por është përgjegjësia e atyre që kanë forcën politike që formulimet t'i realizojnë në funksion të demokratizimit të vendit. Për Kajsium: *“Forcimi i institucioneve apo i shtetit të së drejtës janë procese thellësisht politike dhe si të tilla janë produkte dhe jo burim i procesit politik”*⁵¹⁹.

Në Shqipëri, politika ka ndikuar si në procesin e zhvillimit të demokracisë, të institucioneve dhe shtetit të së drejtës aq edhe në frenimin apo kthimin mbrapa të këtyre arritjeve. Në këto vite tranzicion politika e konfliktit, e ngërçeve dhe mos-bashkëpunimit natyral pozitë-opozitë (pra jo si rezultat i presionit ndërkombëtar) janë argumenti kryesor që tregon se faktori politik nuk ka vepruar me “përkushtim” drejt integritit. Duhet ta pranojmë se mentaliteti i liderëve politikë shqiptarë ndryshon dukshëm nga mentaliteti i liderëve të vendeve perëndimore. Binomi mik-armik apo komunist-demokrat është ende i fortë dhe ndikon në sjelljen dhe vendimmarrjen e liderëve të partive kryesore. Këto mentalitete shfaqen dhe pengojnë kompromisin dhe bashkëpunimin e domosdoshëm në momente historike kyçe për vendin. Shpesh gjatë këtyre viteve në vend të kompromisit dhe të bashkëpunimit politikanët kanë bërë pikërisht të kundërtën, duke sjellë pasoja të rënda për demokratizimin dhe integritimin e vendin.

Ende sot klasa politike shqiptare nuk e zhvillon luftën e saj politike bazuar në konsensusin procedural mbi rregullat e lojës⁵²⁰, pa funksionimin e vazhdueshëm të këtij mekanizmi vështirë se arrihen rezultate në demokratizimin e vendit. Mungesa e traditave demokratike të mëparshme në historinë tonë politike kanë bërë që klasa politike të ketë hera-herës një qasje demagogjike ndaj këtij procesi dhe jo vullnet të vërtetë për drejtimin e Shqipërisë në rrugën drejt anëtarësimit në BE.

Si qytetarët e Shqipërisë dhe ndërkombëtarët bien dakort se kritikën më të mëdha për mungesën e progresit në integritimin e vendit i adresohen klasës politike shqiptare. Në këtë drejtim, përfrimi drejt standardeve të Bashkimit Evropian shfaqet jo vetëm si një proces mekanik i përjasjes legjislativë dhe institucionale të Shqipërisë me BE-në, por edhe si një *proces/vullnet* politik i klasës politike për zbatimin e këtij angazhimi ligjor e institucional. Pikërisht këtu roli i klasës politike ka marrë një rëndësi të veçantë. Në fakt procesi i përfrimit të legjislationit shqiptar me atë evropian ka filluar që me Marrëveshjen Ekonomike e Tregtare të vitit 1992 dhe është përforcuar me nënshkrimin e

⁵¹⁸ Për më shumë shiko: *Kushtetuta dhe material shpjeguese*, dhjetor 1998, Tiranë, QAKAPP fq. 1-9.

⁵¹⁹ “Demokratizim pa politikë: Baza konceptuale e qasjes ndërkombëtare në Shqipëri” Blendi Kajsium fq. 16 online, <http://revistapolis.com/polis/images/stories/Polis%204/Blendi%20Kajsium.pdf> aksesuar më 31.1.2013

⁵²⁰ Op.cit Samuel P. Huntington, *Vala e Tretë*, Tiranë AIIS 2011 fq27

më pas hyrjen në fuqi të MSA-së në vitin 2009-të. Në funksion të këtij procesi Shqipërisë i është dashur jo vetëm të ndërtojë kuadrin e saj rregullator në përputhje me standardet evropiane, por të sigurojë strukturat administrative dhe kushtet e tjera të nevojshme për zbatimin e *acquis-it*⁵²¹. Përfshirja e Shqipërisë në Marrëveshjen e Stabilizim – Asociimit dhe intensifikimi i marrëdhënieve me BE-në ndikoi në krijimin e strukturave të posaçme në nivel ekzekutiv e legjislativ. Në kuadër të këtyre zhvillimeve, në vitin 2002, me vendim të Kuvendit të Shqipërisë Nr. 37, datë 16 maj 2002⁵²², u krijua një komision i posaçëm parlamentar për “Integrimin Evropian dhe Paktin e Stabilitetit”.

Në dukje retorika e të gjithë spektrit politik është pro demokratizimit dhe integritit në Bashkimin Evropian. Themi në dukje pasi pikërisht frenimi i këtyre proceseve ka qënë direkt apo indirekt produkt i politikës së tyre. Nga ana e BE-së përpjekja për të demokratizuar vendet aspirante ka hasur jo rrallëherë në “keqpërdorim” të normave dhe praktikave demokratike. Në rastin e Shqipërisë nuk kanë munguar praktika të tilla nga qeveritë dhe politikanët tanë, duke e “shqiptarizuar” procesin dhe detyruar politikën evropiane të përpiqet që të adaptohet sipas kontekstit dhe ligjërimit momental.

Nëse i referohemi dinamikave të marrëdhënieve Shqipëri – BE pas vitit 2009 vëmendja fokusohet tek refuzimet që i janë bërë kërkesës së Shqipërisë për statusin e vendit kandidat (i treti në dhjetor 2013). Situata e krijuar me Shqipërinë është e paprecedent, në historinë e saj BE-ja nuk njeh ndonjë rast tjetër që të këtë refuzuar kërkesën e një vendi kandidat për të disatën herë rradhasi. Në tërësi kriteret e Kopenhagenit janë njësoj të rëndësishme për anëtarësimin e një vendi në BE, por hapja e negociatave për anëtarësim lidhet ngushtë me përmbushjen e kriterit politik⁵²³. Pikërisht kritikant më të shumta për refuzimin e njëpasnjëshëm të statusit lidhet me mosplotësimin e kriterit politik të Kartës së Kopenhagenit. Pavarësisht refuzimit, Komisioni Evropian përcaktoi 12 prioritetet për qeverinë dhe politikën shqiptare. Pesë nga këto prioritetet lidheshin pikërisht me situatën politike në vend, kjo e shprehur edhe nga Stefano Sannino⁵²⁴ “Dialogu është tashmë pjesë e prioritetëve... është në duart e udhëheqjes politike shqiptare... nëse ka vullnet për të lëvizur në këtë drejtim⁵²⁵”. Komisioni Evropian pohoi se Shqipëria ka bërë *progres* por politika Shqiptare ka ende shumë rrugë drejt

⁵²¹ Shiko: Artikulli: “Plani i zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe rëndësia e tij në procesin e integritit evropian të Shqipërisë”, Erion Fejzullah, Aida Gugu në Buletini Informativ me titull, “Rritja e rolit të Parlamentit në procesin e integritit përmes pjesëmarrjes legjislative dhe transparences” Nr. 2 Mars 2012, fq. 2.

⁵²² Artikulli: “Analiza ligjore: Kuadri ligjor ekzistues mbi rolin e Kuvendit në procesin e Integritit si dhe detyrat e Komisionit Parlamentar të Integritit Evropian”, Erion Fejzulla, në Buletini Informativ me titull, “Rritja e rolit të Parlamentit në procesin e integritit përmes pjesëmarrjes legjislative dhe transparences” Nr.1 Dhjetor 2011, fq. 2.

burimi online: www.ascdpd.org

⁵²³ Referohu: http://europa.eu/legislation_summaries/glossary/accession_criteria_copenhagen_en.htm

⁵²⁴ Zv.drejtori i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme për Marrëdhënie me Jashtë të Komisionit Evropian

⁵²⁵ Marrë nga intervista e z. Sannino radio “Deutsche Welle” dt.13.10.2011

integritit/demokratizimit!!!! Në këtë konteks qasja e Shqipërisë drejt Bashkimit European ka qënë një qasje e mangët institucionale si pasojë e luftës së vazhdueshme të klasës politike për pushtet qeverisës. Vullneti politik vijon të dominojë dhe kushtëzon funksionimin e sistemit *demokratik* dhe institucioneve të pavarura.

4.2.1 Pushtet apo institucione, zgjedhje e vështirë për klasën politike shqiptare!

Ndër shembujt më tipikë të një politike pa *vullnet* janë proceset zgjedhore të realizuara gjatë këtyre 20 viteve tranzicion. Mekanizmi më i kontestuar dhe më i përfolur i demokracisë institucionale Shqiptare janë *zgjedhjet*, pikërisht A-ja e demokracisë. Me pak fjalë *ato* përmbledhin “institucionalizimin” pa “vullnet politik” të një demokracie të cunguar dhe ndofta të një pushteti të shtrembëruar. Për Stefanin, “*Humbja e një mundësie historike për të institucionalizuar lirinë si një sistem politik në Shqipëri është një nga mëkatet më të rënda të udhëheqësve politikë... një mëkat që nuk përjashton të tjerë aktorë politikë pranë tyre, në fakt e tërë klasa politike*⁵²⁶”

Është fakt që pushteti politik i formësuar në pushtet qeverisës është një lakmi dhe pjesë e strategjisë për marrjen e tij nga çdo forcë politike. Ndryshimi thelbësor i këtij procesi në vendet me demokraci të zhvilluar nga ai i vendeve në tranzicion ka të bëjë më së shumti me rrugën ligjore dhe institucionale që ato ndjekin në zbatimin e parimeve demokratike të përligjes së pushtetit. Më këtë duam të themi që njohja dhe pranimi i rezultateve zgjedhore është baza e legjitimitetit demokratik të fitores apo humbjes së pushtetit politik. Kjo do të thotë që përfaqësuesit e zgjedhur nga sovranit kanë njohjen dhe “bekimin” e palës humbëse.

Që nga ndryshimet politike të viteve 90 – 91, historia e zgjedhjeve në Shqipëri është një nga çështjet më dramatike përsa i takon larmisë, formave dhe shtrembërimeve që ka patur ky proces me krizën e përfaqësimit të vullnetit të sovranit. Pavarsisht se “partitë promovuan vlerat e demokracisë dhe krijimin e një sistemi politik tërësisht të kundërt me modelin diktatorial të partisë-shtet, gjatë këtyre viteve ato në mjaft raste po shfaqin mentalitetin e sistemit të vjetër, përfshirë edhe tendencën e ruajtjes së monopolit politik mbi shtetin e shoqërinë”⁵²⁷.

Ato kanë dominuar procesin politik duke pezmatuar rolin e shoqërisë civile, të studiuesve dhe ekspertëve në shumë çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me demokratizimin e vendit. Sipas studiuesit Fisher:

⁵²⁶ Andrea Stefani “*Konspiracioni Kunder Lirise: Shqipëria nga Diktatura ne Demokracine Bolshevike*”, Tirana: Onufri. 2011 fq. 21.

⁵²⁷ Ylli Bufi, “*Tempulli i demokracisë*”, Ombra GVG, Tiranë, 2010. fq.146

“Është shumë dekurajuese nocioni që ekziston mbi bashkëpunimin. Kultura politike ndikon mjaft në natyrën e partive politike shqiptare. Ato nuk bëjnë marrëveshje për demokracinë brenda vetë radhëve të partive dhe as mes partive të tjera. Por nëse nuk ka demokraci tek partitë politike, Shqipëria do ta ketë të vështirë që të zhvillojë një demokraci funksionale në shtetin e vet”⁵²⁸.

Nga ky pohim del se me këtë klasë politike vështirë se “ndërtohen” institucione “realisht” të pavarura dhe funksionale. Vullenti politik përkthehet si konsensusi që duhet të japë klasa politike për respektimin e normave demokratike, ky një tjetër paradoks shqiptar.

Jeta politike në Shqipëri rrotullohet rreth liderëve dhe partive politike. Jashtë këtij binomi zor se merr pushtet apo dëgjohet nga pushtetarët ndonjë individ, grup interesi apo shoqëri civile, aq më tepër kur interesat e këtyre të fundit nuk përputhen me interesat e klasës politike. Për sa më lart shembujt janë të shumtë.

Në Shqipëri partitë politike gëzojnë pushtet dhe ndikim të madh pothuajse në çdo veprimtari të fushës politike, ekonomike dhe sociale. Kjo qasje ndofta i ka rrënjët tek mosrealizimi procesit të *tranzicionit institucional* të shkëputjes së partisë nga shteti. Në fakt për traditën komuniste binomi parti-shtet ishte çelsi i jetëgjatësisë së pushtetit politik. Është fakt që sot politika dhe pushteti qeverisës është kudo. Ajo është prezente më shumë nga sa i takon të jetë edhe për faktin se institucionet e shtetit janë të brishta dhe të varura nga “vullneti” i saj. Dëshira për pushtet madje për shumë pushtet qeverisës është arsyeja themelore ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008. Këtu vlen të ndalemi pak për të analizuar qasjen e klasës politike kundrejt institucioneve të pavarura. Arroganca e pushtetit arriti deri aty sa u anashkalua edhe referendumi i kërkuar nga disa aktorë të vegjël politikë. Për kushtet specifike në të cilat ndodhet vendi ynë referendumi ishte i domosdoshëm. Gjatë këtyre viteve (mbi)pushteti qeverisës haset jo vetëm në stilin e qeverisjes por sidomos në “kontrollin” nga qeveria të institucioneve të pavarura dhe gjyqësorin. Pushteti qeverisës buron nga zgjedhjet, parlamenti si produkt është institucioni i parë që preket nga pushteti partiak. Këtu vlen të përmendim faktin se:

“Kuvendi është institucioni i parë që bëhet objekt i imponimit të modelit “partiak” të shtetit dhe që e përcjell këtë nga ana e tij, në institucionet e tjera të shtetit me pasoja mjaft negative”⁵²⁹.

Kjo nënkupton atë që gjithë regresi dhe paaftësia e konsolidimit të shtetit dhe institucioneve të pavarura është pashmangshmërisht edhe produkt i klasës politike dhe lojrave të tyre për pushtet. “Kur mazhoranca politike funksionon sipas llogjikës së modeli “partiak”, Kuvendi nuk mund të përmbushë përgjegjësit e tij kushtetuese, ai atrofizohet”⁵³⁰. Parë në këtë frymë, partitë që miratuan së bashku ndryshimet e fundit kushtetuese, po të ishin krejtësisht të ndërgjegjshme për domosdoshmërinë e tyre, për të

⁵²⁸ <http://www.ama-news.al/2011/10/fisher-bllokimi-i-integrimit-vjen-nga-mungesa-e-kultures-politike/>

⁵²⁹ Ylli Bufi, “Tempulli i demokracisë”, Ombra GVG Tiranë 2010fq. 144.

⁵³⁰ Ibid.

mishëruar dhe vullnetin popullor, në mënyrë të natyrshme duhet të ishin po ato, që të kërkonin të miratoheshin dhe nga populli. Një gjë e tillë nuk ndodhi, madje një iniciativë e tillë u ndërmor nga disa parti të vogla të cilat nuk gjetën përkrahje, përkundrazi hasën në kundërshtime të ashpra nga dy partitë e mëdha dhe dështuan në qëllimin e tyre. Liderët e dy partive të mëdha shkuan deri aty sa çështja e referendumit shitej sikur të ishte ide apo iniciativë e gabuar. Ja si është shprehur lideri i opozitës për çështjen e referendumit:

“Duke i konsideruar deputetët si përfaqësues të popullit, Rama ka vlerësuar se paketa e amendamenteve kushtetuese ka marrë dhe mbështetjen popullore. “Parlamenti është shprehur një herë për ndryshimet kushtetuese dhe *ai është shprehje e popullit Sovran*”⁵³¹ (nënvizim i autorit)

Deklarata e lartpërmendur tregon qartë rastin kur për të mbrojtur qëllimet e ngushta dhe të paargumentuara, justifikohet dhe flitet në emër të popullit pa e marrë fare në konsideratë zërin e tij. Duke patur rezerva për deklaratën e lartpërmendur natyrshëm që lind pyetja kujt sovranit i është referuar ai? Nëse i referohemi historikut të zgjedhjeve natyrisht që mungesa e përfaqësimit real të sovranit është kryefjala e çdo argumenti. Kontestimi, truket elektorale, kontestimi i rezultateve të zgjedhjeve etj, janë bërë pikërisht që të manipulohet, ndryshohet apo të keqpërfaqësohet vullneti i sovranit, nëse vërtet do të kishte respektim dhe lexim të drejtë të votës së sovranit atëherë nuk do të kishim një mungesë përfaqësimi dhe demokratizimi të jetës politike realisht përfaqësuese të nevojave dhe kërkesave të sovranit. Atëherë kujt sovranit iu referohen lideret e dy forcave më të mëdha politike në vend? Në shumë vende të zhvilluara, prekja e kushtetutës është një çështje tepër serioze që kërkon miratim referendar. “Referendumi apo plebishiti është një formë e ushtrimit të demokracisë së drejtëpërdrejtë. Në këtë kuptim mund të thuhet se vetë referendumi mishëron realizimin e vlerave demokratike universale”.⁵³² Shembujt flasin se “deputeti në shumicën e rasteve, shfaqet më tepër si një “karton partiak votimi” sesa një vendimmarrës i përgjegjshëm”⁵³³ dhe loja e numrave dhe e kartonave fiktivë u përforcua dukshëm me ndryshimet që iu bënë kushtetutës përta i përket sistemit zgjedhor. Me kontestimet dhe akuzat për vjedhje votash e deputetësh në zgjedhjet parlamentare të vitit 2005-së kuvendit që doli si rezultat i tyre ndofta nuk duhej ti lejonte vetes autoritetin për ndërhyrjet substanciale që iu bënë kushtetutës. Ne biem dakort me z. Koplaku kur ai shprehet se: “ky Kuvend megadushku nuk duhet ta prekë fare Kushtetutën, përveç minimumit të nevojshëm për të shmangur megadushkun”. Në këtë linjë z. Sabri Godo është shprehur se: “kushtetuta nuk është punë e disa grupimeve partiake. Nuk mund të bëhen gjërat duke i hedhur njëherë vetëm në tryezë dhe pastaj të detyrohen deputetët nga disiplina partiake që të japin votën e tyre”⁵³⁴. Ndryshimet kushtetuese nuk janë tabu, por ato duhet të bëhen në kuadër të mirëqeverisjes dhe stabilitetit në qeverisje, duke kaluar dhe respektuar të gjitha fazat proceduriale, ku në

⁵³¹ Gazeta shekulli. 2 maj 2008 fq. 4.

⁵³² Meidani, Rexhep. 2009. *Kushtetuta: Bilanci dhe prespektiva*, Tiranë: Toena fq. 24.

⁵³³ Meidani, Rexhep. 2009. *Kushtetuta: Bilanci dhe prespektiva*, Tiranë: Toena fq. 34.

⁵³⁴ Gazeta Shqiptare. 16 prill 2008, fq. 5.

rastin konkret përveç problemeve procedurale nga të dy partitë u mohua edhe miratimi referendar. Përsa më lart nëse do ti referohemi dinamikës së ngjarjeve, Partia Socialiste kishte kohë që kërkonte ndryshime në sistemin elektoral dhe ato që preknin procedurat e zgjedhjes së deputetëve.

Disa deputetë i komentuan si jo transparente dhe pa u lënë kohën e domosdoshme për shqyrtimin e tyre. Vetë z. Besnik Mustafaj⁵³⁵ është shprehur se: “jemi dëshmitarë se procesi po kryhet pa transparencë” ai vazhdon se “më shqetëson në këtë proces fakti që grupi parlamentar i PD-së është shmangur tërësisht, është lënë jashtë loje⁵³⁶”. Ndërsa deputeti Ngjela ishte shprehur për këto nisma “shoqëria është përballë një grushti antikushtetues⁵³⁷”. Deklaratat e mësipërme nuk lënë vend për koment ato janë qartësisht të lexueshme. Pavarsisht mendimeve dhe zërave kundër, kompromisi rezultoi të ishte: secila nga partitë të “rregullonte” nenet që do ti sillnin më shumë përfitim me logjikën se në fund të fundit edhe pala tjetër do të bënte të njëjtën gjë, pra do pranonte në emër të tij.

Kjo besojmë, nuk i vjen në ndihmë forcimit të demokracisë dhe institucioneve në Shqipëri por forcimit të pozitës së drejtuesve të partive dhe shterimin e mendimit ndryshe nga njëshi. Parë nga ky këndvështrim del se këto ndryshime ishin të shpejtuara dhe në një masë të madhe të tyre të panevojshme. Pavarsisht përfitimeve fillestare afatshkurtra, ndryshimet sidomos mbi sistemin zgjedhor, pra eliminimin e një sërë partish politike fiktive që realisht ishte një domosdoshmëri, mënyra dhe mungesa e ekspertizës konstitucionale la ende shumë mangësi. Koha tregoi që këto ndryshime jo vetëm nuk zgjidhën “ngërçet politike” por ato bllokuan më tej ngërçet egzistuese, madje lindën edhe të tjera⁵³⁸. Ndofta problemi i vetmi real dhe urgjent që kishte vendi ynë më Kushtetutën e tij, ishte zhdukja e megadushkut, vjedhja e deputetëve përmes procedurëve që anashkalonin vullnetin e popullit. Sipas mendimit tonë edhe në këtë pikë nuk u gjet zgjidhja më e mirë, doli akoma dhe më shumë në pah roli i kryetarëve të partive. Fuqizohet dukshëm dhe thellonte problemin themelor që kanë partitë politike dhe politikë jonë në tërësi, fuqizimin e njëshit: të pagabueshmit, të pakorrigjueshmin dhe të pazëvendësueshmit. Këto ndryshime rezultuan një dështim në demokratizimin dhe kontrollimin e pushtetit të “njëshit partiak” e më pas të “njëshit ekzekutiv”. Përsa më lart mund të themi se për sa kohë klasa politike është e interesuar vetëm për pushtet ajo nuk do punojë seriozisht për ndërtimin dhe demokratizimin e institucioneve shtetërore. Për të patur rezultate serioze në këtë drejtim nevojitet reformim dhe angazhim serioz i drejtuesve politike në mënyrë që funksionimi dhe respektimi i parimit të ndarjes së pushteteve dhe demokratizimi institucional të bëhet realitet dhe jo thjesht një objektiv.

⁵³⁵ Deputet dhe ish-ministër i jashtëm

⁵³⁶ Gazeta Shqiptare, 17 prill 2008, fq. 4.

⁵³⁷ Gazeta Shqiptare, 18 prill 2008, fq. 4.

⁵³⁸ Psh mënyra e zgjedhjes së presidentit, palet PS-PD ranë dakort për zgjedhjen e tij në raundin e 5-të me shumicë të thjesht ndërsa tani PS-ja e konsideron përsëri çështjen që duhet rishikuar, debat ka edhe për ndryshimet e tjera si sistemin zgjedhor etj

4.3 Angazhimi i politikanëve shqiptarë drejt BE, realitet apo demagogji

Politika e deritanishme ka gjeneruar një mentalitet negativ të asaj çka quhet bashkëjetesë dhe bashkëpunim midis aktorëve politike Shqiptare. Perceptimi negativ rreth angazhimit të politikanëve shqiptarë në procesin e integritimit të vendit drejt Evropës lidhet dukshëm me mungesën e kohezionit midis sipërmarrjes politike dhe asaj demagogjike. Si në asnjë vend tjetër të rajonit mbështetja e shoqërisë shqiptare për politikanët e angazhuar në realizimin e procesit të integritimit ka qenë dhe mbetet i lartë. Po kështu në spektrin e partive politike shqiptare nuk gjen asnjë forcë politike e cila të ketë në platformën e vet qeverisëse një alternativë tjetër që të përjashtojë alternativën e integritimit evropian. Në këtë kuptim anëtarësimi në Bashkimin Evropian është ndër të paktat çështje të politikës shqiptare për të cilën ka një konsensus kombëtar popullor dhe politik. Nëse ekzistojnë asete kaq të vlefshme dhe ato janë vërtetë, atëherë çfarë e ka bërë politikën shqiptare ndër këto vite kaq pak bashkëpunuese dhe rrjedhimisht pak frytdhënëse në drejtim të procesit të integritimit?

Ashtu siç është shprehur edhe studiuesi Kaltsounis “*Nuk ka dyshim që shoqëria shqiptarë ka bërë përparime në rrugën drejt demokracisë, e megjithatë qytetarët e saj ende jetojnë në një vend i cili klasifikohet si pjesërisht i lirë, dhe për këtë nuk ka justifikim*”⁵³⁹. Çfarë e pengon Shqipërinë në rrugën e saj drejtë integritimit? A ka justifikime reale mbi vonesat e anëtarësimit?

Në analizën tonë, ne i qëndrojmë mendimit se angazhimi i politikanëve shqiptarë në drejtim të integritimit të vendit në BE rezulton më tepër demagogji sesa realitet. Një përgjigje e pjesshme për pyetjen e parashtruar më lartë gjendet tek fakti i njohur se integrimi apo demokratizimi nuk bashkëjeton dot me praktikën korruptive dhe abuzimet me pushtetin. Sipas të dhënave të publikuara nga Transparency International perceptimi i opinionit publik vendas mbi klasën politike shqiptare përsa i takon korrupsionit është shumë negativ. Në këtë përfundim ka arritur edhe sondazhi i vitit 2010 mbi korrupsionin në Shqipëri të dhënat e të cilit tregojnë se deputetët dhe ministrat perceptohen si shumë të korruptuar⁵⁴⁰. Po në këtë linjë konvergojnë edhe të dhënat e marra nga studimet e realizuara nga Instituti i Studimeve Ndërkombëtare për një periudhë gati 10 vjeçare të cilat tregojnë se shoqëria shqiptare percepton si faktor me ndikim të lartë në integrimin e vendit në BE, luftën kundër korrupsionit dhe klasën politike, gjithashtu studimi evidenton si faktorin më të rëndësishëm dhe që do ta çojë përpara integrimin e vendit zgjedhjet e lira dhe të ndershme (Tab.10). Kjo nënkupton se qytetarët mendojnë se integrimi varet dhe është në dorë të politikës. Nëse klasa politike dëshiron vërtet të realizojë reforma, shtet të së drejtës, institucione të pavarura, integrim kë kanë kundër? Natyrshëm lind

⁵³⁹ Theodore Kaltsounis “*The Democratization of Albania*”, Palgrave Macmillan, New York, 2010 Fq. 143

⁵⁴⁰ Sipas studimit me titull “Korrupsioni në Shqipëri, Perceptime dhe Përvoja, Sondazhi 2010”, të organizuar nga Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi, rezulton se nga viti 2005 deri në vitin 2010 perceptimi për kategorinë ministra dhe deputet është rreth 75 pikë në shkallën nga 0-100 pikë, ku 0 do të thotë shumë i ndershëm dhe 100 do të thotë shumë i korruptuar. Fq.10

pyetja deklaratat politike të drejtuesve më të lartë të klasës politike lidhen me angazhime serioze ndaj elektoratit apo demagogjia e rastit?

Tabela 10. Faktorët përcaktues të Integritimit European.

	Faktorët përcaktues të Integritimit European të vendit për vitin 2010	Rezultatet në %
1	Zgjedhje të lira dhe të ndershme	87%
2	Lufta kundër korrupsionit	78%
3	Politika Shqipëtare (klasa politike)	74%

Burimi: AHS (studimi) Perspektiva evropiane e Shqipërisë... 2010, fq. 49

Në analizat që i bëhet progresit të vendit në shumë studime krahasuese si me vendet e rajonit dhe më gjerë, rezulton se performanca e Shqipërisë në indikatorët e demokratizimit dhe zhvillimit është mjaftë e ulët. Ne i referohemi raporteve, studimeve dhe indikatorëve të organizmave ndërkombëtarë dhe vendas jo vetëm për të kuptuar se ku qëndron zhvillimi i Shqipërisë nga njëri vit në tjetrin por edhe ku ndodhet zhvillimi i vendit në raport me vendet e tjera. Kjo qasje na ndihmon të kuptojmë sukseset dhe të metat, arritjet dhe regreset, për më tepër të gjykojmë me fakte dhe argumente punën e atyre që votojmë, politikanëve tanë. Bazuar në të dhënat e raporteve të Bertsmann Transformation Index nga viti 2003 deri në vitin 2012 ecuria e Shqipërisë përsa i takon indekseve të transformimit ka qenë i ulët (shiko tabelën 11). Të dhënat që lidhen me zhvillimin e demokracisë tregojnë që një ndryshim i dukshëm haset midis vitit 2003 kohë në të cilën Partia Socialiste ishte në fund të mandatit të dytë qeverisës dhe vitit 2006 kohë e cila përkon me ardhjen në pushtet të Partisë Demokratike (shiko grafikun 1, Aneksi A). Pas vitit 2008 në të katërt indekset e mësipërme ndryshimet pothuajse janë të pandjeshme përsa i takon zhvillimeve demokratike në vend (shiko Grafikun 2 dhe 3, Aneksi A)

Tabela 11. Transformimi i Shqipërisë sipas Bertsmann Transformation Index (BTI 2003-2012).

	Viti 2003	Viti 2006	Viti 2008		Viti 2010		Viti 2012	
	Pikët	Pikët	Pikët	Renditja në 125 shtete	Pikët	Renditja në 125 shtete	Pikët	Renditja në 128 shtete
Status Index	6.1	6.61	7.07	33	7.17	30	7.02	31
Demokracia	3.2	7.25	7.50	32	7.55	32	7.25	34
Ekonomia e tregut	2.9	5.96	6.64	40	6.79	33	6.79	37
Indeksi i Menaxhimit	5.3	5.32	5.60	46	5.85	38	5.42	50

Në dekadën e fundit, Shqipëria është bërë pjesë e monitorimit periodik nga shumë institucione ndërkombëtare prestigjioze. Kështu, në kuadër të thellimit të angazhimit me BE-në, duke filluar nga marsi i vitit 2002, Komisioni Evropian raporton rregullisht pranë

Këshillit dhe Parlamentit mbi progresin e bërë nga ana e Shqipërisë. Monitorimi periodik i Shqipërisë nga institucionet e Bashkimit Evropian ka nxjerrë në pah rolin e këtij të fundit në orientimin e politikave të brendshme në funksion të integritit. Përfshirja e Shqipërisë në Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit dhe intensifikimi i marrëdhënieve me BE-në ndikoi në krijimin e strukturave të posaçme në nivel ekzekutiv e legjislativ. Në këtë drejtim angazhimi i politikanëve ka qenë realitet.

Për të realizuar procesin e përafrimit institucional dhe procedural ligjor ndër vite janë ndërmarrë hapa konkrete, ne po ndalemi tek disa prej tyre:

1. Krijimi i Drejtorisë së përafrimit të legjislacionit, (Drejtoria e Përafrimit u krijua në vitin 1999 fillimisht pranë Këshillit të Ministrave për të kaluar në Ministrinë e Drejtësisë dhe me krijimin e Ministrisë së Integritit pranë kësaj Ministrie).
2. Krijimi i Ministrisë së Integritit Evropian.
3. Krijimi i Komitetit për Koordinimin ndër-institucional të integritit⁴.
4. Krijimi i grupeve ndër-institucionale të punës. (Grupet ndër-institucionale të punës janë të ndarë sipas kapitujve të *acquis*-it dhe ato janë përgjegjës për përafrimin e legjislacionit. Urdhri i Kryeministrit nr. 46 datë 1.04.2006).
5. Krijimi i strukturës së posaçme në Kuvendin e Shqipërisë, njësia e përafrimit e legjislacionit.

Strukturat e lartpërmendura kanë detyrimin për të koordinuar, realizuar dhe certifikuar përafrimin me *acquis* e BE në faza të ndryshme të hartimit të ligjit⁵⁴¹.

Pavarësisht angazhimit në kuadër të përfaqes institucionale dhe legjislative problemi në Shqipëri qëndron në implementimin dhe zbatimin e ligjit. Kjo ka qenë një nga arsyet kryesore për arritjen e rezultateve nga nismat ligjore të ndërmarra. Të paktën që nga viti 2003 dhe deri më sot hapat e integritit të Shqipëria krahasuar me vendet e tjera të rajonit kanë qenë shumë të ngadalta. Të vetmin vend që Shqipëria lë pas pothuajse në të gjitha raportet e institucioneve më prestigjioze është vetëm Bosnje-Hercegovina (shiko tab.12).

Tabela 12. Hapat e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian.

Fillimi i MSA-së	Janar 2003
Nënshkrimi i MSA-së	Qershor 2006
Liberalizimi i Vizave	Dhjetor 2010
Aplikimi për anëtarësim	Aplikimi i parë në Prill 2009

⁵⁴¹ Për sa më lart shiko: artikullin “Vlerësimi i përputhshmërisë së ligjeve me *acquis* e BE-së dhe roli i Kuvendit në këtë proces”, Erion Fejzulla, Aida Gugu në Buletin Informativ me titull “Rritja e rolit të Parlamentit në procesin e integritit përmes pjesëmarrjes legjislative dhe transparences”, Nr. 3, Qershor 2012, fq. 2-8

Opinionimi i Komisionit për aplikimin e anëtarësimit	Refuzimi i Parë nëntor 2010
Statusi i vendit kandidat	Kandidat Potencial
Fillimi i negociatave të pranimit	-----
Pranimi, mbyllja e negociatave	-----

Pas rotacionit politik të vitit 2005, u duk se Shqipëria po linte pas vitet e vështira të tranzicionit politik, pas vitit 1992 këto ishin zgjedhjet e para politike që realizuan rotacionin e butë të pushtetit politik. Klima e bashkëpunimit ndërmjet forcave politike nuk u arrit kjo edhe për arsye të qeverisjes së vendit nga maxhoranca qeverisëse dominante, madje nuk e ekzagjerojmë nëse themi se në funksion të kësaj logjike është prekur institucioni i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Sipas raportit të vitit 2008 Bertelstmann Transformation Index, “Atmosfera politike midis dy partive politike rivale ka qënë gjithmonë e tensionuar dhe përbën një vështirësi të madhe për transformimin e Shqipërisë”⁵⁴². Ende në politikën Shqiptare dominon logjika që “fituesi i merr të gjitha”⁵⁴³, kundrejt respektimit dhe bashkëpunimit me opozitën, shtetin dhe institucionet e tij.

Për sa më lart, analiza e shifrave në realitetin politik shqiptar është një sagë e vërtetë përse i përket interpretimit apo keq interpretimit të tyre. Ajo që vlen për tu marr në konsideratë është fakti që deri më sot asnjë forcë politike nuk i ka interpretuar me objektivitet rezultatet e raporteve dhe për më tepër asnjë syresh nuk e ka bërë qëllim në vetvete të performuarit në politikë me rezultate dhe shifra.

4.4 Shqipëria gjatë viteve 2005 – 2011; vazhdimi i proceseve integruese dhe angazhimi politik i Shqipërisë në kuadrin e perceptimeve të Bashkimit Evropian

Gjatë dekadës së fundit të transformimeve politike, nga shqetësimet kryesore të komunitetit ndërkombëtar kanë qënë rreth drejtimit të zgjedhjeve dhe kjo është një nga vështirësitë kryesore të Shqipërisë në rrugën drejt integrimit Evropian. Zgjedhjet parlamentare të 3 korrikut 2005 shënuan të parin ndryshim paqësor politik të ndodhur ndonjëherë në demokracinë e re të Shqipërisë. Pavarësisht problemeve të hasura në procesin zgjedhor rotacioni politik u krye i butë. Ardhja në pushtet e të djathtëve (pas tetë vitesh në opozitë) do të sillte zhvillime pozitive në drejtim të integrimit të vendit në strukturat euro-atlantike sidomos në mandatin e parë qeverisëse. Sjellja e pjekur e klasës politike pas zgjedhjeve ishte një nga arsyet kryesore që Bashkimi Evropian i ofroi

⁵⁴² BTI, 2008, fq2

⁵⁴³ Op cit “Njëzet vjet pas rënies së komunizmit: Reflektime për shtetin dhe demokracinë” AHS, Tiranë 2010 fq.18

Shqipërisë Marrëveshjen e Stabilizim – Asociimit, (pas afro tre vitesh nga hapja e negociatave) nënshkrimi i të cilës u bë më 12 qershor 2006 nga Sali Berisha⁵⁴⁴. Në drejtim të përshpejtimit të proceseve integruese në nivel ekzekutiv u krijua Ministria e Integritit e cila mori rolin qendror në zhvillimin e procesit të integritit të Shqipërisë në BE.

Për Berishën si kreu i ekzekutivit nënshkrimi i MSA-së nënkuptonte: *“...një punë shumë të madhe për tu bërë. Ka reforma shumë të thela, në të gjitha aspektet, si ato zgjedhore, reformat në fushën e drejtësisë, reformat në fushën e arsimit, reformat në fushën e ekonomisë... në dallim të qartë nga reformat e viteve '92 – '94, (këto reforma) nuk kërkojnë shtrëngimin e rripit, nuk kërkojnë asgjë tjetër veçse të zgjerojmë liritë dhe të drejtat e qytetarëve, të zgjerojmë lirinë e tregut, të përmirësojmë arsimin, shëndetësinë, infrastrukturën, shërbimet, të privatizojmë më tej ekonominë... reforma që realisht u shërbejnë shumë qytetarëve shqiptarë⁵⁴⁵”*. Rotacioni politik dhe nënshkrimi i MSA-së nuk u lexua ashtu siç duhej nga klasa politike.

Tabela 13. Zgjedhjet Parlamentare të Viti 2005.

Pjesëmarrja në votime	49.23%
Subjektet Politike	Nr/Deputetë
PD	56 deputetë
PSSH	42 deputetë
PR	11 deputetë
PSD	7 deputetë
LSI	5 deputetë
PDR	4 deputetë
PAA	4 deputetë
AD	3 deputetë
PBDNJ	2 deputetë
PDK	2 deputetë
PDSSH	2 deputetë
BLD	1 deputetë
I Pavarur	1 deputetë
Total	140 deputetë

Aktorët politikë përveç ndryshimit të pozicioneve të pushtetit nuk kishin ndryshuar mendësinë e të bërit politikë. Kështu sipas raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë në vitin 2006 ishte pikërisht ngërçi politik *Burimi: <http://www.cec.org.al/>* dhe bashkëpunimi i dobët midis palëve që *“pengoi punën e grupeve parlamentare për reformën zgjedhore dhe marrëveshjet e ngadalta politike vonuan emërimin e anëtarëve në Komisionin Qendror Zgjedhor⁵⁴⁶”*. Mungesa e bashkëpunimit midis aktorëve politikë vonoi punën si për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga OSBE – ODIHR dhe gjithashtu ajo tregoi një mungesë maturie politike pasi bashkëpunimi politik i arritur në gusht u realizua në sajë të ndihmës së komuniteti ndërkombëtar. Siç vë re dhe raporti, *“Shqipëria (klasa politike) duhet të demonstrojë se ka kapacitetet për të arritur një bashkëpunim politik pa ndërhyrjen e jashtme⁵⁴⁷”*.

Në kuadër të këtij angazhimi për vitin 2007 Komisioni Evropian i akordoi Shqipërisë një shumë totale prej 61 milionë EURO⁵⁴⁸. Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit hyri në fuqi

⁵⁴⁴ BTI, 2008, fq.2 onine: <http://www.bertelsmann-transformation-index.de/>

⁵⁴⁵ Intervistë e Sali Berishës në Sokol Balla fq. 72-73)

⁵⁴⁶ Progres Raporti 2006, fq. 5.

⁵⁴⁷ Ibid. (Progres Raporti 2006)

⁵⁴⁸ Shqipëria - Progres Raporti i 2007, fq. 4.

më 1 prill 2009, pas ratifikimit të saj nga 25 vendet anëtare të Unionit dhe miratimin e saj nga Kuvendi i Shqipërisë. Procesi i ratifikimit të MSA-së u krye në më pak se 3 vjet dhe u finalizua me ratifikimin e marrëveshjes nga parlamenti Grek në 15 Janar 2009, duke i hapur kështu rrugën Shqipërisë drejt aplikimit në BE për marrjen e statusit të vendit kandidat.

Një ngjarje tjetër e rëndësishme e ndodhur nën qeverisjen e demokratëve ishte dhe anëtarësimi i Shqipërisë në NATO në prill të vitit 2009. Po në të njëjtin muaj hyri në fuqi Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit.

Për kryeministrin Berisha anëtarësimi i vendit në NATO shënonte fundin e tranzicionit ja si shprehet ai: *“vendi është një vend anëtar i NATO-s, domethënë një vend krejtësisht tjetër. Pra, mbyllet kapitulli i tranzicionit dhe çeket një kapitull i ecjes së një rruge normale e ta quajmë, një rruge jo pa vështirësi sërish, por një rruge shumë të sigurt... Shqipërisë i shumëfishohen mundësitë e shpejtimit të zhvillimit... që të gjithë thonë se anëtarësimi i NATO-s ushtron një levë të fuqishme të shpejtimit të zhvillimit⁵⁴⁹”*. Pa vënë në diskutim rëndësinë që ka anëtarësimi i vendit në NATO, për Shqipërinë anëtarësimi në NATO nuk i dha fund tranzicionit politik. Zgjedhjet parlamentare të qershorit 2009 u kontestuan nga një numër partish me në krye Partinë Socialiste. Ato u bënë shkak për krizën e gjatë parlamentare, mungesën e bashkëpunimit midis forcave politike për një sërë reformash si dhe një varg incidentesh të rënda që kulmuan me vrasjen e katër protestuesve në 21 Janar 2011. Nëse faktori vendas dhe kryesisht opozita i cilësoi zgjedhjet të papranueshme, institucionet ndërkombëtare si OSBE/ODIHR i vlerësuan zgjedhjet e 29 qershorit *“si një përmirësim krahasuar me praktikën e mëparshme duke plotësuar shumicën e standardeve ndërkombëtare⁵⁵⁰”*. Pavarësisht arritjeve në lidhje me regjistrimin e votuesve dhe procesin e identifikimit, kuadrin ligjor, votimin, numërimin dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve zgjedhore, u identifikuan mangësi dhe probleme si pasojë e politizimit të procesit të numërimit dhe përgatitjes së tabelave përmbledhëse të rezultateve⁵⁵¹. Polemikën rreth zgjedhjeve midis aktorëve politikë vazhduan gjatë edhe si pasojë e interpretimeve jo objektive të raporteve, deklaratave të ndërkombëtarëve etj.

Rezultatet e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009 janë kontestuar fuqishëm dhe kanë qenë shkak i bojkotit dyvjeçar të parlamentit nga opozita. Gjatë kësaj kohe shumë reforma të rëndësishme që kërkuan miratim me shumicë të cilësuar nga Parlamenti nuk kanë mundur të miratohen pasi ka munguar konsensusi politik. Në vend të institucioneve të qëndrueshme dhe shumë kritereve të tjera që kërkoheshin për anëtarësim në BE, Shqipëria u përball me stanjacion politik, demonstrata popullore dhe përleshje të dhunshme. Një marrëveshje politike midis palëve u arrit në nëntor të 2011-ës, duke i dhënë kështu fund ngërçit politik të krijuar nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2009. Në këtë marrëveshje u miratua një plan dhe një kalendar për realizimin e reformës zgjedhore,

⁵⁴⁹ Intervista e S. Berishës në Sokol Balla, *“33, Tranzicioni në Intervistë”*, UET Press, Tiranë 2010, fq. 78.

⁵⁵⁰ Cituar në Raporti Analitik COM (2010) 680, Komisioni Evropian, Bruksel, 9 nëntor 2010, fq. 11.

⁵⁵¹ Ibid.

për përmirësimin e Rregullores së Kuvendit dhe për miratimin e ligjeve pezull që kërkonin shumicë të cilësuar. Sipas progres raportit të vitit 2012 “Procesi i punës për zbatimin e 12 prioriteteve kyçe ka qenë përfshirës në përgjithësi. Sidoqoftë, ka pasur periudha të shkurtra retorike konfrontuese ndërmjet qeverisë, opozitës dhe institucioneve të tjera shtetërore...⁵⁵². Pavarësisht përpjekjeve të maxhorancës qeverisëse, në mandatin e dytë nuk u arrit marrja e statusit të vendit kandidat. Në këtë drejtim procesi nuk pati arritje të mëtjshme.

Të dhënat e marra nga ‘The Economist’ në lidhje me indeksin e demokracisë tregojnë se tranzicioni politik në Shqipëri ende nuk ka përfunduar (shiko tabelën 14).

Tabela 14. Indeksi i demokracisë për Shqipërinë 2007 – 2012.

Kategoritë	Viti 2007 ⁵⁵³	Viti 2008 ⁵⁵⁴	Viti 2009	Viti 2010 ⁵⁵⁵	Viti 2011 ⁵⁵⁶	Viti 2012
Klasifikimi i Regjimit	Regjim Hibrid	Regjim Hibrid	-	Regjim Hibrid	Regjim Hibrid	Regjim Hibrid
Renditja	vendi i 83	vendi i 81	-	vendi i 84	vendi i 87	vendi i 90
Pikët e përgjithshme	5.91	5.91	-	5.86	5.81	5.67
Proceset elektorale dhe pluralizmi	7.33	7.33	-	7.42	7.00	7.00
Funksionimi i Qeverisë	5.07	5.07	-	5.07	4.71	4.00
Pjesëmarrja në politikë	4.44	4.44	-	4.44	5.00	5.00
Kultura Politike	5.63	5.63	-	5.00	5.00	5.00
Të drejtat e qytetarëve	7.06	7.06	-	7.35	7.35	7.35

Burimi: The Economist Intelligence Unit's index of democracy

Nga viti 2007 deri në vitin 2012 përsa i takon klasifikimit të regjimit Shqipëria mbetet “Regjim Hibrid”. Sipas përcaktimit të bërë nga “The Economist” vendet me regjim hibrid kanë probleme të mëdha me parregullsitë zgjedhore të cilat ndikojnë që zgjedhjet të mos jenë të lira dhe të ndershme. Presioni qeveritar mbi partitë e opozitës dhe kandidatët, mund të jetë shumë i përhapur si fenomen. Korrupsioni është shumë i përhapur dhe sundimi i ligjit konsiderohet i dobët. Gjithashtu edhe shoqëria civile mbetet e dobët. Tipike e këtyre regjimeve është trysnia mbi mediat dhe fakti që gjyqësori nuk është i pavarur.

Të dhëna flasin për një lloj gjendje në vendnumëro të Shqipërisë, që nënkupton se gjatë këtyre viteve nuk ka ndodhur ndonjë progres i qenësishëm por gjithashtu nuk ka ndodhur as ndonjë regres i demokracisë. Krahasuar me vendet e rajonit Shqipëria

⁵⁵² Progres Raporti, 2012, fq. 7.

⁵⁵³ The Economist Intelligence Unit's index of democracy, 2007, fq. 4. Sqarim: Botimi i parë i indeksit të demokracisë publikuar nga The Economist në rang botëror është realizuar në vitin 2007 dhe më pas vijojnë publikimet periodike.

⁵⁵⁴ Democracy Index, 2008, fq. 6.

⁵⁵⁵ The Economist, Democracy index, 2010, fq. 5.

⁵⁵⁶ Democracy index, 2011, fq. 6.

dhe Bosnja klasifikohen si regjime hibride ndërkohë vendet e tjera të Ballkanit klasifikohen si demokraci me të meta (*Flawed democracies*). Po sipas këtyre raporteve, gjatë këtyre viteve nga vendet e Evropës Shqipëria lë pas vetëm Bosnjen.

Gjithashtu të dhënat e marra nga organizata Freedom House konfirmojnë faktin që gjatë këtyre viteve Shqipëria qëndron në vendnumëro përse i përket statusit, vlerësimit të lirisë të të drejtave civile dhe politike (shiko tabelën 15).

Tabela 15. Të dhënat e organizatës Freedom House për Shqipërinë 2006-2013.

Viti	Statusi	Freedom Rating / Vlerësimi I Lirisë	Civil Liberties / të drejtat civile	Political Rights / të drejtat politike
2006	Partly free / pjesërisht i lirë	3	3	3
2007	Pjesërisht i lirë	3	3	3
2008	Pjesërisht i lirë	3	3	3
2009	Pjesërisht i lirë	3	3	3
2010	Pjesërisht i lirë	3	3	3
2011	Pjesërisht i lirë	3	3	3
2012	Pjesërisht i lirë	3	3	3
2013	Pjesërisht i lirë	3	3	3

Burimi: Raportet e Freedom House⁵⁵⁷ për Shqipërinë

Për sa i takon zhvillimeve ekonomike gjatë periudhës 2005-2010, indikatorët kryesorë makroekonomikë tregojnë që ekonomia shqiptare ka ecur me ritme pozitive. Ekonomia Shqiptare ia arriti të përballonte krizën botërore të vitit 2007, duke arritur një rritje prej 5.9% (shiko tabelën). Sipas raportit analitik të Komisionit Evropian “Hapja e moderuar e ekonomisë dhe niveli i ulët i integritimit të sistemit financiar në tregun global, së bashku me përqindjen e lartë që zë prodhimi bujqësor, edhe pse në rënie, bënë që ndikimi i krizës globale në Shqipëri të ishte i kufizuar. Politika makroekonomike ka qenë vendimtare në zbutjen e efekteve të krizës.

Nga viti 2000 deri në vitin 2008 rritja mesatare vjetore e PBB-së ishte pak mbi 6%, ndërsa filloi të ngadalësohej në 2009 e në vazhdim me një mesatare rreth 3%.

Tabela 16. Indikatorët kryesorë të zhvillimit makroekonomik (2005 – 2010).

	2005	2006	2007	2008	2009	2010
PBB në %	5.5	5.0	5.9	7.7	3.3	3.5
Inflacioni në % (CPI)	2.4	2.4	2.9	3.4	2.3	3.5
Papunësia në %	14.1	13.8	-	12.7	13.8 ₅₅₈	-
Borxhi publik % PBB	-	-	53.8	55.2	60.2	59.7

Burimi: Bertelsmann Transformation Index 2010, fq. 14 (të dhënat për vitet 2005-2006)

Bertelsmann Transformation Index 2012, fq. 15-16 (të dhënat për vitet 2007-2010)

⁵⁵⁷ Burimi online: <http://www.freedomhouse.org/report/freedom-world/2013/albania>

Ndryshon vetëm viti.

⁵⁵⁸ Shifër e marrë nga Raporti Analitik 2010, fq. 43.

4.5 Perspektiva e integritit të Shqipërisë në vazhdim

Për sa kohë që Bashkimi Evropian do të egzistojë, ai është një destinacion i pashmangshëm për Shqipërinë dhe Shqiptarët. Sot më shumë se dje mundësit për tu integruar janë më të mëdha. Gjenerata e politikanëve që sollën ndryshimet politike tashmë i përketë historisë. Përsa i takon maturisë së treguar nga forcat politike zgjedhjet e 23 qershorit 2013 ishin një shenjë e mirë. Pas rikthimit të kontestimeve zgjedhore në vitin 2009, pranimi i rezultatit nga forcat politike dhe rotacionit i butë i pushtetit në 2013 jep shpresë se gjërat po ecin në drejtimin e duhur. Rotacioni politik i 23 qershorit riktheu në pushtet pas tetë viteve qëndrim në opozitë koalicionin e majtë. Ardhja në pushtet e të majtëve në 23 qershor pati ndikim edhe në kampin e të djathtëve ku për shkak të humbjes së zgjedhjeve lideri i tyre historik Berisha dha dorëheqje nga posti i kryetarit të Partisë Demokratike.

Tashmë pas 23 vitesh në krye të dy forcave kryesore të vendit kemi dy liderë të rinj, që të dy të zgjedhur me parimin një anëtar një votë dhe që të dy kanë mundësinë që ti japin më shumë arritje Shqipërisë dhe Shqiptarëve. Ardhja e një figure të re në krye të PD-së është një lajm i mirë megjithëse edhe në këtë drejtim pra të largimit nga skena të lidereve historikë Shqipëria është përsëri vendi i fundit në Ballkan. Gjithashtu zgjedhjet e 23 qershorit rezultuan një lajm i mirë edhe për ndërkombëtarët, por pavarësisht kësaj në dhjetor të vitit 2013 Shqipëria për herë të tretë iu refuzua statusi i vendit kandidat ndërkohë që Serbia nisi bisedimet për anëtarësim. Përveç Hollandës, statusi i vendit kandidat u kundërshtua edhe nga 4 vende⁵⁵⁹ të tjera të Bashkimit Evropian. Ashtu siç ka deklaruar edhe Fule; *“Shqipëria ka bërë hapa impresivë përpara, sidomos reforma e integritit në shumë fusha, nga shtatori nuk ka shumë por qeveria dhe parlamenti i ri kanë treguar se kanë mundësi për të mbajtur një konsensus politik. Bëhet fjalë për konsensusin dhe siç e thashë në shënimet e mia është çështje kohe dhe Shqipëria është në rrugë të mbarë të vijojë me reformat dhe kjo çështje do zgjidhet në të ardhmen⁵⁶⁰”*.

BE-ja kërkon nga politika shqiptare më shumë angazhim në drejtim të reformave, më shumë rezultate dhe bashkëpunim në emër të integritit dhe zhvillimit në mënyrë që rezultatet të jenë të prekshme për të gjithë. Përsëri kthehemi në dorën e klasës politike, në varësi të asaj se çfarë rruge do të zgjedhë ajo, e nëse ajo zgjedh bashkëpunim atëhere vërtetë jemi një hap larg anëtarësimit.

⁵⁵⁹ Statusi u kundërshtuar nga Britania, Suedia, Franca dhe Gjermania

⁵⁶⁰ Op cit në: <http://mapo.al/2013/12/17/zhgenjehet-shqiperia-e-shtyn-statusin-per-ne-qershor-hap-negotiatat-serbine/>

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Shumë pyetjeve të ngritura në këtë studim mbi vështirësitë dhe vonesat e tranzicionit politik shqiptarë në rrugën e tij të integritit drejt BE-së jemi munduar ti trajtojmë dhe t'u japim përgjigje bazuar mbi analizën e klasës politike duke përfshirë edhe faktorët historik, ekonomik e social të këtij tranzicioni.

Sot pas 23 vitesh është e lehtë të konstatojmë se tranzicioni politik drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut për Shqipërinë dhe shqiptarët ka qenë tejet i vështirë. Shqipëria e nisi rrugën e saj drejt transformimit nga shembja e diktaturës më të egër dhe si vendi më i prapambetur dhe më i varfër në Evropë.

Në ndryshimet që përfshinë vendet ish-komuniste Shqipëria ishte vendi i fundit që rrëzoi komunizmin, deri në zgjedhjet e 22 marsit 1992 nomenklatura komuniste jo vetëm që ishte në pushtet por drejtoi vendin në fazën e hershme të tranzicionit. Pa mohuar revoltën qytetare dhe studentore, pluralizmi politik në Shqipëri erdhi si një produkt i elitës së vjetër qeverisëse gjithashtu edhe klasa politike e këtyre dy dekadave tranzicion rezultoi produkt i saj.

Zhvillimet e vështira në këto 20 vite tranzicion dhe rrugëtimit të mundimshëm drejt Bashkimit Evropian i atribuohen pa mëdyshje edhe trashëgimisë komuniste, sikundër, edhe gabimeve të bëra nga klasa politike e pas viteve '90.

Nga trashëgimia komuniste drejtuesit e rinj politikë morën një model të keq-qeverisës, një klasë burokratësh abuzues, të korruptuar e të papaftë, plagë të rënda shoqërore, një trashëgimi të mjerë politike, kulturore dhe vlerore.

Tranzicioni politik në Shqipëri nuk u shoqërua me një marrëveshjeje midis elitave politike (midis konservatorëve dhe të moderuarve për një paqe sociale në të mirë të vendit. Kjo është edhe një nga arsyet që konfliktualitetit politik dhe shoqëror sidomos në dekadën e parë të tranzicionit ka qënë shumë i lartë.

Që nga fillimi i tranzicionit, zhvillimet politike në vend pavarësisht spektrit janë shoqëruar pothuajse në mënyrë permanente me konflikte të mëdha qeveri – opozitë. Ky konflikt ka ndikuar jo vetëm në cilësinë e qeverisjes, por dhe në frenimin e përmbushjes së standardeve të BE-së. Rreth 90% e popullsisë shqiptare dëshiron arritjen e standardeve demokratike dhe anëtarësimin e vendit në BE. Në anën tjetër, kjo ëndërr shoqërohet me një realitet politik kundërshtues.

Destabiliteti i vazhdueshëm politik ka larguar partitë politike nga interesat e qytetarëve. Mungesa e alternativave reale në “tregun politik” ka rritur dukshëm krizën e përfaqësimit të shumë grupeve të shoqërisë.

Në Shqipërinë e këtyre 20 viteve tranzicion nuk ka munguar kapitullimi i shtetit si në vitin 1997, grushti shtetit në vitin 1998 dhe pretendimi nga disa për një tjetër të tillë në 21 janar të vitit 2011, kriza të vazhdueshme politike dhe lufta e ashpër për pushtet. Në tërësi, e gjithë kjo klimë politike ka patur në thelb deformimin e procesit zgjedhor dhe monopolizimin e tij nga forcat politike.

Ende sot, demokracia shqiptare mbetet një demokraci e dobët si nga funksionimi i procesit politik, ashtu edhe nga institucionalizimi i saj. Si ndërkombëtarët edhe shoqëria fajëson klasën politike për progresin shumë të vogël në zbatimin e reformave të kërkuara nga Komisioni Evropian.

Megjithë premisat pozitive që ka patur vendi në vitet e fundit për të hedhur hapa të mëtejshëm në drejtim të integritimit, nuk ka mjaftuar puna, përpjekjet dhe dëshira e shqiptarëve për integrim, madje as ndihma e dhënë nga Bashkimi Evropian që ky objektivi të arrihet të paktën në nivel të marrjes së statusit të vendit kandidat.

Për sa më lart duhet që aplikimi për anëtarësim në BE nuk duhet të kthehet në qëllim në vetvete, por të shërbejë si incentivë për përmbushjen e reformave të mirëfillta, të cilat kanë impakt në jetën e qytetarëve. Shqipëria duhet të demonstrojë përmes këtij procesi se është në gjendje të arrijë rezultate konkrete dhe jo vetëm të marrë angazhime që mbeten në letër. Për të patur rezultate në këtë drejtim duhet që vendi të ketë stabiliteti politik. Stabiliteti politik lidhet ngusht me zhvillimin e demokracisë ndaj rritja dhe fuqizimi i bashkëpunimit si brenda të majtës dhe të djathtës ashtu edhe ndërmjet tyre për zbatimin e një politike konstruktive dhe afatgjatë do ndikojë në ndërmarrjen, thellimin dhe përshpejtimin e reformave integruese. Respektimi i parimeve dhe normave demokratike si e vetmja mundësi për një bashkëpunim të vërtet dhe afatgjatë.

Po në këtë funksion nevojitet gjithashtu përmirësimi i demokracisë së brendëshme në partitë politike shqiptare, pasi ato janë institucione që u japin mundësinë për kandidim prurjeve të reja kaq shumë të domosdoshme për rigjenerimin e klasës politike në vend. Gjithashtu vazhdimi dhe përmirësimi i mekanizmit një antarë një votë rrit shancet për evidentimin e figurave meritokratike jo vetëm në strukturat partiake por edhe në ekzekutiv apo si pjesëtar të opozitës. Historia e vendeve më të përparuara dëshmon faktin se mirëorganizimi i partive politike, forcimi i demokracisë së tyre të brendëshme krijojnë bazë dhe besueshmëri për ndërtimin e një shteti demokratik gjithashtu.

BIBLIOGRAFIA

- Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, “*Historia e Shqipërisë, V.4, 1944-1975*”, 8 Nëntori, Tiranë, 1983.
- Alia Ramiz, Benakis Th., “*Duke biseduar për Shqipërinë*” Kurier Ekdotiki, Athinë.
- Alia Ramiz, “*Jeta Ime, Kujtime*”, Toena, Tiranë, 2010.
- Angjeli Anastas, “*Ditari i Tranzicionit Ekonomik*”, Toena & UMSH Press, Tiranë, 2013.
- Arendt Hannah, “*Origjinat e totalitarizmit*”, DIJA, Prishtinë, 2002.
- Bakui A. Gazmend, “*Shqipëria Politike*”, Pegi, Tiranë, 2010.
- Balla Sokol, “*33, Tranzicioni në Intervistë*”, UET Press, Tiranë, 2010.
- Bashkimi Europian, QNK “*Arbnori*” Tiranë, 2010
- Baze Mero, “*Viti ‘97 Prapaskenat e krizës që rrënuan shtetin*”, Toena , Tiranë, 2010
- Beetham David, Boyle Kevin, “*Demokracia: 80 Pyetje dhe Përgjigje*”, Dita, Tiranë, 2001.
- Biberaj Elez, “*Shqipëria në tranzicion, Rruga e vështirë drejtë demokracisë 1990-2010*”, AIIS, Tiranë, 2011.
- Borçard, Diter -Klaus, “*ABC – ja e të Drejtës të Bashkimit Evropian*”, Bashkimi Evropian, 2010
- Bogdani Mirela, Loughlin John, “*Shqipëria dhe Bashkimi Europian, Integrimi Europian dhe Prespektiva e Pranimit*” Dajti, Tiranë 2004
- Braudel Fernand, “*Gramatikë e qytetërimeve*”, SHL&K, Tiranë, 2005
- Bravo Gian Mario, Malandrino Corrado “*Il pensiero politico del novecento*”, PIEMME, 1994
- Brzhezinski Zbigniev, “*Jashtë Kontrollit, trazira që përfshiu botën në prag të shekullit XXI*”, Elena Gjika, Tiranë, 1995.
- Bufi Ylli, “*Tempulli i demokracisë*”, Ombra GVG, Tiranë, 2010.
- Cabanes Pierre, etj “*Historia e Adriatikut*”, SHL&K, Tiranë, 2005.
- Çejku Arben, “*Demokracia e Imponuar; esse*”, Mbrothësia, Tiranë, 2000.
- Dahrendorf Ralf, “*Konflikti shoqëror modern, ese për politikën e lirisë*” Dituria, Tiranë, 1997
- Dahl Robert, “*Poliarkia Pjesëmarrja dhe Opozita*”, Pegi, Tiranë, 2005
- Dawisha Karen and Parrott Bruce (editor) “*Politics, Power, and the Struggle for Democracy in South-East Europe*”, Cambridge University press, second edition, 1999.
- Dedej Arjan..., etj, “*Hyrje në Shkenca Politike*”, Durrës, 2011.
- Dervishi Kastriot, “*Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*” Sh.B 55, Tiranë, 2006.
- Duka Valentina, “*Histori e Shqipërisë 1912-200*”, Kristalina-KH, Tiranë, 2007.
- Elezi Ismet, “*Me syrin e një juristi 20 vjet të qeverisjes moniste*”, Toena, Tiranë, 2004
- Etzioni-Halevy Eva, “*Klasat dhe Elitat në Demokraci dhe në Demokratizim : lexime të zgjedhura*”, Botimet Dudaj, Tiranë, 2009
- Fevziu Blendi, “*Piedestale pa statuja, 8 dhjetor 1990-31 mars 1991*”, UET Press, Tiranë

Fevziu Blendi, “100 Vjet (1912-2012)”, UET Press, Tiranë, 2012

Filo Llambro, “*Historia për sistemet e qeverisjes*”, EXTRA, Tiranë, 2005

Fischer Bernd J., “*Shqipëria gjatë luftës, 1939-1945*”, Cabej, Tiranë, 1999.

Fuga Artan, “*Shtigje drejt Guvës së Gjarprit*”, Botimet Ora, Tiranë, 2004.

Gadeshi Ilir, Mara Hekuran, “*Emigrimi i Elitës intelektuale nga Shqipëria gjatë periudhës së tranzicionit*” Luarasi, Tiranë, 1999

Gilpin Robert, “*Ekonomia Politike Globale; Kuptimi i rendit ekonomik ndërkombëtar*”, ISP&Dita2000, Tiranë, 2009

Glenny Misha, “*Historia e ballkanit 1804-1999*” Toena, Tiranë, 2007

Gjeçovi Xhelal, Milo Paskal..., “*Historia e popullit Shqiptar, IV Shqiptarët gjatë luftës së dytë botërore dhe pas saj 1939-1990*”, Toena, Tiranë

Gjilas Milovan, “*Fytyra e Totalitarizmit*”, Fan Noli, Tiranë, 2006

Gjilas Milovan, “*Shoqëri e Papërsosur*”, Fan Noli, Tiranë, 2008

Haerpfer Christian W., “*Democracy and Enlargement in Post-Communist Europe, The democratisation of the general public in fifteen Central and Eastern European countries, 1991–1998*” Routledge, London and New York, 2002.

Heywood Andrew, “*Politika*”, Dudaj, Tiranë, 2008

Hungington Samuel, “*Vala e trete*”, AIIS, Tiranë, 2011.

Kadare Ismail, dhe të tjerë, “*Ballkani i Jugut: Perspektiva nga Rajoni*” Onufri, Tiranë 2001

Kagan Robert, “*Rikthimi i historisë dhe fundi i ëndrrave*”, Dudaj, Tiranë, 2008.

Kaltsounis Theodore, “*The Democratization of Albania*”, Palgrave Macmillan, New York, 2010

Krasniqi Afrim, “*Fundi i Siberisë Shqiptare*”, Albin, Tiranë 1998.

Krasniqi Afrim, “*Partitë Politike në Shqipëri, (1920 - 2006)*”, EDLOR, Tiranë, 2006

Krasniqi Afrim, “*Partitë Politike dhe Sistemet Politike*”, Ilar, Tiranë, 2008.

Kushtetuta dhe material shpjeguese, Dhjetor 1998, Tiranë, QAKAPP

Lawrence Mayer C., Burnett John H., “*Politikat Krahasuese kombet dhe teoritë në një botë që ndryshon*”. Ora, Tiranë, 2003

Lefort Claude, “*Demokracia dhe Totalitarizmi*”, Pejë, Dukagjini, 1994.

Lijphart Arend, “*Le democrazie contemporanee*”, Il Mulino, Bologna, 2001.

Lipset Seymour Martin, “*Political Man: The Social Bases of Politics*”, Doubleday & Company, inc., Garden City, New York, 1960.

Lory Bernard, “*Europa Ballkanike; nga 1945 në ditët tona*”, Dituria, Tiranë 2007.

Meksi Aleksandër, “*Dhjetor '90 Dokumente dhe Materiale*”, UET Press, Tiranë, 2010.

Meksi Sofokli, “*Mbi disa aspekte të trashëgimisë totalitare gjatë periudhës së tranzicionit shqiptar*” Tiranë Jehona, 2008.

Meidani Rexhep, “*Kushtetuta: Bilanci dhe prespektiva*”, Toena, Tiranë, 2009.

Mezini Adem, “*Shekulli XX*”, EXTRA-R, Tiranë, 2010.

Michels Robert, “*Political parties*”, Free Press Glencoe, 1915, (ribotim 1958)

Millon-Delsol Chantal, *“Idetë Politike në shekullin XX”*, Onufri, Tiranë, 2006.

Morozzo Della Rocca Roberto, *“Shqipëria Rrënjët e Krizës”*, Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, Tiranë, 2000

Musta Agim, *“Libri i zi i komunizmit shqiptar”*, Naim Frashëri, Tiranë, 2007.

Ngjela Spartak, *“Reformë Shqiptare, shmangia e karakterit tiranik të politikës”*, MNS, Tiranë, 2006.

Ngjela Spartak, *“Përkulja dhe Rënia e Tiranisë Shqiptare 1957-2010”*, Vol. 1, UET Press, Tiranë, 2011

Pano Nikolla, *“Albania”* në The Columbia History of Eastern Europe in the twentieth century, The Columbia University Press, New York, 1991

Parry Geraint, *“Elitat Politike”*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2010.

Pettifer James, Vickers Miranda, *“Çështja Shqiptare, Riformësimi i Ballkanit”*, Bota Shqiptare & Edicioni i “Librit”, Tiranë – New York, 2007.

Pëllumbi Servet, *“Dritëhije të tranzicionit”*, Rinia 2000, Tiranë, 2000

Pipa Arshi, *“Stalinizmi Shqiptar”*, IKK&Princi, Tiranë, 2007.

Pipes Richard, *“Komunizmi, Historik i shkurtër”*, Gjergj Fishta, Tiranë, 2002.

Popper Karl, *“Mendime për historinë dhe politikën: referat dhe punime të përzgjedhura”*, Plejad, Tiranë, 2011.

Rama Shinasi A., *“Probleme Politike Shqiptare 1”*, ISKSH, Shkodër, 2006

Rama Shinasi A., *“Përrallat e tranzicionit Shqiptar”*, Botimet Princ, Tiranë, 2012.

Rothschild Joseph, *“Kthim në diversitet”*, Onufri, Tiranë, 1998.

Sartori Giovanni, *“Ç’është Demokracia”*, Dituria, Tiranë, 1998

Sartori Giovanni, *“Edhe njëherë për teorinë e demokracisë”*, Dituria, Tiranë, 1998.

Schmidt G. Manfred, *“Teoritë e Demokracisë”*, Botart, Tiranë, 2012.

Schumpeter A. Joseph, *“Capitalism, Socialism and Democracy”*, Routledge, London and New York, (published in the Taylor & Francis e-Library), 2003.

Stefani Andrea, *“Konspiracioni Kunder Lirise: Shqipëria nga Diktatura ne Demokracine Bolshevike”*, Tirana: Onufri. 2011

Sulstarova Enis, *“Ligjërimi Nacionalist në Shqipëri”*, Afërdita, Tiranë, 2003

Sharp Gene, *“Nga diktatura në demokraci”*, ShB: Pika pa Sipërfaqe, Tiranë, 2012

Tokevil De, Aleksi *“Demokracia në Amerikë”*, Botoi Kristalina-KH, Tiranë, 2002.

Vajdenfeld Verner, *“Demokracia dhe Ekonomia e Tregut në Europën Lindore”*, L&M/Soros, Tiranë, 1999.

Vickers Miranda, *“Shqiptarët një histori modern”*, Bota Shqiptare, Tiranë, 2008

Wolchik Sharon L., Curry Jane L. *“Central and East European politics: from communism to democracy”* Rowman & Littlefield Publishers, UK, 2011.

Zajmi Iva, *“E drejta Europiane”*, Tiranë 2010

Artikuj Shkencorë

- Arias-King Fredo, “*The centrality of elites*”, Demokratizatsiya, winter, 2003.
- Austin C. Robert, “*Fillime të para dhe të dyta: Shqipëria pas Luftës së Parë Botërore dhe komunizmit*”, “*Shqipëria në dhjetë vitet e ardhshme –vështrim drejt së ardhmes*” botim i AIIS, Tiranë 2012
- Brownlee Jason, “*Authoritarianism after 1989; From regime types to transnational processes*”, Harvard International Review, Winter 2010
- Cani Shkëlqim, Hadëri Sulo, “*Sistemi Financiar Shqiptar në Tranzicion: Progres apo brishtësi?*”, Banka e Shqipërisë në dekadën e dytë të tranzicionit.
- Carothers Thomas, “*The end of the transition paradigm*”, Journal of Democracy, January 2002, volume13, Number 1
- Carothers Thomas, “*How Democracies Emerge*” Journal of Democracy, January 2007, Volume 18, Number 1
- Elbasani Arolda, “*Albania in Transition: Manipulation or Appropriation of International Norms?*”, Southeast European Politics Vol. V, No. 1, June 2004
- Grabbe Heather, “*Europeanisation Goes East: Power and Uncertainty in the EU Accession Process*” The Politics of Europeanisation, Oxford: Oxford University Press. 2002 (Chapter to appear in K. Featherstone and C. Radaelli (eds.)
- Gumbell Andrew, “*Regjim gangsterësh që ne financojmë*” The Independent 14 shkurt 1997, botuar në Revista Përpjekja, Nr.11-12, Tiranë shtator – dhjetor, 1997
- Harvard International Review, Winter, 2010
- Heredia Mariana, Kirtchik Olesia, “*Comparing Post-Soviet and Latin American Societies: From “Transition” to “Transformation”*”, Laboratorium, Vol.2 No.3, 2010. ISP&Dita2000, Tiranë, 2009
- Hughes James ..etj “*Conditionality and Compliance in the EU’s Eastward Enlargement: Regional Policy and the Reform of Sub-national Government*”, JCMS 2004, Volume 42. Number 3.
- Jacques Ranciere, “*Demokracia, Republika, Përfaqësimi*”, Polis 4
- Jason Brownlee, “*Authoritarianism after 1989; From regime types to transnational processes*”,
- Kajsiu Blendi, “*Vdekje Politikës, Liri Popullit!-Kriza e Përfaqësimit në Shqipëri*”, Revista Polis nr. 5
- Kajsiu Blendi “*Demokratizim pa politikë: Baza konceptuale e qasjes ndërkombëtare në Shqipëri*”
- Lubonja Fatos, “*Tranzicion apo Kalbëzim*” në “*Tranzicione në Pasqyrë, Një përjasje e krahasuar e proceseve të transformimit demokratik të Spanjës dhe Shqipërisë*” Ciencias y humanismo
- Lleshi Sokol, “*Shqipëria ose Evropianizimi i vështirë*”, Revista Polis, Nr.4

Meksi Ermelinda, Pasha Auron “*Kur mbaron Tranzicioni? Teoria kundrejt realitetit në Shqipëri*”

Mezini Adem, “Si ta përcaktojmë shekullin XX?” Sfidë Nr.5 Viti IV I botimit Vjeshtë 2005-Dimër 2006.

Misha Piro, “*Roli i trashëgimisë historike në tranzicionin pas-komunist Shqiptar*” në “*Tranzicione në Pasqyrë, Një përjasje e krahasuar e proceseve të transformimit demokratik të Spanjës dhe Shqipërisë*” Ciencias y humanismo

Muço Marta, “*Economic transition in Albania: political constraints and mentality barriers*”, NATO Individual Fellowship Program 1995-1997, June, 1997

Offe Claus, “*Capitalism by Democratic Design? Democratic Theory Facing the Triple Transition in East Central Europe*”, Social research Vol. 71: No 3: Fall 2004

“Southern Europe, Eastern Europe, and comparative politics”,(anonymous) World Affairs, Vol.164, No.4 spring 2002.

Rustow Dankwart A., “*Transitions to Democracy: Toward a Dynamic Model*”, Comparative Politics, Vol. 2, No.3 (Apr., 1970)

Vehbiu A., “Obsesioni ynë me origjinën”, *Roli i miteve në historinë e shqipërisë*, Revista Përpjekja, Nr.15-16 Janar-Dhjetor, 1999.

Vyshka Gentian, “(De)Komunizmi: Aktualitet dhe Histori”, *Dekomunizmi: Aktualitet dhe Histori*, ASHRT, Nr. 4, 2004.

Studime dhe Raporte

AIIS, “*Forcimi i Demokracisë së Brendëshme të Partive në Shqipëri*”, Tiranë, 2007.

AIIS, “*Njëzet vjet pas rënies së komunizmit: Reflektime për shtetin dhe demokracinë*”, Tiranë 2010.

AIIS, “*Perspektiva Evropiane e Shqipërisë, perceptime dhe realitete*”, Tiranë, 2010.

AIIS, “*Shqipëria njëzet vjet pas rënies së komunizmit: Reflektime për shtetin dhe demokracinë*”, Tiranë, 2011.

AIIS, Forcimi i Demokracisë.

“*Aktorët negociues, aftësitë dhe teknikat negociuese dhe lobizimi me BE në kuadrin e MSA. Monitorimi i procesit të angazhimeve të mara.*” Përgatitur nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike.

Bertelsmann Transformation Index Albania vitet: 2003, 2006, 2008, 2010, 2012

Buletini Informativ “*Rritja e rolit të Parlamentit në procesin e integritimit përmes pjesëmarrjes legjislative dhe transparences*”, Nr.1, Dhjetor 2011.

Buletin Informativ me titull, “*Rritja e rolit të Parlamentit në procesin e integritimit përmes pjesëmarrjes legjislative dhe transparences*”, Nr. 2, Mars 2012.

Buletin Informativ me titull “*Rritja e rolit të Parlamentit në procesin e integritimit përmes pjesëmarrjes legjislative dhe transparences*”, Nr. 3, Qershor 2012.

Commission Opinion “Albania's application for membership of the European Union”, European Commission Brussels, 9.11. 2010.

“*Dekomunizmi: Aktualitet dhe Histori*”, ASHRT, Nr. 4, 2004.

Demokratizatsiya, Winter 2003

European Bank for Reconstruction and Development, “*Transition Report 1999, Ten years of transition*”, 9 Nov 1999.

Fletorja Zyrtare, Nr.2, (maj 1992)

Gallup, Balkan Monitor, Insights and Perceptions, Voices of the Balkans, 2008 Summary of Findings.

Gallup, Balkan Monitor, Insights and Perceptions, Voices of the Balkans, 2009 Summary of Findings.

Gallup, Balkan Monitor, Insights and Perceptions, Voices of the Balkans, 2010 Summary of Findings.

Human Rights Watch, “*Human Rights in Post-Communist Albania*”, raport, New York, March 1996

Human Rights in Post-Communist Albania, raport.

Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi, ““Korrupsioni në Shqipëri, Perceptime dhe Përvoja, Sondazhi 2010”

IRI, *Observation Report on the Albanian Parliamentary Elections of May 26, 1996*

“*Manuali Informativ mbi Institucionet Shqiptare*”, European Movement in Albania, Tiranë, Shkurt 2010

“*Manuali i Procesit të Integritimit Evropian, Roli dhe rëndësia e institucioneve*”, European Movement in Albania, Tiranë, Shkurt 2009.

Minxhozi Skender , “Europa? E pse na duhet?! A ka vend për të dyshuar për procesin e integritimit tonë në BE? Ja si përgjigjen katër euroskeptikë”, Revista Java burimi online: <http://www.revistajava.al/kryesore-ne-kopertine/2012213/europa-e-pse-na-duhet>

Progres Raporti Shqipëria, KE, 2004.

“*Shqipëria, Progres Raporti 2005*”, Komisioni Evropian Bruksel, 9 nëntor 2005.

Progres Raporti Shqipëria, KE, 2006

Progres Raporti Shqipëria, KE, 2007

Progres Raporti Shqipëria, KE, 2012

“*Korrupsioni në Shqipëri, Perceptime dhe Përvoja, Sondazhi 2010*”, studim, Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi, 2010.

Strategjia e Zgjerimit 2005, Komisioni Evropian, Brussels, 9.11.2005

Raporti Analitik COM (2010)680, Komisioni Evropian, Bruksel, 9 nëntor 2010

Raporti i Stabilizim Asocimit 2003.

Raporti i Stabilizim Asocimit 2004.

Revista “Diskutime”, Vitit I, Nr 1-2, Nëntor, 2012

Revista Perpjekja, “*Roli i miteve në historinë e shqipërisë*”, , Nr 15-16 Janar-dhjetor, 1999.

Revista Përpyjekja, Nr.11-12, Tiranë Shtator – Dhjetor 1997.
Revista Polis Nr.4
Revista Polis, Nr.5/2008
Tranzicione në Pasqyrë, “Një përjasje e krahasuar e proceseve të transformimit demokratik të Spanjës dhe Shqipërisë”, Ciencias y humanismo
The Economist Intelligence Unit’s index of democracy, 2007
Democracy Index, 2008.
The Economist, Democracy index, 2010.
Democracy index, 2011.
Vjetari Statistikor I R.P.S. TË SHQIPËRISË, Tiranë, 1989.
Vjetari Statistikor 1991/1999, INSTAT, botim i 2002-it
Vjetari Statistikor 1998-2007, INSTAT, Tiranë, 2009

Botime periodike

Gazeta “Zëri i Popullit”, 25 janar 1990.
Gazeta: Zëri i Populli, e merkurë 8.09.1999.
Gazeta Shqiptare, 5, Nëntor, 2006
Gazeta Shqiptare. 16 prill 2008.
Gazeta Shqiptare, 17 prill 2008.
Gazeta Shqiptare, 18 prill 2008
Gazeta “Rilindja Demokratike”, 5 Janar 1991.
Gazeta “Rilindja Demokratike”, E premte 26 nëntor 1993,
Gazeta “Shekulli”, 2 maj 2008.
Intervista e z. Stefano Sannino (Zv.drejtori i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme për Marrëdhënie me Jashtë të Komisionit Europian) Radio “Deutsche Welle” dt.13.10.2011


Burime online

<http://www.cec.org.al/>
<http://www.ama-news.al/2011/10/fisher-bllokimi-i-integrimit-vjen-nga-mungesa-e-kultures-politike/>
<http://www.bankofalbania.org>
http://europa.eu/legislation_summaries/glossary/accession_criteria_copenhagen_en.htm
http://pdc.ceu.hu/archive/00002096/01/dec_2003_V_Kuko.pdf
http://www.march.es/ceacs/publicaciones/working/archivos/1998_118.pdf
<http://www.ceses.cuni.cz/CESES-141-version1>
[2_1_Olsen_The_many_faces_of_Europeanization_2001.pdf](http://www.ceses.cuni.cz/CESES-141-version1)


<http://www.punetejashtme.gov.al/al/misioni/integrimi-ne-be/marredheniet-shqiperi-be>
<http://www.em-al.org/?fq=artikuj&gj=gj1&bir=26>,
<http://revistapolis.com/polis/images/stories/Polis%204/Blendi%20Kajsiu.pdf>
<http://shqiperiadhebe.blogspot.com/p/mardheniet-shqiperi-be.html>
<http://www.mie.gov.al/>
<http://www.britannica.com/EBchecked/topic/15352/Ramiz-Alia>
<http://www.revistadrini.com/2013/10/pirro-prifti-a-eshte-demokracia-shqiptare-nje-peng-i-katovices>
<http://www.freedomhouse.org/report/freedom-world/1999/albania>
<http://www.freedomhouse.org/report/freedom-world/2005/albania>
<http://www.freedomhouse.org/report/freedom-world/2013/albania>
www.ascdp.org
http://www.ab.gov.tr/files/ardb/evt/1_avrupa_birligi/1_6_raporlar/1_4_eurobarometers/CENTRAL_AND_EASTERN_EUROBAROMETER_PUBLIC_OPINION_AND_THE_EUROPEAN_UNION_19_COUNTRIES_SURVEY_March_1996.pdf
<http://mapo.al/2013/06/17/ngjela-biseda-me-azem-hajdarin-per-kushtetuten-e-vitit-1994/>
<http://www.mie.gov.al/>
http://eeas.europa.eu/delegations/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/documents/more_info/publications/abc_of_european_laë_sq.pdf
<http://mapo.al/2013/12/17/zhgenjehet-shqiperia-e-shtyn-statusin-per-ne-qershor-hap-negociatat-serbine/>
Transparency International Corruption Perceptions Index 2002,
http://archive.transparency.org/policy_research/surveys_indices/cpi/2002
Transparency International Corruption Perceptions Index 2003,
http://archive.transparency.org/policy_research/surveys_indices/cpi/2003
Transparency International Corruption Perceptions Index 2004,
http://archive.transparency.org/policy_research/surveys_indices/cpi/2004
Transparency International Corruption Perceptions Index 2005, online
http://archive.transparency.org/policy_research/surveys_indices/cpi/2005
The Economist Intelligence Unit's, Democracy Index, 2007 burimi online:
http://www.economist.com/mediapdf/DEMOCRACY_INDEX_2007_v3.pdf

7. Aneksi A.


Grafiku 1. Bertessmann Transformation Index 2003



Grafiku 2. Bertessmann Transformation Index 2006-2008



Grafiku 3. Bertessmann Transformation Index 2010-2012



Tranzicioni Politik dhe Roli i tij në Marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Evropian

Abstrakt

Tranzicioni politik drejt një demokracie të konsoliduar ka rëndësi të madhe jo vetëm për ndërtimin e shtetit funksional dhe për garantimin e përfitimeve politike e shoqërore për të gjithë qytetarët e vendit, por mbi të gjitha sepse është pikërisht demokracia e konsoliduar rruga e vetme drejt integritit dhe anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Ky punim ka në qendër një analizë të thelluar të tranzicionit politik të këtyre dy dekadave, duke iu qasur atij që nga perspektiva historike e gjysmëshekullit të kaluar e deri tek ajo politike e social-politike aktuale. Qëllimi i këtij punimi është: *studimi objektiv i rolit që luajti dhe vijon të luajë klasa politike shqiptare në realizimin me sukses ose jo të tranzicionit politik, si dhe ndikimi i saj në proceset integruese të vendit në Bashkimin Evropian.*

Punimi përpiqet të japë një këndvështrim të ri në shpjegimin e rrugës së tranzicionit që paraqet *rasti shqiptar*, duke vendosur si variabla shpjegues të këtij tranzicioni elementët lokalë. Faktori politik vlerësohet nga autori si një variabël predominues në zhvillimet e shumë sektorëve të sferës politike, ekonomike dhe sociale. Studimi trajton ndikimin konkret të klasës politike në proceset tranzitore dhe ndikimin e saj në rrugën e vendit drejt BE-së. Punimi i përmbahet hipotezës se: *Politika dhe institucionet e saj janë përgjegjëse për reformat e pamjaftueshme dhe për ritmin e ulët të ndryshimit të arritur në vend deri tani.* Nga hulumtimi, të dhënat statistikore dhe nga analizat e bëra nga autori dhe ato që janë përzgjedhur nga studiues të tjerë me kontribut në këtë spektër studimor, rezulton se proceset e tranzicionit dhe integrimi i Shqipërisë në BE kanë qenë dy procese që janë zhvilluar njëkohësisht dhe duke u ndërthurur në mënyrë të ndërlikuar mes tyre.

Punimi arrin në përfundimin se demokratizimi i mëtejshëm dhe procesi i integritit varen në një masë të konsiderueshme, pikërisht, nga klasa politike, reformimi i të cilës konsiderohet vendimtar për zhvillimin e vendit me ritme dhe hapa të shpejta drejt familjes evropiane.

Fjalë kyçe: Tranzicion politik, Klasë politike, Integrim, Bashkim Evropian, Demokraci

The Political Transition and its Role in the Relationships between Albania and the European Union.

The political transition toward a solid democratic system is essential not only to build an effective and functional state, and therefore to guarantee political and social benefits for all citizens of the country. Above all the democratic system represents the way towards integration and membership in the European Union. The present doctoral thesis aims to analyze the political transition of the last two decades in Albania.

The aim of this research is to offer an objective analysis of the role that the Albanian political elite has in the process of political transition and its impact on the integration process in the European Union.

The explanatory variables of the process of transition are based on the political actors, which are considered the predominant factors that determined the whole process. Consequently, the political factor – especially the political elite- influences the development of many sectors of the political, economic and social sphere.

This research gives arguments to support the thesis that Albanian politics and its institutions are the principal responsible party for the insufficient and ineffective reforms that have taken place in the country for more than 2 decades and that caused either stagnation or regress in the process of democratization. As a result the long transition process on one hand and the integration processes on the other have developed simultaneously and are intertwined in a complex way.

This thesis concludes that the success of the democratization and integration process of Albania depends on a large scale on the political elite of this country. The most important reforms are closely connected to the elite and only subsequently there will be a concrete and evident progress in the integration process.

Key words: Political transition, Political class, Integration, European Union, Democracy